



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**DOKTORATË**

**ZHVILLIMET POLITIKO - ARSIMORE NË TREVËN E**

**ELBASANIT NË VITET 1878-1914**

**Disertanti**

**Majlinda PEZA**

**Udhëheqës shkencor**

**Prof. dr. Liman VAROSHI**

**Tiranë, 2014**

**DISERTACION**

**PËRGATITUR NGA MAJLINDA PEZA PËR MBROJTJEN  
E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR I SHKENCAVE HISTORIKE”**

**ZHVILLIMET POLITIKO - ARSIMORE NË TREVËN E ELBASANIT NË  
VITET 1878 – 1914**

**UDHËHEQËS SHKENCOR PROF. DR. LIMAN VAROSHI**

**Mbrohet më, ..... përpara jurisë**

- 1. ----- (Kryetar)**
- 2. ----- (anëtar)**
- 3. ----- (anëtar)**
- 4. ----- (anëtar)**
- 5. ----- (anëtar)**

## **PASQYRA E LËNDËS**

<b>PARATHËNIE</b>	<b>V</b>
<b>HYRJE</b>	<b>XII</b>
<b>KREU I: LËVIZJA POLITIKO - ARSIMORE NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1878 – 1908</b>	<b>1</b>
<b>I. 1.</b> Veprimtaria e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Elbasan	1
<b>I. 2.</b> Komiteti i fshehtë e Manastirit, dega e Elbasanit	17
<b>I. 3.</b> Tipare të lëvizjes arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1908	22
<b>I. 4.</b> Shkollat e huaja në Elbasan dhe mësimi i gjuhës shqipe në to	37
<b>KREU II: TIPARE TË LËVIZJES ARSIMORE-KULTURORE NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1908-1910</b>	<b>41</b>
<b>II. 1.</b> Klubet patriotike shqiptare në Elbasan dhe produktet e tyre intelektuale	41
<b>II. 2.</b> Shoqëritë kulturore në Elbasan dhe aktiviteti i tyre	70
<b>II. 3.</b> Kongresi Kombëtar i Elbasanit dhe vendimet e tij	80
<b>II. 4.</b> Normalja e Elbasanit dhe problemet arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1910-1912	93
<b>KREU III: LËVIZJA E ARMATOSUR NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1911-1912</b>	<b>118</b>
<b>III. 1.</b> Kryengritja e vitit 1911 dhe Elbasani	118
<b>III. 2.</b> Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 në trevën e Elbasanit	126
<b>III. 3.</b> Shpallja e pavarësisë dhe ngritja e flamurit në Elbasan	148
<b>III. 4.</b> Elbasani dhe Kuvendi i Vlorës	162

<b>KREU IV: ELBASANI DHE QEVERIA E VLORËS</b>	<b>167</b>
<b>IV. 1.</b> Prefektura e Elbasanit dhe qeveria e Ismail Qemalit	167
<b>IV. 2.</b> Elbasani dhe kryengritja antiserbe e Dibrës e vitit 1913	179
<b>IV. 3.</b> Zhvillimet politike në Elbasan në vitet 1913-1914	195
<b>IV. 4.</b> Arsimi në Elbasan në vitet 1913-1914	213
<b>PËRFUNDIME</b>	220
<b>BIBLIOGRAFIA</b>	227
<b>SHTOJCA</b>	233

## **PARATHËNIE**

*Studimi: "ZHVILLIMET POLITIKO - ARSIMORE NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1878-1914" priret që në mënyrë objektive të evidentojë, por njëkohësisht dhe të promovojë, tiparet më karakteristike të veprimtarisë patriotike, intelektuale, arsimore e kulturore të trevës së Elbasanit në një diapazon rigorozisht të përcaktuar, që shtrihet nga 30 vitet e fundit të shek. XIX deri në vitet e para të dekadës së dytë të shek. XX. Ky punim është fryt i një pune disavjeçare në kuadrin e kërkesave që shtrohen sot para studiuesve shqiptarë për rishkrimin e historisë së popullit shqiptar në dritën e burimeve të reja arkivore. Kjo përbën edhe motivin bazë në iniciativën e ndërmarrë për të ndriçuar sadopak atë pjesë të historikut të trevës së Elbasanit në periudhën e viteve 1878-1914, si pjesë integrale e historisë kombëtare.*

*Për Elbasanin është shkruar shumë nga studiuesit dhe historianët, përmes punimeve që konsiderohen me vlera të rëndësishme studimi, por një pjesë e tyre më së shumti përfaqësojnë edhe kumtesa apo referate të shkëputura të cilat janë botuar para viteve '90, kohë kur edhe burimet arkivore, sikurse dihet kanë qenë tepër të kufizuara. Ndërkohë, në analizën e bërë artikujve apo studimeve për Elbasanin, duke i parë ato në kontekstin krahasues me burime arkivore vendase por dhe të huaja, jemi përballur me probleme të natyrave të ndryshme, që në jo pak raste karakterizohen nga mungesa e sinkronizimit të fakteve historike apo dhe interpretime subjektive dhe të njëanshme. Probleme të një natyre të tillë kanë nevojë për një rishikim dhe rivlerësim të ri, që përbën një motiv më tepër për ndërmarrjen e një nisme të tillë për tu përfaqësuar me një punim shkencor më të plotë për trevën e Elbasanit.*

*Ky punim trajton dhe analizon problemet e sipërpërmendura në një hapësirë të përcaktuar kohore, në të cilën gjen pasqyrim të gjerë një problematikë që fillon pikërisht me ngjarjen më të rëndësishme të fund shek. XIX, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe përfundon me ngjarjen më të rëndësishme të shek. XX, Shpalljen e Pavarësisë, krijimin e shtetit shqiptar deri në largimin e Ismail Qemalit nga Shqipëria në janar të vitit 1914.*

*Parë në këtë këndvështrim, në procesin e hulumtimit shkencor jemi mbështetur në metodologjinë e njohjes dhe vlerësimit të materialeve dhe dokumenteve historike ekzistuese në kuadrin e përjasjeve me burime arkivore vendase dhe të huaja, duke patur si kriter kryesor vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre. Në këtë kuadër, në qëndrimet dhe interpretimet e parashtruara për problematikat e pasqyruara në këtë punim, shpeshherë kemi dalë me vlerësime*

*dhe interpretime individuale, duke formuluar hipoteza që jo në pak raste shkojnë sinkron me tezat e studiuesve të tjerë.*

*Punimi synon të evidentojë faktorët që kanë kushtëzuar zhvillimet e lëvizjes politiko-arsimore në këtë trevë, duke evidentuar pozicionin gjeografik qendror të trevës së Elbasanit dhe njëkohësisht edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm që lidhen me rolin drejtues në periudha të caktuara të përfaqësuesve të shtresave të ndryshme sociale të kësaj treve në zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare.*

*Duke iu referuar problematikës që ky punim mbart, duke respektuar gërshetimin e kriterin kronologjik, strukturën e këtij punimi e kemi konceptuar me një hyrje dhe katër kapituj e më konkretisht:*

*Në hyrje kemi paraqitur një panoramë të përgjithshme për sa i përket pozicionit gjeografik të trevës së Elbasanit, përdorimit të alfabeve të para në kuadrin e dokumentimit të shkrimit të gjuhës shqipe në dialektin elbasanas dhe kontributit të figurave të kësaj treve në fushën e arsimit gjatë shek. XVIII-XIX. Gjithashtu, një vend të rëndësishëm zë edhe paraqitja e strukturës shoqërore dhe fetare të trevës së Elbasanit gjatë shek XIX. Përfaqësuesit më kryesorë të një mjedisi të tillë do të jenë ndër veprimtarët më kryesorë në zhvillimet e ngjarjeve politiko-arsimore në fund të shek. XIX dhe në vijimësi edhe përgjatë shek. XX.*

*Kapitulli i parë, prirë të nxjerrë në dukje kushtet konkrete në të cilat u zhvillua lëvizja politike, arsimore në trevën e Elbasanit, nga vitet 1878 deri në vitin 1908, me shpalljen e Hyrjetit.*

*Gjatë kësaj periudhe, në trevën e Elbasanit konstatohen fillesat e para të rezistencës së organizuar anti osmane dhe përfshirjes së popullsisë së këtyre trevave në zhvillimet politike në kuadrin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pavarësisht faktit se gjeografikisht treva e Elbasanit ndodhet larg zonave që prekeshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga copëtimi në favor të vendeve fqinje, edhe në Elbasan, që në vitin 1878 do të formohen strukturat organizative të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit sikurse ishte krijimi i komitetit të ndërlidhjes dhe krijimi i degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Elbasan. Pasqyrimi i plotë i strukturës organizative të degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan dhe veprimtarisë së saj, përbën një çështje të trajtuar pjesërisht nga studiuesit paraardhës.*

*Gjithashtu në vijimësi të këtij kapitulli, në çështjen e dytë të tij, një vend të rëndësishëm zë edhe krijimi në vitin 1905 i Komitetit të fshehtë të Manastirit, ku sipas burimeve të kohës një rol të rëndësishëm në krijimin e tij kanë dhënë edhe patriotët elbasanas, të cilët sipas burimeve*

të kohës me aktivitetin e tyre i kanë paraprirë krijimit të Komitetit të fshehtë Manastirit. Çështja e tretë e këtij kapitulli pasqyron veçoritë dhe tiparet më kryesore të lëvizjes arsimore në trevën e Elbasanit në fund të shek. XIX. Pikërisht, është koha kur në trevën e Elbasanit, nëpërmjet përdorimit të alfabetëve ekzistuese të vetë trevës, si ai i Anonimit të Elbasanit, Dhaskal Todrit, K. Kristoforidhit, evidentohet fenomeni i shkollave shëtitëse, që përfaqësonin më së shumti aktivitetin e patriotëve dhe intelektualëve elbasanas, të cilët në cilësinë e mësuesve ilegalë dhe shëtitës rrezikonin edhe jetën për të përhapur mësimin e gjuhës shqipe deri në zonat më të thella malore të kësaj treve, duke e shndërruar Elbasanin në një pikë referimi të lëvizjes për mësimin e gjuhës shqipe. Kjo lëvizje pësoi një evoluim të dukshëm në kushte mjaft të vështira, ku jo në pak raste mësimi i gjuhës shqipe zhvillohej fshehurazi në shkollat shtetërore dhe private turke, apo dhe vllahe, që funksiononin në Elbasan. Në këtë kuadër një vend të rëndësishëm do të zërë aktiviteti dhe veprimtaria e çmuar e njerit prej figurave më kryesore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare pikërisht të Kostandin Kristoforidhit, i cili do të vlerësohet gjithmonë për kontributin e tij në fushën e studimit të dialekteve të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht të mësimin të saj në zonat më të thella të trevës së Elbasanit.

Kapitulli i dytë, pasqyron në mënyrë të zgjeruar përpjekjet e patriotëve dhe të intelektualëve elbasanas për të shfrytëzuar situatën e re të krijuar pas shpalljes së Hyrjetit, në funksion të institucionalizimit të lëvizjes arsimore e intelektuale, që spikat gjatë kësaj periudhe me ngritjen e disa prej klubeve e shoqërive patriotike e kulturore. Të tillë ishin klubi “Bashkimi”, “Vllaznia”, “Bashkimi i ri”, shoqëria muzikore “Afërdita”, “Dielli”, “Drita”. Këto klube dhe shoqëri me karakter patriotik jo vetëm u shndërruan në institucione arsimore dhe kulturore mbarëkombëtare, por njëkohësisht mbajtën peshën dhe përgjegjësinë më kryesore edhe në zhvillimet e punimeve të Kongresit Kombëtar të Elbasanit, që zë një vend të veçantë në këtë punim. Në këtë kuadër, më së shumti jemi përqendruar jo vetëm në arritjet kryesore dhe rëndësinë që pati ky kongres për lëvizjen kombëtare shqiptare, por njëkohësisht jemi fokusuar edhe në problematikat e shfaqura që u evidentuan fillimisht që me thirrjen e tij dhe më pas edhe me zhvillimet e punimeve të këtij kongresi me karakter kombëtar. Një lëvizje me përmasa të tilla në këtë periudhë do të rezultojë vendimtare në procesin e formësimit të identitetit kombëtar dhe konsolidimin e nacionalizmit shqiptar.

Veçanërisht pas përfundimit të punimeve të Kongresit të Elbasanit në funksion të institucionalizimit të lëvizjes arsimore në trevën e Elbasanit vihet re shtimi i shkollave fillore për

*mësimin e gjuhës shqipe dhe hapja e së parës shkollë të mesme të arsimit shqiptar në qytetin e Elbasanit, e njohur me emrin Shkolla Normale. Në këtë kuadër, kemi pasqyruar njëkohësisht edhe problemet më të rëndësishme me të cilën u ndeshën patriotët shqiptarë në mirëfunksionimin e Normales përgjatë vitit të parë të hapjes së saj. Kështu, një vend të rëndësishëm u kemi kushtuar edhe problemeve arsimore që u shfaqën në trevën e Elbasanit në vitet 1910-1912, duke pasqyruar në mënyrë të zgjeruar fillimisht përpjekjet e patriotëve shqiptarë dhe elbasanas për të mbështetur shkrimin e gjuhës shqipe me alfabetin latin dhe gjithashtu përpjekjet e tyre pas mbylljes së detyruar të Normales për të hapur një shkollë të tillë, qoftë edhe në një vend tjetër jashtë Shqipërisë.*

*Kapitulli i tretë, i fokusuar në trajtimin e problemit më të rëndësishëm të historisë së popullit shqiptar, sikurse cilësohet Shpallja e Pavarësisë, trajton fillimisht veprimtarinë aktive të çetave anti osmane që u formuan në trevën e Elbasanit në kuadrin e kryengritjeve të viteve 1911-1912, në funksion të mbështetjes së gjithanshme që ato i dhanë lëvizjes kombëtare shqiptare, kryengritjes së vitit 1911 dhe kryengritjes së përgjithshme të armatosur që shpërtheu në Shqipëri në verë të vitit 1912. Pikërisht kontributin e patriotëve elbasanas, përmes drejtimit nga Komiteti Revolucionar Elbasanit e kemi pasqyruar në mënyrë të plotë duke iu referuar dokumentacionit përkatës të nxjerrë nga Fondi. Lef Nosi. Në vazhdimësi të këtij kapitulli, kemi evidentuar çastet më të rëndësishme të shpalljes së pavarësisë në Elbasan, Gramsh e Peqin, duke evidentuar dukshëm dhe rolin aktiv të personaliteteve, intelektualëve e patriotëve elbasanas, siç ishin Aqif Pashë Elbasani, Lef Nosi, Shefqet Daiu e të tjerë, që me veprimtarinë aktive të tyre në mbështetje të qeverisë së re shqiptare të dalë nga Kuvendi i Vlorës, kanë zënë një vend të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar. Në këtë kuadër, veçanërisht kemi pasqyruar momentet më të rëndësishme të ngritjes së flamurit në Elbasan, duke përfaqësuar njëkohësisht edhe evenimentin e shpalljes së pavarësisë së Elbasanit. Kështu, duke iu referuar burimeve të kohës flamuri në Elbasan rezulton të jetë ngritur jo në 25 nëntor por në 28 nëntor të vitit 1912. Ndërkaq, çështja e fundit e kapitullit të tretë pasqyron përfaqësimin e patriotëve elbasanas në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe njëkohësisht edhe në Qeverinë e Vlorës duke përmbushur me sukses përgjegjësitë e tyre në kuadrin e veprimtarisë së saj.*

*Kapitulli i katërt, pasqyron në mënyrë të plotë rolin dhe kontributin e prefekturës së Elbasanit parë në disa aspekte kryesore: së pari, në kuadrin e reformave administrativo-lokale, në aspektin institucional, në koherencë të plotë me vendimet e Qeverisë së Vlorës, duke mbrojtur*



deri në fund interesat e shtetit kombëtar shqiptar ndaj përpjekjeve separatiste dhe ambicieve të shfrenuara të Esad Pashës. Së dyti, në kuadrin e mbështetjes së drejtpërdrejtë që Prefektura e Elbasanit do t'i japë kryengritjes anti serbe të Dibrës dhe refugjatëve të larguar nga trevat shqiptare të zonave që u prekën drejtpërsëdrejti nga masakrat serbe. Së treti, në përmbyllje të këtij kapitulli jemi përpjekur të pasqyrojmë disa tipare të zhvillimit të arsimit në prefekturën e Elbasanit pas Shpalljes së Pavarësisë, duke u fokusuar më tepër në sistemin e shkollave fillore shqipe që funksionin në këtë kohë në Elbasan, në funksionimin e Shkollës Normale, të kontributit të mësuesve shqiptarë, që do të jepnin mësim në këto në funksion të përpjekjeve të Qeverisë së Vlorës për të krijuar një sistem arsimor mbi baza kombëtare.

Në identifikimin dhe shpalosjen e këtij diapazoni vlerash, që korrespondojnë me drejtimet e sipërpërmendura, është shfrytëzuar një literaturë bashkëkohore, ku përfshihen materiale dhe dokumente të nxjerra nga fondet përkatëse në Arkivin Qendror të Shtetit, në Arkivin e Institutit të Historisë, fondi i Ministrisë së jashtme të Vjenës, fondi arkivor i Muzeut Etnografik të qarkut të Elbasanit. Një burim me mjaft vlera është botimi i Institutit të Historisë me dokumente të nxjerra nga fondi i Lef Nosit “Dokumenta historike 1912-1918”. Një informacion i pasur me dokumente historike gjendet në botimin “Qeveria e Përkohshme e Vlorës 1912-1914, dokumente historike”, botuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në vitin 1963.

Në këtë kuadër, përveç shfrytëzimit të burimeve të arkivave shqiptare, për një përjasje sa më objektive me to, i jemi referuar studimit dhe analizës së burimeve të huaja, e më konkretisht vlen të përmendim botimin në dy vëllime “Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët”, të studiueses Valentina Duka, nxjerrë nga arkiva britanike që përbëjnë një dokumentacion të pasur dhe me vlera për studiuesit dhe historiografinë shqiptare.

Ndërkaq, në shfrytëzimin e burimeve të huaja austro-hungareze, angleze e franceze, më së shumti jemi mbështetur në raportet konfidenciale të diplomatëve të huaj të akredituar në Shqipëri në vitet 1878-1914, sikurse ishin ato austro-hungarezë, britanikë, francezë, italianë etj. Pjesa më e madhe e këtyre burimeve historike kanë gjetur dritën e botimit me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe janë fryt i një pune hulumtuese të studiuesve vendas në bashkëpunim me institute kërkimore shkencore. Të tillë përmendim botimet “Shqipëria në dokumentet austro-hungareze”, vëll. II, III, IV, V, VI, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, botimet “Dokumente britanike për Çështjen Shqiptare” dhe “Dokumente

*franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët”, të studiuesit Muhamet Shatri, botimi “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze 1878-1881”, përpunuar nga Skënder Rizaj etj.*

*Gjithashtu, për të dhënë një panoramë sa më të plotë të historikut të trevës së Elbasanit kemi shfrytëzuar studime, botime, artikuj, kumtesa, tekste e monografi, posaçërisht për problemet e trajtuara në punim, të autorëve vendas por edhe të huaj dhe njëkohësisht edhe dëshmi të bashkëkohësve që kanë jetuar në periudhën së cilës i jemi referuar. Porse monografitë që trajtojnë zhvillimet politike të trevës së Elbasanit janë më të kufizuara në raport me punimet që trajtojnë problemet arsimore në këtë trevë në periudhën kohore që kemi marrë në studim.*

*Në përpilimin e këtij punimi jemi mbështetur në shfrytëzimin e disa botimeve me mjaft vlerë të studiuesit të njohur Kristo Frashërit si: “Lidhja shqiptare e Prizrenit”, “Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë” etj. Botime të rëndësishme që trajtojnë dhe pasqyrojnë zhvillimet arsimore në trevën e Elbasanit të shfrytëzuara në këtë punim janë punimet e autorëve Xhevat Llosh dhe Shyqyri Demiri.*

*Gjithashtu një trajtim të plotë dhe interesant i bën zhvillimeve arsimore në trevën e Elbasanit, studiuesi elbasanas Hysni Myzyri në botimet e tij “Shkollat e para kombëtare shqipe” dhe “Shkolla Normale e Elbasanit”. Me mjaft vlerë rezultojnë gjithashtu kumtesat e studiuesve të tjerë si: Fejzulla Shabani, Fatmira Musaj, Gazmend Shpuza, Kristaq Prifti, Hasan Kaleshi, Tatjana Haxhimihali, Kadri Musaj, Liman Varoshit, Sul Dedej, Kujtim Bevapi, Tomorr Plangarica etj. Burime jo më pak të rëndësishme cilësohen dhe të dhënat që na vijnë njëkohësisht përmes shtypit periodik kombëtar dhe lokal të kësaj periudhe, brenda dhe jashtë vendit, të përfaqësuar nga gazetat “Korça” (1909), “Lidhja ortodokse”, “Lirija”, Selanik (1908-1910), “Tomori”, Elbasan, (1910), “Përlindja e Shqypëniës”, botim periodik i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, “Bashkimi i Kombit” (1909), “Dielli” (1909), Revista shkencore “Jehona”, Shkup, Nova Makedonija, 1993, gazeta “Shqipëria”, Magaga (Egjypt), Nr. 5, 15 qershor 1907, gazeta “Shpnesa e Shqypënisë”, Raguzë, nr. 9, 22 maj 1907, L’Italia all’estero”, Roma, 1920 vjeshtë e parë, nr. 18., “La nazione Albanese”, Catanzaro, 1909, Revista “Normalisti”, Botimi i shkollës Pedagogjike Elbasan, viti 1959 etj.*

*Ndërkaq, falënderoj profesorët e departamentit të historisë së Universitetit të Tiranës, ku unë kam realizuar procesin e kualifikimit shkencor, prof. Dr. Valentina Duka, prof. as. dr. Ilira Çausi, prof. dr. Fatmira Rama për pasionin dhe përkushtimin që tregojnë ndaj studiuesve të rinj.*

*Një falënderim i veçantë i shkon udhëheqësit shkencor prof. dr. Liman Varoshit që nëpërmjet mbështetjes dhe udhëzimeve të dhëna, ka ndikuar në formimin tim shkencor dhe përfundimin me sukses të një punimi të tillë.*

## HJRJE

Historia e trevës së Elbasanit sikurse dhe vetë historia e Shqipërisë ka qenë histori e përpjekjeve për mbijetesë, identitet, për gjuhën dhe shkollën shqipe. Në këtë kalvar të gjatë të historisë çdo qytet apo trevë shqiptare ka lënë shenja dhe gjurmë të tilla sa që rrjedha e kohërave nuk mund t'i zbehë kurrë, çdo qytet apo trevë shqiptare ka nxjerrë personalitete dhe figura të përmasave lokale apo kombëtare sa që emrat e tyre janë shkruar dhe janë gdhendur thellë në faqet e historisë. Përgjatë shek. XIX Elbasani vlerësohej si një ndër qytetet më kryesore të trevave shqiptare dhe veçanërisht të Shqipërisë së Mesme me një pozitë gjeografike tepër të favorshme. Si qendër administrative sanxhaku në përbërje të vilajetit të Manastirit, përfshinte ne vetvete kazatë; e Elbasanit, Peqinit, Gramshit dhe Çermenikës<sup>1</sup>.

Në këtë periudhë, duke iu referuar pozicionit gjeografik të trevës së Elbasanit dhe njëkohësisht përfshirjes së kësaj treve në kuadrin e strukturës administrativo - tokësore të trevave shqiptare, sanxhaku i Elbasanit rezultonte në përbërje të Vilajetit të Manastirit. Ai kufizohej në pjesën më të madhe të tij jo vetëm me sanxhaqet e vilajetit të Manastirit, por edhe me sanxhaqet e vilajeteve të Shkodrës dhe të Janinës. Në kuadrin e përfshirjes në vilajetin e Manastirit pjesë përbërëse e të cilit sanxhaku i Elbasanit rezultonte në shek. XIX-XX, renditej ndër ato sanxhaqe në të cilët popullsia shqiptare përbente shumicën dërrmuese të popullsisë, ndërkohë që në vilajetin e Manastirit popullsia shqiptare zinte 54.1% duke përfaqësuar përqindjen më të vogël krahasuar me vilajetet e tjera.<sup>2</sup>

Ndërsa në Sanxhakun e Elbasanit popullsia shqiptare rezultonte në shumicë, qyteti i Elbasanit renditej ndër qytetet e mëdha të trevave shqiptare, me një popullsi që në shek. XIX shkonte afërsisht nga 11 - 13 mijë banorë<sup>3</sup>. Përgjatë kësaj periudhe, Elbasani paraqitet si një qytet me një traditë të pasur në fushën e zejtarisë që shprehej në ekzistencën dhe funksionimin e një shumëllojshmërie zejesh, në të cilat mbështetej ekonomia qytetare. Pavarësisht lindjes së marrëdhënieve kapitaliste, një traditë e tillë do të vazhdojë të ruhet në vijim si në këtë qytet përgjatë gjithë shek. XIX, e përfaqësuar nga mjeshtëritë tradicionale si; zeja e tabakëve, e

---

<sup>1</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: Botimet Toena, 2002, 43.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Studiuesi Zija Shkodra për popullsinë e Elbasanit në këtë kohë jep shifrën 11 .000 banorë, historiani Petrika Thëngjilli jep shifrën 11.000 banorë, në Enciklopedinë e Elbasanit për këtë periudhë jepen dy të dhëna, në njërin Elbasani rezulton me 4000 shtëpi dhe në tjetrën 7000 familje. Studiuesi elbasanas , Shyqyri Demiri jep shifrën 13.000 banorë

terzinjve, e kazazëve, argjendarëve etj. Rëndësia e këtyre zejeve dëshmohet përmes faktit se toponomastika e disa prej shesheve të këtij qyteti, gjatë shek. XIX-XX do të mbante emrat e këtyre zeje sikurse ishin : “*Sheshi i tabakëve*”, “*Mulliri i Tabakëve*”, “*Rrapi i Tabakëve*”, “*Çezma e Tabakëve*” etj. Gjithashtu, mbiemrat e mjaft familjeve të vjetra të qytetit të Elbasanit janë të lidhur drejtpërdrejt me zejet që ushtroheshin në këtë periudhë.

Ndërkaq, gjatë shek. XIX kuadri i zhvillimit të marrëdhënieve të reja kapitaliste në trevën e Elbasanit rezultonte tepër i kufizuar. Industria përfaqësohej nga funksionimi i disa mullinjve të motorizuar të vajit dhe të drithit, apo ndonjë fabrikë sapuni <sup>4</sup>. Në këtë kuadër, një pjesë e feudalëve të mëdhenj shqiptarë bënë përpjekje për të investuar jo vetëm në fushën bujqësore por në të njëjtën kohë edhe në fushën industriale, duke u bërë njëkohësisht edhe pronarë fabrikash. Kështu, në Elbasan punishtja e duhanit dhe fabrika e sapunit u ngritën nga tregtarë të pasur anëtarë të esnafit si dhe çifligarë elbasanas. Fabrika e sapunit ishte në pronësi të vëllezërve Nosi. Para vitit 1912 në këtë fabrikë punonin 4-5 punëtorë. Vëllezërit Nosi, investuan rreth 20.000 fr. Ar, duke blerë makineri tek firma “Radillos” në Pire, gjithashtu ata sollën edhe një paisje avulli e cila së bashku me makineritë e tjera u bllokua në Durrës nga Esat Toptani.<sup>5</sup>

Ndërkohë, depërtimi përmes tregtisë i mallrave të huaja do të çonte gradualisht në rrënimin e shtresës zejtare dhe rrjedhimisht edhe në eliminimin e shumë zejeve prodhuese, tradicionale për këtë trevë.

Elbasani i ndodhur në kryqëzimin e rrugëve tregtare, konsiderohej si një nga depot qendrore të tregtisë së brendshme të Rumelisë, njëherazi dhe qendra më e rëndësishme ekonomike e Shqipërisë së mesme, ku tregtia më e rëndësishme ishte ajo e vajit, duhanit dhe lëkurëve. Sasira të mëdha të këtyre produkteve kishin si destinacion tregjet e Dibrës, Strugës, Ohrit, Manastirit, Shkupit, Selanikut dhe atë të Durrësit<sup>6</sup>. Duke filluar nga mesi i shek. XIX, konstatohet edhe procesi i krijimit të lidhjeve tregtare nëpërmjet shkëmbimeve të çeqeve midis qyteteve shqiptare si Shkodrës, Prizrenit, Durrësit, Vlorës, Elbasanit Korçës, Janinës etj<sup>7</sup>.

Në vitin 1870, në qytetet kryesore shqiptare u krijuan agjencitë e bankës otomane, ato të bankës bujqësore dhe gjykatoret tregtare. Degët e bankës bujqësore otomane në Elbasan kryenin

---

<sup>4</sup> Petro Kito, *Elbasani në luftë për çlirim*, Tiranë: Naim Frashëri, 1971, 18.

<sup>5</sup> Valentina Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet (1912-1914)*, Tiranë: Toena, 1997, 26-27.

<sup>6</sup> Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë: Mihal Duri, 1984, 233.

<sup>7</sup> Po aty.

veprime krediti <sup>8</sup>. Jo gjithkush mund të merrte kredi. Këtë të drejtë e kishin veçanërisht feudalët dhe të pasurit, ndërsa të tjerët mund të merrnin kredi vetëm nëse u dilte garant ndonjë pronar i madh. Marrja e një kredie nga një fshatar nga Shtërmeni nga Banka e Bujqësisë në Elbasan 1000 grosh, do të realizohej vetëm përmes dorëzarisë së Aqif Pashë Elbasanit. Përveç dorëzarisë individuale ndesheshin edhe kontrata kolektive, ku garantohej shlyerja e huasë me pasurinë e njëri tjetrit.<sup>9</sup> Përgjatë shek XIX, në trevën e Elbasanit evidentohet lindja e një shtrese të re të borgjezisë së vogël që përfaqësohej nga tregtarë, zejtarë të cilët i mbijetuan ligjeve të ekonomisë kapitaliste dhe konkurrencës së huaj gjithashtu dhe nga çifligarë dhe pronarë të mëdhenj tokash të cilët gërshetuan në pronat e tyre format e vjetra feudale me format e reja të prodhimit kapitalist.

Ndërkaq, në zonat rurale dominuese rezultonte ekonomia e madhe çifligare, që bazohej në ekzistencën e çifligjeve të cilat ishin pronë e shtetit, pronë e familjeve të mëdha feudale, të institucioneve fetare, të individëve të veçantë si bejlerë, agallarë, borgjezë e më pak qytetarë, të institucioneve fetare etj.

Ndër familjet e mëdha çifligare në trevën e Elbasanit përmenden familja e Biçakçinjve, Vërlacëve e Bonatëve në Peqin etj. Por, duhet thënë se në kushtet e mungesës së një shtrese të vërtetë të mesme, përfaqësuesit e këtyre familjeve të mëdha feudale do të jenë protagonistët më kryesorë në zhvillimet politike dhe arsimore në trevën e Elbasanit gjatë shek. XIX-XX. Do të jenë këta përfaqësues të cilët edhe nga studiuesit e huaj do të konsiderohen si veprimtarët më kryesorë të shqiptarizmit në trevën e Elbasanit.

Në rrafshin fetar, jo vetëm në nivel qyteti por edhe në nivel treve besimi mysliman suni rezultonte mbizotërues. Tregues të një realiteti të tillë në qytetin e Elbasanit do të jenë lagje të tëra që përbëheshin vetëm nga popullsia myslimane sikurse ishin, lagjia “Daut Bej”, “Çaushlli”, “Haxhi Hasan”, “Karaveli”, Mahzar Hysein”, “Sapuni”, “Kalandrije”, “Eski Ceribash”, “Ebubeqir Celebi”, “Asllan Bej”, ku rreth 82.3% e popullsisë rezultonte e besimit mysliman.<sup>10</sup> Ndërkohë, gjatë shek. XIX përhapje do të gjejë edhe sekt i bektashinjve kontributi i të cilëve në funksion të lëvizjes patriotike në trevën e Elbasanit do të jetë mëse evident.

---

<sup>8</sup> Banka bujqësore turke u krijua me një kapital fillestar prej 10000000 lira turke ose 220 milionë franga ari dhe duhej të mbulonte 19 vilajete të Perandorisë. Kapitali i degëve të saj në tokat shqiptare përfaqësonte 0.5% të të gjithë kapitalit të përgjithshëm.

<sup>9</sup> Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar (395-1875)*, Tiranë: Toena, 2000, 361.

<sup>10</sup> AQSH. Fondi. 113/1 regjistri. Daimi dhe Jokllama, 1892-1908.

Në këtë kuadër, nëse zonat fushore të trevës së Elbasanit rezultonin si qendra të një islami suni, zonat malore sikurse ishin ato të Martaneshit apo të Gramshit konsideroheshin si bastione të bektashizmit. Ndërkaq, duhet thënë se procesi i islamizimit të popullsisë në fillim të shek. XX në Elbasan do të pësojë një rritje të ndjeshme në favor të elementit mysliman.<sup>11</sup>

Për sa i përket popullsisë së besimit ortodoks, kjo popullsi e përqendruar në lagjet “Kala”, “Shën Koll”, “Haxhija” dhe “Sapuni”, zinte rreth 18% të popullsisë së përgjithshme të qytetit të Elbasanit.<sup>12</sup> Megjithëse në një përqindje të vogël, popullsia ortodokse e Elbasanit është përfshirë masivisht në zhvillimet ekonomike, politike dhe arsimore të këtij qyteti. Kështu, një kontribut të rëndësishëm në kuadrin e zhvillimit të lëvizjes patriotike ka dhënë veçanërisht popullsia ortodokse e lagjes “Kala”.

Konsekuenca e një veprimtarie të tillë shumëvjeçare e popullsisë ortodokse, do të shoqërohet me masa ndëshkuese nga Fanari grek, që konsistojnë në ndërprerjen e financimeve që qeveria greke akordonte për mbajtjen e shkollave të komunitetit ortodoks<sup>13</sup>. Një veprim i tillë më së shumti ishte shprehje e tendencave kombëtare shqiptare që po manifestoheshin gjithnjë e më tepër ndërmjet ortodoksëve të Elbasanit. Gjithashtu në Elbasan rezultonte edhe një komunitet i vogël arumunësh(vllahë) të vendosur në jug të qytetit konkretisht në një nga lagjet myslimane të qytetit. Ndërkohë, në vitin 1900 në zonën e Shpatit kishte filluar një lëvizje Uniate nga kriptokristianët e kësaj zone. Një lëvizje e tillë me karakter sa fetar aq dhe politik që drejtohej nga kleriku elbasanas Papa Jorgji Theodhari, mbështetej në parimin një kishë, një komb dhe feja në shërbim të përbashkësisë kombëtare.

Gjatë periudhës së Rilindjes, Lëvizja Kombëtare shqiptare do të shfaqë specifikat e zhvillimit në tërë kompleksitetin e saj. Për më tepër, lëvizja për gjuhën dhe shkrimin e shqipes do të konsiderohej tashmë në fillim të shek. XX jo vetëm si një dukuri mirëfilli gjuhësore por, më së shumti do të marrë përmasat e një lëvizjeje të natyrës politike, duke interferuar drejtpërsëdrejti në zgjidhjen e problematikave të përbashkëta. Kjo për faktin më se të njohur se nën Perandorinë Osmane shqiptarëve u ishte mohuar gjuha dhe shkolla shqipe.

---

<sup>11</sup> Zh. Kadilli, *Besimi fetar në qytetin e Elbasanit në fund të shek. XIX e në fillim të shek. XX*, botuar në Buletinin Shkencor: nr. 4, Elbasan: 2010, 33.

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit.

Shqiptarëve u ishte mohuar gjuha shqipe, sepse ajo ishte shprehja më e qartë e identitetit kombëtar dhe u ishin mohuar shkollat shqipe sepse ato ishin institucionet brenda të cilave ky identitet do të gjente afirmimin e plotë në funksion të një procesi të rëndësishëm politik.

Lëvizja për alfabetin dhe shkrimin e shqipes në trevat shqiptare si problemi më i rëndësishëm në kuadrin e Rilindjes Kombëtare, ka parahistorinë e vet të shoqëruar me zgjidhjen e problematikave që përgjatë shek. XIX do të shkonin përtej nismave individuale. Një veprimtari e tillë nuk do të linte jashtë përfshirjes në të edhe trevën e Elbasanit ku gjurmët e më të hershme të shkrimit të shqipes i gjejmë që gjatë shek. XVII-XVIII.

Dokumentimi i shkrimit të shqipes në Elbasan përmes alfabeve të veçantë lokale përfaqësohet nga dorëshkrimi i Anonimit të Elbasanit (Papa Totasit), përfaqësuar nga përkthime të pjesëve të katër ungjijve. I shkruar me një elbasanishte shumë më të vjetër se alfabeti i Dh. Todrit, me një alfabet origjinal që përbëhej nga 40 germa ku si bazë kishte alfabetin *glagolitik*<sup>14</sup>. Ekzistenca e një dokumenti të tillë dhe përpjekjet për krijimin e alfabeve të gjuhës shqipe në Elbasan, janë tregues i faktit se shkrimi i shqipes kishte kohë që kishte filluar. Kështu, në dorëshkrimet që i përkasin Divanit të Nezimit gjendet edhe një vjershë e një pashai elbasanas (Sulejman Pashë Elbasani) që i përket gjysmës së dytë të shek. XVIII. Pashai në fjalë mendohet se i përket familjes së Vërlacëve dhe mbante titullin *Vezir*<sup>15</sup>. Gjithashtu në Elbasan përmenden gjithashtu edhe emrat e disa bejtexhinjve sikurse ishte Ibrahim Pasha në shek. XVIII dhe Faik Duhaxhiu në shek. XIX<sup>16</sup>.

Kur flasim për abc-në e gjuhës shqipe natyrshëm të shkon në mendje emri i Theodhor Haxhi Filipit i njohur me pseudonimin Dhaskal Todri, pasardhës dhe nxënës i Grigorit prej Voskopoje dhe njëkohësisht bashkëkohës i Theodhor Kavaliotit dhe Kostë Beratit. Alfabeti i Todrit do të studiohet për një kohë të gjatë, duke vënë re ngjashmëritë e tij me alfabetin ‘glagolik’ apo atë ‘mesropean’ që fillimisht mendohej se përmbante edhe elementë etruske. Për më tepër që alfabeti i Todrit u trumbetua nga dijetari austriak von Hahn si një zbulim i kohës duke e konsideruar për një farë periudhe si alfabeti pellazgjik. Shkrimi më i hershëm me alfabetin e Dh. Todrit datohet në 10. VIII. 1795 dhe përfaqësohet në disa llogari tregtare të mbajtur nga elbasanasit Spiro Popa (mësues), Jakov Haxhiu (vëllai i Dh. Todrit) në greqisht dhe

<sup>14</sup> Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqip në vitet (1332-1850)*, Tiranë: Naim Frashëri, 1976, 91. Ka mendime se teksti i Papa Totasit i përket fundit të shek. XVII. Në fshatin Valësh të Shpatit ku gjendet edhe një kishë e pikturuar nga Onufri në shek. XVI, emir i fisit Totoshi i përgjigjet emrit Totasi dhe të dy kanë në rrënjë fjalën ‘totë’ (prift).

<sup>15</sup> Po aty, 143.

<sup>16</sup> Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqip në vitet...*, vepër e cituar, 143.



në shqip<sup>17</sup>. Gjatë vitit 1885, ky alfabet i shqipes do të përdorej nga 50 tregtarë elbasanas për veprime tregtie<sup>18</sup>.

Ndërkohë, alfabeti i Todrit do të gjejë përdorim jo vetëm në trevën e Elbasanit por dhe më gjerë. Një predikim fetar i mbajtur në Kavajë dhe i shkruar nga elbasanasi Jani Popa me alfabetin e Todrit mendohet të jetë mbajtur në 25 mars të vitit 1848. Përgjatë shek. XIX multilinguizmi rezultonte si një dukuri që dominonte në trevat shqiptare. Gjuha shqipe paraqitej e varfër në leksik dhe e përzjerë me huazime turke, greke apo sllave. Ndërkohë që multilinguizmi do të shfaqej përmes përdorimit të gjuhëve të ndryshme në funksione të caktuara, në trevën e Elbasanit një fenomen i tillë nuk rezultonte dominues<sup>19</sup>.

Duke gjykuar mbi këto arritje, nënvizojmë se ndërsa Dhaskal Todri konsiderohet si paraardhës i Rilindjes Kombëtare, veprën e tij e vazhdoi dijetari i madh elbasanas Kostandin Kristoforidhi, duke krijuar një terren të përshtatshëm në funksion të krijimit të një plejade të tërë patriotësh intelektualë, kontributi i të cilëve do të jetë fundamental në zhvillimet e shqiptarizmit jo vetëm në trevën e Elbasanit por dhe më gjerë.

Kristoforidhi do të jetë ndër përfaqësuesit e parë në komisionin e hartuar posaçërisht për çështjen e alfabetit në Stamboll<sup>20</sup>. Përkthimet e shkrimeve fetare të tij përbënin mjetin më kryesor të luftës kundër propagandës shkombëtarizuese greke të Fanarit. Në vitet 1866-1867 do të botoheshin nga Shoqëria Biblike Britanike disa libra të Kristoforidhit sikurse ishin: “Ungjijtë”, “Katër katekizmat” dhe abetarja gegërisht. Ndërsa në vitin 1872 Kristoforidhi do të përkthejë “Dhiata e Re” e plotë në gegërisht<sup>21</sup>. Në shkrimet dhe përkthimet e tij Kristoforidhi fillimisht për botimet në gegërisht përdori alfabetin latin, të plotësuar nga dy shkronja greke dhe për toskërishten alfabetin grek të plotësuar nga disa shkronja latine. Kristoforidhi e konsideronte shkrimin e shqipes si mjetin më efikas për njohjen e kombit shqiptar, ndër kombet e qytetëruar të Evropës<sup>22</sup>.

Gjysma e dytë e shek. XIX karakterizohet nga një ashpërsim i kontradiktave midis popullsisë shqiptare dhe administratës osmane. Në këtë periudhë lëvizja kombëtare shqiptare po

---

<sup>17</sup> Po aty, 140.

<sup>18</sup> AME (Arkivi i Muzeut Etnografik Elbasan), dorëshkrim i Shyqyri Demirit, f. 19.

<sup>19</sup> Turqishtja përdorej më së shumti si gjuhë e administratës, greqishtja dhe italishtja si gjuhë të tregëtisë.

<sup>20</sup> Xhevat Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes*, Shkup-Pishtinë-Tiranë: Logos, 2008, 13. Sipas Xhevat Lloshit komisioni i alfabetit nuk është mbledhur në vitin 1864 sikurse rezulton versioni zyrtar i historisë, por është mbledhur në vitin 1869.

<sup>21</sup> Xhevat Lloshi, *vepër e cituar*, 257.

<sup>22</sup> Dh. Shuteriqi, *Histori e letërsisë shqipe*, Tiranë: 1955, 115.

shënonte një ngritje të re, si në organizimin e qëndresës së armatosur, ashtu dhe në zhvillimin e mëtejshëm të mendimit politik kombëtar. Në këtë kuadër, Elbasani ishte shndërruar jo vetëm në një vatër të spikatur arsimore e kulturore, por edhe në një qendër të rëndësishme të veprimtarisë politike, që zhvillohej në funksion të lëvizjes kombëtare. Dukuria e mësipërme evidentohet mjaft qartë në trevën e Elbasanit, sepse procesi i formimit të vetëdijes kombëtare po vijonte drejt një rritjeje të dukshme.

Ngritja e tensionit në marrëdhëniet ndërmjet popullsisë shqiptare dhe pushtesve otomanë u reflektua në rezistencën e organizuar enkas nga popullsia e trevës së Elbasanit kundrejt reformave të administratës osmane në trevat shqiptare. Pikërisht, këtë konfirmonin konfrontimet e drejtpërdrejta me qeveritarët osmanë si dhe fillimet e organizuara të lëvizjes së armatosur. Lëvizja e fshatarëve të Mallakastrës dhe Myzeqesë ndaj reformave të Tanzimatit konfirmohet edhe përmes udhëtarit anglez Spenser gjatë një udhëtimi të kryer në Shqipëri. Në shënimet e mbajtura ai përmend përfshirjen e Çermenikës në lëvizjen e sipërcituar. Madje ai nuk nguron të përmendë se në këngët popullore të kësaj krahinë(kënga e pleqvet) bëhet fjalë për rezistencën që çermenikasit të udhëhequr nga Selman Lleshi(nga Kutermani) zhvilluan në kontekstin e kësaj lëvizjeje. Aq lart vlerësohej roli i tij udhëheqës i këtij patrioti, sa krahasohej me “Yllin e Dritës”.<sup>23</sup>

Për më tepër, duhet nënvizuar fakti se zonat malore në trevën e Elbasanit u bënë vatrat kryesore të qëndresës shqiptare. Në qëndresën kundër ushtrive osmane, popullsia e këtyre krahinave favorizohej nga faktorë të natyrës gjeografike, si; ashpërsia e vendit e karakterizuar nga terreni i thyer malor. Në këtë aspekt, përmendim si vatra të rëndësishme të kësaj qëndrese Shpatin, Martaneshin, Peqinin, Gramshin, Bërzeshtën etj.

Në të njëjtën kohë, vetë pozicioni i favorshëm gjeografik i këtyre krahinave, pothuajse në qendër të Shqipërisë, ka bërë të mundur që popullsia e këtyre krahinave të përfshihet në lëvizjet dhe kryengritjet e armatosura që drejtoheshin kundër zbatimit të reformave të Tanzimatit si në Shqipërinë e Veriut, ashtu dhe në atë të Jugut. Një kontribut të konsiderueshëm në mbështetjen e kryengritjeve të viteve 1830-1840 do të kenë edhe qytetet më kryesore shqiptare, midis të cilëve edhe qyteti i Elbasanit<sup>24</sup>. Kështu, kryengritjet lokale që shpërthyen në trevat shqiptare në vitin

---

<sup>23</sup> AME, kutia. 2, Dos. 6, f. 2.

<sup>24</sup> *Historia e popullit shqiptar*, vepër e cituar, 82.

1833, në Dibër, Vlorë, Berat, do të gjejnë përkrahjen dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të popullsisë së Elbasanit, në luftën e tyre kundër administratës turke<sup>25</sup>.

Përvoja e kryengritjeve shqiptare si në veri ashtu edhe në jug, do të përshpejtojë kontaktet midis krerëve drejtues të krahinave të ndryshme për organizimin e një kryengritjeje të armatosur. Shpërthimi i kryengritjes në vjeshtë të vitit 1834 në qytetin e Beratit, do të përbëjë njëkohësisht edhe sinjalin për fillimin e saj. Krijimi i një besëlidhje në kuvendin e Beratit, ku merrnin pjesë përfaqësues të shtatë krahinave, do të kishte karakter jo vetëm ushtarak e ndërkrahinor, por në të njëjtën kohë edhe karakter qeverisës<sup>26</sup>.

Në këtë kuadër, është e njohur pjesëmarrja e popullsisë së Sulovës dhe të Vërçës që vareshin nga Elbasani, në kryengritjen e nëntë krahinave të Shqipërisë së Jugut në vitet 1834-1835, të udhëhequr nga Tafil Buzi. Këto krahina do të përfaqësojnë trevën e Elbasanit në besëlidhjen e Beratit<sup>27</sup>. Pikërisht në 9 dhjetor të vitit 1834, rreziku i rënies së kalasë së Beratit në duart e kryengritësve, do ta detyrojë myteselimin e Elbasanit të kërkojë dërgimin e ushtarëve për të përforcuar mbrojtjen edhe të kalasë së Durrësit<sup>28</sup>. Në këtë kohë, qyteti i Elbasanit rrezikohej të pushtohej nga kryengritësit e Matit dhe të Dibrës, të cilët ishin bashkuar me kryengritësit e Beratit dhe ndodheshin disa orë larg qytetit të Elbasanit, duke krijuar panik dhe frikë ndër drejtuesit e administratës së këtij qyteti<sup>29</sup>. Në një situatë të tillë, do të jetë Valiu u Rumelisë që në mbështetje të myteselimit të Elbasanit Jahja beut, përmes urdhrit të tij do t'i kërkojë popullsisë së Elbasanit organizimin e një qëndrese të armatosur ndaj kryengritësve që do të tentonin të futeshin brenda në qytetin e Elbasanit.

Në maj të vitit 1835 qendra e kryengritjes do të jetë Shkodra. Në kuadrin e përpjekjeve të kryengritësve për mbrojtjen e Shkodrës, vërehet se me kryengritësit shkodranë u bashkuan vullnetarë nga Peja, Gjakova, Malësia e Mbishkodrës, krahina e Mirditës etj. Burimet e kohës qartësojnë se në mbështetje të kryengritjes së mësipërme u rreshtuan edhe kryengritësit e ardhur nga Mati e Dibra të cilët u bashkuan në Elbasan<sup>30</sup>. Në këtë mënyrë, kjo kryengritje mori një karakter gjithnjë e më përfshirës, si rezultat i së cilës u arrit të çlirohet bashkë me krahinat e Shqipërisë së Jugut edhe kryeqendra e rëndësishme e kohës, Berati, e madje të pushtohet dhe

---

<sup>25</sup> Po aty, 85.

<sup>26</sup> Po aty, 87.

<sup>27</sup> Me përfshirjen në besëlidhje të dy kazave të Elbasanit asaj të Vërçës dhe Sulovës, numri i kazave të përfshira në kryengritje shkon në nëntë. Nga dhjetë përfaqësues të çdo kazaje do të vendosen brenda kalasë së Beratit.

<sup>28</sup> *Kryengritjet popullore në vitet 30 të shekullit XIX, dokumente osmane*, Tiranë: 1978, 161.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Po aty, 176-177.

kalaja e tij.<sup>31</sup> Një lëvizje e tillë nga gjenerali francez Kybjer do të konsiderohet si një revolucion<sup>32</sup>. Ndërkaq, si rezultat i jehonës së kryengritjes së Shqipërisë së jugut të udhëhequr nga Tafil Buzi do të shtyhet edhe vjelja e taksës së ushtarake Iane-i xihadije në sanxhakët e Shkodrës, Ohrit, Elbasanit dhe Dukagjinit<sup>33</sup>. Një situatë e tillë do të jetë evidente edhe në vitet në vazhdim, kur kryengritësit shqiptarë do të kundërshtojnë zbatimin e reformave të Tanzimatit në trevat shqiptare.

Gjithashtu, gjatë vitit 1835 popullsia e kazasë së Elbasanit do të përfshihet në një lëvizje që synonte më së shumti zëvendësimin e myteselimit të huaj dhe emërimin në vend të tij të një myteselimi vendas<sup>34</sup>. Kjo kërkesë e elbasanasve që do të parashtrohet në prill të vitit 1835, do të konsiderohet si tepër e rrezikshme dhe do të gjejë kundërshtimin e vendosur të autoriteteve osmane për faktin se një fenomen i tillë rrezikonte të përfshinte edhe krahinat e tjera. Porse, parashikimet e autoriteteve osmane do të përmbushen shumë shpejt. Kërkesa e elbasanasve për emërimin e një do të gjejë mbështetje të plotë edhe nga popullsia e kazave të Tiranës, Kavajës, Peqinit, Matit dhe Dibrës, duke marrë tiparet e një lëvizjeje të përgjithshme. Rezultati i një lëvizjeje të tillë në Elbasan do të shoqërohet me dëbimin e myteselimit të huaj Jahja beut dhe emërimin në vend të tij të Dalip beut<sup>35</sup>.

Gjithashtu, janë të njohur përpjekjet e autoriteteve osmane të pushtimit për frenimin e procesit të rritjes së ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve. Në funksion të përmbushjes së këtij synimi ata përdorën strategjinë e përçarjes fetare dhe krahinore, që konsistonte në ndarjen e popullsisë në myslimanë e të krishterë (turq e kaurë), në gegë e toskë, në qytetarë (sheherli) dhe fshatarë.

Strategjia e mësipërme konfirmohet dukshëm në ngjarjet e vitit 1876, kur në pragun e Luftës Ruso-Turke, turqit dhe mbështetësit e tyre fanatikë në Elbasan nxitën popullsinë myslimane të qytetit që të konfliktohej me popullsinë e krishterë të lagjes Kala. Ngjarja ndodhi në qendër të pazarit, te Bezistani. Pikërisht, në çaste të tilla delikate, Mahmut Biçaku, me mençurinë dhe pjekurinë që e karakterizonte, shfrytëzoi gjithë autoritetin dhe influencën që

---

<sup>31</sup> AME. Kutia. 14, f. 1. K. Musaj, *Populli i rrethit të Gramshit në luftë për pavarësi*.

<sup>32</sup> Petrika Thëngjilli, vepër e cituar, 391.

<sup>33</sup> *Kryengritjet popullore në vitet 30 të shekullit XIX*, vepër e cituar, 167. Letër e Hafëz Pashës drejtuar Vezirit të madh në 13 dhjetor 1834.

<sup>34</sup> Po aty, 184-186. Letra e popullit të Elbasanit mban vulat e 45 personave, midis të cilëve gjenden edhe emrat e disa kryepleqve të Shpatit, Çermenikës, Krastës etj.

<sup>35</sup> Po aty, 189.

gëzonte, duke bërë të mundur shmangien e gjakderdhjes.<sup>36</sup> Për këtë ngjarje një studiues i njohur shkruan: “Në Elbasan jetonte ende në rininë time një hoxhë, i cili ishte orvatur në vitin 1876 të bënte hatanë kundër “kaurëve” të qytetit, se plasi luftën “Kauri i madh”. I ati i të famshmit patriot elbasanas, Aqif pashë Biçakut, e ndali masakrën që deshi të bënte<sup>37</sup>.”

Turmës së mbledhur nga qyteti dhe fshatrat përreth, siç tregojnë, i doli përpara Mahmut Biçaku duke i thënë: “Ç bëni kështu, o të bekuar? Jeni vëllezër të një gjaku! Mbani dorë, ruani inatin! Më mirë më vrisni mua, se të vrisni njëri tjetrin!”<sup>38</sup> Kjo ngjarje ka qenë mjaft tronditëse, sepse kujtimet për të janë ruajtur gojë pas goje deri në ditët e sotme. Pikërisht, ndërhyrja e Mahmut Pashë Biçakut rezultoi vendimtare sepse turma jo vetëm u përmbajt, por edhe qyteti shpëtoi nga një masakër e vërtetë. Ushtrimi i një roli të tillë jo vetëm dëshmoi autoritetin që Pasha gëzonte në qytetin e Elbasanit dhe rrethinat e tij, por e bëri atë të njohur në një rrafsh gjeografik edhe më të gjerë. Natyrisht edhe reagimi i qeveritarëve osmanë nuk do të vononte, por do të ishte disi i kamufluar. Kështu menjëherë pas përfundimit të kësaj ngjarjeje, Mahmut Pashë Biçaku emërohet kajmekan(nënprefekt) në Leskovik. Një realitet i tillë do të krijojë truallin e nevojshëm në funksion të koordinimit dhe interferimit të përpjekjeve të patriotëve dhe intelektualëve Elbasanas në zhvillimet e mëvonshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fund shek. XIX që do të kulmojnë me formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

---

<sup>36</sup> Kadri Musaj, *Aqif Pashë Elbasani figurë e ndritur e kombit shqiptar*, Tiranë: Sejko, 2002, 17.

<sup>37</sup> Dhimitër Shuteriqi, intervistë në gazetën “Kombi”, 3 shtator 1996.

<sup>38</sup> Kadri Musaj, vepër e cituar, 18.

## KAPITULLI. I. LËVIZJA POLITIKO - ARSIMORE NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1878-1908.

### I. 1. Veprimtaria e degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan

Lëvizja kombëtare shqiptare në vitet '70, pavarësisht rezistencës dhe kundërshtimit me armë të popullsisë së vilajeteve shqiptare, veçanërisht të trevave veriore kundër ekspeditave ndëshkuese të Perandorisë Osmane, nuk kishte arritur të krijonte një qendër organizative të përbashkët dhe drejtuese, për të bashkërenduar veprimet në të gjithë trevat shqiptare.

Në këtë kohë, Perandoria Osmane do të përfshihet në vorbullën e Krizës Lindore, ndërkohë që edhe konjunkturat ndërkombëtare do të pësojnë ndryshime të dukshme, që do të shfaqen në qëndrimin që Fuqitë e Mëdha do të mbajnë ndaj vetë ekzistencës së Perandorisë në hapësirën ballkanike. Më konkretisht, vendimet e Traktatit të Shën Stefanit që u mblodh pas humbjes së Perandorisë Osmane në luftën ruso - turke, përbënin rrezikun më të madh për copëtimin e trevave shqiptare në favor të shteteve ballkanike. Njëkohësisht ekzistenca e rivaliteteve midis vetë Fuqive të Mëdha, do të shoqërohet me rishikimin e vendimeve të traktatit të Shën Stefanit në një kongres tjetër, që u vendos të mbahej në Berlin në qershor të vitit 1878.

Në këtë kuadër, detyra më urgjente që dilte para patriotëve shqiptarë të organizuar në Komitetin Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësive shqiptare (Komiteti i Stambollit), ishte krijimi i një lidhjeje shqiptare si një qendër organizative, me funksion mbrojtjen e tërësisë territoriale nga vendimet e kongresit që pritej të mbledhej në Berlin dhe parashtrimin e kërkesës për krijimin e një vilajeti shqiptar me status autonom. Anëtarët e këtij grupi ishin të mendimit se: *“ Tërësia e tokave shqiptare mund të mbrohet vetëm në rast se lufta për të mbështetet në parimin e kombësisë dhe çohet deri në sigurimin e autonomisë së Shqipërisë”*<sup>39</sup>.

Për rrjedhojë, ngjarjet e zhvilluara në Shqipëri në fund të shek. XIX, çuan në formimin e Lidhjes së Prizrenit më 10 qershor të vitit 1878. Pikërisht, kjo organizatë që do të shfaqë tipare kombëtare dhe patriotike u krijua në kohën kur situata në Ballkan dhe në Evropë paraqitej mjaft e ndërlikuar.

Për vlerësimin e qëndrimit të Portës së Lartë në këtë periudhë, mendimi ynë rezonon me atë të prof. Kristo Frashërit, i cili afirmonte faktin se ajo kundërshtonte prerazi çdo përpjekje të

---

<sup>39</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 125.

shqiptarëve për krijimin e një organizate kombëtare me cilësinë e garantuesit të tërësisë territoriale dhe njëherësh pranonte formimin e një lidhjeje më karakter islamik<sup>40</sup>.

Ndërkaq, u bë i njohur fakti i thirrjes së Kongresit të Berlinit në 13 qershor të vitit 1878. Në një rrethanë të tillë, patriotët shqiptarë intensifikuan përpjekjet për thirrjen e një kuvendi të përgjithshëm në Prizren të Kosovës në 10 qershor të vitit 1878. Iniciativën për mbledhjen e kuvendit të Prizrenit e mori klubi i Stambollit drejtues i të cilit në këtë kohë rezultonte patrioti Abdyl Frashëri. Në dy peticionet e para që Lidhja e Prizrenit i dërgoi Kongresit të Berlinit dhe Portës së Lartë, kërkohesh krijimi i një vilajeti të bashkuar duke kundërshtuar kategorikisht copëtimin e trevave shqiptare. Në këtë kontekst, në thelb të këtyre peticioneve qëndronte kërkesa për autonomi administrative dhe njëkohësisht ruajtja e integritetit tokësor të trevave shqiptare<sup>41</sup>.

Në një kontekst të tillë, në 17 qershor 1878 u miratua Karanameja dhe Talimati. Por duhet thënë që kërkesa për autonomi fillimisht nuk gjeti pasqyrim në këto dy dokumente kryesore që u miratuan nga Kuvendi i Prizrenit. Një fakt i tillë shpjegohet me dominimin fillimisht në kuvend të delegatëve që përfaqësonin krahun pro sulltanist, ndërkohë që përfaqësuesit e rrymës radikale dhe të rrymës së moderuar fillimisht rezultojnë në minorancë. Në këtë kuadër, duke ju referuar dokumentacionit të kohës, evidentohet një fakt mjaft interesant, parashtruar përmes një memorandumit në 13 qershor 1878, drejtuar kryetarit të delegacionit britanik në Kongresin e Berlinit, lordit Bikonsfild nga një grup patriotësh shkodranë<sup>42</sup>. Duke parashtruar një varg argumentesh historikë, gjeopolitikë dhe fetarë, hartuesit e memorandumit dolën edhe me kërkesën e pavarësisë, për krijimin e një shteti të pavarur sipas rrethanave, në mbrojtjen e Fuqive të Mëdha duke u shprehur se: “... por është gjithashtu e drejtë që të gjithë grekët të bashkohen si një komb i vetëm dhe që shqiptarëve t’u kthehet, t’u konfirmohet dhe t’u njihet pavarësia e tyre”.<sup>43</sup> Në këtë kuadër, nëpërmjet këtij memorandumit synohej të krijohej bindja ndër diplomatët britanikë se një Shqipëri e pavarur do të konsiderohej si një mburojë ndaj pansllavizmit dhe në të njëjtën kohë si një element ekuilibri politik dhe tregtar në Ballkan. Porse, në të njëjtin memorandum paraqitet gjithashtu edhe kërkesa për njohjen e autonomisë duke u

---

<sup>40</sup> Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 1989, vëll.1, 68. Tek konsujt e huaj që ishin në Shqipëri në këtë periudhë ekziston mendimi se lidhja e Prizrenit mori karakterin e një lidhjeje myslimane. Data e parë ishte caktuar 5 qershori i vitit 1878.

<sup>41</sup> Arben Puto, *Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të Periudhës së Imperializmit*, vëll. I, Tiranë: 1984, 150-151.

<sup>42</sup> K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare ...*, vepër e cituar, 213.

<sup>43</sup> Arben Puto, *Çështja shqiptare ...*, vepër e cituar, Tiranë: 1984,144.

shprehur se: “*Prandaj, në qoftë se duhet respektuar më mirë, lidhur me Shqipërinë, parimi i tërësisë së Perandorisë Osmane, ky parim nuk shkelet me njohjen e autonomisë shqiptare*”<sup>44</sup>.

Është rasti të theksojmë se parashtrimi i kërkesës për pavarësi në atë kontekst kohor ishte i parakohshëm. Shkaqet që e kushtëzojnë një dukuri të tillë paraqiten tepër komplekse dhe nuk duhen parë kurrsesi të shkëputur nga konjunkturat politike të kohës. Natyrisht, për to është folur shumë në historiografinë shqiptare, por që në studimin tonë do të ndalemi në trajtimin e njërit prej tyre, e pikërisht të atij që me veprimin e ushtruar rezultonte themelor. Duke vijuar këtë logjikë, pohojmë se domosdoshmëria e thirrjes së Kongresit të Berlinit, buronte nga strategjia e ruajtjes së ekuilibrave territorialë në Evropën e atëhershme. Realiteti i ruajtjes së këtyre ekuilibrave, përputhej tërësisht me strategjinë diplomatike të hartuar e të ndjekur nga kancelari i Gjermanisë Otto Fon Bismark. Madje ruajtja e status-quo-së, që nënkuptonte mospërfitime territoriale nga fuqitë e mëdha të kohës, përbënte edhe një prej tri elementëve të objektivave fundamentale, që kërkonte të përmbushte kancelari i hekurit.

Në këtë kontekst, Kongresi i Berlinit do të rikthente ekuilibrat e prishur territorialë përmes kufizimit të dukshëm në zbatim të traktatit të Shën Stefanit, veçanërisht frenimin e zgjerimit të shteteve sllave me territore që nuk i përkisnin etnisë së tyre. Parë nga optikë, është e kuptueshme se strategjia e Bismarkut për ruajtjen e ekuilibrave territorialë kërkonte ruajtjen e Perandorisë Osmane, ndaj kërkesa për pavarësi do të tingëllonte për momentin e parakohshme.

Ndërkaq, në studimin tonë nuk kemi për objekt trajtimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në tërë problematikën që ajo shtron. Këndvështrimi ynë në këtë rast priret drejt trajtimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si bashkërenduese e veprimeve që zhvilloheshin në atë kohë në nivel pankombëtar. Për rrjedhojë, në këtë punim vend kryesor do të zërë bashkëmarrëdhënia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me degën e saj të krijuar në Elbasan. Sidoqoftë ky punim për sa i takon Lidhjes Shqiptare të Prizrenit do të ndalet në trajtimin e përmbledhur të disa treguesve të veprimtarisë së saj, të cilët në një mënyrë apo tjetër ndikuan drejtpërsëdrejti në portretizimin tërësor të krejt veprimtarisë së saj në dobi të zgjidhjes së çështjes kombëtare.

Në këtë kuadër, Kuvendi që u mblodh në Prizren në 1 korrik 1878, do të jetë përcaktues në karakterin kombëtar të Lidhjes së Prizrenit. Ndërkohë, krijimi i një ushtrie shqiptare nën varësinë e Lidhjes së Prizrenit, do të përfaqësojë njëkohësisht hapin e parë për ti dhënë kësaj

---

<sup>44</sup> *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, Tiranë: 1978, 25. Memorandumi mban datën 13 qershor 1878.



Lidhjeje karakter kombëtar.<sup>45</sup> Fillimisht, evidentohet krijimi i Këshillit të Përgjithshëm me funksione legjislative dhe krijimi i Komitetit të Lidhjes me komisionet vartëse të tij. Krijimi i organeve të tilla, do të krijojë premisat e favorshme drejt formimit të një pushteti të pavarur nga administrata osmane. Në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm do të zgjidhet Iljaz pashë Dibra, ndërsa nënkryetar Mustafa efendi Tetova.<sup>46</sup>

Ndër detyrat më kryesore të Komitetit Kombëtar do të ishin edhe ruajtja e qetësisë dhe e rendit publik, duke ia rekomanduar këtë edhe degëve të lidhjes të krijuar në krahina të ndryshme të vendit. Kështu, me organizimin e rendit publik do të merreshin komitetet dhe degët e Lidhjes së Prizrenit që do të krijoheshin shumë shpejt nëpër krahinat e vendit. Ndërkohë, krijimi i degëve të komiteteve nga ana e Lidhjes Shqiptare, nuk konsiderohej si zgjedhja e duhur nga konsulli britanik Kirby Green, i cili për këtë problem do të shprehej: “ *Meqenëse Lidhja u nda në komitete dhe nënkomitete –disa fetarë dhe ushtarakë-pak a shumë e ka humbur rëndësinë e vet, por akoma ka mjaft influencë për të bërë një rezistencë të ashpër kundër çdo mase që i kundërvihet interesave shqiptare*”.<sup>47</sup> Mendojmë se përmes një pohimi të tillë, konsulli britanik midis të tjerave shprehte njëkohësisht qëllimin dhe karakterin shqiptar të Lidhjes së Prizrenit. Rregullat e vendosura në këtë periudhë që ndalonin gjakmarrjet, pijet alkoolike, lojën e kumarit apo veset banale, mbështeteshin në udhëzimet e Komitetit Kombëtar të Lidhjes për ruajtjen e rendit dhe qetësisë. Ndërkohë, detyrë imediate e këtij Komiteti rezultonte ruajtja e tërësisë territoriale e trevave shqiptare.

Në këtë kontekst, përmes dokumentacionit të kohës pasqyrohen disa nga vendimet që Komiteti Kombëtar i Lidhjes do të marrë në ditët e para të muajit korrik të vitit 1878, disa prej të cilave po i pasqyrojmë si më poshtë:

- Të gjithë burrat e aftë për luftë duhet të marrin armët, nga një njeri për familje.
- Sanxhaku i Shkodrës duhet të japë 30. 000 burra.
- 30. 000 burra të rretheve Tiranë, Elbasan, Ohrit, Matit dhe Dibrës duhet të shkojnë në Shkodër për të formuar një korpus të vetëm me kontigjentin e këtij sanxhaku.<sup>48</sup>

---

<sup>45</sup> *Histori e Popullit shqiptar*, vepër e cituar, 158.

<sup>46</sup> K. Frashëri, *Lidhja ...*, vepër e cituar, 204.

<sup>47</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në Dokumente Angleze (1878-1881)*, përpunuar nga Skënder Rizaj, Prishtinë: 1978, 102.

<sup>48</sup> *Konsullata e Francës në Shkodër*, vëll. 21, fl.(166r – 169v), përkthyer nga origjinali në frëngjisht, në *Akte të Rilindjes ...*, vepër e cituar, 58. Këto vendime janë nxjerrë nga informacioni i dërguar Vadingtonit ministër i punëve

Gjithashtu, përmes burimeve të huaja konstatohet fakti se kontigjentet e armatosura nën varësinë e Lidhjes së Prizrenit, do të kishin si qëllim themelor mbrojtjen vetëm të trevave shqiptare që planifikoheshin të copëtoheshin nga vendimet e Fuqive të Mëdha. Për këtë problem, konsulli britanik në Shkodër do të pohonte se: *“Lidhja nuk ka për qëllim të luftojë as kundër Malit të Zi, e as kundër Austrisë, Serbisë, Bullgarisë, Rusisë ose Greqisë, por do ta njoftojë botën se Shqipëria është në njëfarë mënyre tokë me trashëgimtarë, dhe se sulltani nuk mund ta nxjerrë në treg as një pëllëmbë të saj pa marrë pëlqimin e trashëgimtarëve të saj legjitime - të shqiptarëve”*<sup>49</sup>. Sikurse shihet, ky pohim krahas vendosmërisë për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë të territorit shqiptar, përbën njëkohësisht edhe një premisë më shumë në evidentimin e profilit kombëtar të krejt veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kundërshtia që ajo do t’i ofronte sulltanit në rastin kur ai të nxirrte në treg qoftë edhe një pëllëmbë të territorit shqiptar, pa marrë më parë pëlqimin e tyre, shprehte qartësisht konfirmimin më të mirë të realitetit të sipërpërmendur.

Ndërkaq, sikurse e kemi theksuar në punimin tonë më së shumti do të fokusohemi në shtjellimin e veprimtarisë së degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan. Në këtë kontekst, përmes letërkëmbimit të Abdyl Frashërit me kryetarin e Lidhjes së Prizrenit Iljaz Pashë Dibrën që datohet në 8 dhjetor të vitit 1878, informohemi se në Elbasan ishte krijuar një degë e Komitetit të Lidhjes së Prizrenit të njohur me emrin *Komiteti i Ndërlidhjes*. Funkzioni kryesor i këtij Komiteti me qendër në Elbasan, konsistonte në koordinimin e veprimtarive midis komiteteve përkatëse të trevave të veriut dhe atyre të jugut. Në Elbasan, komiteti në fjalë njihej me emrin *“Xhemijeti Ihtihadije”*(Shoqëria e Besës).

Misioni që kishte marrë përsipër organizatori i Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashëri<sup>50</sup> synonte në përforcimin e bashkëpunimit midis komiteteve të krijuar në trevat shqiptare dhe për më tepër, në forcimin e bashkëveprimit midis komiteteve të veriut dhe atyre të jugut, ku mund të thuhet se lidhjet midis tyre fillimisht rezultojnë të ishin jo shumë të forta. Kështu, Komiteti i Janinës funksiononte në cilësinë e degës drejtuese të Lidhjes për Jugun, ndërsa lidhjet midis jugut dhe komiteteve të veriut të Prizrenit, Shkodrës, përveç degës së krijuar në Selanik,

---

të jashtme të Francës. Vendimet ishin sjellë në Shkodër nga delegatët e Shkodrës në Prizren dhe ishin publikuar në një mbledhje të popullsisë së qytetit në 7 korrik 1878.

<sup>49</sup> *Lidhja Shqiptare ..., vepër e cituar*, 105.

<sup>50</sup> Në një nga burimet e asaj kohe konstatohet fakti se emri i Abdyl Frashërit në memorandumet që Lidhja i dërgonte qeverisë osmane rezultonte të ishte *Abdullah Hysni*. *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare..., vepër e cituar*, 70.

mbaheshin nëpërmjet degës së Elbasanit që shërbente si urë ndërmjetëse midis tyre<sup>51</sup>. Ja si shprehet Abdul Frashëri në letrën e dërguar Iljaz Pashë Dibrës: *“I lumnueshmi Zotni. Me t’u nisun nga Dibra erdha në Elbasan ku takova me Xhamijetin Ihtihadije të këtushëm, të cilët ia dhashë letrën e shkëlqesisë tuaj bashkë me fletën e përfaqësisë s’uaj. E vulosën dhe më dhanë fjalën se do t’iua çojmë shkëlqesisë tuaj. Menjëherë u nisa dhe erdha në Berat.*

*9 dhjetor 1878, prej Janine”.*<sup>52</sup>

Ndërkohë, Abdul Frashëri duke pasqyruar edhe itinerarin e udhëtimit të tij shprehet se: *“Prej andej shkova në Berat. Në Berat paria dhe gjithë populli myslimanë dhe të krishterë u gëzuan shumë për vendimet e Dibrës... Prej Beratit shkova në Vlorë ... Nga Vlora shkova në Delvinë... Prej andej shkova në Prevezë. Këtu u gëzuan shumë tepër për bashkimin e plotë dhe për vendimet e Dibrës.”*<sup>53</sup>*...Prej Preveze erdha këtu në Janinë”*<sup>54</sup>. Kështu, përmes korrespondencës midis Abdyl Frashërit dhe Iljaz Pashë Dibrës, konstatohet ekzistenca e degës së komitetit të Lidhjes së Prizrenit në Elbasan në dhjetor të vitit 1878. Në përputhje me programin themelor të Lidhjes së Prizrenit, veprimtaria e kësaj dege u shtri në krejt trevën trevën e Elbasanit. Ndërkaq, posaçërisht për zhvillimin e një veprimtarie të tillë në këtë trevë, nga dokumentacioni i kohës rezultojnë të jetë krijuar gjithashtu edhe dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Elbasanin e njohur me emrin *“Iftifaku”*.

Përsa i përket kohës së krijimit të degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan dokumentacioni i kohës dëshmon për krijimin e saj në 7 prill të vitit 1879. Ndërkohë duhet thënë se kjo degë ka funksionuar për pothuajse dy vjet<sup>55</sup>.

Sikurse konstatohet në burimin përkatës, në këshillin drejtues të degës së Elbasanit bënin pjesë përfaqësues të familjeve të mëdha feudale sikurse ishin: Ismail bej Vërlaci, Isuf bej Biçakçiu, Shazivar bej Karaosmani dhe myftiu i qytetit të Elbasanit Hasan Tasin efendi Alltoka në cilësinë e kryetarit të kësaj dege, ndërsa anëtarët të saj rezultojnë përfaqësuesit e esnafëve të qytetit të Elbasanit. Ndërkohë, rregullat e pasqyruar në dokumentin përkatës të degës së Lidhjes

---

<sup>51</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 167.

<sup>52</sup> Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Tiranë: Egnatia, 2006, 77.

<sup>53</sup> Kuvendi i Dibrës u mbledh në 1 nëntor 1878. Aty u vendos të krijohet një delegacion i përbërë nga 14 personalitete shqiptare, 8 nga veriu dhe 6 nga jugu, i cili do t’i paraqiste rezolutën e dalë nga ky kuvend. Portës së Lartë. Në viset jugore detyrën për të bindur personalitetet shqiptare për të marrë pjesë në këtë delegacion e mori Abdyl Frashëri si përfaqësues i Lidhjes së Toskërisë. .

<sup>54</sup> K. Frashëri, *Lidhja ...*, vepër e cituar, 278.

<sup>55</sup> AME, Dorëshkrim, kopje dokumentesh nxjerrë nga Fondi. Lef Nosi depozituar nga Shyqyri Demiri.

së Prizrenit në këtë kohë në Elbasan, rezultoni në koherencë të plotë me objektivat e Komitetit Kombëtar të Lidhjes së Prizrenit në funksion të ruajtjes së rendit dhe qetësisë.

Për të krijuar një ide të qartë në lidhje me krijimin dhe përbërjen e degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan po parashtrijmë dokumentin e mëposhtëm.

### ***Iftifaku n Elbasan, (Liga e Prizrenit)***

*Me 25 Maj 1295[Me kalendarin e vjetër] u ngref Iftifaku n Elbasan*

*Konditat ishin: Vrasje mos bahet, vjedhje mos bahet.*

*Njerëzit e këqij të futen në dorë, raki në pazar mos pihet dhe pushkë mos shtihen. Populli këtë gjendje e quante dalja e Sheriatit në Mejdah.*

***Këshilla drejtuese përbëhej nga: Myftiu Hasan Tahsin effendi Alltokës, Ismail bej Vërlacit, Isuf bej Biçakçiu, Shazivar bej Karaosmanit.*** <sup>56</sup>

Duke ju referuar dokumentacionit përkatës të kësaj periudhe, pohojmë se procesi i krijimit të degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan fillimisht do të paraprihet nga krijimi i Komitetit të Ndërlidhjes, rezultonte të ishte krijuar në dhjetor të vitit 1878 dhe njihej me emrin “*Xhemijeti Ihtihadije*”. Do të jetë ky komitet i cili më pas do të marrë funksionet e degës së Lidhjes së Prizrenit për Elbasanin. Ndërkohë duhet thënë se dega e Lidhjes së Prizrenit në Elbasan kishte formuar edhe një njësi të armatosur, të drejtuar nga anëtarët e saj, që përbëhej kryesisht nga përfaqësuesit e esnafëve të qytetit<sup>57</sup>.

Për sa i përket qëllimit që do të shfaqte dega e Lidhjes së Prizrenit në Elbasan, mendimi ynë rezonon me atë të Stavro Skëndit i cili pranon faktin se kjo degë shërbente si një urë komunikimi dhe ndërlidhjeje midis veriut dhe jugut duke pohuar se : “*Kur u krijua Lidhja, të dy degët ajo e veriut dhe ajo e jugut, ishin marrë vesh që të takoheshin me anën e njerëzve të tyre të besuar në Elbasan, në Shqipërinë Qendrore*”<sup>58</sup>.

Pikërisht, në këtë kohë aktiviteti i degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan, u shtri deri në krahinat më të thella të trevës së Elbasanit, si në Shpat, Sulovë, Vërçë, etj. Në këtë periudhë, Elbasani në kuadrin administrativ bënte pjesë në kazanë e sanxhakut të Manastirit. Sipas të dhënave që na jepen nga konsulli austro-hungarez Knapic, konstatojmë se në këtë qytet patriotët arritën të përfundojnë regjistrimin e vullnetarëve të gatshëm për të luftuar kundër vendimeve

<sup>56</sup> Po aty. Gjithashtu përfaqësues rezultoni edhe anëtarët e esnafit; Abduraman Zaimi, Mehmet Pajuni, Faje Uruçi, Veli haxhi Misërliu, Beqir Mezja, Ismail Haxhimusaj, Haxhi Fejzulla Miraku.

<sup>57</sup> Kadri Musaj, *Aqif Pashë Elbasani...*, vepër e cituar, 20.

<sup>58</sup> Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, përkthyer nga Skënder Luarasi e Nestor Nepravishta, Tiranë: Phoenix, 2000, 95.

antishqiptare të Kongresit të Berlinit.<sup>59</sup> Një pjesë e vullnetarëve që iu përgjigjën thirrjes së degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishin nga krahina e Shpatit, përfaqësues i së cilës në degën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit rezultonte patrioti Jonuz Topuzi, i cili mbante kontakte edhe me Abdyl Frashërin<sup>60</sup>.

Në këtë kuadër, mendojmë se roli i Elbasanit në kuadrin organizativ falë pozicionit gjeografik të tij midis veriut dhe jugut të Shqipërisë ishte paracaktuar që me krijimin e Lidhjes së Prizrenit. Kështu, në vitet 1878-1880 patriotët Elbasanas pavarësisht pengesave të shumta që vinin nga administrata osmane e përmbushën me sukses një detyrë të tillë. Duke hulumtuar në dokumentacionin e kohës, konstatojmë përpjekjet e pandërprera që zhvillonte kajmekani turk i Elbasanit, për të penguar zgjerimin e degës së Lidhjes së Prizrenit të Elbasanit, përmes ushtrimit të dhunës e presionit. Duke iu referuar të dhënave që ofron dokumentacioni i mësipërm, informohemi se dega e Lidhjes së Prizrenit përmes veprimtarisë së njësisë së armatosur të Elbasanit e detyroi kajmekamin të heqë dorë nga veprimet e tij<sup>61</sup>.

Në kërkesën që qytetarët e Elbasanit në këtë periudhë i bëjnë valiut të Manastirit, kërkohej zëvendësimi i kajmekanit të mëparshëm me një kajmekan vendas, duke e konsideruar plotësimin e kërkesës së tyre si garanci për ruajtjen e qetësisë. Dokumenti përkatës që pasqyron një kërkesë të tillë shoqërohet me firmat e myftarëve të mëhallave që përfaqësonin të gjitha lagjet e qytetit të Elbasanit<sup>62</sup>. Ky dokument është paraqitur në formën e një ultimatumit të nënshkruar prej 25 kryepleqve të lagjeve të qytetit të Elbasanit dhe njëkohësisht të shumë esnafëve myslimane e të krishterë, gjithsej 153 vula dhe firma, nga të cilat 38 firma janë në greqisht<sup>63</sup>.

Ndërkaq, kur veprimtaria e degës së Elbasanit ishte në kulmin e saj, autoritetet turke, me ndihmën edhe të përfaqësuesve të krahut sulltanist në Elbasan, u përpoqën të pengonin pjesëmarrjen e fshatarëve të trevave të Elbasanit në këtë degë, e për më tepër dy vjet pas formimit të saj të arrinin deri në eliminimin e saj<sup>64</sup>. Në periudhën e viteve 1879-1880 qeveritarët osmanë organizojnë kundrejt aktivistëve të degës së Lidhjes së Prizrenit të Elbasanit terror individual, duke krijuar një situatë të rënduar.

---

<sup>59</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan: 2003, 344.

<sup>60</sup> Po aty.

<sup>61</sup> Kadri Musaj, *vepër e cituar*, 20.

<sup>62</sup> Dokumenti mban datën 21 qershor 1879. Vulat e lagjeve muslimane janë në turqisht ndërsa ato të lagjeve të krishtera në greqisht.

<sup>63</sup> Sh. Demiri, *vepër e cituar*, 76.

<sup>64</sup> Po aty.

Në këtë kohë, dy nga drejtuesit kryesorë të Lidhjes Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Beu (Vrioni) ndërmorën një udhëtim në kryeqytetet e Evropës për të siguruar përkrahjen ndërkombëtare rreth çështjes së kufijve jugorë të trevave shqiptare. Sipas raportit të konsullit britanik në Shkodër ata ndaluan në Romë, Paris, duke u shprehur se: “... në porosinë e tyre politike duke iu dërguar letra shokëve të vet në qytetet kryesore të Shqipërisë së Mesme, e duke i ngritur që t'i kundërshtojnë të gjitha idetë në lidhje me bashkimin e ardhshëm me Greqinë...”<sup>65</sup>. Pikërisht, në këtë kohë vjen në qytetin e Elbasanit Mahmut Pashë Biçaku, i cili merr përgjegjësinë e drejtimit të degës së Elbasanit. Nga ky çast veprimtaria e kësaj dege fillon të gjallërohet<sup>66</sup>.

Mahmut Pasha spikat si aktivist i shquar i kësaj dege. Faktikisht, në dokumentat që disponojmë për këtë periudhë ndër emrat që përbëjnë këshillën drejtuese të degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan, nuk rezulton emri i Mahmut Pashë Biçakut. Por rezulton evidente veprimtaria aktive e tij në këtë periudhë, përmes korrespondencës së rregullt dhe kontakteve që ai kishte me Abdyl Frashërin dhe Iljaz Pashë Dibrën.

Në këtë kontekst, duke ju referuar aktivitetit të tij në këtë periudhë jemi të mendimit se realisht ai ishte drejtuesi degës së Elbasanit. Mahmut Pashë Biçaku bënte pjesë në grupin e të moderuarve që ishte krijuar në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në këtë periudhë, krahas Ali bej Guci-së, Iljaz pashë Dibrës dhe Omer pashë Vrionit, të cilët e mbështetnin idenë e krijimit të një vilajeti të bashkuar autonom shqiptar të pajisur me autonomi administrative, por që deri në atë periudhë nuk e shikonin këtë vilajet si një hallkë drejt krijimit të një shteti të pavarur shqiptar<sup>67</sup>. Mahmut Biçakçi do të organizonte pritje të ngrohta e përcjellje të sigurta për shumë anëtarë të Lidhjes, përfshirë këtu dhe anëtarë me shumë rëndësi, sikur ishte Abdyl Frashëri e të tjerë.

Kështu, në vitin 1880 konstatohen përpjekjet e Komitetit Ndërkrahinor për Shqipërinë e Jugut, në funksion të zbatimit të platformës autonomiste, që më së shumti u pasqyrua në kundërshtimin e taksave të vendosura dhe reformave administrative në vilajetet shqiptare. Kësaj kohe i përket edhe krijimi gradualisht i një administrate shqiptare paralelisht me atë osmane. Duhet thënë se në qendër të kësaj lëvizjeje për autonomi qëndronte Vilajeti i Manastirit dhe ai i Janinës. Çështja e autonomisë u diskutua fillimisht në mbledhjen e organizuar në Frashër(të

---

<sup>65</sup> *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze*, vepër e cituar, 121.

<sup>66</sup> AME, Kutia 2, Dos. 6, fl. 3.

<sup>67</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 150.

Përmetit) në fillim të qershorit 1880, ku u vendos krijimi i një qeverie të përkohshme për të gjithë Shqipërinë<sup>68</sup>. Gjithashtu, mbledhja e Frashrit u pasua edhe nga kuvende të tjera, sikurse ishte Kuvendi i Gjirokastrës në 23 korrik 1880, i cili u mbledh me nismën e Komitetit Ndërkrahinor për Shqipërinë e Jugut. Qëllimi i Kuvendit të Gjirokastrës konsistonte në kundërshtimin e rezolutës Nr. 1, të miratuar në Kongresin e Berlinit për ratifikimin e kufirit jugor në favor të Greqisë. Pikërisht, ndër vendimet që u morën në këtë kongres, më kryesori ndër to kishte të bënte me synimin e shqiptarëve për të penguar Portën e Lartë të zbatonte rezolutën nr. 1 të miratuar në Kongresin e Berlinit, në rast të kundërt deklarohet se do të krijohet një qeveri e Përkohshme dhe do të hartohet një Kushtetutë<sup>69</sup>.

Në këtë kuadër, mund të themi se lëvizja shqiptare në këtë periudhë po përvijonte tensione edhe në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane. Një fakt i tillë gjen pasqyrim edhe në pohimet e të ngarkuarit të Francës në Cetinë në maj 1880 i cili shprehet se: *“Mjerisht kjo gjendje është shumë e rrezikshme dhe mund të shkaktojë përsëri ngritjen e Çështjes së Lindjes”*<sup>70</sup>.

Në këtë kohë, figura kryesore në kuadrin e kësaj lëvizjes për autonomi që kishte përfshirë si veriun dhe jugun e Shqipërisë rezultonte të ishte Abdyl Frashëri, veprimtaria e të cilit konsiderohej si një kërcënim për vetë Perandorinë. Nën/konsulli i Francës në Janinë, në raportet që i dërgonte eprorëve të tij ishte mese i informuar për aktivitetin dhe veprimtarinë e Abdyl Frashërit duke e konsideruar atë si përgjegjës kryesor për gjendjen e krijuar në Shqipëri duke u shprehur se: *“Abdyl beu, [Frashëri], partizan i qëndresës, po mundohet t’u futë toskëve ose shqiptarëve të jugut këto ide të mos nënshtrimit duke i quajtur gegët e veriut si racë e pamposhtme”*<sup>71</sup>. Gjithashtu, në të njëjtin burim informohemi edhe për urdhrin për arrestimin e Abdyl Frashërit dhe dërgimin e tij në Janinë.

Ndërkohë, në 20 tetor të vitit 1880, do të mbledhet kuvendi i dytë i Dibrës në të cilin morën pjesë 300 delegat përfaqësues të katër vilajeteve shqiptare të shoqëruar nga 5 mijë shqiptarë të armatosur.<sup>72</sup> Mbledhja e këtij kuvendi do të pasqyrohet përmes informacioneve të konsullit francez në Shkodër i cili raportonte se: *“Në këtë moment janë mbledhur në Dibër krerët*

---

<sup>68</sup> Po aty, 193.

<sup>69</sup> Po aty, 197.

<sup>70</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, vëll. II, Tiranë: 1986, 191. AMAE CP, vëll. 2, fl. 174r-175r.

<sup>71</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes ...*, vepër e cituar, 153. AMAE CPC, Nënkonsullata e Francës në Janinë, vëll. 10, fl. 298r-301r.

<sup>72</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 202.

*kryesorë dhe bejlerët më me ndikim të Shqipërisë, me qëllim që të diskutojnë çështjen e pavarësisë[vetëqeverisjes] së vendit të tyre*<sup>73</sup>.

Në kuvendin e Dibrës treva e Elbasanit do të përfaqësohet nga Sadik pashë Elbasani. Në kuadrin e problemeve që trajtoi ky kuvend, domosdoshmëri konsiderohej mbrojtja me armë e Ulqinit dhe krijimi i një vilajeti autonom shqiptar mbi bazën e programit të miratuar në Kuvendin e Gjirokastrës. Ndër të tjera pati propozime edhe për kryeqytetin e këtij vilajeti, ku kandidatura më e fortë ishte për Elbasanin<sup>74</sup>.

Ndërkaq, përmes një korrespondencë të nënkonsullit austriak në Tivar, informohemi se Elbasani i është përgjigjur propozimit që vinte nga Komiteti i Shkodrës për të kërkuar autonominë e Shqipërisë dhe njëkohësisht edhe kërkesës për vullnetarë në mbrojtje të Ulqinit. Në këtë kontekst, nga treva e Elbasanit në mbrojtje të Ulqinit (tetor-nëntor 1880) u nisën rreth 3000 vetë që u vunë në shërbim të degës së Shkodrës.<sup>75</sup> Në informacionet e konsullit francez në Shkodër në 29 tetor 1880, rezultonte se shumë vullnetarë ishin drejtuar për në Ulqin, duke shfaqur vendosmërinë për të rezistuar ndaj aneksimit të qytetit<sup>76</sup>.

Sikurse konstatohet nga burimet e kohës, përpjekjet për aneksimin e Ulqinit zgjatën rreth një muaj. Në 1 nëntor 1880 trupat shqiptare i prenë rrugën 6 batalioneve të përbërë nga trupa të rregullta turke të cila u nisën nga Shkodra për në Ulqin dhe drejtoheshin nga Riza Pasha, ndërkohë që reparte të tjera turke pritëshin të zbarkonin nga deti për të mbështetur trupat tokësore<sup>77</sup>. Në 2 nëntor 1880 zbarkimi i trupave turke nën drejtimin e Dervish Pashës gjen kundërshtim të plotë nga forcat shqiptare, duke e detyruar Dervish Pashën të drejtohej për në Shkodër<sup>78</sup>. Në takimin e tij me krerët shqiptarë ai u përpoq t'i bindë ata se dorëzimi i Ulqinit ishte i pashmangshëm, duke kërkuar prej tyre në këtë rast sigurinë për mos ndërhyrje. Ndërkohë në 19 nëntor konsulli francez në Shkodër raportonte për konfrontimet e para të trupave turke me ato shqiptare në rrethinat e Ulqinit.<sup>79</sup>

Sikurse është bërë e njohur, pas një rezistence heroike të popullsisë shqiptare dhe me asistencën detare të Fuqive të Mëdha në Adriatik në mbështetje të zbatimit të vendimit për

---

<sup>73</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare...*, vepër e cituar, 326. Konsullata e Francës në Shkodër, vëll. 22, fl. 174r.

<sup>74</sup> Ebasani-Enciklopedi, vepër e cituar, 344.

<sup>75</sup> Sh. Demiri, vepër e cituar, 78.

<sup>76</sup> *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare...*, vepër e cituar, 328. AMAE CPC, Konsullata e Francës në Shkodër, vëll. 22, fl. 174r.

<sup>77</sup> *Po aty*, 329..

<sup>78</sup> *Po aty*, 330.

<sup>79</sup> *Po aty*, 372.



dorëzimin e qytetit, trupat ushtarake turke të drejtuara nga Dervish Pasha do të hyjnë në Ulqin në 24 nëntor 1880. Përfaqësuesi i Francës në Cetinë, konfirmon futjen e trupave ushtarake të Malit të Zi në mbasditen e 26 nëntorit të vitit 1880<sup>80</sup>.

Ndërkohë, duhet thënë se në vitin 1881 veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit njohu një rënie, si rrjedhojë e veprimit të shumë faktorëve, përfshirë këtu edhe masat represive që ndërmoi ndaj saj Porta e Lartë në Prizren dhe në Shkup.

Në këtë kontekst, një ndër udhëheqësit kryesorë të Lidhjes së Prizrenit Abdyl Frashëri, në prill të vitit 1881 për ti shpëtuar arrestimit u detyrua të largohet nga Prizreni. Mendohet se Abdyl Frashëri, (për kapjen e të cilit ishte vendosur edhe një shpërblim), kishte vendosur të largohej nga Shqipëria për në Angli, por nuk arriti dot të largohet në kohë nga Shqipëria<sup>81</sup>. Ai kaloi nga Mozga (sot Katundi i Ri), kapërceu Shkumbinin për të dalë në fshatin Bujqëz, në drejtim të Cërrikut, ku do të takohej me atdhetarët e Elbasanit me në krye Mahmut Pashë Biçakun në çifligun e tij në Cërrik. Burimet dokumentare të kohës dëshmojnë se autoritetet qeveritare informohen për këtë takim nga Shazivar bej Karaosmani. Pikërisht ky informacion bëri të mundur arrestimin në afërsi të Bujqëzitet të Abdyl Frashërit nga një togë xhandarësh të drejtuar nga një çauash (reshter), i quajtur Jakup Shehu<sup>82</sup>.

Për udhëtimin e Abdyl Frashërit nën prefektura e Elbasanit lajmërohet nga prefektura e Dibrës. Abdyl beu së bashku me dy shoqëruesit e tij Mehmet Islamin nga Arbona dhe Ymer Mustafën nga Mamujësi në fshatin Bujqës, ndeshet me patrullën e drejtuar nga Jakup Çaushi, që ju paraqit si i dërguar i Mahmut Biçakut me të cilin Abdyl Beu kishte lënë takim. Kur arritën në qytet, Jakup Shehu (Çaushi) e dërgon Abdyl Beun tek Kajmekani. Në këtë moment ai i drejtohet me këto fjalë: *“Më trahtove se un po përpiqem t’a shpëtoj këtë vend”*<sup>83</sup>.

Një kopje e raportit të arrestimit të Abdyl Frashërit i dërgohet dhe vije-konsullit të Manastirit (Novikov) dhe mban datën 22 prill / 4 maj të vitit 1881.

Gjithashtu çështja e kapjes së Abdyl Frashërit do të ndeshet edhe një vit më pas, në një dokument tjetër që mban datën 25 maj 1882 në të cilin thuhet:

*Prefekturës së Dibrës*

*Nr. 93. 12 maj 1297(25 maj 1882)*

---

<sup>80</sup> Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare..., vepër e cituar, 389. Misioni i Francës në Malin e Zi.

<sup>81</sup> Stavro Skëndi, vepër e cituar, 102.

<sup>82</sup> AME, Kutia. 2, Dos. 6, fl. 3.

<sup>83</sup> Xhaferr Belegu, Lidhja e Prizrenit, Tiranë: Naim Frashëri, 1939, 190.

*Me urdhnesë të Dervish Pashës që na u komunikua në shkresën tuaj Nr. 108, datë 10 maj 1297, kërkohet të dihet se Abdyl bej Toska është kapur nga patrulla e organizuar prej Elbasanit apo si ka deklaruar ai vetë (Abdylbeu) rastësisht iu ka dorëzuar vetë gjindarmëve, në qoftë se është kap prej patrullës, kush qe oficeri që ish në krye të patrullës, kush qenë ata që i dhanë shkak kapjes së tij. U banë me këtë rast hetimet. Me të marrë telegramin tuaj, menjëherë kajmekani i kazasë Reshit beu mori masat e duhura dhe efikase. Kajmekani vetë dhe ndihmës kryekomandanti i gjindarmërisë Xhaferr Beu vëzhguan disa ditës pikat nga mund të kalonte në Toskëri, në breg të lumit Shkumbin, afër katundit Bujqës, aty u vu një patrullë e përbëme prej Jakupit, prej dy gjindarmëve dhe katër vetëve nga populli dhe u kap e u sull në qeveri”<sup>84</sup>.*

Sikurse konfirmojnë edhe burimet përkatëse Abdyl Frashëri u kap nga Jakup Çaushi<sup>85</sup> i cili mori edhe shpërblimin e dhënë nga Dervish Pasha. Për këtë veprim Jakup Çaushi, do të ekzekutohet në mes të qytetit të Elbasanit në vitin 1888 nga patrioti shpatarak Jonuz Topuzi, i cili sikurse e kemi përmendur kishte qenë përfaqësues i Shpatit në degën e Lidhjes së Prizrenit për Elbasanin<sup>86</sup>. Një ngjarje e tillë është përjetësuar edhe në krijimtarinë popullore nëpërmjet këtyre vargjeve:

“ Ke muri, ke Namazgjaja  
Krisi pushka, u çudit kasabaja  
Kush e vrau Jakup Çaush’n?  
Çuni i Qoftes me Jonuz Topuz’n  
Çuni i Qoftes me rroba nizami,  
Vranë bylykbashn’ e Elbasanit<sup>87</sup>

Gjithashtu, një fakt tepër interesant në këtë kohë rezulton edhe propozimi i konsullit të përgjithshëm britanik dhe atij austro-hungarez në Shkodër për krijimin e një administrate autonome sikurse thuhej: “... në të gjitha ato distrikte që kishin qenë nën autoritetin e Lidhjes”<sup>88</sup>.

---

<sup>84</sup> Sh. Demiri, *vepër e cituar*, 79.

<sup>85</sup> Jakup Shehu për veprimin që bëri mori shpërblim 5000 grosh dhe u gradua Çaus. Pas kapjes Abdyl Frashëri u dërgua në Manastir, më pas në Prizren ku takohet me Dervish Pashën. Atje u mbajt tre vjet si i burgosur e më pas e dërguan në Balliqesër të Anadollit ku ndenji një vit e më pas u shpall i lirë. Vdiq në shtator të vitit 1892 në Stamboll.

<sup>86</sup> Sh. Demiri, *vepër e cituar*, 79.

<sup>87</sup> Jonuz Topuzi ishte përfaqësues i Shpatit në degën e Lidhjes së Prizrenit Elbasan.

<sup>88</sup> Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Dituria: 2005, 67.

Porse një propozim i tillë që ju drejtua Komisionit të Rumelisë Lindore mbeti në kuadrin e një projekti që nuk gjeti zbatim.

Kështu, pas vitit 1881 lëvizja e organizuar e shqiptarëve pësoi një farë staniacioni, duke u shprehur më së shumti në forma të rezistencës lokale ndaj administratës osmane, që evidentoheshin nëpërmjet kundërshtimit ndaj regjistrimit të popullsisë, vendosjes së taksave të reja dhe pagimit të tyre, kundër mobilizimit të përgjithshëm ushtarak etj.

Në këtë periudhë, një lëvizje e tillë në trevën e Elbasanit evidentohet dukshëm në zonën e Shpatit e cila ishte shndërruar në një qendër të rëndësishme të shqiptarizmit. Midis të tjerave, çështja e regjistrimit të popullsisë me emra myslimanë më së shumti ishte shndërruar në objekt konflikti midis shpatarakëve dhe administratës osmane. Kjo për faktin se në këtë krahinë kishte kohë që ishte shfaqur fenomeni i kriptokristianizmit. Burimet e kohës konstatojnë faktin se shpatarakët, duke filluar që nga vitet tridhjetë të shek. XIX kishin kërkuar haptazi për tu njohur si të krishterë<sup>89</sup>. Në kohën e mbledhjes së taksave shpatarakët e paraqitnin veten si myslimanë dhe në momentin e rekrutimit në ushtri deklaroheshin si të krishterë. Një dukuri e tillë shoqërohej me organizmin ndaj shpatarakëve të ekspeditave ndëshkuese ushtarake, të cilat rezultojnë të kenë qenë të vazhdueshme gjatë viteve 1887-1900. Një ndër ekspeditat më të egra ndaj shpatarakëve konsiderohet ajo e vitit 1894, qëllimi i së cilës ishte shkatërrimi i çetës së Jorgji Joses dhe shuarjen e rezistencës në këtë zonë<sup>90</sup>.

Nisur nga treguesit e mësipërm theksojmë se qëndresa dhe përfshirja e popullit të Elbasanit në lëvizjen patriotike shqiptare ka qenë e vazhdueshme, duke u shfaqur në forma nga më të ndryshme. Ndërkaq, veprimtaria e patriotëve elbasanas evidentohet dukshëm në pjesëmarrjen aktive në mbledhjet e fshehta të Kuvendit të Dibrës, mbajtur në 28 shkurt 1899, qëllimi i të cilave ishte përkrahja ndaj Lidhjes së Pejës, e formuar në janar të po këtij viti me kryetar Haxhi Zekën. Sikurse dihet, qëllimi i kësaj lidhjeje ishte mbrojtja e trevave shqiptare nga rreziku i copëtimit. Patriotët elbasanas, në mbështetjen që i dhanë kësaj lidhjeje, gëzonin përkrahjen edhe të popullsisë së qytetit, e cila shpalli besën e bashkimit me Lidhjen Shqiptare të Pejës. Kështu, në maj të vitit 1899, Lidhja Shqiptare e Pejës u shtri edhe në Elbasan, duke u bashkuar me të edhe popullsia e Çermenikës dhe e Shpatit<sup>91</sup>.

---

<sup>89</sup> E. Nikolaidhou, *Kriptokristianët e Shpatit*, Janinë: 1979, 160.

<sup>90</sup> Po aty.

<sup>91</sup> Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: AlbPAPER: 2004, 156.

Sipas raportimeve të konsullit Kral, në Lidhjen e Pejës komiteti i Elbasanit kishte kërkuar vendosjen e nënpunësve shqiptarë në administratë dhe mësimin e gjuhës shqipe, kërkesa këto që sipas tij shfaqnin tipare autonomiste<sup>92</sup>. Ndërkaq, konstatohet se pas mbledhjes së Pejës, nën drejtimin e komitetit të Elbasanit banorët e armatosur të zonave malore të Shpatit dhe Çermenikës e mbajtën të rrethuar “hyqymetin” në Elbasan, derisa morën garanci nga Valiu i Manastirit për plotësimin e kërkesave të tyre.<sup>93</sup> Forma të tilla të protestave dhe të rezistencës së popullsisë së këtyre krahinave malore në trevën e Elbasanit do të shfaqen edhe në vitet në vazhdim, veprimtaria e cila do të drejtohej nga përfaqësuesit e komitetit të Elbasanit.

Pas Lidhjes Shqiptare të Pejës, lëvizja kombëtare në trevën e Elbasanit do të vijojë të zhvillohet si edhe më parë. Në këtë kontekst, Çermenika kundërshton pagimin e taksave. Çeta të vogla shpatarakësh që vepronin në këtë zonë në formën e lëvizjes së kaçakëve krijojnë një atmosferë të trazuar në administratën osmane. Ndërkohë, në vitin 1901, popullsia e kësaj zone mori pjesë përkrah popullsisë së trevës së Tiranës në kryengritjen kundër regjimit arbitrar të administratës osmane në këtë trevë<sup>94</sup>.

Një mbështetje e tillë konstatohet edhe në vitin pasardhës, kur popullsia e Çermenikës do të përfshihet përsëri në rezistencën e popullsisë së zonës së Shëngjergjit në Malësinë e Tiranës, kundër ekspeditës ushtarake të organizuar nga Valiu i Shkodrës në 11 korrik 1902. Kjo rezistencë, falë mbështetjes së popullsisë së trevës së Tiranës dhe të Elbasanit do të marrë përmasat e një kryengritjeje, që sikurse konstatohet nga burimet e kohës, rrezikonte të krijonte ndërlikime ndërkombëtare për vetë Perandorinë Osmane. Largimi i trupave ushtarake osmane nga zona e Shëngjergjit në 29 korrik 1902, më së shumti do të konsiderohet produkt dhe rezultat i drejtpërdrejtë i një lëvizjeje me përmasa të tilla<sup>95</sup>.

## **I. 2. Komiteti i fshehtë i Manastirit, dega e Elbasanit**

Lëvizja patriotike në trevat shqiptare, do të marrë karakter më të organizuar në vitin 1905, kur krijohet dhe Komiteti i Fshehtë i Manastirit. Në nëntor të vitit 1905, pas disa

---

<sup>92</sup> Tatjana Haxhimihali, *Aleks Buda Kujtime*, Tiranë: 2005, 24.

<sup>93</sup> Po aty.

<sup>94</sup> *Histori e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 304.

<sup>95</sup> Po aty.

kontakteve që patriotët shqiptarë patën në Dibër, Elbasan, Tiranë e në qytete të tjera, me nismën dhe nën kryesinë e Bajo Topullit krijohet një organizatë e fshehtë e njohur me emrin “*Komiteti për Lirinë e Shqipërisë*”, ku ndër detyrat kryesore të tij përveç të tjerave, ishte dhe veprimtaria e natyrës politike<sup>96</sup>.

Duke ju referuar mendimit të studiuesve të huaj, organizimi i tij mbështetej në strategjinë e organizimit të lozhave të Karbonarëve, duke pranuar gjithashtu edhe ndikimin e lëvizjes “sllavo- maqedonase” në formimin e tij<sup>97</sup>.

Në statutin e tij të botuar në Sofje në dy versione; në gegë dhe toskë, përcaktohej si qëllimi më kryesor i formimit të komitetit “ringjallja e Shqipërisë”.<sup>98</sup> Ndërkohë në statut parashikohej edhe parimi kryesor i funksionimit të Komitetit të Manastirit sipas të cilit, çdo anëtar i tij do të njihete vetëm katër anëtarë të tjerë duke krijuar një grup prej pesë anëtarësh. Çdo anëtar i ri i grupit të dytë duhej të rekrutonte nga pesë anëtarë të tjerë. Struktura organizative e këtij komiteti, përcaktohej në rregulloren e brendshme të tij, ku detyrat më kryesore të anëtarëve të Komitetit të Manastirit konsistonin së pari në zbatimin detyrimisht të urdhrave të dhëna prej tij deri në vetëmohim dhe së dyti në pjesëmarrjen sistematike në mbledhjet e organizuara<sup>99</sup>.

Ndërkaq, rezulton se qëllimi kryesor i Komitetit të Manastirit ishte organizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare duke u mbështetur në taktikën e krijimit të çetave të armatosura shqiptare. Në këtë kuadër, ishte ky komitet i fshehtë i cili do të organizojë daljen në mal të çetave të para në pranverë të vitit 1906. Fillimisht konstatohet të jetë krijuar çeta e Bajo Topullit, e cila në jo pak raste ka shkelur nëpër zonat e Shpatit dhe të Bërzeshtës. Në kuadrin e zgjerimit të veprimtarisë së tij në gjithë vendin, komiteti në fjalë në mënyrë të menjëhershme vendosi lidhje të drejtpërdrejta me disa nga patriotët më aktivë të qytetit të Elbasanit, të cilët u bënë nismëtarët e drejtpërdrejtë të formimit të bërthamës së tij, e cila do të funksiononte me cilësinë e degës së këtij komiteti për trevën e Elbasanit.<sup>100</sup> Kështu, përmes dokumentacionit të kohës, konstatohet fakti se edhe në Elbasan është formuar tashmë e para organizatë patriotike kombëtare e fshehtë. Por, ka të dhëna që dëshmojnë në favor të faktit se një organizatë e fshehtë është krijuar në Elbasan, por se ajo rezulton e krijuar disa vite përpara “Komitetit të Manastirit”.

---

<sup>96</sup> *Po aty*, 319.

<sup>97</sup> Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: Përpyjekja, 2009, 507-510. Studiuesja i është referuar raportit të konsullit Kral në Manastir.

<sup>98</sup> *Po aty*, 511.

<sup>99</sup> Stavro Skëndi, *vepër e cituar*, 192.

<sup>100</sup> Mahir Domi, *Të dhëna mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Buletini shkencor, Shkodër 1875, nr. 1, 159.

Këto të dhëna mbështeten në një raport të konsullatës austro-hungareze të Manastirit, e cila ishte e mirinformuar për këtë problem, pasi në gjirin e komitetit të formuar në Elbasan rezultonte anëtar i tij edhe një dragoman (përfaqësues) i saj. Mbështetjen financiare ky komitet do të përpiquej ta siguronte përmes kontributit të diasporës shqiptare por njëkohësisht edhe përmes qeverisë së Vjenës dhe përfaqësuesve të saj në Shqipëri<sup>101</sup>. Përmes raportit të konsullit austro-hungarez të Manastirit, theksohet se kjo lëvizje përbën përpjekjen e parë të shkëputjes nga interesat lokale, për të vepruar më tej në funksion të interesave të përgjithshme<sup>102</sup>. Ja si pohohet në një dokument posaçërisht për problemin në fjalë: “ *Origjina e formimit të Komitetit të Manastirit duhet kërkuar shumë përpara. Qysh para disa viteve është kërkuar ndërmjet patriotëve të atij vilajeti për të themeluar shoqëri kombëtare në të gjithë Shqipërinë dhe për t’i vënë këto në kontakte me njëra-tjetrën. Tentativa e parë u bë në Elbasan, por kjo mbeti dhe e vetmja*”<sup>103</sup>.

Këtë të dhënë e mbështet edhe ndonjë burim tjetër. Në raportin e konsullatës austro-hungareze të Manastirit që mban datën 8.05.1899, thuhet se në Elbasan disa patriotë shpesh herë mbajnë mbledhje të fshehta. Por më qartë flet letra që i dërgohet nga Elbasani, Halit Bërzeshtës në Manastir në fillim të vitit 1900, ku bëhet fjalë për bashkimin e patriotëve të atjeshëm[në Elbasan] në një shoqëri të fshehtë dhe përmendet projekti i tyre për të ngritur në mënyrë më se të hapur kërkesën për njohjen e gjuhës shqipe nga qeveria turke. Gjithashtu, nga një burim tjetër i kësaj periudhe pasi jepet krijimi i Komitetit të Manastirit mjaft domethënës është shprehja e konsullit Kral Goluchowskit i cili thotë se: “*Zanafillën Komiteti e kishte që disa vjet më parë, kur patriotët e atij vilajeti biseduan mes tyre për krijimin e degëve tyre në të gjithë Shqipërinë, për ti lidhur ato me njëra-tjetrën më vonë. Një përpjekje e parë u bë në Elbasan, por se ajo mbeti e vetmja nga frika e persekutimeve*”<sup>104</sup>.

Gjithashtu, sikurse e kemi përmendur edhe më lart, pjesëmarrës në Lidhjen e Pejës që në vitin 1899 rezultonin edhe përfaqësues të komitetit të Elbasanit. Një përfaqësim i tillë, parakupton faktin se në këtë kohë(viti 1899) një komitet i fshehtë rezultonte të ishte krijuar në Elbasan. Ndërkohë, në librin “Shkolla Normale e Elbasanit”, autori e përmend këtë qytet si qendrën kryesore të Shqipërisë së Mesme për krijimin e degëve të Komitetit të Manastirit, por

<sup>101</sup> Sejfi Vlamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri*, Tiranë: Neraida 2000, 42-43.

<sup>102</sup> HHST, PA, Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit.

<sup>103</sup> M. Domi, *Të dhëna ..., vepër e cituar*, 159.

<sup>104</sup> Kral Goluchoëski, Shkodër, 5 korrik 1906, marrë nga Fondi i Arkivit të Vjenës, në *Zgjidhje Kombëtare i Shqiptarëve*, Tiranë: PHOENIX, 2000, 192.

nga ana tjetër nuk lë pa përmendur edhe faktin se këtu në Elbasan kishte pasur edhe më parë shoqëri të fshehta<sup>105</sup>. Gjithashtu, burimet e kohës konfirmojnë faktin se në vitet 1897-1898 si veprimtar i komitetit të fshehtë të Elbasanit rezultonte patrioti Hysen Ceka<sup>106</sup>. Një e dhënë e tillë është tregues i pohimit të mësipërm se në këtë kohë në Elbasan rezultonte të ishte formuar një komitet i fshehtë.

Në këtë kuadër, kontakti dhe mbështetja që patriotët e trevës së Elbasanit i dhanë Komitetit të Manastirit ishte mëse e evidente. Nga një letër e Bajo Topullit në maj të vitit 1906 kuptohet se, ndikimi i Komitetit të Manastirit dhe i lëvizjes së udhëhequr prej tij shtrihej jo vetëm në Janinë, Gjirokastër, Berat, Vlorë, Mallakastër, Kolonjë, Korçë, Tiranë, por gjithashtu edhe në Elbasan etj<sup>107</sup>.

Gjithashtu, nëpërmjet një udhëtimi që sekretari i “Komitetit të fshehtë të Manastirit” Nuçi Naçi, ndërmerr nëpër qytetet më kryesore shqiptare në vitin 1906, konstatohet se qëndrimet më të gjata ai i pati në qytetet e Elbasanit dhe të Shkodrës. Pikërisht, përshtypjet e para të tij për Elbasanin ai i boton në gazetën “Kombi” nën pseudonimin “*Shkumbia*”. Porse, ajo çka i kishte mbetur më shumë në kujtesë Nuçi Naçit në qëndrimin në Elbasan kishte të bënte më së shumti me ndjenjat kombëtare mjaft të theksuara, pa u ndikuar nga përkatësia fetare<sup>108</sup>.

Ndërkaq, në këtë periudhë veprimtaria e patriotëve elbasanas përfaqësues të degës së komitetit të fshehtë, pasqyrohej në organizimin e protestave kundër qeveritarëve turq. Në fillim të shek. XX acarimi i kontradiktave me qeveritarët turq ishte i dukshëm. Burimet e kohës konstatojnë faktin se në vitin 1906, populli i Elbasanit u ngrit kundër një sundimtari të korruptuar, Qemal Pashës që në atë kohë vepronte me cilësinë e mytesarifit të Elbasanit.

Udhëheqësit e esnafëve, veçanërisht të terzinjve dhe të tabakëve në emër të popullit të Elbasanit në një telegram drejtuar valiut të Manastirit, prej nga varej Elbasani, kërkonin largimin e menjëhershëm të Qemal Pashës. Por kjo kërkesë e tyre mbeti pa përgjigje. Në këtë kontekst, një turmë prej rreth 4 000 vetash, që përfaqësonin popullsinë e qytetit, të acaruar u drejtuan në shtëpinë e Qemal Pashës. Dy prej tyre iu drejtuan Pashës me këto fjalë: “*Pashë, qyteti asht egërsue shumë kundër jush, kaq shumë sa që asht frika që të mos ngjajë ndonji gja e ligë. Mirë pra ban të ngrihesh e të ikësh përgjithherë, kohë të apim deri në mëngjes. Hap sytë pra, bahu*

<sup>105</sup> Hysni Myzyri, *vepër e cituar*, 157.

<sup>106</sup> Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë: 1973, 167.

<sup>107</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 321.

<sup>108</sup> Gazeta “Kombi”, nr. 43, Boston, qershor 1907.

*gati e nisu pa fjalë, se tjetër soj mund të vush ...*”. Një kërkesë e tillë e formës ultimative e detyroi Qemal Pashën të mendohej mirë për alternativën që do të zgjidhte. Në rrethanat e vendosmërisë së popullsisë, Pasha u detyrua të zgjidhte alternativën e largimit të menjëhershëm nga qyteti i Elbasanit. Akti në fjalë konfirmoi në mënyrë më të qartë triumfin e protestës së popullsisë së Elbasanit, e cila në këtë qytet kishte arritur kulmin<sup>109</sup>. Në të njëjtën kohë edhe Peqini dëboi me ceremoni kajmekamin turk sikurse thuhej: “*Me daulle e me zurrë*”<sup>110</sup>.

Ndërkohë, pasojat e një akti të tillë do të shoqërohen me dërgimin e një force ushtarake nën komandën e Shemsi Pashës, akti i parë i të cilit do të ishte çarmatimi i krahinës së Çermenikës. Më tej veprimi i tij vijoi në dhënien e titujve e të gradave të gjithëve atyre që e ndihmuan në përmbushjen e synimeve që kishte. Në vitet 1906-1907, çeta të armatosura vepronin vazhdimisht përreth Elbasanit, veçanërisht në zonën e Shpatit, sikurse ishte çeta e Jonuz Topuzit, Ymer Dervishit, Sadik Zharrit etj. Fillimisht, veprimtaria e tyre më së shumti, konsistonte në mbrojtjen e banorëve të zonës nga dhuna dhe persekutimet e ushtruara nga administrata turke për mbledhjen e taksave, marrjen e nizamëve dhe për konvertimin e popullsisë së kësaj krahine në fenë islame<sup>111</sup>. Kështu, çeta e Jonuz Topuzit ka zhvilluar një aktivitet të dendur gjatë viteve të para të shek.XX deri në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912, vit në të cilin u inkuadrua në çetën e Bushekut.

Mënyra më e zakonshme e aplikuar nga autoritetet osmane për të detyruar shpatarakët në pagimin e taksave, ishte organizimi i ekspeditave ushtarake ndëshkuese nga ushtria, ekspedita që ishin bërë mëse të zakonshme dhe organizoheshin sistematikisht një herë në vit kryesisht në stinën e pranverës dhe të vjeshtës. Më konkretisht, si rezultat i dy ekspeditave që ushtria osmane ndërmori në muajt maj dhe tetor të vitit 1907 në zonën e Shpatit, rezistenca antiosmane në këtë zonë do të marrë karakter të organizuar dhe gjithëpërfshirës, duke pasur mbështetjen edhe të vullnetarëve të armatosur nga zona e Vërçës dhe e Sulovës me të cilën kufizohej Shpati<sup>112</sup>.

Parë në këtë këndvështrim, mund të themi se në vitet 1906-1907 veprimtaria e çetave në zonën e Shpatit do të shënojë një ngritje në nivelin organizativ duke shfaqur tendenca të

---

<sup>109</sup> AME, Kutia. 14, fl. 2.

<sup>110</sup> AME, Kutia. 15, Dos. 63, fl. 23-24.

<sup>111</sup> Në këtë zonë mjaft i përhapur rezultonte fenomeni i kriptokristianizmit. Shpatarakët, kur kërkohej të paguanin taksa, e paraqitnin veten si myslimanë dhe kur kërkoheshin si rekrutë në ushtri paraqiteshin si të krishterë.

<sup>112</sup> E. Nikolaidhou, *vepër e cituar*, 110.



koordinimit të veprimtarisë së tyre edhe me komitete të fshehta që vepronin në këtë periudhë jo vetëm në trevën e Elbasanit por dhe më gjerë.

Gjithashtu, në ekspeditën e organizuar nga Shemsi Pasha në vitin 1907 kundër popullsisë së Elbasanit, konstatohet fakti se në zonën e Shpatit forcat ushtarake të boshnjakut Shemsi Pasha u përpoqën të vendosnin autoritetin e administratës osmane dhe njëkohësisht të eliminonin patriotët shpatarakë, një ndër të cilët ishte dhe kryetari i çetës Ymer Dervishi.

Në këtë kuadër sikurse konstatohet përmes materialit të parashtruar më sipër duhet thënë se ngjarjet patriotike të viteve 1906-1907 shënojnë një rritje të ndërgjegjen kombëtare të popullit të Elbasanit. Pavarësisht dallimeve të mundshme fetare që ekzistonin (më tepër se gjysma e popullsisë rezultonin të ishin myslimanë), vëzhguesit e kohës kanë konstatuar se: “Atdhetaria në këtë krahinë është më e zjarrtë se doktrinën fetare”.<sup>113</sup>

### **I. 3. Tiparet e lëvizjes arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878 - 1908**

Një ndër problemet më të rëndësishme, që përbënte një motiv më tepër në funksion të acarimit të mëtejshëm të kontradiktave midis popullsisë shqiptare dhe pushtuesve turq, konsiderohej zgjidhja e çështjes së mësimin dhe shkrimit të gjuhës shqipe. Kështu, në të gjitha kuvendet dhe kërkesat e lëvizjes kombëtare shqiptare një vend të rëndësishëm zinte çështja e gjuhës dhe shkollës shqipe. Në jo pak raste lëvizja e armatosur spontane, që drejtohej kundër barrës së rëndë të taksave dhe shtypjes së pushtetit otoman, shtronte kërkesa të një natyre të tillë. Veprimtaria në funksion të zgjidhjes së problemeve të një natyre të tillë, do të evidentohet dukshëm në trevën e Elbasanit. Duke hulumtuar me kujdes në dokumentacionin e kohës, përfshirë këtu korrespondencën midis patriotëve shqiptarë që ushtronin veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë Shqipërisë, rezulton se grafiku i lëvizjes kombëtare shqiptare në trevën e Elbasanit rezultonte në ngritje e sipër. Përmes letërkëmbimeve në shtypin e kohës, evidentohen qartë lidhjet e Elbasanit me Korçën, Manastirin, Bukureshtin, Ohrin prej nga vinin abetare e libra në mënyrë ilegale. Në këtë periudhë, mësimi i gjuhës shqipe në trevën e Elbasanit zhvillohej në

---

<sup>113</sup> Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë: Argeta, 1998, 298-299.

mënyrë ilegale e individuale, pa mjedise të përshtatshme, kryesisht nëpër dyqanet e qytetarëve të ndryshëm, në shtëpi e në kushte mjaft të këqija.

Duhet thënë, se që gjatë fundit të shek. XVIII dhe në fillimet e shek. XIX, në trevën e Elbasanit fshehurazi shkruhej e lexohej shqipja. Duke vijuar më tej, vërejmë se në këtë kohë në trevën e Elbasanit njiheshin një sërë alfabetesh të veçantë, si ai i Anonimit të Elbasanit (Papa Totasit) dhe Dhaskal Todrit, i cili ka qenë mësues në shkollën greke të Kalasë. Ndër to, alfabeti i Dhaskal Todrit përdorej nga shumë tregtarë ortodoksë të Elbasanit për mbajtje llogarish. Ky fakt u evidentua tek “defterët e hesapeve të Kostë Andonit që u dogjën në vitin 1852”<sup>114</sup>. Ndërkaq, edhe në botimet e studiuesve të huaj për Shqipërinë, përmendet emri i Dhaskal Todrit, që na del nën emërtimin “Teodori i Elbasanit”, që sikurse thuhej: “hartoi një fjalor shqip”<sup>115</sup>.

Kështu, gjatë shek. XIX do të evidentohen përpjekjet e para për përdorimin e gjuhës shqipe përmes përkthime të materialeve kishtarë, duke krijuar kështu një letërsi fetare në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër, duhet përmendur roli dhe kontributi që ka dhënë në këtë drejtim që në fillim të shek. XX Shoqëria Biblike Britanike, që përmes përkthimit të shkrimeve të shenjta në gjuhën shqipe do të konsiderohet si nismëtare dhe kontribuuese në përhapjen e gjuhës shqipe në trevat shqiptare që në vitin 1827<sup>116</sup>.

Kështu veprimtaria e shoqërisë Biblike Britanike në bashkëpunim me patriotët shqiptarë e filluar në vitet ’20 të shek. XIX do të jetë evidente edhe në vitet në vazhdim duke u shfaqur në disa drejtime kryesore:

Së pari, në përpjekjet drejt përdorimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Së dyti, në veprimtarinë e drejtpërdrejtë për hapjen e shkollave shqipe, gazetave

Së treti përmes përkthimeve të materialeve fetare por në të njëjtën kohë edhe përmes botimit të abetareve të para<sup>117</sup>.

Në këtë kuadër, veprimtaria e patriotëve shqiptarë në funksion të përpjekjeve arsimore në fund të shek. XIX nuk duhet parë e shkëputur nga zhvillimet e përgjithshme në kuadrin e Perandorisë Osmane dhe përmes koncesioneve të administratës osmane në funksion të çështjeve të arsimit, pavarësisht karakterit të kufizuar të tyre sidomos për shqiptarët.

---

<sup>114</sup> Sh. Demiri, *Histori e shkurtër...*, vepër e cituar, 88.

<sup>115</sup> Joseph Sëire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, 68.

<sup>116</sup> Xhevat Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, Logos: 2008, 14.

<sup>117</sup> Po aty.

Duke gjykuar mbi këto arritje, nënvizojmë se ndërsa Dhaskal Todri konsiderohet si pararendës i Rilindjes Kombëtare, veprën e tij e vazhdoi dijetari i madh elbasanas Kostandin Kristoforidhi. Përkthimet e shkrimeve fetare të tij përbënin mjetin më efikas të luftës kundër propagandës shkombëtarizuese greke të Fanarit. Në vitet '70 të shek. XIX, Kristoforidhi konsiderohet si një ndër studiuesit shqiptarë që kontribuoi me përpjekjet dhe përvojën e tij në krijimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe. Në këtë kuadër Kristoforidhi konsiderohet edhe si mbledhës i folklorit shqiptar që përfaqësohej nga fjalë shqipe dhe disa tekste në dialektin elbasanas. Të tillë përmendim katër këngë fëmijësh, të tipit “*oloria boloria*” dhe tetë këngë të Nezimit<sup>118</sup>.

Kostandin Kristoforidhi në shkrimet dhe përkthimet e tij fillimisht për botimet në gegërisht ka përdorur alfabetin latin të plotësuar nga shkronja greke dhe për toskërishten alfabetin grek të plotësuar nga disa shkronja latine. Përmes burimeve dhe korrespondencës së kohës konstatojmë faktin se në vitin 1882, Kristoforidhi kishte hartuar gjithashtu edhe një fjalor të gjuhës shqipe i cili ishte në proces botimi nga Shoqëria e Bukureshtit. Nëpërmjet letrës që Kristoforidhi do t'i dërgojë në 25 dhjetor të vitit 1888 Nikolla Naços, informohemi se abetaret e dërguara prej tij nuk i kishin rënë në dorë për shkak të censurës turke duke u shprehur: “... *sepse miret vesh se i ka ndaluarë ghydryku i Stambollit, a ghydryku i Selanikut*”, duke i rekomanduar N. Naços si rrugë më të sigurtë për dërgimin e abetareve rrugën Trieste-Durrës<sup>119</sup>. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj letrë informohemi edhe për hartimin e një leksiko(fjalori) të gjuhës shqipe të përbërë afërsisht nga 40 mijë fjalë shqip, për botimin e të cilit ai kishte dërguar patriotë për të mbledhur ndihma financiare në Vllahi e Misir. Rezultat i një veprimtarie të tillë do të jetë mbledhja e 400 napolonave flori, por sikurse rezultonte, në vitin 1888 ky fond i mbledhur ishte përdorur nga shoqëria e Bukureshtit për të shtypur libra dhe jo për botimin e fjalorit të gjuhës shqipe të Kristoforidhit. Pakënaqësinë ndaj një veprimi të tillë Kristofordhi do ta shprehë përmes fjalëve: “... *zunë të bënin mur pa vënë themelin më përpara, nuk menduan ata vëllezër të bekuar se muri pa themeli nukë qëndron por rëzohet e shëmbet, nuk e zunë kalin nga freri por nga bishti që shpëton e ikën*”.<sup>120</sup> Gjithashtu po në këtë letër, Kristoforidhi shpreh dëshirën për të shkruar dhe për të ndihmuar Shoqërinë e Bukureshtit për botimin e librave të ndryshëm në gjuhën shqipe, si

---

<sup>118</sup> Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqip...*, vepër e cituar, 268.

<sup>119</sup> AQSH, Fondi. K. Kristoforidhi (nr. 29), Dos.11, fl.1. Letra e dërguar N. Naços përbëhet nga 5 fletë.

<sup>120</sup> AQSH, F. 29, Dos. 11, fl.2.

gjeografi, politikë, matematikë, kozmografi, gjeometri, astronomi, histori në gegërisht dhe toskërisht<sup>121</sup>.

Në këtë kuadër, pas një pune të gjatë afro 30 vjeçare, në vitin 1888 përfundimisht Kristoforidhi do të heqë dorë nga alfabeti me bazë shkronjat greke duke u paraqitur si përkrahës i alfabetit me shkronja latine. Një fakti tillë pasqyrohet nëpërmjet pohimit të vetë Kristoforidhit i cili shprehet se: *“Ndë më pyetshi mua [Kristoforidhin] unë pëlqej më fort alfavitënë latiniste sepse me atë alfavitë mund të shtypenë vivla shqip kudo... edhe është një alfavitë i kuptuar e i njohurë nga të tërë kombet e Evropësë”*.<sup>122</sup> Pikërisht, edhe varianti i fundit i alfabetit latin të përdorur prej tij do të konsiderohet më pas si varianti më i ngjashëm me alfabetin latin të miratuar në Kongresin e Manastirit. Në këtë variant, Kristoforidhi përdor tri dyshkronjësha (për *dh, gj, e th*), gjithashtu dyfishoi *r* për *rr* dhe përdori shenja diakritike për (*ç, ë, nj, sh, y*)<sup>123</sup>.

Pas një përvoje të gjatë në studimin e gjuhës shqipe posaçërisht të dy dialekteve kryesore të saj, Kristoforidhi konstatoi afrinë që ekzistonte midis gegërishtes dhe toskërishtes në disa fusha, si në: fonetikë, në leksik, në gramatikë dhe fjalëformim. Sipas Kristoforidhit ndryshimet ndërmjet dialektit gegë e toskë nuk shkonin më larg se ndryshimet midis anglishtes dhe skocishtes, duke u paraqitur njëkohësisht si një njohës i thellë i gjuhës angleze.

Në këtë kuadër, mund të themi se kontributi më i madh i veprimtarisë së Kristoforidhit, konsiston në përpjekjet e tij për të pasqyruar sa më shumë afri gjuhësore midis dialektit gegë dhe toskë si rrugë drejt krijimit të një gjuhe të unifikuar për të gjithë shqiptarët. Pikërisht, ngjashmëria midis dialekteve në aspektin gjuhësor që u përpoq të argumentojë Kristoforidhi përfaqësonte një hap të rëndësishëm në kuadrin e përpjekjeve të rilindësve shqiptarë për bashkim kombëtar, duke e konsideruar mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe i faktorin kryesor drejt procesit të evoluimit të nacionalizmit shqiptar por njëkohësisht edhe si mjetin më efikas kundër procesit të helenizimit.

Parë nga kjo optikë rezulton se kundërshtarët e përhapjes së gjuhës dhe shkrimit shqip nuk ishin vetëm turqit, por edhe grekofilët.

Në këtë kuadër, intensifikimit të propagandës së helenizimit i shërbente organizata greke, e themeluar që në vitin 1871 nën hijen e Patriarkanës me emrin “Vëllazëria Qendrore Kulturele” e në mënyrë të veçantë “Sillogu [klubi] kultural epirot”, i themeluar në vitin 1871. Qëllimet dhe

<sup>121</sup> AQSH, F. 29, Dos. 11, fl. 5.

<sup>122</sup> AQSH, F. 29, Dos. 11, fl. 4. Letër dërguar Niko Naços nga Kristoforidhi.

<sup>123</sup> Tomorr Osmani, *Udha e Shkronjave shqipe*, Shkodër: 1999, 188-195.

veprimtaria e “Sillogut” grek nxiteshin nga rreziku që vinte si rezultat i ngritjes së lëvizjes kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe e popullsisë së krishterë në veçanti.<sup>124</sup>

Pikërisht, një ngritje e tillë ishte evidentuar edhe në viset malore të trevës së Elbasanit, sikurse ishte dhe krahina e Shpatit. Në këtë krahinë, kjo ngritje më së shumti u reflektua edhe në mësimin fshehurazi të gjuhës shqipe. Ndër familjet shpatarake që u shndërruan në nismëtarë të drejtpërdrejtë të mësimi të gjuhës shqipe përmenden Qosjat, Dedjet, Sharrët, Panxhët etj. Ndërkohë, në Elbasan, që në vitin 1879 rezultoi të jetë krijuar shoqëria kulturore “*Omonia*” në Kala, nismëtar i krijimit të së cilës ishte Kolë Xhufka. Për t’u përmendur është fakti se kjo shoqëri në përbërjen e saj përfshinte vetëm ortodokët e qytetit. Edhe këtu, fshehurazi mësohej e propagandohej gjuha shqipe. Po këtij qëllimi i shërbente edhe shkolla greke e hapur në Valësh të Shpatit në vitin 1899 me mësues Mini Bibajën.<sup>125</sup> Duke vazhduar në gjurmët e Kristoforidhit, kjo shkollë që rezultonte në gjuhën greke do të shërbente për të mësuar fshehurazi edhe gjuhën shqipe. Ata që kishin më tepër njohuri në këtë drejtim u mësonin të tjerëve në mënyrë ilegale gjuhën shqipe kudo e si të mundnin. Disa shpatarakë, duke ardhur herë pas here në qytetin e Elbasanit, patën mësuar fshehurazi shqip prej personave që merreshin me këtë veprimtari<sup>126</sup>.

Ndërkohë, pati edhe patriotë elbasanas që të veshur si fshatarë punuan me plot pasion e përkushtim në zonën e Shpatit, që t’u mësonin banorëve të kësaj zone gjuhën shqipe. Ndër ta përmendim Hysen Cekën i cili kishte mbaruar shkollën e Mylkies (shkollë e lartë turke për administratë). Në vitet 1890-1897, veprimtaria e tij arsimore ishte përqendruar në zonën e Shpatit duke përfaqësuar në vetvete një shkollë shëtitëse. Në këtë kohë Hysen Ceka konsiderohet edhe si një ndër veprimtarët më aktivë të shoqërisë së fshehtë të Elbasanit<sup>127</sup>.

Ekzistojnë mendime të ndryshme për sa i përket kohës kur ka filluar mësimi i gjuhës shqipe në Shpat. Një ndër këto mendime parakupton faktin se mësimi i gjuhës shqipe në krahinën e Shpatit dëshmohet me shpalljen e Hyrjetit, atëherë kur fillon dhe çelja e shkollave shqipe në Elbasan dhe trevat e tjera.

Mendimi tjetër mbështetet në faktin se mësimi i gjuhës shqipe në mënyrë ilegale në zonën e Shpatit ka filluar shumë kohë para shpalljes së Hyrjetit, e konkretisht aty nga gjysma e

---

<sup>124</sup> Sul Dedej dhe Xhemal Xhepa, “Mësimi i gjuhës shqipe dhe shkolla shqipe në Shpat”, *Buletini shkencor*, Shkodër: 1975, f. 89.

<sup>125</sup> Hysni Myzyri, vepër e cituar, 167. Raport i konsullit të Manastirit shtator 1899.

<sup>126</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër cituar, 551.

<sup>127</sup> Hysni Myzyri, vepër e cituar, 167.

dytë e shekullit XIX. Procesi në fjalë rezultoi produkt i kontributit si i patriotëve të zonës, ashtu dhe atyre elbasanas<sup>128</sup>.

Të dhënat që konfirmojnë faktin e mësipërm ofrohen përmes kujtimeve të patriotëve shpatarakë, si Kodhel Dedja, Kol Paxhi, mësuesit Vasil Llapushi, si dhe nga dokumentet e pasqyruara në vëllimin e dytë të Historisë së Popullit Shqiptar, botuar në vitin 1965 nga Instituti i Historisë e Gjuhësisë. Kështu, mësuesi Vasil Llapushi kujtonte se : “Para shpalljes së Hyrjetit në Shpat ishte formuar një grup kaçakësh me udhëheqës Ymer Dervishin. Ky grup ka pas miqësi me patriotë elbasanas. Këta patriotë përpiqeshin me shfrytëzue çdo rast në interes të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. N’ Elbasan ka pasë mësues patriotë që i kishin vu vetes si detyrë me u mësue katundarëve shkrim e këndim. Nga këta mësues mbaj mend Hysen Cekën, Gori Lekën e Kodhel Deden. Këtë punë pa dalë shqipja në shesh, d.m.th. para Hyrjetit e kam ba edhe unë, abetaren ua kam mësue kaçakëve atje në mal të Shpatit dhe shumë katundarëve që vijshin n’ Elbasan për ditë pazari”<sup>129</sup>.

Gjithashtu, veterani Kodhel Dedja, sipas disa kujtimeve të pabotuara, ka deklaruar se: “Shqipen e kam mësue hern e par nga Simon Shuteriqi dhe Fetah Ceka nga viti 1900. Vinja herë pas here n’qytet, takohesha me njërin ose me tjetrin, merrja libra e shkonja përsëri në fshat e mësonja në pyll”<sup>130</sup>. Ndërsa, vëllimi i dytë i Historisë së Popullit Shqiptar na informon se: “Me gjithë dështimin e pësuar në vitin 1876, grupi i patriotëve të Stambollit nuk hoqi dorë nga përpjekjet e tij për të krijuar një qendër organizative të lëvizjes kombëtare, veçanërisht në kohën e intensifikimit të propagandës së “Helenizimit”, së cilës i shërbente organizata e themeluar nën hijen e Patrikanës së Stambollit me emrin “VËLLAZËRIA QENDRORE e KULTURALE” dhe në mënyrë të veçantë “SILOGU KULTURAL EPIROT”, i themeluar në vitin 1871 (sikurse e kemi përmendur më lart).

Se çfarë qëllimi kishte kjo organizate ishte mëse e qartë, por duhet theksuar fakti se duke e vënë në dukje se edhe në viset malore, siç ishte krahina e Shpatit të Elbasanit, kishte filluar të mësohej fshehurazi shqipja, statuti i këtij klubi theksonte nevojën për të shtuar përpjekjet për përhapjen e arsimit grek në Shqipëri<sup>131</sup>.

---

<sup>128</sup> Sul Dedej dhe Xhemal Xhepa, mësimi i gjuhës ..., vepër e cituar, 88.

<sup>129</sup> Pirro Kito, Elbasani në luftë për çlirim, Tiranë: 8 nëntori, 1971, 301.

<sup>130</sup> AME, Kutia. 13, Dos. 5, fl. 1.

<sup>131</sup> Sul Dedej dhe Xhemal Xhepa, vepër e cituar, 88.

Pikërisht, duke gjykuar se klubi kulturor “Sillogu” u themelua në vitin 1871, konstatimi i shprehur në statutin e këtij klubi mbi mësimin e gjuhës shqipe në krahinën e Shpatit në Elbasan i takon të jetë e pakta para kësaj date, d.m.th. para vitit 1871. Pikërisht, duke iu referuar këtyre fakteve, mendojmë se mësimi i gjuhës shqipe në Shpat duhet të ketë filluar aty rreth gjysmës së parë të shek. XIX.

Në të njëjtën kohë, në një dokument të kohës që i përket vitit 1872, thuhet shprehimisht se: “*Në Shpat kanë dalë disa veta, që nxisin njerëzit e thjeshtë të mësojnë shqip*”.<sup>132</sup> Gjithashtu studiuesit e gjuhës shqipe janë të mendimit se edhe dorëshkrimi më i vjetër i gjendur në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, që i përket shek. XVII dhe përfaqësohet nga përkthimi i pjesëve të ndryshme nga të katër ungjijtë në të folmen e Elbasanit, origjinën e kishte nga Polisi i Shpatit e më konkretisht në fshatin Valësh<sup>133</sup>.

Në fund të vitit 1896, popullsia e krahinës së Shpatit përmes një peticioni u kërkon Fuqive të Mëdha të ndërhyjnë tek autoritete turke për t’u akorduar shqiptarëve të drejtën e arsimimit në gjuhën shqipe. Ndër të tjera në këtë peticion thuhet: “*Ne banorët e krahinës së Shpatit në Shqipëri Ju drejtohem i Juve dhe nëpërmjet Jush, Fuqive të Mëdha, duke i lutur Ato nxehtësisht që të bëjnë përçapje pranë Portës së Lartë, me qëllim që ajo të na akordojë edhe neve lirinë për t’u arsimuar në gjuhën tonë kombëtare, si të gjithë kombet e tjera nënshtetase të Perandorisë. Duke qenë shqiptarë e në qendër të Shqipërisë, ne nuk kuptojmë as greqishten, as bullgarishten dhe asnjë gjuhë tjetër, dhe nuk mund të shkollohem veçse në gjuhën tonë shqipen*”.<sup>134</sup> Në të njëjtën kohë, nga dokumentacioni i kohës konstatohen në zonën e Shpatit, elementet e para të fillimit të lëvizjes uniate, e cila shfaqej në përpjekjet për bashkimin fetar me Romën<sup>135</sup>.

Ndërkaq, Elbasani u lidh ngushtë me veprimtarinë e shumanshme të lëvizjes kombëtare në fund të shek XIX. Nxënësit e Kristoforidhit po e vazhdonin traditën e të mësuarit shqip nëpër dyqane, shtëpi të ndryshme në mënyrë ilegale. Në vitin 1890 depoja e dyqanit të bojaxhiut dhe patriotit Losh Papamihalit, shok i ngushtë i Kristoforidhit shërbente si qendër ku merrnin mësim të rritur në moshë, të cilët më vonë bëheshin mësues të shokëve e të miqve të tyre të besuar. Vetë

<sup>132</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, 551.

<sup>133</sup> Dh. Shuteriqi, *vepër e cituar*, 91. Ky dorëshkrim njihet si Anonimi i Elbasanit, por në kapakun e tij lexohej emri i Papa Totasit. Sipas Ilia Spiro Xhufkës ky dorëshkrim e kishte origjinën nga Polisi i Shpatit. Në katundin Valësh ku gjendet një kishë e pikturuar nga Onufri në mes të shek. XVI, emri i fisit Totoshi i përgjigjet emrit Totasi dhe të dy kanë në rrënjë fjalën “totë” që do të thotë prift.

<sup>134</sup> M. Domi, vepër e cituar, 175.

<sup>135</sup> Si burim informacioni shërben letërkëmbimi midis kontit Ipen në Shkodër dhe baronit Cvidinek, 9 dhjetor 1898.

Konstandin Kristoforidhi u mësonte shkrim e këndim në gjuhën shqipe bashkëpunëtorëve e miqve të tij më të afërm, si Ali Çaushtit, Ali Saraçit, Emin Haxhiademit etj<sup>136</sup>. Dyqani i Muç Shqiptarit (Mustafa Osman Berberi) ishte një qendër tjetër e rëndësishme e të mësuarit shqip. Veprimtaria e tij përfshinte transportin ilegal të abetareve që dërgoheshin nga shoqëritë patriotike shqiptare të diasporës në Manastir ku një pjesë e tyre shpërndaheshin nga konsullata austro-hungareze atje. Ndërkohë që dyqani i tij shërbente si një librari ilegale të librave shqip dhe vetë ai njihej me epitelin Muç Shqiptari<sup>137</sup>.

Kështu, nga qyteti i Elbasanit bëheshin kërkesa të vazhdueshme për abetare, libra e gazeta në gjuhën shqipe. Dërgesa të shpeshta me artikujt e mësipërm mbërrinin në Elbasan përmes karvanëve që vinin nga Manastiri. Këto botime shpërndaheshin më pas nëpër persona të ndryshëm përmes disa dyqaneve që merreshin me këto punë. Jani Vretoja i dërgonte herë pas here Sotir Kolesë në Ohër letra e libra shqip, duke e porositur që një pjesë të tyre t'i dërgonte në Elbasan. Në këtë kontekst, në 22 maj të vitit 1893, ai nisi 20 copë abetare për në Elbasan. Më 3 gusht 1893, Jani Vretoja i shkruante Sotir Kolesë se *“të dërgoj vivllat që më shkruan”, rreth 80 copë, si dhe 20 abetare gegërisht, 10 abetare toskërisht, 10 libra leximi, gramatika, histori si dhe “Bagëti e Bujqësi” dhe “Lulet e Verës”*<sup>138</sup>.

Ndërkohë, rritja e dëshirës për mësim e shkollë në gjuhën shqipe në Elbasan nxiti dhe kërkesat e të rinjve elbasanas për t'u formuar si mësues të shqipes. Në këtë kontekst, duke shfrytëzuar letërkëmbimin e patriotëve Gjeraqim Qiriazit dhe Nikolla Naço, informohemi se dy të rinj nga Elbasani dhe një nga Bërzeshta janë dërguar në Bukuresht për të mësuar në Shkollën Normale, që kishte çelur shoqëria “Drita”, e drejtuar nga Nikolla Naço. Letërkëmbimi në fjalë fikson emrat e Damjan Buradanit dhe Petro Baniskas nga qyteti i Elbasanit<sup>139</sup>.

Dukuria e mësipërme konfirmohet dhe nga gjuhëtari shqiptar Gjergj Pekmezi, i cili në cilësinë e të dërguarit të Akademisë së Shkencave të Vjenës në Elbasan për qëllime studimi do të shkruante: *“Në Elbasan arrita të mbledh edhe disa tekste e materiale. Është fjala në radhë të parë për shkrimet e lëna nga Dhimitër Andrea Pina, një elbasanas mësues atje, që ka vdekur para disa vjetësh në moshën 27-vjeçare. Ato përbëheshin nga 20 fjalime fetare të hartuara e të mbajtura prej tij, nga përkthime këngësh kishtarë bizantine bashkë me notat, nga një sprovë e*

<sup>136</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale ...*, vepër e cituar, 135-136.

<sup>137</sup> H. Myzyri, *Shkollat e para ...*, 166.

<sup>138</sup> AQSH, Fondi. 54, Dos. 70, fq. 55-56, 3 gusht 1893.

<sup>139</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale...*, vepër e cituar, 38.



gramatikës së gegërishtes shkruar elbaskanisht, një fragment leksikografik e nga një pjesë përthimesh prej klasikëve grekë e latinë (p. sh. *Edipi i Sofokliut*<sup>140</sup> )”. Më tej Gjergj Pekmezi sqaronte se këto tekste ishin shkruar “me alfabetin e Frashërve”, d.m.th. me alfabetin e Stambollit, “disa të pakta me alfabetin grek”, por disa edhe “me alfabetin e Elbasanit që u bë i njohur nga nga Hahn dhe Geitler. Gjuha e Dhimitër Pinës shprehet ai ishte “thjesht elbasançe”, por ai shkroi “edhe në gjuhën greke siç e tregojnë disa artikuj të shkurtër mbi Shqipërinë”.

Gjithashtu, përmes letërkëmbimit në vitet 1896-1897 ndërmjet Dervish Himës dhe dr. Ibrahim Temos, Hamdi Ohrit, Dervish Biçakut, Dhimitër Pinës, evidentohet mjaft qartë fakti se përhapja e librave në gjuhën shqipe në Elbasan përbënte një dukuri më se të zakonshme. Në këtë kontekst, Dervish Hima, më 4 korrik të vitit 1896 i shkruante Ibrahim Temos se “Abetaret që na dërgove në rrugën e Vlorës, i morëm edhe pse me një mijë mundime, edhe Dervish Hiçit në Elbasan i mbërritën”.<sup>141</sup>

Po kështu, në 22 gusht të vitit 1896 Dervish Biçakçiu (Elbasani) i shkruante Ibrahim Temos se nuk i kishte marrë ende librat shqip, që ai i kishte çuar me rrugën e Durrësit dhe i lutej t’ia dërgonte drejtpërdrejt në Elbasan. Ndërkohë, ai i kërkonte t’i dërgonte edhe gazeta shqipe, për të cilat kishin shumë nevojë.

Nëpërmjet letrave që Dervish Hima i dërgonte Ibrahim Temos evidentohet fakti se ai, si pjesëmarrës i lëvizjes së Turqve të Rinj në Elbasan dhe në qytete të tjera, kishte dhënë kontributin e tij në funksion të ngritjes së degëve të reja të kësaj lëvizjeje. Në letrën e gushtit të vitit 1896, Dervish Hima shkruante se në Elbasan ishte ngritur xhemijeti “*Bashkimi Osman*” dhe se kishte futur në të të gjithë ata që dëshironin. Kurse në letrën e shtatorit të vitit 1896 bëhet fjalë për degë të Xhemijetit “Bashkim e Përparim” të krijuara në Elbasan, në Strugë etj. Këto degë mbanin lidhje me degën e komitetit “Bashkim e përparim” të Kostancës, me Ibrahim Temon, por dhe drejtpërdrejt me redaksinë e gazetës “Meshveret” të Parisit, së cilës i dërgonin materiale dhe i siguronin abonime në Shqipëri.

Ndërkaq, në një letër që Faik Konica i dërgoi I.Temos, e vinte në dijeni se kishte vendosur marrëdhënie me historianin e shquar Leon Koh, i cili jo vetëm kishte marrë përsipër të hapte një kurs të gjuhës shqipe pranë Universitetit të Parisit, por ishte shprehur i gatshëm të punonte në funksion të krijimit në Shqipëri të një kolegji franko-shqiptar, i cili do të ishte nën

---

<sup>140</sup> M. Domi, *Të dhëna mbi ...*, vepër e cituar, 154.

<sup>141</sup> K. Prifti, *Dr. Ibrahim Temo*, Prishtinë: 1996, 86-87.

drejtimin e shoqërisë “Përlindja e Shqiptarëve”. Një ndër qytetet ku planifikohej të hapej kolegji franko-shqiptar ishte propozuar edhe Elbasani. Por sikurse konstatohet si rezultat i pengesave të autoriteteve osmane një kolegji i tillë nuk arriti të hapej<sup>142</sup>.

Por ajo që duhet të nënvizojmë është fakti se veprimtaria e dendur atdhetare e patriotëve elbasanas nuk kaloi pa rënë në sy të konsujve të huaj të Manastirit, e më drejtpërdrejt të atyre austriakë dhe rusë. Në korrespondencën që ata mbanin me eprorët e tyre nuk do të ngurronin aspak që të pohonin zgjerimin e veprimtarisë patriotike në drejtim të mësimin dhe të përhapjes së shkollave në gjuhën shqipe në trevën e Elbasanit. Vlerësimet e konsujve të huaj për përpjekjet e bëra në trevën e Elbasanit drejtuar eprorëve të tyre ishin të shumta.

Kështu, në tetor të vitit 1899, konsulli austriak i Manastirit u shkruante eprorëve të vet se në vendet ku ai kaloi ishte mjaft e madhe dëshira për shkolla shqipe dhe se popullsia kërkonte mësues shqiptarë. “*Po të kishte pasur mësues*”, - shkruante ai, - “shumë katunde do të kishin hapur shkolla me kokën e tyre, si Bërzeshta, ku dhe hoxha i fshatit dëshiron të japë mësimin e gjuhës shqipe. Veç kësaj mungojnë dhe mjetet mësimore”. Të njëjtën situatë konsulli austriak e kishte konstatuar edhe në dy katundet myslimanë, Polis e Shushicë, që i përkisnin zonës së Shpatit.<sup>143</sup> Ndërsa në katundin Nexhar, situata paraqitej dhe më e favorshme. Këtu u bënë përpjekje jo vetëm për të hapur një shkollë shqipe, por u bisedua për të dërguar disa fëmijë nga Shpati në shkollën shqipe të djemve në Korçë<sup>144</sup>. Në këtë kohë konstatohen edhe përpjekjet e patriotëve shqiptarë jashtë vendit në organizimin e mbledhjeve të përbashkëta që shtronin nevojën e përdorimit të gjuhës shqipe në shkollat e huaja që ekzistonin në këtë kohë në Shqipëri.

Në këtë kontekst, në faqet e gazetës “Albania” që dilte në Bruksel, nëpërmjet një artikulli në gjuhën frënge nën titullin “Congres Albanais” informohemi për organizimin në 13 nëntor 1898 të një kongresi për shkollat shqipe, me pjesëmarrjen e disa patriotëve shqiptarë si: M. Dodani, Evangjeli, Polo-Meksi, Spirobeg dhe Toptani. Në përfundim të punimeve të kongresit, pjesëmarrësit do të dalin me një rezolutë të përbashkët përmes së cilës do t’i kërkohet Sulltanit hapja e një kursi të gjuhës shqipe në çdo shkollë të huaj që ekzistonte në Shqipëri. Sipas burimit në fjalë rezultonte se në këtë kohë në Shqipëri ekzistonin rreth 5 mijë shkolla të huaja. Ndërkohë, përmbushja e një kërkese të tillë nga pjesëmarrësit e kongresit më së shumti duhej të konsiderohej nga Stambolli si një obligim moral dhe gjithashtu material, për arsye të taksës së

---

<sup>142</sup> Po aty, 110.

<sup>143</sup> HHSTA/PA, *Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit*, nr. 67, 26 tetor 1899.

<sup>144</sup> HHSTA/PA, nr. 76, 26 tetor 1889.

arsimit që paguanin shqiptarët por që kjo taksë nuk shkonte në funksion të mësimin të gjuhës shqipe<sup>145</sup>.

Në një raport që konsulli rus i Manastirit si një vëzhgues i mprehtë i situatës arsimore në Shqipëri, në fillim të vitit 1900 u dërgonte eprorëve të tij, pohonte se në fshatrat e Elbasanit shkrimi i gjuhës shqipe me alfabetin shqip ishte një dukuri e përhapur dhe realizohej në shkolla. Pikërisht, këtë dukuri ai e konsideronte si të rëndësishëm në kuadrin e evoluimit të procesit të zgjimit kombëtar të shqiptarëve, duke u shprehur se; “... gjatë udhëtimit për Elbasan jam ndalur në çdo fshat nëpër të cilin kalon rruga dhe kam hyrë në bisedime. Kur i pyeta a ka shkolla, të gjithë m'u përgjigjën se në fshatrat e malësisë, ku pushteti turk është vetëm sa për sy e faqe janë hapur shkolla, kurse në fshatrat e tjera mësojnë njëri-tjetrin dhe më treguan me kënaqësi librat shqip (tekste shkollore e almanakë të ndryshëm)”<sup>146</sup>.

Në këtë kontekst dhe mikja e shqiptarëve, Edit Durhami në kujtimet e saj konfirmon shkallën e lartë të patriotizmit në Elbasan, duke u shprehur se: “Në Elbasan prekesh nga përpjekjet që bëhen për dije e kulturë, numri i njerëzve të mësuar e të edukuar është shumë i madh”.<sup>147</sup>

Pikërisht, kësaj periudhe i përket edhe shfaqja e krijimtarisë letrare të përfaqësuesve elbasanas pasqyruar në shtypin e kohës. Në “Kalendarin Kombiar” të Sofjes të vitit 1900, janë botuar 8 vjersha të dërguara nga Elbasani. Në njërin prej këtyre i këndohet gjuhës dhe shkollave shqipe:

*“Ta zbukurojmë gjuhën tonë.*

*Pas shkrojtore të punojmë.*

*Të çelim shkolla anëmbanë, atdhenë të ndriçojmë.*

*Ditunitë t'i përhapim në të gjithë dhen e Shqipërisë”.*<sup>148</sup>

Në këtë periudhë një rol të rëndësishëm në kuadrin e lëvizjes patriotike në Elbasan, ka dhënë popullsia ortodokse e lagjes Kala. Në vitin 1902 konstatohet krijimi i një shoqërie të fshehtë burrash të lagjes “Dryni Kala”, që bëhet e njohur në rrethet patriotike brenda dhe jashtë vendit me emrin “Shoqëria e Diellit”. Sipas këtyre burimeve mendohet se kjo shoqëri ishte krijuar me mbështetjen dhe ndihmën e Austro-Hungarisë dhe kryesohej nga Papa Jorgji

<sup>145</sup> Gazeta “Albania”, vëll. B, (maj1898-dhjetor1898), ribotim, shtëpia botuese DDS, 2010, 145.

<sup>146</sup> AQS, Çështja shqiptare në marrëdhëniet ruso-turke, Dos. 17, 16 mars 1900.

<sup>147</sup> E. Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë: Argeta, 1998, 299.

<sup>148</sup> M. Domi, vepër e cituar, 158.

Theodhari. Duhet thënë se për shkak të kushteve të ilegalitetit, të dhënat për aktivitetin e kësaj shoqërie janë të kufizuara, por kjo shoqëri mbështetjen morale, materiale e diplomatike e pati nga shoqëritë shqiptare të Amerikës, Bullgarisë, Rumanisë, Korfuzit dhe Misirit<sup>149</sup>.

Por, mungesa e një alfabeti të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe konsiderohej si një ndër problemet më të rëndësishme në fillim të shek. XX. Për shtypjen e librave në shqip përdorshin alfabetet e ndryshëm duke filluar nga alfabeti i Stambollit, i shoqërisë Bashkimi të Shkodrës apo edhe alfabetet e veçantë etj. Në këtë kuadër, vetëm në Shkodër rezultonte të përdorshin tre lloj alfabetesh<sup>150</sup>. Problemi i mungesës së një alfabeti të përbashkët gjente pasqyrim edhe në artikuj të botuar në shtypin e kohës, duke u përvijuar si një shqetësim madhor që duhej zgjidhur sa më shpejt. Në vitet 1902-1905, nevoja e përdorimit të një alfabeti të përbashkët konsiderohej si domosdoshmëri edhe nga konsujt e huaj në Shqipëri. Çështja e një alfabeti të përbashkët në këtë kohë, lidhej më së shumti me interesat politiko-fetare të monarkisë Austro-Hungareze. Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi në pohimet e drejtpërdrejta të konsullit Kral, që shfaqej si një njohës i mirë i dy dialekteve të gjuhës shqipe nëpërmjet fjalëve: “*Unifikimi i alfabetit është i ngutshëm për arsye kombëtare dhe gjuhësore, është pastaj i nevojshëm edhe nga pikpamja jonë politike dhe, veçanërisht nga ajo e politikës kishtarë, pse pa të do të jetë e vështirë të sigurohet paqja në episkopatin shqiptar dhe zhvillimi i qetë i shkollave tona*”<sup>151</sup>.

Në këtë drejtim, në vitet 1900-1907 nga Vjena do të ndërmerren disa nisma në funksion të këtij qëllimi, që gjetën shprehje në organizimin e një konference episkopate në maj 1902. Rezultati i një konference të tillë në funksion të unifikimit të alfabetet në shkrimin e shqipes sikurse konstatohet nga burimet e kohës, nuk rezultoi fort i kënaqshëm në përmbushjen e interesave austro-hungareze, pasi si alfabeti më i përshtatshëm u përcaktua ai i shoqërisë letrare Agimi<sup>152</sup>. Ndërkohë, konsulli Kral, financonte botimet e Gjergj Fishtës që shkruheshin me alfabetin e shoqërisë “Bashkimi”. Një situatë e tillë, nuk do të frenojë aspak përpjekjet e konsullit Kral në funksion të gjetjes së një kompromisi qoftë edhe me shqiptarët e jugut që më së shumti përdornin alfabetin e Frashërve<sup>153</sup>.

---

<sup>149</sup> Aleks Vini, *Traditat zakonore në qytetin e Elbasanit*, përgatiti për botim Drejtorja e Trashëgimisë Kulturore, Elbasan: “Rama Graf”, 337.

<sup>150</sup> Ibrahim. D. Hoxha, *Nëpër udhën e penës shqiptare*, Tiranë: 1986, 198.

<sup>151</sup> Po aty.

<sup>152</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 534-535.

<sup>153</sup> Po aty, 536.

Pikërisht, në këtë periudhë Aleksandër Xhuvani do të përfshihet në debatin për çështjen e alfabetit dhe gjuhës letrare shqipe duke shprehur njëkohësisht edhe pikëpamjet e tij të mbështetur në argumente gjuhësore dhe kombëtarë. Në një letër botuar në të përkohshmen “Albania” në prill të vitit 1906, A. Xhuvani parashtron qëndrimin e tij për çështjen e mbledhjes së një kuvendi arsimor, duke e konsideruar një iniciativë të tillë si domosdoshmëri për kohën, por njëkohësisht duke shfaqur edhe rezerva rreth rrezikut të mundshëm të dështimit të këtij kuvendi. Në organizimin e një kuvendi të tillë A. Xhuvani shikonte më së shumti edhe mundësinë e thellimit të përçarjeve në rrethet patriotike shqiptare duke u shprehur se: “... *vallë do të pajtoheshin mendimet e të dërguarve[në kongres], apo do të përçaheshin? Po qe se do të ndodhte kjo e fundit ç’vlen të mbledhja?*”<sup>154</sup>

Gjithashtu, në pikëpamjet e A. Xhuvanit alfabeti i “Bashkimit” pavarësisht ekzistencës së disa mangësive, konsiderohej si më i përshtatshëm për shkrimin e shqipes, ndërsa si gjuhë letrare pranonte toskërishten. Kështu veprimtaria e tij do të përqendrohet në botimet e shumë artikujve në gazetën e kohës në funksion të mbrojtjes së pikëpamjes së tij për rëndësinë që shfaqte pranimi i alfabetit të “Bashkimit”, duke e konsideruar atë njëkohësisht si një armë të fuqishme kundër helenizimit<sup>155</sup>. Në këtë periudhë, në shtypin shqiptar të kohës shprehej mendimi i përdorimit të dy alfabeteve më të përdorshëm në shkrimin e gjuhës shqipe, duke ju referuar si alfabetit të Stambollit ashtu dhe atij të shoqërisë “Bashkimi”, pavarësisht problemeve që të dy alfabetet mbartnin.

Ndërkaq, në vitin 1907 botohet një tregim patriotik me titullin “Historia e Skënderbeut”, mbretit të Shqipërisë, nga një autor elbasanas nën pseudonimin Banush Shpataraku. Në të shumtën e rasteve autorët e veprave të tilla rrezikonin jetën e tyre, sepse bëheshin objekt i përndjekjes së drejtpërdrejtë nga autoritetet osmane, si dhe nga qarqe të ndryshme antishqiptare. Veprimtarët e shqiptarizmit në Elbasan, përveç Kristoforidhit ishin edhe Tushi i Pinës (vdekur në vitin 1900), Mahmut Hastopalli (mik i ngushtë i Kristoforidhit), Mimi Bibaja, Loshi i Bardhë i Papamihalit, Hysen Ceka, Muç Berberi (Shqiptari), Fetah Ceka, Aleksandër Xhuvani, Hasan Gjevari, Faik Duhaxhiu etj.

Gjithashtu, në këtë kohë shoqëria “Mbarësia” kërkonte organizimin e një diskutimi të përgjithshëm në faqet e shtypit kombëtar të kohës, përmes të cilit synohej të përfytohej alfabeti

<sup>154</sup> *Mendimi Politik dhe Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: 1971, 286-287. Artikull botuar në gazetën “Albania” London, nr.1, 1906, Autori A. Xhuvani(Dok Sula). A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë: 1980, 48-49.

<sup>155</sup> *Po aty*, 303. Artikull botuar në gazetën “Shqipëria”, Magaga(Egjypt), Nr. 5, 15 qershor 1907.

më i pëlqyeshëm. Formimi i kësaj shoqërie, bëhet i njohur në shtypin kombëtar të mërgimit në vitin 1907<sup>156</sup>. Kjo shoqëri i kishte vënë vetes si qëllim përhapjen e mësimimit të gjuhës shqipe kudo që ishin e jetonin shqiptarët dhe për këtë kishte si qëllim hartimin e shtypjen e librave të dobishme e të nevojshme mësimore, sepse sikurse thuhej “... sot në Shqipni ndër ata barijt e maleve po kanë një etje të madhe për të mesu gjuhën e vet”<sup>157</sup>. Shoqëria e mësipërme, sikurse rezultoi edhe nga burimet dokumentare, si dhe nga të dhënat që ofron shtypi i kohës, është përpjekur shumë që të përgatisë disa prej këtyre librave.

Në këtë kuadër, përpjekjet e saj janë zhvilluar dhe në funksion të arritjes së një alfabeti të njësuar. Një fakt i tillë pasqyrohet edhe në një letër të Aleksandër Xhuvanit, botuar në gazetën “Drita” të Sofjes, në vitin 1907. Ndër të tjera, në këtë letër gjendja shpirtërore e popullit të Elbasanit paraqitej mjaft e përshtatshme për kohezionin politik. Po kështu dhe dëshira për të mësuar rezultonte jashtëzakonisht e madhe. Më tej, sipas A. Xhuvanit, shquhej në këtë lëvizje edhe një hoxhë. Periudha në vazhdim konfirmoi faktin se hoxha në fjalë ishte Fejzulla Guranjaku, i cili ishte ndër të parët klerikë myslimanë në trevën e Elbasanit që u përfshi aktivisht në lëvizjen kombëtare shqiptare<sup>158</sup>. Gjithashtu, burimet e kohës japin të dhëna rreth ekzistencës së një dege të shoqërisë Lidhja Ortodokse me qendër në Korçë. Shoqëria në fjalë që përfshinte popullsinë ortodokse të qytetit, synonte përmbushjen e disa objektivave kryesore ku ndër më të rëndësishme do të konsiderohej përpjekja për t’i shkëputur Patriarkanës Greke të drejtën për të zhvilluar ceremonitë fetare në gjuhën shqipe dhe njëkohësisht futjen e mësimimit të gjuhës shqipe në shkollat ortodokse të qytetit<sup>159</sup>. Ndërkohë që para shpalljes së Hyrjetit (Kushtetutës Turke) duhet thënë se gjuha shqipe mësohej fshehurazi në shkollat e huaja ishin rezultoni në këtë kohë në trevën e Elbasanit.

---

<sup>156</sup> Lajmërimi për formimin e kësaj shoqërie jepet në gazetën “SHPNESA E SHQYPËNISË”, Raguzë, nr.4, 19 shkurt 1907. Studiuesi M. Domi, është i mendimit që kjo shoqëri është formuar në Elbasan.

<sup>157</sup> Po aty.

<sup>158</sup> Gazeta “Drita”, Sofje, 1907.

<sup>159</sup> Joseph Sëire, *vepër e cituar*, 72.

#### **I. 4 Shfrytëzimi i shkollave ekzistuese turke në Elbasan, në funksion të mësimin të gjuhës shqipe**

Në Elbasan mjaft e fuqishme dhe në ilegalitet të plotë do të paraqitej lëvizja kombëtare arsimore për mësimin e gjuhës shqipe edhe në sistemin e shkollave të huaja që ekzistonin në këtë qytet. Nëse deri me shpalljen e Hyrjetit të mësuarit e gjuhës shqipe bëhej në fshehtësi të plotë, në qytetin e Elbasanit kanë ekzistuar disa shkolla në gjuhën turke, apo greke ku mësonin nxënës shqiptarë dhe në të njëjtën kohë këto shkolla shfrytëzoheshin nga mësuesit patriotë elbasanas për mësimin e gjuhës shqipe.

Si paraqitej gjendja e arsimit turqisht në qytetin e Elbasanit deri në pragun e Hyrjetit?

Përgjatë shek. XIX shkollat që ekzistonin në sistemin arsimor turk në Shqipëri rezultojnë me këtë ndarje: shkolla fillore njihet me emrin *ibtidaije*. Ajo kishte zakonisht një përgatitore për tri klasa. Në përgatitoren e ibtidaijes mund të hynin edhe ata fëmijë që ishin para moshës shkollore (hriçet). Pas mbarimit të saj, vijonte shkolla qytetëse, *ryzhdijet*, e cila përfaqësohej nga tri klasa. Më vonë ryzhdija u suprimua dhe vendin e saj do ta zërë *idadija* (gjimnazi) me pesë klasë. Në Shqipërinë e Mesme e para shkollë ryzhdije rezultojnë të jetë hapur në Tiranë në vitin 1862 dhe më pas shkolla të tilla u hapën në Elbasan, Durrës dhe Krujë.<sup>160</sup>

---

<sup>160</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 90.

Kështu, dy klasat e larta të idadijes mund të plotësoheshin në Manastir, që ishte qendër e vilajetit prej nga varej sanxhaku i Elbasanit. Në këtë kontekst, në Elbasan, deri në prag të shpalljes së Hyrjetit rezultoi tri shkolla fillore publike shtetërore (Ibtidaije):

- 1- Hamidije afër Xhamisë Sulejmanie, me kryemësues Ibrahim Gumën <sup>161</sup>
- 2- Tek ndërtesa e depos së kripës (afër Xhamisë Mbret) me mësues Mustafa Qafëmollën dhe Ali Krypën);
- 3- Mejtebi i Adem Grykshit dhe Afëz Ukut, në fillim të rrugës së Xhamisë Mbret. <sup>162</sup>

Kurse si shkolla private funksiononin katër shkolla.

- 1- Shkolla ku mësonte Fejz Guranjaku bashkë me të vëllanë, Arifin, afër Xhamisë së Agait.
- 2- Shkolla e Hafëz Karadakut në Qoshe;
- 3- Shkolla e Mullah Tahirit, afër lapidarit të Dyli e Haxhire Myzyrit.
- 4- Shkolla e Hidrajt në merkatë, me mësues Hafiz Gjelin dhe Imam Vrapin.

Ndër shkollat e sipërpërmendura nivelin më të lartë në aspektin e përgatitjes mësimore, e cila dallohej jo vetëm ndër shkollat e tjera private, por dhe tek ato shtetëroret, rezultonte ta kishte ajo e Fejz Guranjakut<sup>163</sup>. Ka të dhëna që dëshmojnë se kjo shkollë funksiononte si shkollë gjysmë publike, që evidentohet përmes faktit se kur zhvilloheshin provimet (imtihenet), në to ishte i pranishëm edhe një përfaqësues i autoriteteve shtetërore turke.

Ndërkaq, për përgatitjen e klerit të lartë mysliman funksiononin medresetë. Në to merrnin pjesë gjithsej 10-12 vetë, të cilët ishin të përjashtuar nga shërbimi ushtarak.

Por duhet thënë se arsimit në shkollat e huaja në Shqipëri përcaktohej nga niveli ekonomik dhe përkatësia social-shoqërore dhe fetare. Në këtë kuadër, numri i të diplomuarve që dilnin nga shkollat ryzhdije rezultonte i kufizuar. Gjithashtu, në numër më të vogël rezultoi edhe të diplomuarit nga Elbasani në shkollat e Janinës, Athinës apo Stambollit. Pikërisht, sipas statistikave në vjetarin e Mektebi-i Harbiye, në vitin 1880 përmenden emrat e shtatë personave të diplomuar nga Elbasani në shkollat jofetare në Stamboll. <sup>164</sup>

Ndërkohë, përveç myslimanëve burimet e kohës konstatojnë edhe faktin e frekuentimit të kufizuar të të krishterëve të pasur të Elbasanit të shkollave në Athinë<sup>165</sup>.

---

<sup>161</sup> Kjo shkollë e kishte marrë këtë emër për nder të Sulltanit. Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, përkthyer nga Artan Puto, Tiranë: Botimet Përpjekja, 2009, 90.

<sup>162</sup> AME, Materiale historike depozituar nga Sh. Demiri.

<sup>163</sup> Sh. Demiri, *Histori e shkurtër...*, vepër e citur, 87.

<sup>164</sup> Nathalie Clayer, *vepër e cituar*, 90-91.

<sup>165</sup> Po aty, 92.



Gjithashtu, në lagjen Shën Koll ka funksionuar një shkollë rumune dhe një shkollë greke, ku mësonin greqisht Llaz Bebi, Vasil Llapushi, Simon Shuteriqi, Dhimitër Papparisto, Sotir Toci dhe Pandora Perlepi. Këto shkolla financoheshin nga Stambolli me ndërmjetësinë e Syllogosit Epirot (të krijuar në vitin 1871) dhe nga Athina me ndërmjetësinë e Syllogosit Kulturor për përhapjen e gjuhës dhe kulturës helene, i themeluar në vitin 1869<sup>166</sup>.

Nuk është rastësi panorama që po i bëjmë gjendjes së shkollave të huaja në qytetin e Elbasanit, pasi në mungesë të shkollave shqipe, si në shkollat greke ashtu dhe ato turke patriotët elbasanas do të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë për t'i shndërruar ato në vatra të rëndësishme të mësimin të gjuhës shqipe. Një fakt i tillë gjen pasqyrim të qartë dhe në dokumentacionin e kohës. Kështu, në shkollën e Xhamisë së Agait rezultonte që Fejz Guranjaku dhe Xhaferr Dedej të kenë punuar me përkushtim të plotë për mësimin e gjuhës shqipe, duke qenë të ndërgjegjshëm për rrezikun që i kanosej. Njëkohësisht e njëjta dukuri konstatohej edhe në Hamidijen e Sulejmanies.

Kuadrin e kësaj veprimtarie e plotëson më së miri edhe fakti se vetë përfaqësuesi i klerit mysliman sheh Ibrahim Guma, pasi mbaronte mësimi i rregullt u krijonte mundësi patriotëve elbasanas të vazhdonin procesin e mësimdhënies, por me një ndryshim - mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. Të dhënat e kohës na konfirmojnë faktin se vetë sheh Ibrahim Guma nuk jepte mësim në gjuhën shqipe në këtë shkollë, por veprimtarinë e tij arsimore ai e ushtronte nëpër fshatrat e trevës së Elbasanit, duke u mësuar fshatarëve gjuhën shqipe.

Ndër patriotët elbasanas që ushtronin fshehurazi profesionin e mësuesit të gjuhës shqipe në këtë shkollë rezultonin të ishin: Sabri Dervishhasani, Hasan Mezja dhe Vasil Hatibi, të cilët krenoheshin me faktin se shqipen e kishin mësuar prej Kristoforidhit.<sup>167</sup>

Njëkohësisht, patriotët elbasanas u përpoqën të shfrytëzonin edhe shkollën vllahe që ishte projektuar të hapej aty. Hapja e kësaj shkolle u përkrah nga popullsia e të dyja besimeve kryesore fetare. Planifikimi nga patriotët elbasanas për të përfshirë në programin e kësaj shkolle edhe gjuhën shqipe, do të gjejë kundërshtimin e valiut të Manastirit, i cili nuk do të akordoi edhe lejen për hapjen e saj kur çdo gjë ishte pothuaj gati. Pikërisht nëpërmjet dokumentacionit të kohës, në një raport të konsullit austro-hungarez të Manastirit, informohemi për vendimin e valiut të Manastirit, i cili kishte deklaruar shprehimisht se: *“Derisa të jem në krye të administratës, nuk do të ap kurrë aprovimin për këtë shkollë”*, sepse hapjen e saj ai e

---

<sup>166</sup> Po aty, 101.

<sup>167</sup> AME, materiale historike depozituar nga Sh. Demiri.

konsideronte vetëm një pretekst për intriga nacionale shqiptare.<sup>168</sup> Shkolla vllahe arriti të hapet në Elbasan vetëm në shtator të vitit 1908, pas heqjes nga plani mësimor të gjuhës shqipe.

Gjithashtu, me iniciativën e Isuf Qoses dhe mbështetjen e konsullit grek të Manastirit një shkollë greke do të hapet edhe në zonën e malore të Shpatit. Mësues i greqishtes nga Elbasani në këtë shkollë ishte Amina Biba (Mini Bibaja), i cili përveç greqishtes do të jepte fshehurazi edhe mësimin e gjuhës shqipe. Sikurse shprehej edhe një ndër nxënësit e parë të kësaj shkolle: *“Ditën mësojim greqisht dhe natën shqip”*<sup>169</sup>.

Por, ajo çka është e dukshme gjatë periudhës së cilës i jemi referuar konsiston në faktin se patriotët elbasanas, në veprimtarinë e tyre në koherencë me lëvizjen kombëtare shqiptare, kanë pasur si moto udhëheqëse parimet e rilindësve shqiptarë, duke vlerësuar rolin dhe kontributin e gjuhës dhe të arsimit si një hap të rëndësishëm drejt së ardhmes së vendit, sikurse shprehej Sami Frashëri: *“Në ka gjë për të cilët shqiptarët duhet të kujdesen, ajo pa dyshim është dituria”*<sup>170</sup>.

---

<sup>168</sup> HHSTA/PA, *Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit*, nr. 45, dhjetor 1898.

<sup>169</sup> Xhemal Xhepa, Sul Dedej, “Mësimi i gjuhës shqipe dhe shkolla shqipe në Shpat”, në *Arësimi Popullor*, nr. 2, 1966, 90-91.

<sup>170</sup> Sami Frashëri, *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”*, Tiranë: Naim Frashëri, 1962, 79.

## **KAPITULI. II. TIPARET E ZHVILLIMIT TË LËVIZJES, ARSIMORE - KULTURORE NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1908 - 1910**

### **II. 1. Klubet patriotike shqiptare në Elbasan dhe produktet e tyre intelektuale**

#### **- Klubi “Bashkimi” në Elbasan dhe veprimtaria e tij**

Pas fitores së Revolucionit Xhonturk dhe shpalljes së kushtetutës turke (Hyrjetit) më 23 korrik të vitit 1908, lëvizja patriotike shqiptare u zhvillua në kushte të reja politike që u krijuan në Shqipëri dhe në të gjithë Perandorinë Osmane. Rrethet patriotike shqiptare e patriotët shqiptarë u përpoqën të shfrytëzonin liritë e përkohshme kushtetuese, për të realizuar me rrugë legale disa nga të drejtat themelore kombëtare në fushën e arsimit e kulturës. Fillimisht xhonturqit nuk guxuan të dilnin hapur kundër kësaj lëvizjeje për shumë arsye, prej të cilave do të veçonim rolin e rëndësishëm që luajtën shqiptarët në fitoren e Revolucionit Xhonturk dhe faktin se xhonturqit ende nuk e kishin stabilizuar dhe konsoliduar sa duhej pushtetin e tyre politik. Por kjo nuk përjashtonte faktin se ata do të përdornin të gjithë mjetet dhe format e mundshme për të penguar zhvillimin normal të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare sikurse shprehet Sejfi Vllamasi: “... me qëllim që nacionalizmin tonë ta mbytnin, para se të zhvillohej ndërgjegjja kombëtare”<sup>171</sup>.

Në fazën e parë pas Revolucionit Xhonturk(1908-1909), lëvizja për arsim kombëtar jo vetëm që doli më në dukje por u shndërrua në një lëvizje të gjerë patriotike me karakter gjithëpërfshirës, që u evidentua në procesin e krijimit të menjëhershëm të një rrjeti shkollash në gjuhën shqipe. Një lëvizje e tillë njohu një evoluim të dukshëm organizativ përmes organizimit edhe të kongreseve mbarëkombëtare për çështjen e alfabetit dhe shkollave shqipe. Kështu, duke përfituar nga lëshimet e pjesshme të bëra në këtë kohë, në funksion të procesit organizativ të Lëvizjes Kombëtare, patriotët shqiptarë u kujdesën për të krijuar klube e shoqëri kombëtare në të gjitha trevat shqiptare. Deri në fund të vitit 1908 konstatohet të jenë formuar afërsisht rreth

---

<sup>171</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Neraida 2000, 50.

tridhjetë klube e shoqëri patriotike kombëtare, ndërkohë që numri i tyre gjatë harkut kohor 1908-1912 arriti në 80, pa përfshirë këtu shoqëritë patriotike që ekzistonin në diasporë<sup>172</sup>.

Klubet dhe shoqëritë kombëtare që u formuan dhe ushtruan aktivitetin e tyre gjatë kësaj periudhe shfaqën disa tipare të përbashkëta, që konsistojnë në këto drejtime:

- Së pari ato ishin organizata gjithëpërfshirëse me karakter demokratik, të cilat përfshinin në radhët e tyre përfaqësues të shtresave të ndryshme të popullsisë. Në to merrnin pjesë intelektualë, nëpunës të aparatit shtetëror, mësues shkollash, përfaqësues të borgjezisë qytetare të prodhuesve dhe tregtarëve të vegjël të qytetit dhe të fshatit, pronarë të mëdhenj të tokave bejlerë-çifligarë, gjithashtu oficerë dhe përfaqësues të administratës osmane. Ato bashkonin në gjirin e tyre përfaqësues të rrymave politike të ndryshme në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si radikalët dhe të moderuarit, ndërsa në organet drejtuese të tyre qëndronin patriotë të shquar edhe më parë për veprimtari politike. Në këtë kuadër, mund të themi se procesi i formimit të tyre nuk ishte i lehtë, ai kaloi përmes kontradiktash dhe përplasjeve midis përfaqësuesve rrymave prezentë në gjirin e tyre.

- Së dyti ato u bënë nxitësit kryesorë për çeljen e kurseve e të shkollave në gjuhën shqipe. U kujdesen për sigurimin e fondeve e të lokaleve të nevojshme e të domosdoshme, për zhvillimin e procesit mësimor, u morën me përgatitjen e personelit pedagogjik dhe njëkohësisht me sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve mësimore shkollore. Ndërkohë që në statutet e tyre këto klube do të paraqiteshin si organizata me karakter thjesht humanitar. Në 31 korrik të vitit 1908, u themelua klubi “Bashkimi” i Manastirit me kryetar Feim Zavalanin dhe nënkryetar Gjergj Qiriazin<sup>173</sup>. Ky klub u shndërrua në një ndër klubet më të mëdha dhe më të rëndësishëm, që luajti një rol aktiv në formimin e klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e regjimit xhonturk. Me krijimin e tij ky klub përmes dërgimit të përfaqësuesve në qytete të ndryshme të vendit, do të krijojë komitete të reja në qytetet e Korçës, Vlorës, Elbasanit, Shkodrës, Shkupit, Tetovës, Beratit, Selanikut, në cilësinë e degëve të klubit të Manastirit<sup>174</sup>.

Në këtë kontekst, në vitet 1908-1909 edhe në trevën e Elbasanit u formuan disa klube dhe shoqëri të rëndësishme patriotike. Është për t'u përmendur fakti se kryesitë e klubeve dhe të shoqërive patriotike që u formuan në qytetin e Elbasanit zgjidheshin duke aplikuar sistemin e

<sup>172</sup> Hysni Myzyri, *Shkolla Normale ..., vepër e cituar*, 66.

<sup>173</sup> Historia e Popullit Shqiptar, vepër e cituar, 381.

<sup>174</sup> Po aty.

rotacionit. Këto klube e shoqëri kishin një këshill mbikëqyrës dhe kontrollues, që i drejtonte patrioti Aqif pashë Elbasani.

Kështu, në bazë të orientimit të klubit qendror “Bashkimi” të Manastirit, u formua në Elbasan një degë e këtij klubi me të njëjtin emër, pra klubi “Bashkimi” i Elbasanit<sup>175</sup>. Ky klub u shndërrua në një ndër klubet më të rëndësishme të kohës jo vetëm në trevën e Elbasanit, por dhe në të gjithë Shqipërinë. Pikërisht një status të tillë, sipas studiuesit elbasanas Shyqyri Demiri, e konfirmon dhe fakti që patriotët shqiptarë nuk nguruan ta cilësojnë klubin në fjalë për një periudhë kohe si klubin qendror në Shqipëri.<sup>176</sup> Ndërkohë që një vlerësim për aktivitetin dhe veprimtarinë e këtij klubi do ta japë edhe studiuesja Nathalie Clayer, duke e konsideruar klubin patriotik të Elbasanit si djepin e nacionalizmit shqiptar në Shqipërinë e Mesme<sup>177</sup>.

Për sa i përket kohës së krijimit të klubit “Bashkimi” në Elbasan, ekzistojnë të dhëna të ndryshme. Sipas studiuesit elbasanas Hysni Myzyri, mendohet që ky klub patriotik të jetë krijuar në të njëjtën kohë me çeljen e shkollës së parë fillore shqipe (më 2 gusht të vitit 1908), ndërsa zyrtarizimi i tij u bë disa ditë më vonë në 13 shtator të vitit 1908.<sup>178</sup> Një tjetër burim historik na e paraqet të formuar këtë klub në fund të muajit korrik të vitit 1908 pas shpalljes së Hyrjetit dhe pas krijimit të klubit të Manastirit.<sup>179</sup> Porse, ajo për të cilën studiuesit elbasanas bien dakord është fakti se në 2 gusht të vitit 1908 me ndihmën e këtij klubi është hapur e para shkollë shqipe në Elbasan.

Parë në këtë këndvështrim, hapja e së parës shkollë shqipe publike legale në Elbasan me ndihmën e këtij klubi, parakupton faktin se në këtë datë klubi “Bashkimi” realisht rezultonte i krijuar.

Në këtë kontekst mendojmë se klubi “Bashkimi” i Elbasanit është krijuar pas shpalljes së Hyrjetit dhe pas krijimit të klubit të Manastirit midis datave 2-3 gusht të vitit 1908, por më e pranueshme sikurse rezulton edhe në dokumentacionin përkatës është data 2 gusht e vitit 1908. Gjithashtu, përmes dokumentacionit përkatës rezulton se Lef Nosi që me krijimin e këtij klubi, në 8 shtator 1908 do të kontribuojë me një shumë prej 60 groshë<sup>180</sup>.

---

<sup>175</sup> AME, Kutia. 2, Dos. 6, fl. 5.

<sup>176</sup> Sh. Demiri, *Histori e shkurtër...*, vepër e cituar, 94.

<sup>177</sup> Nathalie Clayer, *vepër e cituar*, 78.

<sup>178</sup> AQSH, Fondi. 102, Dos. 100, fl. 1. Telegram dërguar nga Elbasani Feim Zavalanit në 31 gusht 1324/13 shtator 1908.

<sup>179</sup> Tomorr Plangarica, “Mjedisi intelektual në qytetin e Elbasanit në prag të Shpalljes së Pavarësisë”, botuar në *Normalja në Traditë*, Elbasan: Sejko, 1995, 30.

<sup>180</sup> AQSH, F. 32, Dos. 7, fl. 1.

Në mbledhjen e organizuar në Selanik në fillim të vitit 1908, për aprovimin e statuteve të klubeve shqiptare, Mit'hat Frashëri dhe shokët e tij deklaruan se këto shoqëri nuk duhet të ndjekin qëllime politike, por vetëm qëllime humanitare<sup>181</sup>.

Sikurse konstatohet, statuti i klubit “*Bashkimi*” të Elbasanit rezultonte në koherencë të plotë me programet e klubeve të tjera të krijuara në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Në mbledhjen e organizuar në Selanik në fillim të vitit 1908, për aprovimin e statuteve të klubeve shqiptare, për shkak të situatës politike të krijuar Mid'hat Frashëri dhe shokët e tij deklaruan se këto shoqëri nuk duhet të ndjekin qëllime politike, por vetëm qëllime humanitare.<sup>182</sup> Pavarësisht kësaj, klubi i Elbasanit sikurse dhe klubet e tjera shqiptare nuk paraqitej si një klub me karakter thjesht kulturor. Ai e shtriu veprimtarinë e tij edhe në fushën politike në favor të interesave kombëtare të popullit shqiptar. Përsa i përket strukturave drejtuese, në kryesinë e klubit “*Bashkimi*” të Elbasanit rezultonin:

**Kryetar** Refik efendi Myftiu

**Nënkryetar:** Dhimitër Buda, i cili pasi dha dorëheqjen, u zëvendësua nga Hysen Hostopalli

**Sekretar:** Simon Shuteriqi

**Nënsekretar:** Ahmet Dakli

**Arkëtar:** Nexhip Haxhiademi

**Anëtarë:** Qamil beu, Muç Shqiptari, Beqir Plangarica, Pavli Papadhopuli dhe Kamber efendiu.

Përmes burimeve të kohës konstatohet fakti se pas zgjedhjeve të reja që bëhen në tetor të vitit 1909 për kryesinë e Klubit “*Bashkimi*”, kryetar i tij zgjidhet Hysen Hastopalli që në vitin 1908 kishte zëvendësuar përkohësisht në cilësinë e nënkryetarit të klubit Dhimitër Budën<sup>183</sup>.

Klubi i Elbasanit kishte një përbërje heterogjene në aspektin social, me përfaqësues që vinin nga shtresa të ndryshme sociale, si nga zanatçinjtë, tregtarët, intelektualët, nëpunësit etj. Përsa i përket përkatësisë fetare të anëtarëve të klubit “*Bashkimi*”, konstatohet fakti se ai përbëhej në shumicë nga myslimanë bektashinj dhe gjithashtu edhe nga të krishterë ortodoksë<sup>184</sup>.

---

<sup>181</sup> HHSTA/PA, informacion i konsullit Austriak në Selanik, 7 shtator 1908.

<sup>182</sup> Po aty.

<sup>183</sup> K. Bevapi, *Hulumtime etnologjike*, Elbasan: Sejko 2007, 128.

<sup>184</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 611.

Duhet thënë se fillimisht krijimi i klubeve shqiptare nuk kaloi pa probleme. Kështu, tensionet dhe konfliktet që u shfaqën brenda klubeve shqiptare ishin produkt i drejtpërdrejtë i taktikës së instrumentalizimit që do të përdornin xhonturqit, që ushtrohej pikërisht nëpërmjet degëve të komitetit “Bashkim dhe Përparim” në qytetet shqiptare. Duke shfrytëzuar divergjencat sociale, fetare apo krahinore, në disa raste ata u përpoqën ti paraqitnin klubet shqiptare si organizata me karakter fetar, pse jo shpeshherë me synimin për tu vënë në krye të tyre.

Në këtë kuadër, në gjirin e klubeve shqiptare që u formuan pas shpalljes së “Hyrjetit”, do të konstatohen konfrontime midis përfaqësuesve të dy rrymave që ishin krijuar në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Një dukuri e tillë shfaqet edhe me formimin e klubit “Bashkimi” në Elbasan, në të cilin krahu i moderuar i përfaqësuar nga Dervish bej Biçaku u përpoq të siguronte drejtimin e tij. Ja çfarë na ofrojnë burimet e kësaj periudhe për këtë problem: “*Në Elbasan formimi i klubit “Bashkimi” u shoqërua me përleshje midis patriotëve shqiptarë dhe turqëve të rinj që u përkrahën nga aventurierë të tillë si Dervish bej Biçaku etj. që deshën të hynin me forcë në klub dhe ta shtinin në dorë atë*”<sup>185</sup>.

Ndërkohë, edhe në klubin e Manastirit sipas të dhënave të konsullit francez atje, thellimi i kontradiktave të brendshme do të shoqërohet me krijimin e dy fraksioneve; grupi i parë përfaqësohej nga elementët më të vendosur dhe patriotët e krahut radikal ku bënë pjesë 150 anëtarë, ndërsa grupi i dytë përbëhej nga 400 anëtarë të krahut të moderuar. Sipas konsullit të Manastirit, ndarja në dy grupe ishte rezultat dhe vepër e turqëve të rinj të cilët ishin të shqetësuar për shkak të përhapjes së idesë së pavarësisë në klube.<sup>186</sup> Qëllimi më kryesor i një rivaliteti të tillë në klubin e Manastirit, konsistonte në përpjekjet e disa prej përfaqësuesve më në zë të zonës, (sikurse ishin myftiu i Dibrës, Vehbi efendi dhe Abdurraman beu) për ti dhënë këtij klubi karakter mysliman. Nga shkrirja e dy fraksioneve në 20 tetor 1908 u formua një klub i ri drejtues i të cilit u zgjodh Rexhep Voka.<sup>187</sup>

Pavarësisht problemeve të shfaqura, mund të themi se një vend të rëndësishëm në programin e këtij klubi zinte pa dyshim zhvillimi i arsimit, kulturës, përhapja e gjuhës shqipe dhe rritja e ndërgjegjes kombëtare në trevën e Elbasanit. Klubi “Bashkimi” i Elbasanit, gjatë gjithë veprimtarisë së tij mbajti lidhje e marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me klubin e Manastirit.

<sup>185</sup> AQSH, Fondi. Klubi “Bashkimi”, i Manastirit, Dos. 6, fl. 350; Dos. 7, fl. 291; Dos. 9, fl. 1.

<sup>186</sup> *Alfabeti i gjuhës shqipe ..., vepër e cituar*, 59. Informacion i konsullit francez në Manastir, 21 tetor 1908.

<sup>187</sup> Nathalie Clayer, *vepër e cituar*, 560.

Në këtë drejtim një rol të pazëvendësueshëm ka luajtur në këtë klub dhe Halit Bërzeshta, një nga anëtarët më me autoritet të këtij klubi dhe njëherësh përfaqësues i trevës së Elbasanit.

Ndërkaq, një vit pas shpalljes së Hyrjetit, sikurse në Elbasan, edhe në Gramsh u krijua në korrik të vitit 1909 klubi i shoqërisë “Bashkimi”.<sup>188</sup> Patrioti gramshiot Asllan Shahini, lidhur me ngritjen e këtij klubi në maj të vitit 1909, në një letër të botuar në një nga gazetat e kohës, ndër të tjera shkruan: “.. *Sa pra dhe ne me ndihmat e popullit po përpiqemi të ngrehim një klub shqip, për pak dit çeljen dot ia rrëfejme me gzim të madh*”<sup>189</sup>. Në këtë klub bënin pjesë anëtare nga zona e Vërçës, nga fshati Lenije (Shënepremte), Kishtë, Bersik, Ostentë e deri në Mollas të Sulovës. Klubi “Bashkimi” në Gramsh mbante lidhje të ngushta me klubin e Elbasanit në zhvillimin e veprimtarisë politike arsimore e patriotike.

Rëndësi të madhe ky klub i kushtoi përhapjes së shkrimit të shqipes në Gramsh, duke kërkuar hapjen e shkollave shqipe. Një ish-nxënës në një shkollë fillore turke në një fshat të Gramshit, në kujtimet e tij tregon se “Lëvizja kombëtare ka filluar në Gramsh me mësimin e gjuhës shqipe”<sup>190</sup>. Më tej edhe nga korrespondenca ndërmjet klubeve të Manastirit dhe atij të Elbasanit evidentohen lidhjet që ekzistonin midis patriotëve gramshakë e atyre elbasanas.

Kuadrin e këtij bashkëpunimi e plotëson më së miri dhe një letër e dërguar nga Elbasani në adresë të klubit “Bashkimi” në Manastir në shtatorin e vitit 1908, ku ndër të tjera shkruhej: “... *Si u kemi shkruar dy muaj më parë, kemi nevojë shumë të madhe për libra, si brenda e jashtë nga Peqini, Gramshi, . . . e nga katundet vijnë njerzit e kërkojnë libra e abetare*”<sup>191</sup>.

Por, sikurse e kemi përmendur, deri në gusht të vitit 1908 të mësuarit e gjuhës shqipe në trevën e Elbasanit si dhe në trevat e tjera shqiptare bëhej në mënyre ilegale. Është më se i njohur në trevën e Elbasanit fenomeni i mësuesve dhe shkollave shëtitëse, përmes të cilëve mundësohej mësimi i gjuhës shqipe në fshatra të ndryshëm të krahinave të Shpatit, Çermenikës etj. Si të tillë mund të përmendim: Hysen Cekën, Hasan Gjevorin, Simon Shuteriqin, Hysen Haxhiun etj. Midis tyre vlen të përmendim dhe gratë arsimdashëse elbasanase: Tushi Xhonin, Shahu Dylgjerin etj. Hysen Ceka, sapo mori vesh shpalljen e Hyrjetit, nxitoi të hapë një kurs publik për të mësuar gjuhën shqipe<sup>192</sup>.

---

<sup>188</sup> AME, K. Musaj, sesione, D. 14, fl. 2.

<sup>189</sup> “Lirija”, Selanik, 6 qershor 1909, në *Mendimi politik dhe shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vepër e cituar, 447.

<sup>190</sup> *Lufta për çlirim kombëtar*, kujtime të Tafil Musajt, Tiranë: 1962, 306.

<sup>191</sup> AQSH, Fondi. “Klubi Bashkimi i Manastirit”, Dos. 5, f. 137-138.

<sup>192</sup> Sh. Demiri, *Histori e shkurtër...*, vepër e cituar, 94.



Ndërkohë, më 2 gusht të vitit 1908 patriotët elbasanas, anëtarë të klubit “Bashkimi”, hapën të parën shkollë fillore publike në qytetin e Elbasanit. Për finalizimin e aktit në fjalë klubi “Bashkimi” zhvilloi një veprimtari të mirorganizuar<sup>193</sup>. Kështu, për shkak të numrit të madh të nxënësve të regjistruar, si godinë e shkollës së parë shqipe në Elbasan do të shërbejë godina që ishte ngritur për tu përdorur si burgu i ri i Elbasanit.<sup>194</sup>

Përmes dokumentacionit të kohës mësojmë se në Elbasan, nën kryesinë e Aqif pashë Biçakçiu, u zhvillua një mbledhje e cila kishte si synim sikurse thuhej: “*vetëm të mësojë djemtë e vajzat në gjuhën e vet*”. Brenda dy ditësh u bë e mundur që të mblidheshin më tepër se 200 lira turke, me anën e të cilave do të paguheshin mësuesit, pa prituri që ata të paguheshin nga organet shtetërore osmane. Gjithashtu, ishte vendosur të caktohej nga një mësues për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat fillore turke dhe greke të qytetit.<sup>195</sup> Hapjes të së parës shkollë fillore publike në Elbasan i bëhet jehonë edhe nga gazetatat më të rëndësishme të kohës. Kështu, gazeta “Lirija” në Selanik shkruante: “*Sot u çel në Elbasan shkolla e parë shqip. Ishin mbledhur me mijëra shqipëtare me gaz në buzë e shpresë në zemër. Erdhi Mytesarifi dhe disa nëpunës. Hafëz Sulejman efendiu këndoi një lutje, pastaj për të bekuar këtë ditë u hodhën 21 topa*”<sup>196</sup>. Edhe gazeta “Kalendari Kombiar” në Sofje do të shkruante: “*E para shkollë u çel në Elbasan në javë të konstitucionit; pas asaj erdh e Tiranësë...*”<sup>197</sup>. Ndërkaq, në fund të tetorit të vitit 1908 edhe në zonën e Shpatit u hap një shkollë e tillë shqipe<sup>198</sup>.

Një shkollë shqipe ku mësimi i gjuhës shqipe bëhej nga patriotë vendas u hap në fund të vitit 1908 në Bërzeshtë të Librazhdit, ku mësuesi i saj ishte patrioti Rifat Leka.<sup>199</sup>

Edhe në krahinën e Peqinit, patriotët Adem Gjinishi, Demir Godelli, Rexhep Peza, Hekuran Bedalli, Ramazan Teqja, pa marrë parasysh rreziqet që u kanoseshin, përmes një përkushtimi të madh kontribuuan për përhapjen e mësimin dhe të gjuhës shqipe.

Por meqenëse hapja e shkollave shqipe për arsye financiare ishte një proces i vështirë, patriotët shqiptarë e panë të arsyeshme futjen e gjuhës shqipe në shkollat e huaja ekzistuese deri

---

<sup>193</sup> AME, D. 63, fl. 26.

<sup>194</sup> Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, gusht 1908. Numri i nxënësve të regjistruar mendohej se ishte rreth 1000 -1500 nxënës.

<sup>195</sup> “Lirija”, Selanik, nr. 8, vjeshtë e parë, 1908.

<sup>196</sup> “Lirija”, nr. 4, Selanik, 4 gusht 1908, 3.

<sup>197</sup> “Kalendari Kombiar”, Sofje, viti 1909, në *Mendimi Politik dhe Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptar*, vepër e cituar, 440.

<sup>198</sup> AME, Dos. 63, fl. 26.

<sup>199</sup> Pirro Koto, vepër e cituar, 29.

në atë periudhë në Shqipëri. Në këtë kuadër, konstatohen përpjekjet e klubeve shqiptare të Elbasanit, Janinës dhe klubeve të tjera në kërkesat e shprehura ndaj autoriteve lokale në funksion të këtij qëllimi. Duhet thënë se klubi i Elbasanit arriti të sigurojë edhe mjetet financiare për mbajtjen e mësonjësve që do të jepnin gjuhën shqipe në shkollat e qytetit madje edhe në ato të katundeve.

Kështu, Pleqësia e klubit të Elbasanit pas refuzimit të kërkesës nga mytesarifi dhe drejtori(mydyrit) i stërvitores turqishte(idadijes) për futjen e gjuhës shqipe në këtë shkollë, i drejtohet Valiut të Manastirit. Por, në informacionin e dërguar nga Elbasani klubit të Manastirit, informohemi për urdhrin e Valiut të Manastirit që ndalonte mësimin e gjuhës shqipe në stërvitoret turqishte derisa të merrej përgjigja e nevojshme prej kryeqytetit<sup>200</sup>.

Që në fillimet e tij, veprimtaria e klubit të Elbasanit kishte rënë në sy të konsullit austro-hungarez në Halla në Durrës, i cili pasi thekson se në asnjë qytet të sanxhakut të Durrësit nuk ishte krijuar ndonjë klub shqiptar shprehet se: “... përveç bejlerëve të Elbasanit, prej të cilëve Akif Pasha ka marrë përsipër drejtimin e klubit, bëjnë pjesë në të edhe të tjerë nga paria muhamedane dhe e krishterë. Në fillim klubi shqiptar ishte në një pozitë të vështirë kundrejt fanatizmit të ndonjë muhamedani, por, si duket, këto vështirësi sot janë mënjeluar krejt”<sup>201</sup>. Me tej konsulli austro-hungarez, e konsideron si vepër të këtij klubi edhe futjen e gjuhës shqipe si gjuhë mësimi e parë në shkollën e komunitetit ortodoks të Elbasanit, duke i lënë gjuhës greke vetëm vendin e dytë.

Në korrespondencën midis klubit të Elbasanit dhe atij të Manastirit që mban datën 31 Shëndre të vitit 1908, parashtrohet kërkesa e përfaqësuesve të klubit të Elbasanit për ti kërkuar Stambollit njohjen zyrtare të kombit shqiptar. Përmes këtij burimi informohemi gjithashtu edhe për përpjekjet e Patriarkanë Grekë për të penguar mësimin e gjuhës shqipe në zonën e Shpatit. Për këtë problem me konkretisht thuhej se: “...Në Shpat ku klubi jonë mezi vuri tre mësonjës, me vrap, po sa e mësuan këtë punë grekërit, po dërgohet nga Korça një mësonjës i gjimnazit atjeshëm elbasanas Efrem Gjini me shum të zotume e me durët plot prej konsullit Greqis”<sup>202</sup>.

---

<sup>200</sup> AQSH, F. Klubi shqiptar “ Bashkimi” i Manastirit, Dos. 6, dok. nr. 142.

<sup>201</sup> HHSTA/PA, raport i konsullit austro – hungarez në Durrës, Halla, drejtuar Vjenës në 7 nëntor 1908. *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: 1972, 351-352.

<sup>202</sup> AQSH, F. Klubi Shqiptar “ Bashkimi”, i Manastirit, Dos. Nr. 6, dok. nr. 142.

Kuadrin e bashkëpunimit midis klubit të Manastirit dhe Klubit të Elbasanit e pasqyron edhe telegrami dërguar në shtator 1908 klubit “*Bashkimi*” në të cilin parashtroheshin këto kërkesa kryesore:

1. Mbajtja e një kongresi të gjuhës shqipe (jepen mendime që ky kongres të mbahet në një qytet në qendër të Shqipërisë);
2. Caktimin e dërgimin e delegatëve;
3. Nevojën e unifikimit të dialekteve në gjuhën e shkruar;
4. Nevojën për t'i bërë një kërkesë qeverisë turke në emër të të gjithë shoqërive për njohjen e kombit shqiptar<sup>203</sup>.

Në të njëjtën kohë, përmes burimeve të kohës evidentohet bashkëpunimi dhe ndihma e klubit “*Bashkimi*” të Elbasanit ndaj mësuesve dhe nxënësve të zonës së Shpatit. Kështu, sapo u krijua klubi i Elbasanit shpatarakët të udhëhequr nga Isuf Qosja një pjesë e të cilëve rezultoi komandantë çetash, i kërkuan klubit “*Bashkimi*” sigurimin e mësuesve për zonën e tyre. Por pas përgjigjes negative që Aqif Pasha i jep atyre për shkak të mungesës së mësuesve përkatës, ata u shprehën të gatshëm ta merrnin përsipër vetë këtë mision. Pikërisht djemtë që u morën në provim ishin Kodhel Dedja, Sul Panxhi nga Valëshi, Bim Panxhi nga Valëshi, Dyl Dervishi nga Valëshi dhe Cane Sharra nga Pashtreshi të cilët pas dhënies më sukses të provimit u pranuan si mësues<sup>204</sup>.

Në këtë kuadër, pas sigurimit të këtyre mësuesve në Shpat u hapën katër shkolla shqipe, duke u krijuar katër zona të grupuar në disa fshatra. Mësuesit që jepnin mësim ishin:

- Kodhel Dedja, jepte mësim në katundet, Zavalinë, Jeronishtë e Seltë me qendër në Seltë e Zavalinë. Dy javë mësim jepej në Seltë, ku vinin dhe nxënësit e Nexharit dhe dy javë të tjera në Zavalinë ku vinin dhe nxënësit e Jeronishtit.

- Bim Panxhi, jepte mësim në katundet Gjinar, Valësh, Stërstan, Lukan, Lleshar dhe Pashtresh me qendër Gjinar.

- Cane Sharra, jepte mësim në katundet Shelcan, Trepsenisht, Tudan, Kryezjarrth e Mëlizë me qendër Shelcan.

---

<sup>203</sup> AQSH, F. 102, Dos. 102, fl. 1-6. Letër e klubit të Elbasanit dërguar klubit të Manastirit, shtator 1908.

<sup>204</sup> AME, kujtime të Kodhel Dedes depozituar në muzeun etnografik Elbasan.

- Dyl Dervishi, jepte mësim në katundet Shtërmen, Bujarës, Kodrabujarës e Malasej me qendër në Shtërmen<sup>205</sup>.

Organizimi i procesit mësimor në zonën e Shpatit administrohej nga patriotët Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Petro Dodbiba dhe Dhimitër Paparisto. Në këto shkolla, përsa i përket metodës që përdorej për mësimin e gjuhës shqipe në klasën e parë, fillimisht u mësoheshin nxënësve zanoret dhe më pas bashkëtingëlloret sipas rendit alfabetik. Për mësimin e bashkëtingëlloreve, çdo zanore lidhej me të gjitha bashkëtingëlloret duke qëndruar zanorja para p.sh; *ab, ac, aç...*, *eb, ec, eç...*etj. Qëllimi ishte që të mësohej alfabeti mekanikisht dhe më pas të mësoheshin fjalët duke u zbërthyer në rrokje. Në këtë kuadër, pas një punë të vështirë por të suksesshme një vjeçare të mësuesve në zonën e Shpatit, në qershor të vitit 1909, shkollat e krahinës së kësaj zone dërguan mësuesit dhe gjithë nxënësit e tyre për të bërë provimet vjetore në klubin “Bashkimi”. Përfundimi i suksesshëm i provimeve u shoqërua me organizimin e një ceremonie festive dhe tepër miqësore.<sup>206</sup>

Në Elbasan, krahas shkollës shqipe të ditës, u hapën edhe shkolla të natës, për t’u mësuar shkrim e këndim veçanërisht të rriturve, zanatçinjve, nëpunësve etj. Fillimisht, në janar të vitit 1909, konstatohet hapja e shkollës së natës nga ortodoksët e lagjes Kala, kontributi i të cilëve ka qenë mëse evident gjatë gjithë lëvizjes politike dhe arsimore në qytetin dhe trevën e Elbasanit. Lajmi për çeljen e shkollës së natës pasqyrohet në një artikull botuar në gazetën “Lirija” të Selanikut nga Rrasë e Bardhë (pseudonimi i Josif Haxhimimës), ku ndër të tjera thuhej: “*Me gëzim ju lajmërojmë se të krishterët e këtushëm hapën një mësonjëtorë nate dhe mësimet po jepen rregullisht*”<sup>207</sup>.

Lëndët që jepeshin në këtë shkollë rezultonin: Mësim gjuhe, Istori, Dheshkronjë (Gjeografi), nga ana e z. Lef Nosi, z. Fot Papajani në lagjen Kala. Në artikull thuhej se: “*Mësonjëtorja ka 40 nxënës. Shumë mirë do të jetë që edhe muhamedanët e këtushëm të hapin një mësonjëtorë nate*”.<sup>208</sup> Gjithashtu dokumentacioni i kohës konfirmon faktin e çeljes në Elbasan edhe të një shkolle tjetër të natës, përveç shkollës së natës të përmendur më sipër. Kjo

---

<sup>205</sup> Po aty.

<sup>206</sup> Pirro Kito, vepër e cituar, 29.

<sup>207</sup> “Lirija”, nr. 23, Selanik, 3 janar 1909, fl. 2. Artikulli ishte dërguar nga Elbasani në 10 janar 1910 nga autori i tij me pseudonimin Rras e Bardhë (Josif Haxhimima).

<sup>208</sup> Po aty.

shkollë si ambient mësimor përdorte vetë godinën e klubit “Bashkimi” të Elbasanit dhe në të mësonin rreth 60-70 të rinj myslimanë e të krishterë<sup>209</sup>.

Rritja e shpejtë e lëvizjes për arsim kombëtar pas shpalljes së kushtetutës turke, çelja e shkollave të reja shqipe të ditës e të natës, përhapja e gjerë e shkrimit dhe leximit shqip shtruan si detyrë emergjente caktimin e një alfabeti të njësuar e të detyrueshëm për të gjithë shqiptarët, në kushtet e ekzistencës së shumë alfabeteve që krijonin vështirësi në shkrimin e gjuhës shqipe. Pikërisht ky do të ishte një nga objektivat kryesore të kongresit që do të mbledhet në Manastir në 14 -22 nëntor të vitit 1908.

Përdorimi i disa alfabeteve në shkrimin e gjuhës shqipe kishte vite që ishte përvijuar si një problem tepër shqetësues edhe nga konsujt austro-hungarezë në Shqipëri, shqetësim ky që pasqyrohet në raportet që konsujt i dërgonin eprorëve të tyre në Vjenë. Vetëm në Shkodër përdroreshin disa alfabete, ku ndër më të rëndësishmit konsideroheshin alfabeti i shoqërisë “Bashkimi” në përdorimin e të cilit dha një kontribut të madh abati Preng Doçi dhe përdorej për shtypjen e librave shqip që përdroreshin në shkollat italiane. Alfabeti i Mjedës ose i shoqërisë “Agimi” përdorej më tepër për shtypjen e librave që përdroreshin në shkollat austro-hungareze<sup>210</sup>.

Gjithashtu, përdorimi i disa alfabeteve në shkrimin e librave në gjuhën shqipe në Shkodër përveçse krijonte probleme në aspektin e shkrimit të shqipes, konsiderohej edhe si shprehje e rivalitetit midis Austro-Hungarisë dhe Italisë për dominim në këtë zonë<sup>211</sup>. Problemi i unifikimit të alfabeteve do të konsiderohet si tepër i rëndësishëm nga konsulli austro-hungarez Posfai. Në këtë kuadër, në raportet sistematike që ai i dërgonte Vjenës zyrtare konstatohen përpjekjet e tij në mbështetje të klubit të Manastirit për të organizuar në Manastir një kongres për çështjen e alfabetit, duke u shprehur se: *“Thirrja e një Kongresi të përgjithshëm që e kam lajmëruar, u shty disa herë dhe u bë vetëm tani shpejt. Duke marrë parasysh ramazanin dhe bajramin që po afrohen, kongresi do të mbledhet më 1 nëndor të stilit të vjetër”*<sup>212</sup>.

Duke ju referuar këtij burimi mendojmë se bëhet fjalë për Kongresin e Manastirit. Ndërkaq, konstatojmë faktin se konsulli Posfai jo vetëm që ishte i mirinformuar për thirrjen e Kongresit për çështjen e alfabetit, por mendojmë se ai ka luajtur një rol tepër aktiv në

<sup>209</sup> AQSH, Fondi. Klubi shqiptar “Bashkimi”, Dos. 5, 137-138. *Alfabeti i gjuhës ...*, vepër e cituar, 61.

<sup>210</sup> HHSTA/PA Raport i konsullit Kral dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme Vjenë, 28 qershor 1904.

<sup>211</sup> Po aty.

<sup>212</sup> HHSTA/PA. Raport i konsullit Posfai dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme Vjenë, 31 gusht 1908. *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Botim i Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë: 1972, 312-313.

organizimin e tij. Dokumenti në fjalë rezulton të jetë dërguar në 31 gusht të vitit 1908, pikërisht më parë se të dalë nga klubi i Manastirit thirrja për mbledhjen e Kongresit. Sipas burimeve të kohës rezulton se ftesa e parë e klubit të Manastirit për Kongresin e alfabetit është bërë në 23 shtator 1908<sup>213</sup>.

Në një kontekst të tillë historik, do të shfaqen lidhjet e ngushta midis klubit “Bashkimi” të Elbasanit e atij të Manastirit. Kjo bashkëmarrëdhënie ndërmjet këtyre dy klubeve pasqyrohet në ftesën për pjesëmarrje në kongres të klubit të Elbasanit ku midis të tjerave thuhej: “Duke vlerësuar lidhjen e ngushtë dhe rëndësinë që kishte njësimi i alfabetit për *“përparimin dhe arsimimin e kombit tonë”* dhe pasi *“u shoshën e u përshoshën”* ato që u kishte shkruar klubi i Manastirit, ne anëtarët e klubit Bashkimi të Elbasanit ju përgëzojmë e falënderojmë për ftesën që na bani<sup>214</sup>.

Më tej klubi “Bashkimi” i Elbasanit i parashtroi klubit të Manastirit disa sugjerime për mbledhjen e kongresit e më konkretisht:

- Për vendin e mbajtjes së Kongresit thuhej se :“Na duket ma e drejtë që një mbledhje e tillë e përgjithshme të bahet në kërkthizët të Shqipërisë”[bëhej fjalë për Elbasanin]
- Për gjuhën që duhej përdorur duke sugjeruar si gjuhë të përbashkët të folurën e Elbasanit dhe duke u shprehur se: *“Mbas mendimit tonë lypset që mbledhja të marri masa që si gjuhë e përgjithshme në gjithë Shqipërinë, ligjëroja ma e bukur me të cilën asht bashkumun si me thanë toskënishtja me gegënishten asht ajo e Elbasanit, që mund të merret vesh e të flitet prej të gjithë shqiptarëve”*.<sup>215</sup>
- Për nevojën e unifikimit të dialekteve në gjuhën e shkruar;
- Për domosdoshmërinë për t’i drejtuar një kërkesë qeverisë turke në emër të të gjithë shoqërive për njohjen e kombit shqiptar<sup>216</sup>.

Sipas letërkëmbimeve që disponojmë për këtë periudhë për problemin e mbledhjes së Kongresit të Alfabetit, pohojmë se jo vetëm ndër patriotët elbasanas por edhe ndër patriotët e tjerë shqiptarë ekzistonte mendimi që Elbasani konsiderohej si vend i përshtatshëm për mbledhjen e një kongresi arsimor kombëtar. Një mendim i tillë gjen shprehje edhe në një letër që Luigj Gurakuqi i dërgon një mikut të tij në Elbasan në të cilën midis të tjerave ai shprehet se:

---

<sup>213</sup> *Alfabeti i gjuhës shqipe...*, vepër e cituar, 316.

<sup>214</sup> AQSH, F. 102, Dos. 102, f. 2.

<sup>215</sup> Po aty.

<sup>216</sup> AQSH, F. 102, Dos. 102, f. 1-6, Letër e klubit të Elbasanit dërguar klubit të Manastirit, shtator 1908.

“Edhe mue më dëshironte zembëra që kongresi për çështje t’alfabetit të mbahej n’Elbasan, po, pasi që ata të Manastirit i kishin bamun gati të gjitha punët, tash nuk asht mirë të kundërshtohemi.- - - Të lutem, pra, mundohu sa të kesh fuqi që të mos të dalin ngatrrime t’jera... Shkrova në Manastir që t’a thërasin domosdo Faik Konicën në kongres ku kam shpresë se ke për të qenë edhe ti<sup>217</sup>; na do të vijmë nj’a pesë a gjashtë vetë; tue u k-ëthye nga Manastiri kemi për t’ardhun n’Elbasan”<sup>218</sup>.

Ndërkohë, në një tjetër letër që Luigj Gurakuqi i dërgon nga Shkodra Feim Zavalanit shprehet se:“Nga Elbasani më shkruajnë se atyre nuk u pëlqen që Mbledhja e Abc-esë të bëhet në Manastir, nga ana tjera po marr vesh se edhe në Berat duan të bëjnë një mbledhje për të zgjidhur çështjen e alfabetit... Nga Elbasani më shkruajnë edhe se Ju kini qëllim që mos t’a ftoni në mbledhje Faik bej Konicën, drejtorin e **Albanies** së Londonit; unë nuk e zë besë këtë punë, ju si do që në qoftë, ju lutem dhe një herë që të thirrni të gjithë shkronjëtorët shqiptarë, e kryetarët e klubevet e të shoqëriravet kudo që ndodhen, kështu që Mbledhja e Manastirit të dalë një mbledhje Kombëtare, e përgjithshme e që t’i japë fund një herë e për gjithëmonë çështjes së alfabetit”<sup>219</sup>.

Në letërkëmbimin midis klubit të Manastirit dhe atij të Elbasanit që mban datën 12 tetor 1908, informohemi rreth faktit se anëtarët e klubit të Elbasanit megjithë dëshirën e tyre që kongresi të mbledhej në Elbasan, përfundimisht bien dakord duke shprehur miratimin e tyre për mbledhjen e kongresit në Manastir, duke u shprehur se: “Letrën që na shkruani më 8 të këtij muaji e muarëm ene me kujdes e këndumë. Mas mendimeve që na shfaqni s’qenka e munëshme me u banum mbledhja në vend tjetër për veç se Manastirit. Fort bukur. Ne neve s’ngulim kamë që të bahet e tona, sepse as patëm as nuk kemi qëllim, qi të kundërshtohemi, veç deshëm vetëm të shfaqim mendimet e tana”<sup>220</sup>.

Kështu, në 14 nëntor 1908 do të hapet Kongresi i Manastirit. Në të ishin të pranishëm 50 delegatë, por e drejta e pjesëmarrjes me votë ju njoh 32 anëtarëve. Sipas programit të parashtruar nga klubi i Manastirit për mbledhjen e kongresit, fillimisht ishte vendosur që klubet shqiptare të

---

<sup>217</sup> Letra nuk e ka emrin e adresatit që i drejtohet Luigj Gurakuqi, por duke u mbështetur në përmbajtjen e saj mendojmë se personi që i dërgohet letra duhet të jetë delegat në kongres sepse sikurse konstatohet fillimisht nga rregullorja e hartuar ishte vendosur që në kongres të merrnin pjesë kryetarët e klubeve shqiptare, pra mund të jetë kryetari i klubit të Elbasanit.

<sup>218</sup> AQSH, Fondi. Luigj Gurakuqi, Dos. 30, letër e datë 17 tetor 1908.

<sup>219</sup> AQSH, Fondi. Luigj Gurakuqi, Dos. 28, f. 1. Letra mban datën 8 tetor 1908.

<sup>220</sup> AQSH, Fondi. Klubi Shqiptar “Bashkimi”, Dod. 5. Elbasan më 12-të vjeshtës së dytë 1908, nënshkruar nga Simon Shuteriqi.

përfaqësueshin me jo më shumë se dy delegatë me të drejtë vote. Një fakt i tillë u konstatua në ftesat që organizatorët e kongresit fillimisht i dërguan pjesëmarrësve në kongres<sup>221</sup>. Por më pas, sikurse rezulton nga burimet e kohës ky rregull u ndryshua. Një fakt i tillë, konfirmohet edhe përmes korrespondencës së vazhdueshme midis klubit të Manastirit dhe atij të Elbasanit, ku në letrën e dërguar nga klubi i Elbasanit fillimisht ishte vendosur që në kongres të dërgohej nga një përfaqësues për çdo klub duke u shprehur se: “ *Letrën, që na shkruani më 16 të këtij muaji e muarëm ene me kujdes e këndumë. Me çudie shofim, qi na thoni mos dërgojmë një përfaqësonjës për në mbledhjet e abcesë po ma shumë. Ju lutemi veni re letrën, qi ju bamë, ju shkrumë, me gas du t’ju dërgojmë përfaqësonjësit (representant)...*” Po aty informohemi se në mbledhjen e mbajtur nga këshilla sundimtare e klubit të Elbasanit u zgjodhën si përfaqësues zotërinjtë: Taqi Anastasi(Taqi Buda), Simon Shuteriqi dhe Kamer Efendi Sejдини, Ysbash i Avxhi Taborrit(kapiten i batalionit gjujtës). Përsa i përket këtij të fundit thuhet se: “*Ky zotni qi përmendëm në fundt, u nis sot për në Manastire, ene prandaj ju lutemi shumë të përpiqeni të merrni prej kumandantit këti lejen qi t’qëndrojë aty deri sa t’mbarohet puna e bashkimit të abecesë*”<sup>222</sup>.

Një pjesëmarrje e tillë pasqyrohet edhe në shtypin e kohës. Në një artikull të botuar në faqet e gazetës “Lirija” të datës 8 nëntor 1908, rezultonin edhe delegatët e Elbasanit në Kongresin e Manastirit që ishin Simon Shuteriqi dhe Dhimitraq Buda, i cili në këtë kongres u shpreh se: “*Qëllimi i Kongresit nuk është të merret me filozofi se këtë fuqi s’e kanë delegatët, por është më mirë të merremi vetëm me **a, b e ce-të***”<sup>223</sup>.

Duke ju referuar një tjetër burimi konstatojmë se në kongresin e Manastirit kanë marrë pjesë edhe Josif Haxhimina e Petër Dodbiba<sup>224</sup>. Gjithashtu, nëpërmjet një letre që klubi i Elbasanit i dërgon atij të Manastirit informohemi së në Kongresin e Manastirit si pjesëmarrës pa të drejtë vote ka marrë pjesë edhe Lef Nosi.<sup>225</sup> Gjithashtu, përfaqësues të Elbasanit në këtë kongres, në cilësinë e të ftuarve përmenden; Bexhet Beu, Kamber Efendiu dhe Muhtarit Selmanit(shok i Cercizit)<sup>226</sup>. Ndëkaq, duhet thënë se nënkryetar i Kongresit të Manastirit u

---

<sup>221</sup> *Alfabeti i gjuhës shqipe ..., vepër e cituar*, 317. Xhevat Lloshi në botimin e tij “*Rreth alfabetit ..., vepër e cituar*, jep një numër prej 60 pjesëmarrësish në kongres.

<sup>222</sup> AQSH, Fondi. klubi shqiptar “Bashkimi” në Manastir, Dos. 5, fl. 239.

<sup>223</sup> “Lirija” Selanik, vjeshtë e tretë 1908.

<sup>224</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, 303.

<sup>225</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale...*, vepër e cituar, 175.

<sup>226</sup> Ibrahim. D. Hoxha, *vepër e cituar*, 201.



zgjodh Gjergj Qiriazi, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqërisë Biblike Britanike dhe kryesoi mbledhjen e parë të kongresit.<sup>227</sup>

Problematika më kryesore në kuadrin e zhvillimeve të punimeve Kongresit të Manastirit më së shumti do të evidentohet përmes diskutimeve paraprake të delegatëve pjesëmarrës, me synimin kryesor pranimin e një alfabeti të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe. Sikurse u konstatua nga diskutimet e delegatëve në ditët e para në Kongres, për shkak të një kompleksiteti faktorësh, divergjencat për pranimin e një alfabeti ishin evidente. Në këtë kuadër konsensusi i arritur nga delegatët e kongresit u finalizua me krijimin e një komisioni me kompetenca të plota i përbërë prej 11 anëtarësh. Në këtë komision që u zgjodh me votim të fshehtë, rezultonte anëtar edhe përfaqësuesi i Elbasanit Dhimitraq Buda.

Komisionit të Kongresit të Manastirit iu atribuua e drejta për të caktuar alfabetin e përbashkët kombëtar. Duke ju përmbajtur zbatimit të statusit të Kongresit, vendimmarrja e këtij komisioni do të përcaktohej me shumicë zërash(votash) dhe njëkohësisht do të ishte i pranueshëm për të gjithë përfaqësuesit e Kongresit. Në këtë kuadër, anëtarët e tij dhanë besën se do të ruanin fshehtësinë për bisedimet që do të bëheshin. Pikërisht, synimi kryesor i Komisionit që u formua në Kongresin e Manastirit, do të shfaqej përmes diskutimeve rreth çështjes së pranimit me unanimitet të një alfabeti të përbashkët, jo vetëm për të lehtësuar mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe, por në të njëjtën kohë edhe për të frenuar ndikimet e grupeve të ndryshme turkofile apo grekofile brenda dhe jashtë vendit në çështjen e pranimit të alfabetit.

Ndërkaq, që para mbledhjes së Kongresit, klubi i Manastirit kishte shpallur edhe programin e këtij kongresi. Mbi bazën e tij përcaktohej si president nderi Guvernatori i përgjithshëm Hivzi Pashaj dhe si presidentë do të funksiononin presidenti dhe nënpresidenti i klubit “Bashkimi”, Rexhep Hoxha dhe Feim bej Zavalani.

Duhet thënë, se në kuadrin e zhvillimit të punimeve të komisionit të zgjedhur për çështjen e alfabetit rezulton të jetë marrë në konsideratë edhe abetarja e Kostandin Kristoforidhit, pavarësisht faktit se ajo nuk u shqyrtua më tej nga përfaqësuesit e kongresit duke “u quajtur njëzëri” e papërshtatshme<sup>228</sup>. Ndërkaq, vendimi më i rëndësishëm i kongresit do të konsiderohet miratimi i një alfabeti me bazë latine dhe njëkohësisht pranimi me disa ndryshime edhe i

---

<sup>227</sup> Xhevat Lloshi, *Rreth alfabetit...*, vepër e cituar, 44.

<sup>228</sup> Ibrahim. D. Hoxha, *vepër e cituar*, 204. Abetarja e K. Kristoforidhit përfshinte katër copa leximi me përmbajtje nga Dhjata e vjetër, me shkronja të përziera.

alfabetit të Stambollit. Një vendim i tillë duhet thënë ishte një hap përpara në krahasim me të periudhën paraardhëse, por duke mos i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së alfabetit.

Përmes burimeve ta asaj kohe konstatohet fakti gjatë punimeve të Kongresit të Manastirit, [duke u përqëndruar më tepër në diskutimet rreth çështjes së alfabetit], nuk u trajtuan disa nga problemet të cilat ishin përfshirë më parë në programin e shpallur nga klubi i Manastirit.

Konkretisht, nuk u trajtua problemi për krijimin e shkollave më të larta shqipe nga vetë shqiptarët dhe sigurimi i fondeve për mbajtjen e tyre, kërkesa drejtuar qeverisë osmane për të futur mësimin e gjuhës shqipe në të gjithë shkollat shtetërore turke dhe për të marrë masat për emërimin e mësuesve që do të jepnin gjuhën shqipe në këto shkolla.<sup>229</sup>

Ndërkohë, përsa i përket problemit të organizimit të klubeve dhe shoqërive patriotike-kulturore ekzistuese deri në atë kohë, nuk u përcaktua ndonjë klub konkret qendror përsa i përket drejtimit të tyre. Por, në vendimin e ditës së fundit lihej të nënkuptohej fakti se drejtimin e klubeve patriotike do ta kishte klubi i Manastirit. Në këtë kuadër, në ditën e fundit të kongresit në vendimet që u morën thuhej: *“Klubet dhe shoqërië që janë në Shqipëri të shkruajnë te klub i Manastirit për çdo gjë që u shkon në mendje dhe klubi i Manastirit të ketë për detyrë të bëjë në muaj një herë nga një raport dhe ta dërgojë në tërë klubet dhe shoqëritë, duke u shprehur se: “Në këtë mënyrë klub’i Manastirit do të jetë si shkronjës i klubevet të tjerë, por s’do ketë nonjë fuqi tjetër”*.<sup>230</sup>

Në këtë kuadër, duke ju referuar vendimeve të Kongresit të Manastirit, veprimtaria e klubit patriotik të Elbasanit u zgjerua e dhe më tej. Ajo nuk shtrihej vetëm brenda kësaj treve, por sfera e shtrirjes së veprimtarisë së tij ishte edhe më e gjerë duke shfaqur njëkohësisht tendenca gjithëpërfshirëse. Pikërisht një veprimtari e tillë u pasqyrua në lidhjet dhe bashkëmarrëdhëniet që klubi i Elbasanit do të krijonte me klube të tjera jashtë trevës së Elbasanit, veprimtari kjo që gjen pasqyrim edhe në faqet e shtypit të kohës.

Në këtë kontekst, është më se evident fakti i bashkërendimit të veprimtarisë së tij me një ndër klubet më të rëndësishëm të kësaj kohe, siç ishte Klubi shqiptar i Selanikut.

Në shtypin e kohës pasqyrohet qartë ky bashkëpunim dhe në mënyrë më konkrete pasqyrohet një vizitë që klubi shqiptar i Selanikut, fill pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit, rezulton të ketë bërë në Shqipëri, me synimin që të kultivonte tek shqiptarët “Vëllazërim e

---

<sup>229</sup> *Alfabeti i gjuhës shqipe ...*, vepër e cituar, 44.

<sup>230</sup> *Mendimi politik e shoqëror...*, vepër e cituar, 289.

bashkim”. Delegacioni i Klubit të Selanikut qëndroi në Elbasan tri ditë. Në këtë delegacion bënin pjesë: Riza bej Dibra, Abdyl bej Kolonja (Ypi), Haxhi Vildon efendi Dibra<sup>231</sup>.

“E 25-ta ditë e Vjeshtës së tretë” (8 dhjetor 1908), shkruante Lef Nosi nën pseudonimin Mal i Vashës, “qe një ditë historike, ditë e ndritshme”. Më tej informacioni i Nosit vijon me evidentimin e faktit se qytetarët e Elbasanit ishin përgatitur për pritjen që do të organizonin posaçërisht për delegatët e klubit të Stambollit. Si për të përligjur mirorganizimin e kësaj pritjeje, përmes informacionit që na vjen, mësojmë se çunakë të rinj me kësula të bardha në të cilat shkruhej “Rroftë Lirija”, i gjeje kudo nëpër qytet. Është i pakundërshtueshëm fakti se organizatori kryesor dhe qendra e kësaj lëvizjeje rezultonte të ishte klubi “Bashkimi” i qytetit të Elbasanit<sup>232</sup>.

Gjithnjë përmes informacionit dokumentar mësojmë se rendi i veprimeve në kuadrin e kësaj pritjeje me të vërtetë festive filloi me pritjen e parë të delegacionit jashtë qytetit tek “Rrapat e Vojvodës”, për të vijuar më tej me çastin kur kryetari i Beledijes, Emin Haxhiademi, “dha urdhër të radhiteshin çunat e shkollave veç e veç e anëtarët e klubit pranë flamurëve. “Herën e parë i priti shkolla Idadie, më pas i priti shkolla Hamidie, e më pas shkolla e veçantë e atdhetarit z. Fezi Guranjaku, pas kësaj shkolla e “Xhamisë së Mbretit”. Fjalën e hapjes e mbajti Abdyl Ypi (Kolonja), i cili drejtohet me fjalët “mirëse ju gjejmë o djemtë e Shkumbinit plak”. Delegacioni vizitoi klubin “*Bashkimi*”, shkollën “Kristiane” të Kalasë, ku i priti mësuesi Dhimitër Paparistoja, e më pas u drejtuan për në Peqin”<sup>233</sup>.

Por vështirësitë me të cilat do të përballeshin patriotët elbasanas gjatë vitit 1908 ishin shumta. Kështu, sipas informacioneve të konsullit austro-hungarez Posfai në dhjetor të vitit 1908, informohemi rreth shfaqjes së konflikteve në qytetin e Elbasanit midis partisë nacionale shqiptare(liberales) dhe muhamedanëve fanatikë. Një konfrontim i tillë midis tyre, që kishte filluar në tetor të vitit 1908 dhe lidhej me përcaktimin e kandidatit për mandatin e deputetit të sanxhakut të Elbasanit, kishte arritur deri në përleshje midis përfaqësuesve të dy rrymave sikurse shprehet konsulli austro-hungarez: “*Lufta midis të dy partive u bë kaq e rreptë sa që me rastin e*

---

<sup>231</sup> Lirija”, nr. 41, Selanik, 25 prill 1909, fl. 4.

<sup>232</sup> Po aty.

<sup>233</sup> Po aty.

*një mbledhjeje në një xhami të Elbasanit ndodhën rrahje. Mytesarifit u detyrua t'i arrestojë disa liberalë, për me qetësue popullin*<sup>234</sup>.

Për zgjidhjen e një situatë të tillë, vendimtare do të rezultonte ndërhyrja e Aqif Pashë Elbasanit si përfaqësues i rrymës liberale-nacionaliste, që do të shoqërohej me tërheqjen nga kandidatura e përfaqësuesit të krahut liberal në favor të kandidatit të krahut muhamedan. Përmes të njëjtit burim informohemi edhe për faktin se si rezultat i trazirave politike në këtë qytet shkolla shqipe e qytetit të Elbasanit ishte mbyllur për një periudhë të shkurtër dhe pas zhvendosjen nga godina e burgut të ri në një lokal tjetër ishte hapur përsëri<sup>235</sup>.

### **Krijimi i klubit “Vllaznia”**

Pas Kongresit të Manastirit lëvizja politiko-arsimore në trevën e Elbasanit po përvijonte një zhvillim të tillë që rezultonte gjithnjë e më shumë në ngritje. Në rrethana të tilla është më se e natyrshme që klubi “Bashkimi” nuk mund t’u përgjigjej të gjithë nevojave e kërkesave në rritje të qytetarëve të trevës së Elbasanit për arsim e dije. Kështu, në vitet 1909-1910 veprimtaria për krijimin e klubeve dhe të shoqërive patriotike në Elbasan do të intensifikohet edhe më shumë.

Pikërisht në këtë periudhë, Elbasani vlerësohet si një nga qytetet me veprimtari të dendur të klubeve patriotike. Në një artikull të botuar në gazetën “Dielli” që botohej në Boston me titull “KLUBET SHQIP”, pasi jepet mbyllja e klubit të Leskovikut, Follorinës, Tiranës, klubit “Labëria” të Vlorës, thuhet se: “... Të vetëmit klube, pra, që përparojnë janë ata të Korçës, të Manastirit, të Elbasanit të Shkupit dhe të Stambollit. Klubeve të tjerë nukë u dëgjohet as zëri”<sup>236</sup>.

Më së miri këtë e konfirmon një dokument i cilësuar sekret, dërguar nga konsulli austro-hungarez në Manastir në 7 shkurt 1909, Ministrisë së P. Jashtme në Vjenë, nëpërmjet të cilit konstatojmë rolin kryesor që luante klubi “Bashkimi” i Elbasanit në mbarëvajtjen e shkollave shqipe jo vetëm në qytet por edhe në zonat përreth tij. Sipas dokumentit në fjalë, në Elbasan funksiononin katër shkolla me nga 80 nxënës secila, të cilat mbaheshin nga klubi “Bashkimi”

<sup>234</sup> HHS/PA, nr. 57/rez. Ministrisë së P. Jashtme, Vjenë. Letra mban datën 25 tetor 1908. përfaqësuesi i partisë liberale ishte mjeku Ibrahim Et-hem, ndërsa fanatikët muhamedanë kandidatit Abdullah Mahir.

<sup>235</sup> HHS/PA, nr. 84. Letra mban datën 22 dhjetor 1908.

<sup>236</sup> “Dielli”, Boston, nr. 2, 27 shkurt 1909. Artikull pa emër autori.

dhe gjithashtu me ndihmën e këtij klubi paguheshin mësuesit shqiptarë edhe në shkollat turke dhe greke të sanxhakut të Elbasanit<sup>237</sup>.

Në këtë kohë konstatohen kërkesat e Lef Nosit drejtuar konsullatës së Durrësit për dërgimin e rreth 100 librave mësimi të nevojshëm për shkollat shqipe, por dhe për shkollat e huaja ku gjuha shqipe ishte futur si lëndë e detyrueshme për tu mësuar në Sanxhakun e Elbasanit. Një dërgesë e një sasive kaq të madhe librash nga konsulli i Durrësit do të konsiderohej e vështirë për tu dërguar njëherësh, duke pranuar dërgimin e tyre pjesë - pjesë<sup>238</sup>.

Në të njëjtën kohë, në Elbasan funksiononin edhe katër shkolla elementare (filllore) turke me afërsisht 270 nxënës gjithsej dhe gjithashtu edhe një shkollë ruzhdije. Në këto shkolla si lëndë të detyrueshme ishin gjuha turke edhe gjuha shqipe. Përveç shkollave turke, në Elbasan rezultonte edhe një shkollë ortodokse me rreth 80 nxënës. Në këtë shkollë ishte futur edhe mësimi i gjuhës shqipe, ndërsa natën zhvilloheshin kurse mësimi të gjuhës shqipe që ndiqeshin nga rreth 60 të rinj. Në këtë kuadër, konsulli austro-hungarez në Durrës në raportin dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vjenës, pas kërkesës së tyre për të konstatuar tashmë gjendjen e shkollave të huaja në Elbasan shkruan: *Shkolla shqipe e Elbasanit është përkohësisht vetëm një shkollë nate. Ajo ndiqet prej afërsisht 100 djemvet dhe mbahet prej klubit shqiptar*<sup>239</sup>.

Në kuadrin e kërkesave për zhvillimin e mëtejshëm të shkollës shqipe, përpjekjet e patriotëve elbasanas do të finalizohen me krijimin e klubeve e të shoqërive të reja patriotike. Në këtë kontekst, në muajin prill në qytetin e Elbasanit do të krijohet një klub i ri me karakter patriotik. Pikërisht patriotët elbasanas e konsideruan si domosdoshmëri themelimin e një klubi tjetër, i cili sikurse rezulton nga përmbajtja e programit të tij do të kishte objektiva të njëjta me klubin “Bashkimi”. Ky klub u quajt “Vllaznia” dhe u përrurua si i tillë në 18 prill të vitit 1909<sup>240</sup>.

Të dhënat më të rëndësishme për formimin e këtij klubi na jepen përmes shtypit të kohës. Konkretisht në faqet e tij për këtë problem shkruhej: *“Sot u çel në Elbasan një klub me emrin “Vllaznia”.* Më tej informacioni vazhdon me përcaktimin e qëllimit të klubit, i cili përmbledh në përhapjen e gjuhës shqipe me alfabetin e Kongresit të Manastirit. Ndërkohë, të ftuarit që morën pjesë në përrurimin e këtij klubi rezultonin të ishin nëpunës të administratës lokale, anëtarë

---

<sup>237</sup> HHS/PA, nr. 3 sekret. Ministrisë së P. Jashtme, Vjenë

<sup>238</sup> HHS/PA, nr. 37, Ministrisë së P. të Jashtme, Vjenë. Durrës, më 1 shkurt 1909. Raport i konsullit austro-hungarez Halla në Durrës

<sup>239</sup> HHS/PA, nr. 27, Ministrisë së P. të Jashtme, Vjenë. Durrës, më 12 mars 1909. Raport i konsullit austro-hungarez në Durrës.

<sup>240</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale..., vepër e cituar*, 181.

të kryesisë së klubit “Bashkimi” dhe të klubit xhonturk “Ittihad”. Fjalën përshëndetëse në emër të klubit të sapoformuar e mbajti Qamil Haxhi Feza, që u pasua nga një përshëndetje urimi për klubin “Vllaznia” që bëri Shefki efendiu, shkronjës i klubit osmanli “Ittihad”<sup>241</sup>. Në mbledhjen themeluese të tij, u shqyrtua dhe u miratua statuti i klubit. Organet kryesore drejtuese të këtij klubi u formuan përmes procedurës së votimit, duke marrë në mënyrë unanime votëbesimin e të gjithë përfaqësuesve të pranishëm.

Gjithashtu, një dukuri mjaft e rëndësishme që evidentohet me krijimin e këtij klubi, shprehet në faktin se kryesia e klubit “Vllaznia”, më së shumti nga klerikë myslimanë e të krishterë, gjë që dëshmon për dominimin e harmonisë dhe tolerancës fetare që ekzistonte në qytetin e Elbasanit, fakt ky që konstatohet në vazhdimësi në popullsisë e trevë së Elbasanit edhe përmes informacioneve që diplomatët e huaj në jetonin në Shqipëri u dërgonin sistematikisht eprrorëve të tyre<sup>242</sup>.

Përsa i përket përbërjes fetare të klubit “Vllaznia” studiuesja Nathalie Clayer shprehet se: *“Me qëllim që të tërhiqnin pas tyre myslimanët jo –bektashinj, që nuk mund t’i bashkoheshin këtij shqiptarizmi tepër të ngjyrosur me heterodoksi dhe kristianizëm, ata krijuan një klub tjetër, të drejtuar nga një bej “pak patriot”. Ky klub i quajtur Vllaznija ishte shumë aktiv, në drejtimin e Lef Nosit, një ortodoks i qytetit, që organizonte kurse nate dhe diskutime mbi temat e shqiptarizmit”*.<sup>243</sup> Një pohim i tillë gjen konfirmin edhe përmes informacionit të konsullit austro-hungarez të Manastirit i cili konstatonte faktin e përfaqësimit në këtë klub të muhamedanëve fanatikë që nuk ishin përfshirë në klubin “Bashkimi”<sup>244</sup>.

Organet kryesore drejtuese përfaqësoheshin nga *Këshilla sundimtare (Kryesia) dhe Këshilla Përmikëqyrëse*.

*Këshilla Sundimtare përbëhej nga: Kryetar: z. Dervish Ibrahim, nënkryetar: z. Lef Nosi, arkëtar: Hysen Ceka, shkronjës: z. Fot Papajani, këshillonjës (anëtarë): z. Demir bej Sulçebeu, z. Tahsin Myftiu, z. Isuf Skilja, z. Simon Popa, z. Anton Beçja.*

*Këshilla Përmikëqyrëse përbëhej nga: Kryetar: myderrizi Haxhi Ali, shkronjës (sekretar): z. Mustafa Qafëmolla, këshillonjës (anëtarë): Haxhi sheih Riza, Z. Sheih Xhaferri, Z. Isuf Be’ Taushani, Z. Ibrahim Bizhuta, Z. Ismail Daiu, Z. Hysen Pajuni, Z. Hafëz Qazim*

<sup>241</sup> “Lirija”, nr. 41, Selanik, 25 prill 1909, f. 4.

<sup>242</sup> HHSTA/PA, Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr.28, datë 9 maj 1909.

<sup>243</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 611.

<sup>244</sup> HHSTA/PA, Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr.28.

Bejtja, Z. Imami Isuf Hallva, Z. Prift Veniamin Deliana, Z. Mylazim Riza<sup>245</sup>. Komunikata e hapjes së klubit “Vllaznia” parashtron: “Klub në Elbasan”

*Të 18 ditë të Prillit u hap në këtë qytet klubi “Vllaznia” për me përhapun gjuhën shqipe në qytet si dhe nëpër fshatrat rreth tij. Hapja e tij zyrtarisht u kremtue me gëzim të madh prej vendit. Vazhdojnë nënshkrimet; ndër to janë edhe patriotët Hysen Ceka, Fot Papajani etj. Nga shkronjëtorja e klubit “Vllaznia”. Elbasan, 25 prill 1909.*<sup>246</sup>

Krijimi i klubit “Vllaznia” jo vetëm do të ndihmojë në zgjerimin e lëvizjes politike arsimore në trevën e Elbasanit, por në të njëjtën kohë ekzistenca e tij, përbënte një premisë të rëndësishme dhe një mbështetje mjaft të madhe edhe për ecurinë normale të veprimtarisë së klubit “Bashkimi”, që do të evidentohet në bashkërendimin e vazhdueshëm të veprimtarisë midis tyre.

Në këtë kuadër, pohojmë se:

Së pari, krijimi i klubit “Vllaznia” rezultonte produkt i potencialeve intelektuale-patriotike që kishte qyteti dhe treva e Elbasanit në këtë periudhë.

Së dyti, krijimi i tij rezultonte domosdoshmëri e kohës në kuadrin e intensifikimit të lëvizjes arsimore e kulturore në trevën e Elbasanit dhe më gjerë. Për më tepër, përmes informacionit të konsullit austro-hungarez të Durrësit në mars të vitit 1909, informohemi për faktin se qeveria greke e kishte ndërprerë subvencionimin e shkollave të komunitetit ortodoks që ekzistonin në Sanxhakun e Elbasanit. Administratorët e këtyre shkollave zgjidhjen e një situatë të tillë do ta kërkojnë në kërkesën për mbështetje financiare drejtuar klubit ekzistues “Bashkimi” në Elbasan<sup>247</sup>.

Ndërkaq, evidentohen edhe përpjekjet e qeverisë italiane për tu paraqitur të gatshëm në funksion të zgjidhjes së një problemi të tillë të komunitetit ortodoks, me synim shtrirjen e ndikimit në trevën e Elbasanit<sup>248</sup>. Një nismë e tillë nga pala italiane ishte ndërmarrë që në gusht të vitit 1908 për të subvencionuar shkolla shqipe, porse nuk kishte pasur rezultat pozitiv, duke gjetur kundërshtimin e vendosur veçanërisht të Dervish bej Biçakut.<sup>249</sup>

Në një situatë të tillë, përmes informacionit të konsullit austro-hungarez të Durrësit, rezultonte se klubi shqiptar në Elbasan në maj të vitit 1909 kishte marrë përsipër të paguante

---

<sup>245</sup> AQSH, F. 102, Dos. 46, f. 2-3.

<sup>246</sup> Po aty, f. 4.

<sup>247</sup> HHSTA/PA, nr. 30. Raport i konsullit austro-hungarez Halla drejtuar Baronit fon Erental, Vjenë.

<sup>248</sup> Po aty.

<sup>249</sup> Po aty, fl. 7.

edhe mësuesit që jepnin mësim në shkollën e komunitetit ortodoks, duke mos pasur mundësitë financiare për ta mbajtur dhe administruar vetë këtë shkollë<sup>250</sup>.

Parë në këtë këndvështrim, duke ju referuar dokumentacionit përkatës të kësaj periudhe mendojmë se, krijimi i klubit “Vllaznia” nuk erdhi si rrjedhojë e divergjencave të brendshme midis anëtarëve të klubit ekzistues “Bashkimi”, dhe nuk u krijua si fraksion i dalë nga ky klub.

Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi në faktin se në përbërjen e klubit “Vllaznia” nuk rezultonin si anëtarë të tij përfaqësues të klubit “Bashkimi”. Një fakt i tillë konstatohet edhe përmes raportit të konsullit austro-hungarez të Manastirit i cili shprehej se: “ ... *mungojnë personalitete të njohur si Aqif Pasha, Dervish Bej dhe Shefqet Bej*”<sup>251</sup>.

Gjithashtu, dokumentacioni i kohës flet në favor të faktit se midis këtyre dy klubeve do të krijohet një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi dhe bashkëveprimi që konstatohet në vijimisi në muajt dhe vitet pasardhës.

Kuadrin e bashkëpunimit dhe ekzistencës së marrëdhënieve të mira midis klubit “Bashkimi” dhe klubit “Vllaznia”, fillimisht e konstatojmë në një përgjigje që Dervish Ibrahim i në cilësinë e kryetarit të Klubit “Vllaznia”, i jep Mit’hat Frashërit kryetar i Klubit shqiptar të Selanikut ku shprehimisht thuhet: “*U vërtetojmë zotni se i vetmi qëllim i hapjes së këtij klubi asht të përhapunit e gjuhës shqipe me shkronjat e pëlqyeme të Kongresit të Manastirit në qytet të Elbasanit si dhe nëpër fshatrat rreth ku nuk ka mujtun me e përhap klubi “Bashkimi”, me të cilin marrëdhëniet i kemi e do t’i kemi të mira*”<sup>252</sup>. Ndërkaq, duke iu referuar informacionit të konsullit austriak, në formimin e klubit “Vllaznia” një rol të konsiderueshëm ka luajtur edhe patrioti Dervish Hima,<sup>253</sup> që konsiderohej në këtë periudhë si një ndër organizatorët e komiteteve të fshehta në disa qytete shqiptare<sup>254</sup>. Prej një kohe relativisht të gjatë Dervish Hima jetonte e vepronte në qytetin e Elbasanit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti edhe në formimin e klubit “Vllaznia”, rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kësaj do të ishte edhe rritja e autoritetit të tij në klubin “Vllaznia”<sup>255</sup>.

Përmes korrespondencës midis patriotëve shqiptare dhe klubit “Vllaznia” të Elbasanit evidentohet një fakt mjaft i rëndësishëm: atë që ky klub sapo u krijua bashkë me klubet e tjera e

---

<sup>250</sup> HHSTA /PA, nr. 40. Raport i konsullit austro-hungarez Halla drejtuar Baronit fon Erental, 6 maj 1909. Çdo mësues paguhej nga 100 groshë.

<sup>251</sup> HHSTA/PA, Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr.28, datë 9 maj 1909.

<sup>252</sup> AQSH, F. 102, Dos. 46, fl 2-3. Letra mban datën 25 prill 1909 dhe është nënshkruar nga Dervish Biçaku

<sup>253</sup> Dervish Hima ishte pseudonimi i patriotit Ibrahim Naxhi Spahiu

<sup>254</sup> HHSTA/PA, f. 203. Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, nr.28, datë 9 maj 1909.

<sup>255</sup> Po aty, fl. 204



kishin paracaktuar rolin dhe pozicionin e tyre në lëvizjen arsimore e politike shqiptare në fillimet e shek. XX.

Në një korrespondencë midis vilajetit të Manastirit dhe sanxhakut të Elbasanit në 17 gusht të vitit 1909, konstatohet kërkesa që i bëhet klubit të Manastirit me qëllim që komisioni i arsimit të Elbasanit të zgjidhet nga klubi “Vllaznia” duke u shprehur se: “Për t’i dhanë ma tepër randësi zhvillimit e përhapjes së arsimit, dëshirojmë që komisionin e arsimit t’ Elbasanit ta formojmë me persona të zellshëm. Prandaj ju porosisim që të shënoni dy vetë nga klubi juaj, të cilët të kenë cilësitë e duhura e na njoftoni emrat e tyre. Prefekti i Elbasanit Sami <sup>256</sup>.

Gjithashtu, që në muajt e parë të krijimit të klubit “Vllaznia”, letërkëmbimet midis përfaqësuesve të këtij klubi dhe patriotëve shqiptarë rezultonin të shumta. Në këtë kontekst, nga dokumentacioni i kohës vërejmë se nëpërmjet telegrameve të shumta, dërguar klubit “Vllaznia” në shtator të vitit 1909, midis të tjerave diskutohet edhe çështja e zgjedhjes së kandidatëve për deputetë, ndër të cilët përmendet edhe Dervish Hima. Në një nga këto letra thuhet: “Në është e vërtetë që do të zgjidhni deputet Himën, meritoni lëvdata” <sup>257</sup>.

Në një letër të Stavri Stavrit dërguar klubit “Vllaznia” jepen falënderimet e tij për besimin që i jep ky klub emërimit të tij si drejtues i fletores “Bashkimi i Kombit”, që do të shtypet në Manastir.<sup>258</sup> Në letër shkruhet:

*“Vllaznija asht faltorja jonë*

*Na e ruj ti o perëndi*

.....

*Elbasan u bafshin si ti*

*Gjith sa jan qytetet n’ Shqipëri.*

Duke ju referuar dokumentacionit të kohës, konstatohet fakti se anëtarësimi në klubin “Vllaznia” ishte i lirë për shqiptarët e të dyja besimeve, por jo për ata persona që cilësoheshin si turkomanë edhe nuk e dinin gjuhën shqipe. Mendojmë se një kufizim i tillë përse i përket anëtarësimit në klubin “Vllaznia”, që nuk konstatohet në krijimin e klubit “Bashkimi”, bëhej më së shumti për të kufizuar pjesëmarrjen në këtë klub të përkrahësve të xhonturqve në kuadrin e rivaliteteve ekzistuese dhe intensifikimit në këtë kohë të konfliktit rreth çështjes së shkrimit të

---

<sup>256</sup> AQSH, F. 102, Dos. 64, f. 1

<sup>257</sup> AQSH, F. 102, Dos. 68, f. 1-2.

<sup>258</sup> Po aty. f. 1.

gjuhës shqipe me alfabetin latin që përkrahej nga rrethet patriotike shqiptare dhe alfabetit arab që mbështetej me forcë nga xhonturqit.

Ja çfarë na ofrojnë për këtë problem burimet e asaj kohe: “*Hamdi efendiut nuk i u pranue kotacioni për arsye se nuk e njef gjuhën tonë*”. “*Vllaznia*” drejtue “*Ittihad ve Tereki*” 12 Prill 1325/ 1909<sup>259</sup>.

Gjithashtu, në një letër dërguar klubit “*Vllaznia*” nga disa anëtarë të tij në tetor të vitit 1909, konstatohet fakti se zgjedhja e kryesisë së klubit realizohej nëpërmjet procesit të votimit. Pikërisht nëpërmjet këtij dokumenti informohemi se ne tetor të vitit 1909 si nënkryetar i ri i klubit “*Vllaznia*” zgjidhet Hasan Bej Elbasani, i cili për efekt të detyrimeve të tjera i paraqet kryesisë së klubit dorëheqjen duke u shprehur “... *Ju lutem me pranue dorëheqjen vëllazën*”<sup>260</sup>.

Sikurse konstatohet, veprimtaria e klubit “*Vllaznia*” në Elbasan evidentohet në shumë drejtime. Kjo veprimtari shfaqet në lidhjet dhe marrëdhëniet e ngushta me klubin “*Bashkimi*”, marrëdhënie të cilat vijnë duke u konsoliduar e njëkohësisht në drejtim të zhvillimit e të rritjes së nivelit arsimor në trevën e Elbasanit. Kjo lidhje midis dy klubeve të Elbasanit shfaqet dukshëm në ftesat e shpeshta që të dy klubet e Elbasanit i bënin gjatë sezonit të provimeve të shkollave që ekzistonin në Elbasan në këtë periudhë. Ja çfarë na ofron dokumentacioni i kohës për këtë problem.

*Këshillës sundimtare të ndershme të klubit “Vllaznia”*<sup>261</sup>

*Zotnij. Nesër më 12 paradreke nisin provimet e mësojores çunavet të Shtëpishtes) Shën Kollit. Ju lutem pra të keni mirësinë t’i nderoni me ardhjen tuaj e të zotnisë së jujë*

*Këtu më 20.6. 19 Parësi e mësonjëtores*

*Klubi “Bashkimi”*

-----

*“Këshillës sundimtare të ndershme të klubit “Vllaznia”. Zotnij. Nesër më 1 paradite nisin provimet e mësonjtorevet shqipe të Shpatit në klubin “Bashkimi”. Ju lutem pra të keni mirësinë t i nderoni me ardhjen e zotnisë së jujë.*

*Mbetemi me nder*

*Këtu më 28. 6.1909*

*Kryesonjësi*

*Shkronjësi*

*Hysen Hastopalli*

*Simon Shuteriqi*

<sup>259</sup> Sh. Demiri, material i depozituar në muzeun historik, Elbasan, nxjerrë nga AQSH.

<sup>260</sup> AQSH, F. 102, Dos. 59, f. 1-5. Kërkesë personash për dorëheqje nga kryesia e klubit “Vllaznia”.

<sup>261</sup> Sh. Demiri, material i depozituar në muzeun historik, Elbasan.

Nuk është rastësi që misionarët amerikane F.Kenedi dhe T.Erikson, pas vëzhgimeve në disa qytete të Shqipërisë së Mesme, si në Elbasan, Durrës, Tiranë, e zgjodhën Elbasanin si qendrën më të përshtatshme për çeljen e një shkolle fillore dhe të një shkolle të mesme me konvikt me shpjegimin se “*Elbasani konsiderohet si terreni kulturor më pjellor*”<sup>262</sup>.

Një fakt i tillë konstatohet edhe nga burimet e kohës. Pikërisht, në 28 maj të vitit 1909, Fineas Kenedi (Phineas B. Kennedy) në një letër dërguar nga Korça klubit “*Vllaznia*” të Elbasanit, e njoftonte duke u shkruar se: “*Shoqata jonë amerikane kërkon të hapë një shkollë të mesme për djemtë shqiptare me pagesë të ulët*”, gjithashtu ai kërkonte “*një ndërtesë të bukur, ku do të kishte dhe një degë industriale*”. Klubet “*Bashkimi*” dhe “*Vllaznia*” reaguesan pozitivisht ndaj kësaj kërkesë<sup>263</sup>.

Për këtë problem, në fillim të qershorit 1909, në klubin “*Vllaznia*” u organizua një mbledhje e përbashkët e dy kryesive të klubeve “*Vllaznia*” dhe “*Bashkimi*”, ku u vendos që të ndihmonin me një shumë prej 100 lirash turke, por me qëllim që të futej dhe të mësuarit e gjuhës shqipe në këtë shkollë amerikane.<sup>264</sup> Për arsye të pengesave që nxorën autoritetet xhonturke (zvarritja e miratimit të lejes nga autoritetet xhonturke dhe arrestimi i Kristo Dakos, që ishte emëruar drejtor i kësaj shkolle), kolegji amerikan nuk u çel. Për më tepër që në këtë periudhë Elbasani konsiderohej si qendra më e rëndësishme e shqiptarizmit në Shqipërinë e Mesme<sup>265</sup>.

Por veprimtaria e këtij klubi patriotik nuk mbeti me kaq. Në një nga burimet e kësaj kohe që mban datën 29 korrik të vitit 1909, informohemi për një telegram proteste që klubi “*Vllaznia*” i dërgon Senatit turk lidhur me vendimin e marrë për mbylljen e klubeve shqiptare. Një kopje e këtij telegrami do t’i dërgohet edhe klubeve shqiptare në Selanik, Manastir, Shkup dhe Janinë. Në telegramin e dërguar klubeve shqiptare u bëhet thirrje për të protestuar kundër këtij vendimi<sup>266</sup>.

Në çastet e acarimit të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe xhonturqve për çështjen e alfabetit dhe probleme të tjera politike, veprimtaria e klubeve “*Bashkimi*” dhe “*Vllaznia*” të Elbasanit

---

<sup>262</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale...*, vepër e cituar, 196.

<sup>263</sup> Po aty.

<sup>264</sup> Sh. Demiri, Material i depozituar në muzeun etnografik, Elbasan.

<sup>265</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 611.

<sup>266</sup> AQSH, F. 102, Dos. 60, f. 1-2. Pjesa e parë e letrës i dërgohet Senatit turk 29 korrik 1325/1909, ndërsa pjesa e dytë e letrës i dërgohet klubeve shqiptare po në të njëjtën datë.

shënon një fazë më të lartë, duke hyrë në një proces të ri organizimi, që konsiston në shkrirjen e të dy klubeve në një klub të vetëm.

Kështu, në 13 mars të vitit 1910, në një letër dërguar shoqërive të ndryshme informohemi për shkrirjen e klubit “*Bashkimi*” dhe “*Vllaznia*” dhe për formimin në Elbasan të një klubi të vetëm me emrin “*Bashkimi i Ri*”.<sup>267</sup>

Për problemin në fjalë shprehimisht thuhej:

“Ju lutem bani një vulë të re, që të jetë shqip dhe turqisht, të ketë formën e parë të vulës qi pat “*Bashkimi*” dhe dy duar të rrokun njana me tjetnën”.

*Në emër të këshillës sundimtare,*

*Hysejn Hastopalli*

*Elbasan 14 Mars 1910*<sup>268</sup>

Nga të dy kryesitë e klubeve “*Bashkimi*” dhe “*Vllaznia*” u zgjodh një kryesi e re heterogjene e përbërë nga: Hasan bej, Emin Haxhiademi, Demir bej, Hysen Hastopalli, Lef Nosi, Ahmet Dakli, Shefik Daiu dhe Qamil Feza<sup>269</sup>.

Njoftimin për krijimin e klubit “*Bashkimi i Ri*” e gjejmë edhe në faqet e gazetës “*Tomorri*”, e cila sapo kishte filluar të botohej dhe drejtohej nga patrioti elbasanas Lef Nosi.<sup>270</sup> Gazeta në fjalë na informon se bashkimi i të dy klubeve u bë më 13 mars të vitit 1910.<sup>271</sup> Njëkohësisht e njëjta gazetë konfirmon edhe faktin e mbështetjes financiare ndaj shoqërisë “*Afërdita*”<sup>272</sup>.

Gjithashtu, përmes dokumentacionit përkatës, në Elbasan në vitin 1910 rezulton të jetë botuar edhe një gazetë tjetër e njohur me emrin “*Elbasani*”. Sipas dëshmisë së lejes për botimin e kësaj gazete, drejtor dhe pronar i saj ishte Qamil Musa Haxhi Fejza. Gazeta do të ishte e përjavshme dhe sikurse shkruhej në lejen e dhënë: “... do të kishte për qëllim t'i shërbente *Kushtetutës dhe interesave të përgjithshme me botime politike, ekonomike dhe kulturore*”<sup>273</sup>.

---

<sup>267</sup> AQSH, F.102, Dos. 79, f. 1.

<sup>268</sup> Po aty.

<sup>269</sup> “*Lirija*”, nr. 8, 20 mars 1910, f. 4.

<sup>270</sup> Gazeta “*Tomorri*” filloi të botohej në Elbasan në mars 1910, me drejtues Lef Nosin. Përgatitja e materialit bëhej në Elbasan, ndërsa shtypja në Manastir, për mungesë shtypshkronje.

<sup>271</sup> “*Tomorri*”, nr. 3, Elbasan, 31 mars 1910, f. 4.

<sup>272</sup> “*Tomorri*”, nr. 5, Elbasan, 20 prill 1910, f. 4.

<sup>273</sup> AQSH, ekspozita *Elbasani* në 100 vjetorin e shtetit shqiptar. Dëshmi mbi lejimin e Qamil Musa Haxhi Fejzës për të botuar një gazetë shqip turqisht, të titulluar “*Elbasani*” viti 1910.

Duhet thënë se veprimtaria e patriotëve elbasanas u shtri si brenda ashtu edhe jashtë trevës së Elbasanit. Të rinjtë elbasanas në kohën e krijimit të klubit “*Bashkimi i ri*” zhvillojnë një aktivitet patriotik në favor të çështjes kombëtare jo vetëm në Elbasan, por edhe në qendrën e vilajetit të Manastirit. Patriotët, të rinjtë elbasanas, si Emin Matraxhiu, Kamber Dardha, Kostaq Cipo me shokë, nxënës të idadijes (gjimnazit) në Manastir, kundërshtojnë urdhrin e Ministrisë së Arsimit të Turqisë, që konsistonte në të mësuarit e gjuhës shqipe në këtë idadije me germa arabisht e jo me shkronja latine. Të dhënat na konfirmojnë faktin se: “*Të rinjtë patriotë të lartpërmendur, tue kundërshtue urdhrin e Ministrisë, organizojnë një miting në favor të shkronjave shqipe*”<sup>274</sup>.

Ndërkohë, në 23 korrik 1910, të rinjtë elbasanas do të ndërmarrin një aksion patriotik me karakter politik. Kështu, me rastin e përvjetorit të shpalljes së Hyrjetit, “që ishte ditë shënlluku” (ditë feste shtetnore) turke, autoritetet turke dhanë urdhrin për vumjen e flamurit turk në të gjithë dyqanet. Ndërsa disa i vunë flamurët turk, flamurë të vegjël, sado që edhe këta në mënyrë të kufizuar, një tregtar filoturk (të cilit nuk i përmendet emri), në sheshin e drithërave, për të treguar që ishte osmanlli, vuri një bajrak të madh turk me gjysëm hanën. Ky provokacion e indinjoji për së tepërmi popullin. Disa të rinj elbasanas, si Hasan Osmanaj, Sabri Dervishhasani, Demir Telegrafçiu me shokë i rrëmbyen bajrakët turq e veçanërisht bajrakun e madh turk, i grisën ata, i shkelën me kambë dhe i vunë zjarrin. Vetëm largimi i tyre i shpejtë pas aktit që kryen i shpëtoi këta të rinj nga dënimi i rreptë që i priste nga ana e autoriteteve turke”<sup>275</sup>.

Por, sikurse konstatohet nga mesi i vitit 1910 në Elbasan, sikurse dhe në disa nga qytetet e tjera të Shqipërisë, lëvizja arsimore-kulturore do të pësojë një farë staniacioni, rezultat i drejtpërdrejtë i ekspeditës së Shefqet Turgut Pashës, i cili pas ekspeditës në Kosovë e Shkodër në vitin 1910 i drejtohet edhe Elbasanit.

Edhe këtu, sikurse në qytet e tjera të Shqipërisë, duke shkelur kushtetutë e ligje, filloi të torturojë patriotët elbasanas me rrahje në sheshet publike, si në namazgja nëpër kazerma, madje edhe nëpër hajatat e xhamive. Shkollat shqipe e Shkolla Normale u mbyllën, personeli që u kap, u keqtrajtua, si Fejzi Guranjaku, Simon Shuteriqi etj. Një pjesë e patriotëve mundën t’i shpëtojnë torturave vetëm nëpërmjet arratisjes.

---

<sup>274</sup> AME, Kutia. 14, dok, nr. 8, f. 12.

<sup>275</sup> Po aty.

## **II. 2 Shoqëritë kulturore në Elbasan dhe aktiviteti i tyre**

### **- Shoqëria “Afërdita” në Elbasan**

Veç klubeve patriotike “Bashkimi”, “Vllaznia” që u krijuan në Elbasan në vitet 1908-1909, në maj të vitit 1909 në Elbasan do të krijohet një shoqëri kulturore që njihet me emrin shoqëria “Afërdita”.

Ekzistojnë të dhëna të ndryshme përsa i përket kohës së krijimit të kësaj shoqërie. Sipas burimeve arkivore shoqëria “Afërdita” rezulton të jetë krijuar në 2/15 maj 1909. Në këtë dokument, posaçërisht për problemin në fjalë shprehimisht thuhej: *“Me nderim ju lajmërojmë se në të dytën ditë të Majit u ngref këtu në qytet tonë një shoqëri me emrin “Afërdita””*<sup>276</sup>.

Organet kryesore të kësaj shoqërie përbëheshin nga: Pleqësia, me kryetar Lef Nosin, nënkryetar: Fot Papajani, arkëtar: Dhimitër Papajani, shkronjës(sekretar): Dhimitër Deliana.

---

<sup>276</sup> AQSH, Fondi. 102, Dos. 75, f. 1.

Ndërsa si anëtarë të saj rezultinin: Petër Dodbiba, Myrteza Demeti, Petër Papamihali, Jorgji N. Paparisto e Hysen Ceka.

Lajmin për krijimin e kësaj shoqërie e gjejmë të pasqyruar edhe në faqet e gazetës “Korça”. Informacioni i paraqitur për formimin e shoqërisë “Afërdita” rezultonte t’i ishte dhënë kësaj gazete nga sekretari i shoqërisë “Afërdita” që sipas dokumentacionit përkatës ishte Dhimitër Deliana<sup>277</sup>.

Ndërkaq, qëllimi kryesor i krijimit të shoqërisë “Afërdita” përcaktohet në mënyrë shumë të qartë në statutin e saj, madje qysh në nenin e parë të tij thuhej se kjo shoqëri kishte për mision: *“Të përhapunit e Dashunisë, Vëllazënise e njisisë ndërmjet vendasve të qytetit e të fshatrave për rreth që të marrin rrugën e qytetnimit”*. Ndërkaq, duke ju referuar nenit të dytë të saj informohemi rreth fushës së veprimtarisë së kësaj shoqërie që konstatohet përmes fjalëve se: *“Shoqëria sot për sot do të përbajë një bandë muzikore me emnin “Banda Muzikore Afërdita”*<sup>278</sup>. Porse veprimtaria e shoqërisë “Afërdita” nuk do të kufizohej vetëm në fushën e muzikës. Në statutin e saj gjejmë të pasqyruar edhe një fakt mjaft interesant, që lidhej me zgjerimin e sferës së veprimtarisë së saj në të ardhmen, duke synuar krijimin e një palestere për gjimnastikë dhe një mjedisi për organizimin e sportit të qitjes në funksion të zgjerimit të veprimtarisë kulturore-sportive të të rinjve të Elbasanit. Kështu në nenin e dytë të statutit të kësaj shoqërie përcaktohej se: *“Shoqëria sipas rregullores së saj ka ndër mend me përbamun sot për sot një Bandë Muzikore “Afërdita” e pas ca kohe t’i shtohet një stërvitore të trupit bashkë me një shenjëtore (mjedis qitjeje). Punërat e mëdha lypin ende ndihma”*<sup>279</sup>.

Në rrethanat e atëhershme krijimi i një shoqërie me fizionomi të tillë, do të synonte më së shumti përmbushjen e qëllimeve të saj jo vetëm në trevën e Elbasanit por edhe më gjerë.

Hapësira gjeografike e shtrirjes së veprimtarisë së saj synonte të përfshinte gjithashtu edhe rajonin e Shqipërisë së Mesme, veçanërisht qytete të tilla si; Tiranën, Kavajën, Krujën, Peqinin, Durrësin etj, ku domosdoshmëria e emancipimit kombëtar jo vetëm që ishte evidente, por njëkohësisht ndeshte edhe në pengesa të mëdha<sup>280</sup>.

Krijimi i një shoqërie të tillë në Elbasan nuk mbeti jashtë vëmendjes së shtypit të kohës. Në faqet e tij në jo pak raste gjejmë të pasqyruar jo vetëm çastin e krijimit të shoqërisë, përmes

<sup>277</sup> “Korça”, Korçë, nr.26, 18 dhjetor 1909.

<sup>278</sup> Rregullore e shoqërisë “Afërdita”, Elbasan, 2-15 maj 1909.

<sup>279</sup> Po aty.

<sup>280</sup> AQSH, F. 102, Dos. 11, f. 4.

fjalëve: “Në Elbasan dy javë më parë u formua shoqëria “Afërdita”, por edhe qëllimin për të cilin ajo u krijua. Përmes informacionit të marrë në faqet e gazetës “Lirija” evidentohet fakti se kjo shoqëri përfshinte në rradhët e saj rreth 100 anëtarë<sup>281</sup>.

Gjithashtu, në nenin shtatë të rregullores së kësaj shoqërie ku përcaktoheshin edhe simbolet e shoqërisë shprehimisht thuhej: “*Shoqnia do të ketë një vulë shkrumun shqip “Shoqnia Afërdita” Elbasan 1909, me yllin e mëngjesit tyke lemun. Kjo rregullore me 21 nene asht shtypun në 1909 në Manastir në shtypshkronjën “Bashkimi i Kombit” dhe në fund mban datën, 2 maj 1909*”<sup>282</sup>.

Por përmes informacionit që na ofron dokumentacionit përkatës, origjina e krijimit të kësaj shoqërie duhet kërkuar para vitit 1909. Kështu, mendojmë se shoqëria “Afërdita” më së shumti do të konsiderohet si vazhdim i shoqërisë “Ylli i Mëngjesit” që rezultoi të jetë themeluar në Elbasan që para shpalljes së “Hyrjetit” e më konkretisht në vitin 1907, me kryetar Dhimitër Kapedanin. Ajo që të bën më tepër përshtypje, është fakti se kjo shoqëri përfshinte në strukturat drejtuese dhe në rradhët e saj pothuajse vetëm rininë e lagjes Kala, e cila rezultonte në shumicë e besimit ortodoks.<sup>283</sup> Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi në faktin se afërsisht 90% e anëtarëve të kryesisë së kësaj shoqërie sipas dokumentacionit të kohës rezultoni të ishin të besimit ortodoks. Ndërkohë që një dukuri e tillë do të jetë prezente edhe në vitin 1909, ku në shumicë anëtarët e shoqërisë “Afërdita” do të rezultojnë të jenë të besimit ortodoks.

Përsa i përket emërimit të kësaj shoqërie, në një dokument tjetër thuhet se u zgjodh emri “Afërdita”, për ta lidhur me qëllimin e shoqërisë, pikërisht me yllin Afërdita që konsiderohet si Ylli i Mëngjesit, i cili me rrezet e tij lajmëron agimin. Pikërisht një pohim i tillë faktori njëkohësisht edhe lidhjen dhe origjinën e saj me shoqërinë “Ylli i Mëngjesit”<sup>284</sup>.

Gjithashtu, në faqet e gazetës “Korça” pasqyrohet jo vetëm krijimi i kësaj shoqërie, por njëkohësisht jepet edhe lajmërimi që kjo gazetë vendos të hapë një fond me qëllim mbledhjen e ndihmave nga cilido qytetar korçar në ndihmë të shoqërisë “Afërdita” të Elbasanit, duke

---

<sup>281</sup> “Lirija”, nr. 46, Selanik, maj 1909, 2. Lef Nosi ishte korrespondent i gazetës “Lirija” për Elbasanin, Peqinin, Kavajën.

<sup>282</sup> AME, Kutia. 31, Dos. 2, f. 1.

<sup>283</sup> AME, Kutia nr. 14, Elbasani qendër e Lëvizjes Kombëtare 1900-1912, f. 7.

<sup>284</sup> Adem. Jahja, *Mbi themelimin dhe veprimtarinë e e shoqënisë “Afërdita” N’Elbasan*, material depozituar në arkivin e muzeut historik Elbasan, Kutia. 31, Dos. 2, f. 1.



përfaqësuar një veprim shumë kuptimplotë mbështetës dhe bashkëpunues për shoqërinë “Afërdita”<sup>285</sup>.

Pothuajse në të njëjtën kohë me klubin “*Vllaznia*” u formua në Elbasan nga të rinj dhe nxënës të shkollave një shoqëri tjetër që njihet me emrin “*Dilli*”<sup>286</sup>. Burimet e kohës nuk na japin datën e saktë të krijimit të kësaj shoqërie, por kohën e krijimit të saj e përcaktojmë përmes përqasjes së informacioneve që na vijnë nëpërmjet korrespondencës së kohës.

Parë në këtë këndvështrim, ka të dhëna që flasin në favor të faktit se kjo shoqëri është krijuar në prill të vitit 1909.<sup>287</sup> Ndërkohë, duke ju referuar të dhënave të marra nga burime të tjera informohemi se kjo shoqëri është formuar në 29 mars të vitit 1909.<sup>288</sup> Mendojmë se një mospërputhje e tillë në datën e krijimit të kësaj shoqërie më së shumti është e lidhur me diferencën prej 13 ditësh të kalendarit osman, kështu që data 29 mars 1909 përkon me datën 11 prill 1909.

Dokumentacioni i kohës konfirmon faktin e shfaqjes së kësaj shoqërie me fizionomi demokratike, e cila kishte si qëllim të vetëm mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Kryetar i shoqërisë “*Dilli*” ishte Logor Bezhani, ndërsa si anëtar kryesie rezultonte Kostandin Çipo.

Në këtë kontekst, përmes një korrespondence që na vjen nga Elbasani, informohemi se në prill të vitit 1909, ditën e themelimit të saj, anëtarë të shoqërisë “*Dilli*” kryen një vepër të lavdishme, që mund të vlenë si shembull për të gjithë Shqipërinë. Ditën e Pashkëve të mëdha djelmosha elbasanas vajtën me flamurin e shoqërisë së tyre “*Dilli*” te varri i shkrimtarit rilindës dhe patriotit të njohur Konstantin Kristoforidhi, ngulën atje atë flamur dhe e lanë të valojë për tri ditë. Në rrethana të tilla informohemi se: “... ky gjest i rinisë elbasanase bani bujë të madhe. Njëkohësisht u kënduan edhe “*kangë kombëtare, tue ngrite lart kështu veprën dhe kujtimin e atij që e çoi jetën tue shkruie shqip e tue mbledhë fjalët e gjuhës sonë si bleta mbledh mjaltin nga lulet*”<sup>289</sup>.

Gjithashtu, dokumentacioni i kohës konfirmon faktin se në mungesë të një lokali të përhershëm, kjo shoqëri mbledhjet e saj do t’i zhvillonte në selinë e klubit “*Bashkimi*”. Ndërkohë, pas Kongresit të Elbasanit, shoqëria “*Dilli*” do të kalojë një proces riorganizimi, duke

---

<sup>285</sup> “*Korça*”, *Korçë*, nr. 26, 18 dhjetor 1909.

<sup>286</sup> Emri i kësaj shoqërie ndeshet “*Dilli*” ose “*Dielli*”.

<sup>287</sup> AME, D. 14, f. 7.

<sup>288</sup> “*Shqypeja e Shqypënis*”, Nr, 17, Sofje, 6 shkurt 1910, f. 3 Letër prej shoqënis “*Dielli*” në Elbasan. H. Myzyri, *Shkolla Normale ...*, vepër e cituar, 380.

<sup>289</sup> Materiale depozituar në AME, Dos. 1, f. 3, (nxjerrë nga AQSH. Fondi, Lef Nosi).

marrë si model referimi statutin e klubit “Vllaznia”. Veprimtaria e saj do të njohë një fazë të re bashkëpunimi përmes i lidhjeve edhe me grupe e shoqëri të tjera.<sup>290</sup> Një fakti i tillë gjen pasqyrim në faqet e gazetës “Shqypeja e Shqypënis” që botohej në Sofje në 6 shkurt të vitit 1910. Në një letër të shoqërisë “Dielli” të Elbasanit botuar në këtë gazetë, pasqyrohet procesi i riorganizimit të kësaj shoqërie duke parashtruar edhe objektivat më kryesorë të saj. Pas riorganizimit të shoqërisë, kur radhët e saj u mbushën me nxënës të Normales, në programit e saj u përfshinë gjithashtu edhe mësimet gjimnastike dhe këngësh kombëtare për të rinjtë e Elbasanit. Ndërkohë, në programin e saj përcaktohej se me të ardhurat e mbledhura do të hapeshin shkolla në gjuhën shqipe sidomos në fshatrat e varfër të qarkut të Elbasanit<sup>291</sup>.

Por problem shqetësues si edhe më parë mbeti gjetja e një lokali të përhershëm, prandaj mbledhjet e kësaj shoqërie zhvilloheshin herë pas herë në shtëpinë e Grigor Nosit por edhe në sallonin e klubit “Bashkimi” sikurse kishte ndodhur që me krijimin e saj.

Ndërkaq, interesant në këtë periudhë paraqitet krijimi në Elbasan i një klubi të ri që nuk e kemi ndeshur më parë në punimet e studiuesve vendas dhe që njihet me emrin “Klubi i Fukarave”. Duke ju referuar përjasjes së dokumentacionit përkatës, ky klub rezultoi të jetë krijuar në vitin 1909<sup>292</sup>.

Në këtë kuadër, të dhëna më të plota për fizionominë e klubit në fjalë i gjejmë në faqet e shtypit të kohës. Në gazetën “Bashkimi i Kombit” që mban datën 1 tetor 1909 dhe botohej në Manastir, gjejmë të pasqyruar një artikull nën titullin “*THIRRJE MI GJITHË ELBASANASIT QË NDODHEN JASHTË*”. Duke ju referuar përmbajtjes së dokumentit në fjalë rezultoi se klubi i “Fukarave” është krijuar në 17 qershor të vitit 1909 dhe njihet me emrin “Klub’i të vorfënet”. Ai na shfaqet si një klub me një fizionomi disi të veçantë, duke rezultuar si një klub me karakter human apo bamirës sikurse konstatohet në thirrjen e shpallur prej tij, në të cilën thuhej : “ *T’i vijë ndihmës gjithve atyne të vorfëne qi ndodhen në shtrëngim pa vumën re besë e fe. Klubi ka me u ndifun të sëmurëve, të burgosurve pa faj, atyne që s’munden me pagu pagjesat e mretnisë, atyrne qi s’kanë me se ta qisin bijën e tyre me fat të vet e atyne që s’mund të qisin bukën e gojës, atyne qi s’kanë me se të vorrojnë të vdekunin qi kanë në shpi, ene atyne xhamiave e kishave qi*

---

<sup>290</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale ... , vepër e cituar*, 184.

<sup>291</sup> “Shqypeja e Shqypënis”, Nr, 17, Sofje, 6 shkurt 1910, f. 3. Letër prej shoqërisë “Dielli” në Elbasan. H. Myzyri, *Shkolla Normale ... , vepër e cituar*, 380.

<sup>292</sup> AME, Dosja. 14, f. 7.

*s'kanë me se u përmajtun*"<sup>293</sup>. Për këtë qëllim, "Klubi i Fukarave" përmes thirrjes së tij do të kërkonte mbështetjen financiare të gjithë shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, duke ju referuar statutit të këtij klubi përcaktohej se nuk pranoheshin si anëtarë të tij përfaqësues nga shtresa të tjera sociale, përveçse atë që konsideroheshin të varfër, pavarësisht kontributit të tyre financiar.<sup>294</sup>

Ndërkohë, përsa i përket karakterit të "*Klubit të fukarave*" autorë të huaj mendojnë se ky klub ishte krijuar posaçërisht nga xhonturqit, si një mjet presioni ndaj klubeve dhe shoqërive shqiptare që ishin krijuar në Elbasan në këtë kohë. Për këtë problem Nathalie Clayer, do të shkruante: "*Klubi i Fukarave*" ishte krijuar nga xhonturqit për t'ia kundërvënë klubit patriotik të Elbasanit dhe merrej gjithashtu me vepra filantropie"<sup>295</sup>. Ndërkaq në këtë kohë në Elbasan funksiononte edhe një klub osman që njihej me emrin "Ihtihad".

Gjithashtu, në Elbasan u formua në 18 tetor të vitit 1909 edhe një shoqëri tjetër e njohur me emrin "*Drita*". Nga dokumentacioni i kohës informohemi se nismëtarë për krijimin e kësaj shoqërie rezultojnë të ishin patriotët elbasanas Mehmet Hastopalli dhe Ibrahim Hastopalli. Burimi në fjalë na paraqet edhe qëllimin për të cilin kjo shoqëri u formua, duke u shprehur se: "*Qëllimi kryesor i kësaj shoqërie ishte të botonte e të shpërndante libra në gjuhën shqipe në trevën e Elbasanit dhe në të gjithë Shqipërinë*".<sup>296</sup> Duke ju referuar korrespondencës së kohës rezulton se zyrtarizimi i kësaj shoqërie është bërë në 19 tetor të vitit 1909, në godinën e klubit "*Bashkimi*"<sup>297</sup>.

Por në kuadrin e veprimtarisë së klubeve patriotike e kulturore në Elbasan problem parësor mbetej sigurimi i mjeteve financiare për mbajtjen e shkollave shqipe, për pagesat e mësuesve dhe njëkohësisht për botimin e librave dhe të teksteve shkollore në gjuhën shqipe etj. Burimet dhe rrugët përmes të cilave patriotët elbasanas arrinin të siguronin këto të ardhura rezultonin të ishin nga më të ndryshmet. Përqindja më e madhe e këtyre të ardhurave sigurohej nëpërmjet kuotizacioneve që jepeshin nga anëtarët e klubeve. Në jo pak raste një pjesë e tyre sigurohej nëpërmjet dhurimeve nga popullsia, por njëkohësisht evidentohet edhe dukuria e shfrytëzimit të objekteve të ndryshme në funksion të sigurimit të të ardhurave financiare.

---

<sup>293</sup> *Mendimi Politik e Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, pregatitur nga Zihni Haskaj, vëll. II, Tiranë: 1976, 463.

<sup>294</sup> Po aty.

<sup>295</sup> Nathalie Clayer, 136.

<sup>296</sup> "Korça", nr. 17, Korçë, vjeshtë 1909, fq. 4. H. Myzyri, *Shkolla Normale...*, vepër e cituar, 186.

<sup>297</sup> AQSH, F. 102, Dos. 76, f. 1.

Nëpërmjet burimeve të kohës informohemi se të ardhurat që do të nxirreshin nga një kanal vaditës që po ndërtohej, do t'i dhuroheshin klubit “*Bashkimi*” të Elbasanit, duke konfirmuar njëkohësisht dhe qëllimin e përdorimit të tyre: “Që ai t’i përdorte ato për me përhapë mësimin e gjuhës amtare n’qytet e nëpër katundet”<sup>298</sup>.

Veprimtaria aktive dhe gjithëpërfshirëse e shoqërive dhe klubeve patriotike shqiptare në Elbasan jo vetëm e gjallëroi më shumë jetën arsimore e kulturore të qytetit dhe forcoi ndjenjat kombëtare e bashkimit pa dallim feje të popullit elbasanas, por në të njëjtën kohë e pozicionoi Elbasanin si një nga vatrat më të zjarra të lëvizjes kombëtare shqiptare të kësaj periudhe. Sukseset e arritura në fushën e arsimit në kushtet legale pas shpalljes së Hyrjetit filluan të vënë në lëvizje turqit e rinj, për të cilët shqetësimi parësor ishte përhapja e gjerë që kishte marrë gjuha dhe shkolla shqipe në Shqipëri.

Ndërkohë, pas shtypjes së kundërrevolucionit të prillit të vitit 1909, turqit e rinj e forcuuan dhe e konsoliduan pushtetin politik, gjë që u reflektua dhe në qëndrimin e tyre ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare. Kjo politikë e turqve të rinj u shoqërua me përdorimin e formave të ndryshme, që u shfaqën përmes ushtrimit të presionet dhe dhunës së drejtpërdrejtë ndaj klubeve dhe shoqërive patriotike dhe shkollave shqipe për mbylljen e tyre e deri në përdorimin e legjislacionit osman në funksion të kësaj politike.

Në këtë kuadër, në parlamentin osman do të miratohet ligji “mbi shoqëritë”, i cili i ndalonte të gjitha shoqëritë e krijuara në bazë të “emërimit dhe dallimit kombëtar”. Sipas këtij ligji në Perandorinë Osmane duhej të kishte vetëm shoqëri “Osmane” dhe jo shoqëri kombëtare. Në një artikull të botuar në gazetën “*DIELLI*” në Boston flitet për rrezikun e mbylljes së klubeve shqiptare si rezultat i miratimit të ligjit të përgatitur nga Ferid Pasha ministër i punëve të brendshme të perandorisë. Aty thuhet se qeveria hoqi tabelën e klubit të Stambollit sepse shkruante “Klub Bashkim”, hoqi tabelën e klubit të Manastirit vetëm për fjalën “Bashkim”, mbase do të na mbyllnë “Bashkimin e Kombit”, mbase do të ndjekë ata njerëz që përdorin fjalën Bashkim...<sup>299</sup>.

Sipas një artikulli të botuar në gazetën “*Dielli*” të Bostonit pasi flitet për mbylljen e klubit të Leskovikut[informacion i marrë nga gazeta “*Besa*” e Stambollit], të klubit të Follorinës[informacion i marrë nga gazeta “*Lirija*” e Sealnikut] thuhet se: “... dhe një atdhetar

---

<sup>298</sup> “*Lirija*”, nr. 28, Selanik, shkurt 1909, f. 4.

<sup>299</sup> “*Dielli*”, Boston, Nr. 41, 7 janar 1910, Autori: Shpata.

na shkruan se përpiket t'i mbyllë dyert'e tij edhe klub i Tiranës; edhe intrigat ven'e vijnë për të mbyllur “ Labërinë” e Vlorës... të vetëmit që përparojnë janë ato të Korçës, Manastirit dhe Elbasanit<sup>300</sup>.

Gjithashtu, përmes një letre që i referohet periudhës maj të vitit 1909 informohemi për shkatërrimin e klubit të Labërisë e atij të Ohrit. Në vazhdimësi ky burim konfirmon se: “*Hamdi beu mezi i ka shpëtue arrestimit .... Edhe këtu n'Elbasan vijnë përçark kundërshtarët. Pardje ikën nga këtu dy të dërguar të “Xhemietit”, të cilët erdhën të shohin në ç'shkallë gjendet shqiptarizma e si munden ta luftojnë...*”<sup>301</sup>.

Kështu, sikurse konstatohet nga burimet e kohës të parët që reagan kundër ligjit “mbi shoqëritë” ishin klubet “*Bashkimi*” dhe “*Vllaznia*” të Elbasanit. Në një telegram që i dërgohet senatit turk protestohet lidhur me vendimin e marrë për mbylljen e klubeve shqiptare.<sup>302</sup> Kopje e telegrameve ju dërgohet dhe klubeve shqiptare të Selanikut, Manastirit, Shkupit e Janinës, ku i bëhet thirrje për tu bashkuar edhe ato në këto protesta<sup>303</sup>.

Ndërkaq, veprimtaria e klubeve patriotike të rrethit të Elbasanit u shtri edhe në rrethin e Gramshit, ku me kohë kishin filluar përpjekjet për mësimin e gjuhës shqipe, nëpërmjet shpërndarjes së librave shqip, duke gjetur tashmë një truall të përgatitur patriotik. Popullsia e kësaj treve nën drejtimin e shoqërive patriotike të lëvizjes kombëtare e të patriotëve të Elbasanit, ka qene tepër aktive në lëvizjen kombëtare për gjuhën e shkollën shqipe dhe për çlirim kombëtar nga zgjedha osmane. Në krye të lëvizjes kombëtare në Gramsh rezultonte patrioti i njohur gramshak Kamber Dyrmyshi, i cili për disa kohë kishte ushtruar aktivitetin e tij në qytetin e Elbasanit<sup>304</sup>. Në Elbasan ai u formua si patriot arsimdashës, gjë që e pasqyroi në vitet e mëvonshme. Patriotët gramshakë mbanin lidhje të rregullta jo vetëm me patriotët e Elbasanit, por edhe me ata të Korçës, Beratit etj. Librat, abetaret dhe gazetat shqipe vinin në Gramsh nga Elbasani, por dhe nga Korça, nga krahinat e tjera të vendit dhe drejtpërdrejt nga shoqëritë patriotike jashtë vendit.

Nevoja për libra, abetare dhe mësues për të mësuar shqip në Gramsh ishte mjaft e madhe. Një grup patriotësh të fshatit Dufshan do të shkruajnë: “...*Neve të lutemi shumë të na dërgosh*

<sup>300</sup> Po aty, nr. 2, 27 shkurt 1909. Artikull pa emër autori, është fjala për gazetën “Besa” që botohej në Stamboll gjatë viteve 1908-1909

<sup>301</sup> Sh. Demiri, Kujtime veteranësh, material i depozituar në muzeun historik Elbasan, Dos. nr. 1.

<sup>302</sup> AQSH, F. 102, D. 60, f. 1-2 (pjesa e parë dërguar senatit, pjesa e dytë dërguar klubeve të tjera).

<sup>303</sup> Po aty.

<sup>304</sup> K. Musaj, *Popullsia e rrethit të Gramshit në luftë për pavarësi*, material në muzeun historik, Elbasan, 178.

*një mësonjë, se këtu janë ngritur në kambë njerëzit, se janë në mëshirën tuaj, për të na dërguar një mësuës për të na mësuë shqip*”<sup>305</sup>. “Mësuesi që kërkuam erdhi”, vazhdon informacioni, “e paguanim vetë, por qëndroi vetëm disa muaj.”

Ndërkohë, rezistenca kundër imponimit të alfabetit arab për shkrimin e gjuhës shqipe në trevën e Elbasanit, përbën një aspekt tjetër që është tregues i faktit se, patriotët elbasanas ishin të parët që e shndërruan atë një problem mbarë kombëtar.

Xhonturqit nuk mundën të frenonin procesin e zgjerimit të lëvizjes arsimore në trevat shqiptare në vitet 1908-1909. Ata do të përpiqen të gjejnë forma dhe mënyra të tjera në funksion të përmbushjes së synimeve të tyre politike. Kështu, në fillim të vitit 1909 filloi të dalë në qarkullim një abetare me shkronja arabe, e cila u shpërnda nga elementët turkomanë në qytete të ndryshme të vendit. Në të njëjtën kohë u formua në Stamboll një shoqëri që njihej me emrin “*Shoqëria për mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja turqisht*”, e cila synonte zgjerimin e saj nëpërmjet krijimit të degëve në të gjithë trevat shqiptare<sup>306</sup>. Përmes udhëzimeve të dhëna nga autoritetet qeveritare qendrore turke organeve lokale që në Elbasan, Kosovë dhe Filat kërkohej mësimi i gjuhës shqipe me alfabetin arab, duke ju kundërvënë në mënyrë të drejtpërdrejtë përdorimit të alfabetit latin.

Në këtë kuadër, për ti dhënë një karakter më të organizuar një veprimtari të tillë, në korrik të vitit 1909 me rastin e përvjetorit të revolucionit xhonturk me iniciativën e xhonturqve do të mbledhet Kongresi i Dibrës.<sup>307</sup> Pjesëmarrja në këtë kongres do të rezultojë heterogjene, duke u përfaqësuar delegatë nga vilajetet e Shkodrës, Manastirit, Kosovës, Janinës e Selanikut. Ndërkaq, duhet thënë se përveç tyre merrnin pjesë edhe delegatë turq, maqedonas, grekë, serbë, vllahë, oficerë xhonturq etj. Megjithë vështirësitë e shumta, në këtë kongres u përfaqësuan edhe disa prej patriotëve shqiptarë si: Dervish Hima, Feim Zavalani, Sotir Peci, Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Loni Logori.

Përfaqësues të Elbasanit në këtë kongres do të jenë Haxhi Aliu, Dervish Biçaku, Veniamin Nosi dhe Aqif Pashë Elbasani. Ekziston mendimi se qëllimi i këtij kongresi ishte që të sillte përçarje në lëvizjen kulturore shqiptare. Një fakt i tillë gjen pasqyrim përmes disa prej vendimeve të tij, ku përsa i përket çështjes së përdorimit të alfabetit thuhej: “*Sa për shkronjat, le të jenë si të dojë populli*”, duke vënë në diskutim një çështje që ishte zgjidhur nga Kongresi i

<sup>305</sup> Dokumente të Komitetit të Manastirit, dt. 21. 4. 1906, f. 169.

<sup>306</sup> *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I, Tiranë: 2003, 192.

<sup>307</sup> Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: 2009, 563.

*Manastirit*.<sup>308</sup> Ndërkaq, në një nga vendimet e tjera të tij shprehej besnikëria dhe bashkëpunimi me xhonturqit që në thelb shprehej përmes fjalëve: “*Të jemi së bashku me osmanllit*”<sup>309</sup>.

Gjithashtu në pjesën e dytë të vendimeve të këtij kongresi, në nenin e tretë parashikohej që në Shqipëri të hapeshin “me të shpejtë” shkolla fillore, qytetëse e gjimnaze, si dhe shkolla teknike e bujqësore. Në këto shkolla, përveç gjuhës zyrtare do të mësohej “edhe gjuha e vendit” dhe mësuesit e shqipes duhej të paguheshin nga organet qeveritare osmane<sup>310</sup>.

Në këtë kuadër duhet thënë se midis vendimeve të kongresit të Dibrës disa prej tyre synonin riafirmimin e një identiteti osman dhe besnikërisë ndaj Perandorisë Osmane. Vendimet e këtij kongresi më së shumti ishin tregues i një realiteti shoqëror që ndërthurej midis interesave dhe kontradiktave brenda shoqërisë shqiptare në raport me qëndrimin ndaj Perandorisë Osmane.

### **II. 3. Kongresi Kombëtar i Elbasanit dhe vendimet e tij**

---

<sup>308</sup> *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I, vepër e cituar, 196.

<sup>309</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (32), Dos. 60/1, f. 73.

<sup>310</sup> Po aty, f. 194.

Nëse Kongresi i Manastirit rezultoi i suksesshëm në zgjidhjen e çështjes së alfabetit, duhet përmendur fakti se gjatë punimeve të tij nuk u trajtuan disa nga problemet që ishin përfshirë në programin e shpallur nga klubi i Manastirit e më konkretisht nuk u trajtua:

- Problemi për krijimin e shkollave më të larta shqipe nga vetë shqiptarët
- Sigurimi i fondeve për mbajtjen e shkollave shqipe
- Kërkesa drejtuar qeverisë osmane për të futur mësimin e gjuhës shqipe në të gjithë shkollat shtetërore turke
- Masat që do të merreshin për emërimin e mësuesve që do të jepnin mësim në këto shkolla<sup>311</sup>.

Gjithashtu, në Kongresin e Manastirit u vendos që brenda dy vjetëve të mbledhesh një kongres tjetër që do të vazhdonte të merrej me problemet e gjuhës shqipe duke përcaktuar si vend të mbledhjes së kongresit të ardhshëm Janinën. Ndërsa data e mbledhjes u përcaktua 10 korriku i vitit 1910.

Pavarësisht problematikës së sipërpërmendur, ajo çka rezulton evidente në periudhën pas Kongresit të Manastirit, është fakti se lëvizja arsimore e kulturore në trevat shqiptarë njohu një zhvillim të dukshëm. Tashmë ishte krijuar një rrjet i gjerë klubesh dhe shoqëri patriotike, ishin çelur një varg shkollash shqipe të ditës e të natës, si dhe qenë shtuar së tepërmi botimet shkollore dhe jo shkollore, organet e shtypit kombëtar etj.

Por sikurse konstatohet nga burimet përkatëse të kësaj periudhe përmes korrespondencës së patriotëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, megjithë përparimet në fushën arsimore e kulturore, ekzistonin një varg problemesh të cilat kërkonin zgjidhje. Ndër to më të rëndësishëm rezultojnë nevojat dhe kërkesat për mësues të gjuhës shqipe, ndërkohë që deri në fund të vitit 1909, në Shqipëri nuk kishte ndonjë shkollë të mesme shqiptare që të nxirrte nxënës të një niveli të tillë.

Ja si shprehet për këtë problem Simon Shuteriqi: “.. *Mësimore duam të çelim, po mjerisht mësonjës të zotët të marrin përsipër këtë punë të lartë, mësonjës që të munt të mësojnë me systemë gjuhën tonë, dhe ta dijnë këtë mbë një shkallë të mjaftë përgjithësisht të thomi na mungojnë*”<sup>312</sup>.

---

<sup>311</sup> *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit ...*, vepër e cituar, 44.

<sup>312</sup> “Tomorri”, nr. 10, Elbasan, 10 qershor 1909, autori Simon Shuteriqi me pseudonimin Ura e Shkumbinit.



Ndërkaq edhe problemet organizative të rrjetit të shkollave fillore ekzistuese shqipe dhe çështje të natyrës financiare akoma nuk kishin marrë zgjidhje të plotë. Pikërisht, një detyrë të tillë të vështirë por që rezultoi mëse e suksesshme do ta merrte përsipër Kongresi Kombëtar që u vendos të mbledhej posaçërisht në Elbasan.

Parë në këtë këndvështrim mund të themi se edhe më parë patriotët e këtij qyteti kishin kërkuar mbajtjen e një kongresi në Elbasan”<sup>313</sup>.

Në këtë kuadër, faktorët që përcaktuan zgjedhjen e qytetit të Elbasanit si vendi organizator për mbajtjen e Kongresit janë të shumtë, por midis tyre mund të përmendim:

- Së pari, traditat patriotike, arsimore e kulturore, me figura të shquara të Dhaskal Todrit, Konstandin Kristoforidhit etj, ishin të njohura në të gjitha trevat shqiptare dhe kishin ushtruar një ndikim të fuqishëm në ata intelektualë që vendosën për mbledhjen e këtij kongresi në këtë qytet.
- Së dyti, Elbasani në atë kohë ishte shndërruar në një qendër të rëndësishme të ngjarjeve e veprimtarive për çështjen kombëtare dhe paraqiste një nivel të kënaqshëm të zhvillimit arsimor në shkallë kombëtare. Nga të dhënat e lartpërmendura në këtë kohë në Elbasan ishin krijuar dhe zhvillonin veprimtarinë e tyre 5 klube dhe shoqëri patriotike me një aktivitet gjithëpërfshirës.
- Së treti, një fakt tjetër që mundësoi zgjedhjen e Elbasanit si qytet organizator të kongresit ishte edhe pozita gjeografike në qendër të trevave shqiptare, e cila favorizonte ardhjen e delegatëve nga të katër anët e vendit.

Kështu, duhet thënë se ekzistenca i një mjedisi të tillë intelektual në Elbasan përbën faktorin kryesor që kushtëzoi thirrjen në atë kohë të këtij kongresi mbarëshqiptar për zgjidhjen e problemeve të ngutshme arsimore, kulturore, organizative dhe politike.

Duke hulumtuar me kujdes në dokumentacionin e kohës, vërejmë se data e fillimit të punimeve të Kongresit të Elbasanit u shty dy herë<sup>314</sup>. Në thirrjen që klubi shqiptar i “Selanikut” i bënte klubeve dhe shoqërive shqiptare për mbledhjen e Kongresit Kombëtar në Elbasan, si datë e mbledhjes së tij ishte vendosur data 1/14 maj e vitit 1909. Por, sikurse konstatojmë nga dokumentacioni i kësaj periudhe, në një tjetër thirrje të klubit të Selanikut që mban datën 21 prill 1910, njoftohej shtyrja e datës së mbledhjes së Kongresit në një afat të pacaktuar.

---

<sup>313</sup> Është fjala për sugjerimin e patriotëve elbasanas të cilët kërkuan që Kongresi i Manastirit të mbledhej në Elbasan.

<sup>314</sup> “Dielli”, Boston, 1 tetor 1909.

Në këtë kontekst, ekzistojnë mendime të ndryshme përsa i përket motiveve që kushtëzuan shtyrjen e fillimit të punimeve të Kongresit të Elbasanit. Disa prej tyre parakuptojnë mendimin se shtyrja e datës së mbajtjes së Kongresit në Elbasan ishte e lidhur më disa faktorë ndër të cilët si më të rëndësishmit mund të përmendim :

**Së pari:** Tensionet që u krijuan në kryeqytetin e Perandorisë në Stamboll lidhur me situatën kundërrevolucionare që u krijua atje gjatë muajit prill të vitit 1909;

**Së dyti:** Pengesat që krijoi regjimi xhonturk nga frika se thirrja e këtij kongresi, krahas problemeve me karakter kulturor do të ngrinte edhe probleme me karakter politik.

**Së treti:** Mënyra e shpalljes së thirrjes së tij nga Klubi i Selanikut

Në këtë kuadër, në shtypin e kohës evidentohet një fakt tepër interesant dhe shumë kuptimplotë. Në një nga datat e caktuara për fillimin e punimeve të këtij kongresi në Elbasan mundën të arrijnë 14 delegatë nga 35 që duhej të vinin, nga këta 4 ishin oficerë xhonturq të veshur civilë<sup>315</sup>.

Për problemin në fjalë, studiues të tjerë mbështesin mendimin se shtyrja e datës së mbledhjes së Kongresit të Elbasanit, përveç ndikimit të faktorëve të jashtëm, më së shumti është e lidhur edhe me problemet që u shfaqën fillimisht me shpalljen e thirrjes së tij dhe gjithashtu me çështje të natyrës organizative.

Parë në këtë këndvështrim, ekziston mendimi se, thirrja që klubi i Selanikut shpalli për mbledhjen e Kongresit të Elbasanit pa u konsultuar me klubin e Manastirit konsiderohej si shkelje e vendimeve të Kongresit të Manastirit. Gjithashtu, përcaktimi i vendit, datës dhe programit të Kongresit ishte vendosur në mënyrë arbitrare nga klubi i Selanikut pa u konsultuar me klube apo shoqëri të tjera shqiptare brenda apo jashtë vendit aq më tepër edhe me klubin e Manastirit<sup>316</sup>. Për problemin në fjalë në një artikull të botuar në gazetën “Dielli” shkruhej: *“Pa ndonjë marrëveshje nërmes të klubeve, pa shtruar një program të përbashkëm nër mes tyre edhe me një nxitim të parsyeshmë po përgatitej kongresi i dytë”*<sup>317</sup>.

Në këtë kuadër, mënyra e thirrjes së Kongresit të Elbasanit edhe nga konsujt e huaj në Shqipëri do të konsiderohej si një ndër faktorët që ndikoi në mospërfaqësimin e trevave të tjera shqiptare në Kongres veçanërisht atyre veriore. Për këtë problem, konsulli austro-hungarez do të shprehej: *“Vetëm Shqipëria Jugore dhe e mesme kishin dërguar delegatë, kurse veriu pothuajse*

---

<sup>315</sup> Po aty.

<sup>316</sup> Nga patriotët shqiptarë thirrja e këtij kongresi nga klubi i Selanikut u prit me dyshime dhe skepticizëm, pavarësisht se qëllimi ishte pozitiv. Edhe konsulli austriak i Manastirit shprehte të njëjtin dyshim për mbajtjen e kongresit.

<sup>317</sup> “Dielli”, Boston, nr. 7, 29 prill 1909, f. 2.

*s'mori aspak pjesë. Spjegimi optimist i këtij fakti të hidhur për idenë nacionale të përbashkët që përpiqen të japin toskët është se gegët nuk shkuan në Kongresin e Elbasanit jo se u mungonte kuptimi dhe interesi për çështjet kombëtare, por se fajin e kishte mënyra e papërshtatshme e thirrjes, që u botua vetëm në gazetën “Liria” të Selanikut, kurse pritej që klubet të merrnin seicili nga një ftesë.<sup>318</sup> Parë në këtë këndvështrim, një veprim i tillë i klubit të Selanikut do të shërbente si motiv kryesor që mund të ndikonte në lindjen e kontradiktave dhe të përçarjeve në kuadrin e klubeve dhe shoqërive shqiptare.*

Kështu, misionin për zgjidhjen e një problemi të tillë do ta marrë përsipër Luigj Gurakuqi. Përmes korrespondencës në këtë kohë me patriotë elbasanas, informohemi rreth kërkesës që ai do t'i parashtrojë kryetarit të klubit të Selanikut Mit'hat Frashërit për shtyrjen e kohës së mbajtjes së Kongresit, duke nxjerrë si pretekst afatin e shkurtër që ishte përcaktuar për mbajtjen e kongresit. Qëllimi kryesor i kësaj kërkesë, synonte më së shumti që përgjatë kësaj kohe klubi i Selanikut të koordinonte veprimet me klubin e Manastirit dhe klubet e tjera shqiptare për problemet organizative dhe tematike që do të diskutoheshin në këtë kongres. Pikërisht, këto kërkesa Luigj Gurakuqi do t'ja paraqesë Mit'hat Frashërit në formën e sugjerimeve personale në një letër që do t'i dërgojë nga Shkodra në maj të vitit 1909<sup>319</sup>.

Në këtë kuadër, sikurse dihet data e çeljes së kongresit u shty dy herë, ndërkohë që mbledhja e tij konsiderohej si domosdoshmëri në konjunkturën politiko-arsimore të krijuara në Shqipëri në 23 korrik të vitit 1909 pas mbledhjes së kongresit të Dibrës, ku qëndrimi antishqiptar i xhonturqve ishte mëse evident.

Kështu, në rrethana të tilla dhe pasi data e mbledhjes së Kongresit të Elbasanit u shty dy herë, komisioni organizator vendosi që punimet e kongresit të fillonin në ditët e para të muajit shtator të vitit 1909. Siç dëshmon një nga delegatët në këtë kongres më 31 gusht 1909 ishin takuar në Qukës delegatët e Manastirit, Dibrës, Korçës, Shkupit, të Selanikut dhe ditën e mërkurë në 1 shtator hynë në Elbasan. Në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore shumica e madhe e qytetit na kishte dalë përpara bashkë me të “ç'quarët bejlerë” dhe fëmijët e shkollave shqipe të cilët depërtonin erën me këngët e ëmbla që këndonin. Pasi u mbajt një fjalë e shënuar për mirë se

---

<sup>318</sup> HHSTA/PA, Vjenë, raport dërguar nga konsulli austro-h ungarez i Manastirit, Nr. 72, 20 shtator 1909.

<sup>319</sup> “Lirija”, Selanik, nr. 42, 2 maj 1909.

atdhetarë nga një i shquar vendas mëmëdhetarë ata u nisën të gjithë tok drejt klubit Bashkimi, ku ishin gati të gjithë lehtësirat për miqtë udhëtarë<sup>320</sup>.

Gjithashtu, në faqet e revistës “Ylli” pritja e delegatëve që do të përfaqësoheshin në kongres nga populli Elbasanit konsiderohej madhështore dhe e paparashikueshme”.<sup>321</sup> Një bashkëkohës i huaj që u ndodh ato ditë në Elbasan ka shkruar: “*Elbasani është në festë, delegatët nga të gjithë anët e Shqipërisë erdhën sot dhe pritet që nesër të arrijnë përfaqësuesit e qyteteve më të largëta*”<sup>322</sup>.

Në këtë mënyrë, më 1 shtator të vitit 1909, arritën në Elbasan delegatët që do të merrnin pjesë në punimet e këtij kongresi, ku gjetën një atmosferë të ngrohtë të krijuar nga klubet e këtij qyteti, “*Bashkimi*”, dhe “*Vllaznia*”. Ja si e përshkruan pritjen e popullsisë së Elbasanit gazeta “*Bashkimi i Kombit*” : “*Nuk mund të gjejmë fjalë për pritjen dhe nderin që na bënë vëllezërit tanë elbasanas gjatë gjithë kohës që u mbajt kongresi*”.<sup>323</sup> Midis 35 delegatëve që përfaqësonin të gjitha krahinat e vendit si dhe dëshirat e interesat e mbarë kombit, ndodheshin, krahas personaliteteve të shquara, edhe veprimtarë e mësues të njohur të arsimit kombëtar.

E gjykojmë me interes që evidentimin e delegatëve që morën pjesë në Kongres ta fillojmë nga ata të qytetit organizator, të Elbasanit pasi për ata, për arsye që tashmë dihen, e vërteta nuk është thënë asnjëherë e plotë.

Kështu, nga klubi “*Bashkimi*” i Elbasanit mandatin e përfaqësimit e morën zotërinjtë Emin Haxhiademi dhe Taq Buda, nga klubi “*Vllaznia*” i Elbasanit mandatin e përfaqësimit e morën zotërinjtë Dervish Biçaku dhe Qamil Feza, ndërsa shoqëria “*Afërdita*” u përfaqësua nga zotërinjtë Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhimima. Përveç delegatëve me të drejtë vote, në Kongresin e Elbasanit, do të marrin pjesë vullnetarisht edhe Lef Nosi, Dhimitër Paparisto dhe Hysen Ceka<sup>324</sup>.

Gjithnjë në këtë kuadër heshturazi është kaluar nga historiografia e regjimit të kaluar përfaqësimi në Kongres i misionarisë amerikane të Korçës dhe Tiranës. Në të misionaria

---

<sup>320</sup> Po aty.

<sup>321</sup> Revista “Ylli” nr. 9, viti 1979, f. 14.

<sup>322</sup> “*Bashkimi i Kombit*” nr. 1, 10 shtator 1909, f. 1.

<sup>323</sup> Po aty.

<sup>324</sup> H. Myzyri, *Shkolla Shkolla Normale ..., vepër e cituar*, 192.

amerikane protestane e Korçës u përfaqësua nga Grigor Cilka e Sevasti Qiriazhi, ndërsa misionaria protestane e Tiranës nga Kristo Dako<sup>325</sup>.

Përsa i përket pjesëmarrjes së delegatëve të tjerë në Kongres, sipas një informacioni të marrë përmes raportit që konsulli Pallanz i dërgonte eprorëve të tij në Vjenë, informohemi se pjesëmarrja e Durrësit fillimisht në Kongres nuk ishte e sigurtë. Vetëm pas insistimit telegrafik të anëtarëve të Kongresit, delegatët e Durrësit të cilët do të përfaqësohen nga famulltari katolik i qytetit imzot Kaçorri, tregtari Jahja efendi dhe ortodoksi Mihal Guraskoviçi arritën dy ditë para mbylljes së Kongresit<sup>326</sup>.

Gjithashtu, në këtë Kongres nuk u përfaqësua Vlora e cila nuk arriti të dërgojë delegatë, për arsye të reprezaljeve të shumta që ishin bërë atje nga xhonturqit. Por, përmes burimeve austro-hungareze informohemi për prezencën në Elbasan disa ditë para fillimeve të Kongresit të Elbasanit të disa prej patriotëve vlonjatë e më konkretisht, të vëllezërve Halim bej e Qemal bej Risilia, Hamza Isa Efendi dhe vëllezërit Hasan Aga e Zeno Aga Sharra. Si rezultat i urdhrimit të tyre dërguar nga kajmekani i Vlorës zyrtarëve të Elbasanit, ata do të detyrohen të largohen menjëherë nga Elbasani<sup>327</sup>.

Gjithashtu, sikurse thuhet në një raport të konsullit austro-hungarez Kraus që mban datën 18 shtator 1909, në Vlorë edhe vendimet e Kongresit të Elbasanit nuk patën ndonjë efekt të madh sepse shprehet ai: “... *çështja më urgjente për nacionalistët e këtushëm [në Vlorë] shënimi ynë, ndërmarrja e një aksioni ndihmës për ata, nuk u prek fare në Kongresin e Elbasanit*”<sup>328</sup>.

Por në një tjetër dokument posaçërisht për problemin në fjalë, gjykojmë që përmbajtja e informacionit të dhënë nga konsulli Kraus nuk rezulton në përputhje me informacionin e konsullit Austro-Hungarez në Durrës Pallanz, që mban datën 14 shtator 1909. Në raportin e tij ai informon Vjenën zyrtare se Kongresi i Elbasanit jo vetëm u muarr më në fund me persekutimin e patriotëve shqiptarë të Vlorës, por vendosi që t’i drejtonte një telegram Vezirit të madh në të cilin ata[delegatët e kongresit] protestonin kundër këtyre veprimeve të padrejta<sup>329</sup>.

---

<sup>325</sup> L. Varoshi, *Vështrim i përgjithshëm mbi punimet e Kongresit Kombëtar të Elbasanit*, botuar në “Normalja në traditë”, Elbasan: Sejko, 1995, 37.

<sup>326</sup> HHSTA/PA, Vjenë, raport dërguar nga konsulli a-h Pallanz, Durrës, Nr. 65 Ref/I, 14 shtator 1909.

<sup>327</sup> Po aty, raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit.

<sup>328</sup> HHSTA/PA, Vjenë, raport dërguar nga konsulli austro-hungarez Kraus, Vlorë Nr. 88, 18 shtator 1909.

<sup>329</sup> Po aty, raport dërguar nga konsulli austro-hungarez Pallanz, Durrës, Nr. 65 Ref/I, 14 shtator 1909.

Gjithashtu, për arsye objektive megjithëse Shkodra, Kosova dhe shoqëritë patriotike të diasporës nuk patën përfaqësues në këtë Kongres. Por nuk munguan prej tyre letrat dhe telegramet e urimit për punimet e Kongresit.

Në kuadrin e përfaqësimit të delegatëve, në Kongresin e Elbasanit morën pjesë patriotët dhe aktivistët më kryesorë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si: Mithat Frashëri, Orhan Pojani, Gjergj Qiriazi, Andrea Konomi, Thoma Papapano, dom Nikollë Kaçorri, Qemal bej Elbasani, Refik Toptani, Hamdi Ohri, Idhomene Kosturi, e shumë të tjerë. Megjithëse e drejta e përfaqësimit në Kongres në emër të klubit të Shkupit ju ngarkua Mithat Frashërit, nga konstatimet e mësipërme rezulton se përfaqësuesit në Kongresin e Elbasanit përfaqësonin më së shumti trevat e jugut dhe të Shqipërisë së mesme, ndërkohë që Vlora dhe trevat e veriut nuk ishin të përfaqësuara.

Kongresi i Elbasanit i hapi punimet në 2 shtator të vitit 1909, [20 gusht 1325 me kalendarin e vjetër] në selinë e klubit “*Bashkimi*” dhe më pas në 3 shtator në selinë e klubit “*Vllaznia*”<sup>330</sup>.

Sikurse konfirmohet nga dokumentacioni i kohës, pas diskutimeve të pjesëmarrësve u vendos që çdo klub do të kishte të drejtën e dy votave të delegatëve të dërguar qoftë personalisht qoftë me përfaqësim. Me votim të fshehtë duke marrë 39 vota, kryetar i Kongresit u zgjodh z. Dervish Biçaku (Dervish bej Elbasani), ndërsa nënkryetar u zgjodh Mithat bej Frashëri me 24 vota; si shkronjës të kongresit (sekretarë) u caktuan Simon Shuteriqi dhe Josif Haxhimina.<sup>331</sup> Njëkohësisht, vlen të përmendet fakti se në të tria komisionet e krijuara në këtë kongres, Elbasani do të ketë përfaqësuesit e tij, ndërmjet të cilëve përmendet emri i patriotit të njohur Simon Shuteriqi.

Kongresi i Elbasanit do të trajtojë gjerësisht problemet që kishin të bënin me përhapjen e mëtejshme të arsimit në gjuhën shqipe, me përgatitjen e mësuesve për shkollat shqipe dhe me organizimin më të mirë të lëvizjes kulturore e asaj kombëtare në përgjithësi. Në këtë kontekst, ai mori një sërë vendimesh që u evidentuan në të ashtuquajturin *Akti i Vendimeve të Kongresit*, që përbëhej prej 15 pikave, por siç është shkruar në shtypin e kohës shpirti i kongresit dhe i Shqipërisë ishin tri vendime:<sup>332</sup>

- Çelja e një shkolle normale në Elbasan (pika 1);

<sup>330</sup> AQSH, Fondi. 143, Dos. 1788, fl. 4-5.

<sup>331</sup> Po aty.

<sup>332</sup> *Normalja në traditë*, Elbasan: Sejko, 1995, 38.

- Krijimi i një shoqërie qendrore shkollore në Korçë (pika 2);
- Zgjedhja e Klubit të Manastirit si klub qendror për dy vitet e ardhshme (pika 9).

Në funksion të vendimit të parë, gjatë punimeve të tij Kongresi trajtoi problemin e miratimit të rregullores dhe të statuteve që kishin të bënin me konturimin e strukturave organizative dhe programin e shkollës normale që do të çelej së shpejti për përgatitjen e mësuesve për shkollat fillore.

Në lidhje me vendimin e dytë, Kongresi evidentoi nevojën e ndihmës urgjente që duhej t'u jepej shkollave ekzistuese dhe orientoi çeljen e shkollave të reja në vise të ndryshme, si dhe futjen e mësimit shqip në të gjitha shkollat e huaja që ekzistonin.

Në këtë kuadër, një ndihmë të madhe do të jepte shoqëria qendrore shkollore, që u vendos të krijohet në Korçë me emrin “Shoqëria e mësonjëtorëve shqip Përparimi”. Kongresi kërkoi që kjo shoqëri të njihej zyrtarisht nga qeveria e Stambollit, si dhe pranë saj të krijohet arka e fondit të përgjithshëm. Në lidhje me këtë të fundit Kongresi në një nga seancat e tij vendosi që të ngrihej një komision i përbërë prej: Dervish Biçakut, Mithat Frashëri në cilësinë e kryetarit dhe nënkryetarit dhe delegatët Ahmet Dakli, Teki beu, Kristo Dako, Selman Blloshmi, Gjergj Qiriazhi, Irfan beu dhe Haxhi Bajrami. Komisioni do të merrte përsipër njoftimin në të katër anët e Shqipërisë dhe telegrafisht t'u kërkonte në emër të Kongresit ndihma në të holla, brenda mundësive, për mbajtjen e mësonjëtorëve dhe të mësonjësve<sup>333</sup>. Në një dokument nxjerrë nga arkivi qendror në Tiranë për problemin në fjalë shprehimisht thuhej: “*Komisioni përgatiti aty një plan tue tregue spenzimet e administrimit hamendësisht 710 lira)turke. Ky propozim u pranue dhe u hap regjistri. Ato qi ishin të lejuem nga klubet e regjistruen sasinë dhe ata që nuk kishin të drejtë thanë se duhet te pyesin telegrafisht dhe i regjistrojshim posa vinte përgjigja. Në këtë rast veç klubeve u banë edhe ndihma personale*”<sup>334</sup>. Një fakt i tillë gjen konfirmin edhe përmes burimeve të huaja.

Gjithashtu, në një letër dërguar nga Korça në 25 shtator 1909, njoftoheshin Pleqësitë e klubeve “*Bashkimi*” dhe “*Vllaznia*” në Elbasan për përbërjen përfundimtare të Pleqësisë së Shoqërisë së Mësonjëtorëve Shqip Përparimi. Në këtë kuadër në letrën në fjalë shkruhet: “... *ju kallxojmë çkoqitur dhe emrat e zz. Pleq. Kryetarë, z. Orhan Be Pojani, ndën Kryetarë Stavre*

<sup>333</sup> AQSH, F. 143, Dos. 1788. fl. 5-6. H. Myzyri, Shkolla Normale ..., vepër e cituar, 198.

<sup>334</sup> Po aty. Letër me shkrim dore, në të thuhet se Dervish bej Biçaku regjistroi si dhurim 50 lira, Neki bej Rusi, 25 lira, klubi i Korçës 50 lira dhe në emër të shqiptarëve të Bukureshtit 4 0 lira.

*Karoli, Arkëtarë Idomene Kosturi, shkronjës Mihal Grameno, Këshillonjës Hafëz Ali dhe Sami Be Pojani*”<sup>335</sup>.

Për sa i përket vendimit të tretë, gjatë punimeve të tij, Kongresi i Elbasanit shtjelloi gjerësisht problemin e forcimit të bashkëveprimit dhe lidhjeve ndërmjet klubeve e shoqërive që ekzistonin në Shqipëri. Megjithatë duhet thënë se problemi në fjalë ishte përvijuar si shqetësim në shtypin e kohës qysh përpara mbledhjes së kongresit. Kështu në faqet e gazetës “*Dielli*”, që dilte në Boston nën drejtimin e Faik Konicës, një muaj përpara kongresit, ndërsa evidentohet fakti i çeljes së klubeve të reja, tërhiqej vëmendja në tri aspekte kryesore:

Së pari, në bashkërendimin e veprimeve të klubeve në dobi të zgjidhjes së çështjes kombëtare;

Së dyti, në domosdoshmërinë e hartimit të një programi të përgjithshëm;

Së treti, këto shqetësime kërkohej që të parashtroheshin për zgjidhje në Kongresin kombëtar të Elbasanit.

Sipas dokumentacionit të kohës, konfirmohet fakti se gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit të Elbasanit ka zotëruar fryma e debatit (i referohemi qëndrimit të mbajtur nga Mithat Frashëri për kalimin e statusit si klub qendror, klubit të Selanikut.)

Në këtë kontekst, krahas vendimit për zgjedhjen e Klubit të Manastirit si klub qendror, kongresi miratoi edhe rregulloren e klubeve e të shoqërive shqiptare, që përveç dispozitave të përgjithshme e të detyrueshme për çdo klub apo shoqëri të hartohet edhe statusi individual, në përputhje me kushtet dhe nevojat konkrete. Në këtë kuadër theksohej shprehimisht: “*Të gjitha klubet e shoqëritë duhet të punojnë me të gjitha forcat e tyre në të mirën e kombit shqiptar e të vendit për përparimin e qytetërimin popullor etj*”<sup>336</sup>.

Kongresi trajtoi edhe problemin e amnistisë për të gjithë shqiptarët e pafajshëm që ishin burgosur apo larguar nga mëmëdheu nga frika e arrestimeve. Në lidhje me këtë problem, kongresi vendosi që: “*Ti kërkohet Sulltanit me shkrim që të gjithë shqiptarët, për të cilët e vërteta konfirmon pafajësinë, të lirohen, kurse ata që janë larguar nga dheu mëmë t’u lejohet kthimi e t’u garantohet paprekshmëria*”<sup>337</sup>.

Në kuadrin e vendimeve më kryesore të Kongresit të Elbasanit, nuk mund të lemë pa përmendur edhe disa nga vendimet e tjera po aq të rëndësishme që u morën në Kongres, midis të

<sup>335</sup> AQSH, F. 102, Dos. 67. fl. 1. Letër me shkrim dore, Korçë 25 Vjesht’ e I -rë 1909.

<sup>336</sup> Lef. Nosi, *Dokumente historike për ti shërbyer historisë sonë kombëtare*, material depozituar në AME.

<sup>337</sup> Po aty.



cilëve vendimin që përcaktonte klubin shqiptar të Manastirit me statusin e klubit qendror të klubeve shqiptare.<sup>338</sup> Ky klub, si detyrë kryesore do të kishte hartimin e një programi të përbashkët për të gjithë klubet shqiptare dhe përpjekjet e tij për futjen e mësimin shqip në shkollat qeveritare turke në Shqipëri.

Por sikurse konstatohet nga dokumentacioni i kësaj periudhe, një vendim i tillë gjeti kundërshtimin e vendosur të Mithat Frashërit, i cili në Kongres deklaroi se nuk e njihte klubin e Manastirit si klub qendror.<sup>339</sup> Në këtë Kongres, Mithat Frashëri e shprehu hapur armiqësinë ndaj Austrisë nëpërmjet fjalëve: “*Armiku ynë më i madh është Austria, poshtë me Austrinë.*” Ndërkaq, në të njëjtin burim përsa i përket qëndrimit të Mithat Frashërit në Kongres, Konsulli A-H i Durrësit Pallanz shprehet: “*... Mithat beu ishte veçanërisht shumë i prekur për pritjen e ftohtë që iu bë në Elbasan. Si qëndrimi i tij miqësor kundrejt xhonturqve ashtu dhe refuzimi i tij për ta njohur Klubin shqiptar të Manastirit si klub qendror, që buronte nga motive egoiste, i kishte dëshpëruar shumë delegatët. Edhe fakti se ay tërheq nga xhonturqit një ndihmë mujore prej 15 lirash turke, duket se nuk është i panjohur në Elbasan*”<sup>340</sup>.

Një ndër vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Elbasanit ishte vendimi për shkrimin e shqipes me dialektin elbasanas. Për këtë problem në dokumentin përkatës të Kongresit thuhej: “*Prej të gjithë publicistëve dhe zhurnalistëve shqiptarë kërkohet që paskëtaj të shkruajnë në dialektin e Elbasanit, mbasi atë e kuptojmë mirë si toskët dhe gegët*”<sup>341</sup>.

Gjithashtu, delegatët në Kongres duke ju referuar kushteve konkrete të zhvillimit të ekonomisë shqiptare ku dominonte ekonomia bujqësore, e panë të arsyeshme që në një nga vendimet e tij të përfshinin edhe kërkesën që popullsia e vilajeteve shqiptare do ti drejtonte qeverisë për hapjen e një shkolle bujqësore në ato pjesë të Shqipërisë ku nevojat ishin më të mëdha<sup>342</sup>. Por ky projekt mbeti i parealizuar.

Në kuadrin e problemeve që u trajtuan nga delegatët në Kongresin e Elbasanit, nuk mund të lemë pa përmendur edhe trajtimin në të, të kërkesës që vinte nga misionarët protestantë të Korçës dhe Tiranës. Një kërkesë e tillë jo pa qëllim nuk është përmendur më parë nga historia e

---

<sup>338</sup> *Akte të Rilindjes kombëtare shqiptare 1878-1912*, botim i Institutit të Historisë, Tiranë: 8 nëntori, 1978, 200.

<sup>339</sup> *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, vepër e cituar, 382. Konsulli austro - hungarez i Manastirit raporton se vetëm prestigji i familjes Frashëri e shpëtoi Mithat Frashërin nga të rrahurit, gjithashtu Mithat Frashëri desh të shënojë një protestë kundër caktimit të klubit të Manastirit si klub qendror, por shkaktoi një indijatë aq të madhe sa hoqi dorë nga ky qëllim( 385)

<sup>340</sup> *Po aty*, 383.

<sup>341</sup> *Akte të Rilindjes kombëtare shqiptare*, vepër e cituar, 200.

<sup>342</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 416.

regjimit të kaluar. Qëllimi kryesor i kërkesës së tyre konsistonte në shkëputjen ortodoksëve shqiptarë nga ndikimi i klerit grek dhe Patriarkanës greke.<sup>343</sup> Një kërkesë e tillë mendojmë se parakuptonte faktin e krijimit të një kishe të pavarur shqiptare. Por kjo kërkesë u konsiderua nga delegatët e tjerë të Kongresit si e parakohshme dhe e përsheptuar kohën. Gjithashtu, edhe propozimi tjetër i tyre që në shkollën pedagogjike të mos lejohej mësimi i fesë nuk gjeti përkrahjen e shumicës së delegatëve të Kongresit.

Në përfundim të punimeve të veta, delegatët e kongresit hartuan një shkresë turqisht, që do t'i drejtohej mytesarifit të Elbasanit. Në të evidentohej qartë qëllimi i Kongresit Kombëtar të Elbasanit e kërkohej njëkohësisht respektimi i të drejtave kombëtare të shqiptarëve. Për hartimin e një dokumenti të tillë, Kongresi krijoi një komision të përbërë nga zotërinjtë Mithat Frashëri, Qemal bej Elbasani, Abdurrahim Kavaja, Emin Haxhiademi dhe Haxhi Bajrami. Kongresi i Elbasanit vendosi që një javë pas mbylljes së punimeve të tij, më 14 shtator 1909, të hapej në Elbasan Shkolla Normale ose, siç u quajt në dokument “Mësonjëtorja e mësonjësve”.

Ndërkaq, duhet thënë se jehona që pati Kongresi i Elbasanit, për nga rëndësia e vendimeve që mori pasqyrohet në këtë kohë në faqet e shtypit të kohës.<sup>344</sup>

E përkohshmja “*L’Italia all’estero*” me titullin “*Një kongres i shqiptarëve*” ndër të tjera thekson se: “*Në Elbasan u mbajt një kongres i madh ku muarnë pjesë shqiptarë të shkëlqyer me qëllim që të bisedojnë dhe të venë ndë udhë të gjitha ato që janë të nevojshme për përparim dhe paqen e Shqipërisë*”<sup>345</sup>.

Kështu, ndër vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Elbasanit do të konsiderohet hapja e një shkolle Normale, përgatitjet për të cilën do të rezultojnë të menjëhershme. Kështu, në 6 shtator 1909 në letrën që kryesia e Kongresit të Elbasanit do t'i drejtojë pleqësive të klubeve të Elbasanit, “*Bashkimi*”, “*Vllaznia*” dhe shoqërisë “*Afërdita*”, do ti rekomandonte formimin e një Pleqësie për shkollën Normale të përbërë prej 8 personash, e cila në bashkëpunim me drejtorin e shkollës do të kujdesej për emërimin e mësuesve dhe shumë probleme të tjera të rëndësishme.<sup>346</sup> Kështu, Kongresi do të njoftohet për formimin e “*Pleqësisë kujdestare për shkollën e mësonjësve*” një ditë më pas në 7 shtator 1909, në përbërje të të cilës u zgjodhën 8 persona, që të gjithë rezultojnë nga Elbasani e më konkretisht: Dervish bej Biçakçiu (kryetar), Hysen Ceka,

<sup>343</sup> HHSTA/ PA. Vjenë, raport dërguar nga konsulli austro-hungarez Pallanz, Durrës, Nr. 65 Ref/I, 14 shtator 1909.

<sup>344</sup> *Normalja në traditë*, vepër e cituar, 48.

<sup>345</sup> “*L’Italia all’estero*”, Roma, 1920 vjeshtë e parë, nr.18.

<sup>346</sup> Sh. Demiri, *Elbasani, qendër e lëvizjes kombëtare*, material i depozituar në muzeun historik, Elbasan, Kutia. 14, nr. 8, 12.

Lef Nosi, Emin Haxhiademi, Dhimitër Buda, Petër Dodbiba, Dhimitër Paparisto dhe Ahmet Dakli<sup>347</sup>.

Me shumë vlerësim për Kongresin e Elbasanit do të shprehet dhe patrioti i njohur, arbëreshi A. Lorekio, i cili në *“La nazione Albanese”* në artikullin me titull *“Kongresi gjuhësor shqiptar në Elbasan”* thotë se: *“ Kongresi i Elbasanit ka qenë, dhe e përsërisim me kënaqësi në homazh të së vërtetës, pohimi më i lartë i intelektit shqiptar, shprehja më e lartë dhe më praktike e tij... ”. Kushti i parë dhe i domosdoshëm është që të ketë në shërbim një numër mësuesish dhe madje ky qe problem numër një, që iu shtrua folësve në Kongresin e Elbasanit. Ata njerëz të mençur vendosën të formojnë një shkollë normale, e aftë si në të gjitha vendet e qytetëruara të përballojë me specialistë dhe mësues filloreje”*<sup>348</sup>.

---

<sup>347</sup> Po aty.

<sup>348</sup> *“La nazione Albanese”*, Catanzaro, nr.19, 15 tetor 1909.

## **II. 4. Normalja e Elbasanit dhe problemet arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1910-1912.**

Me përfundimin e punimeve të Kongresit të Elbasanit, detyra më e rëndësishme për patriotët shqiptarë konsistonte në zbatimin e vendimeve të tij. Parë në këtë këndvështrim, pohojmë se në këtë kohë duke marrë në konsideratë nivelin e prapambetur ekonomik, e një rëndësie të veçantë rezultonte sigurimi i fondeve financiare, pa të cilat nuk mund të zbatoheshin vendimet e Kongresit të Elbasanit për më tepër të hapej dhe shkolla Normale. Një problem i tillë nuk kaloi pa rënë në sy të konsujve të huaj që në këtë kohë ishin vëzhgues të mprehtë të zhvillimit të ngjarjeve në Shqipëri. Kështu, konsulli austro-hungarez i Manastirit duke qenë skeptik për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Elbasanit do të shprehej se: *“Në përgjithësi mund të themi se Kongresi i Elbasanit nuk do t’i plotësojë aspak shpresat që kanë tek ai për çështjet kulturele, për arsye se zbatimi i vendimeve të Kongresit dhe sidomos hapja e një normale qysh në fillim do të hasë në vështirësi materiale.”*

Një pohim i tillë fillimisht do të gjejë konfirmim përmes faktit se Shkolla Normale nuk do të hapet në datën e përcaktuar nga Kongresi i Elbasanit dhe as në datën e lajmëruar nga “Këshilli mbikëqyrës të Normales”<sup>349</sup>. Porse një situatë e tillë do të rezultojë e përkohshme dhe shkolla Normale do të hapë dyert e saj në 1 dhjetor të vitit 1909. Procesi i rregullt mësimor do të fillojë në 2 dhjetor fillimisht me një kapacitet prej 50 nxënësish<sup>350</sup>.

Një ngjarje e tillë do të konsiderohej produkt i kontributit të pandërprerë për një periudhe afro tre muajore të “Këshilli Mbikëqyrës” të Normales dhe shoqërisë “Përparimi”. Kështu, përfundimisht pas shumë përgatitjesh pasi u kapërcyen jo pak pengesa e probleme të natyrave të ndryshme organizative dhe financiare, patriotët e shqiptarë me mbështetjen e vetë popullit të

---

<sup>349</sup> Data e parë e vendimit të Kongresit të Elbasanit për hapjen e shkollës Normale ishte 14 shtatori dhe data e dytë e lajmërimit nga “Këshilli Mbikëqyrës”, sipas informacionit të gazetës “Lirija”, ishte 17 nëntori.

<sup>350</sup> “Lirija”, nr. 64, Selanik, 1909, f. 2.

Elbasanit, arritën të hapin në Elbasan shkollën e parë të mesme në gjuhën shqipe brenda vendit, Shkollën Normale. Themelimi i kësaj shkolle përfaqëson kurorëzimin e përpjekjeve të pareshtura të patriotëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit.

Ndër mësuesit e parë të shkollës Normale do të ishin; Luigj Gurakuqi, drejtori i parë i saj (që jepte gjuhën shqipe në klasën 2,3); Aleksandër Xhuvani që jepte (gjuhën shqipe, histori dhe gjuhë frënge); Petër Dodbiba; H. Blloshmi; Simon Shuteriqi; Dh. Papparisto; Hasan Mezja dhe Hafiz Ibrahim Dalliu nga Tirana. Trupa pedagogjike e cila drejtonte shkollën përfaqësonte elitën intelektuale shqiptare.<sup>351</sup> Gjithashtu, në cilësinë e të dërguarit të Federatës Shqiptare “VATRA” të Bostonit, do të jetë Sotir Peci që do të japë matematikë – fizikë<sup>352</sup>.

Sikurse edhe pritej që në vitin e parë të hapjes së saj Normalja do të ndeshë në një sërë problemesh dhe vështirësish. Një ndër problemet me të cilat u përballën fillimisht mësuesit e Normales ishte mungesa e teksteve mësimore, problem ky që do të gjejë pasqyrim edhe në shtypin e kombëtar të asaj kohe. Në thirrjen që u bëhej intelektualëve shqiptarë e sidomos mësuesve të Normales së Elbasanit, thuhej: *“Bekim i madh e lumturi e paanët do të jetë për kombin tonë në qoftë se secili prej të diturit tonë do të punojë për ndonjë të këtillë vivllë, dhe veçan profesorët e shkollës Normale, se prej tyre kombi pret dritën e madhe e jo vetëm për çunat që gjenden në këtë skoli, por edhe për gjithë ata që mësojnë, ose të mëdhenj janë këta, ose të vegjël”*<sup>353</sup>.

Përmes burimeve të huaja duhet thënë se në këtë kohë evidentojnë gjithashtu edhe përpjekjet e xhonturqve për të imponuar zgjedhjen e strukturave drejtuese të Normales. Kështu, në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi xhonturqit do të përpiqen të emërojnë si drejtor të Normales një drejtor mysliman ndërkohë që mendimi i patriotëve shqiptarëve ishte për të emëruar një drejtues të krishterë<sup>354</sup>. Mendojmë se një zgjedhje e tillë nga patriotët shqiptarë synonte më së shumti të frenonte përpjekjet e xhonturqve për të kontrolluar drejtimin e një shkolle shqipe.

Në këtë kuadër, nuk është rastësi që si drejtori i parë i Normales do të emërohet një katolik jo elbasanas i cili dispononte kapacitetet dhe përvojën e duhur në fushën e arsimit. Kështu, pas refuzimit që Bajo Topulli do t’i bëjë ofertës për të drejtuar Normalen, si drejtor i

---

<sup>351</sup> “Normalja në traditë”, vepër e cituar, 63.

<sup>352</sup> Charles Telford Erickson, *Shqiptarët Enigma e Ballkanit*, vëll. II, përgatit Mal Berisha, Edualba 2012, 116.

<sup>353</sup> “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”, vepër e cituar, 88-89

<sup>354</sup> Charles Telford Erickson, *Shqiptarët Enigma e Ballkanit*, vepër e cituar, 116.

“Këshillit Përmbikëqyrës” të saj do të zgjidhet Luigj Gurakuqi, i diplomuar në Itali për shkencë natyrore dhe filozofi dhe njëkohësisht autor i një sërë botimeve shkollore e letrare. Me statusin e drejtorit, ai do të përpiqej në krijimin e një stafi mësimor të kualifikuar profesorësh dhe intelektualësh të cilët edhe më parë kishin kontribuar në çështjen e arsimit brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë kontekst, informohemi për ftesën që L. Gurakuqi do t’i drejtojë A. Xhuvanit për të qenë pjesë e stafit të Normales duke u shprehur se: “*Duke të njohur vlerat si gjuhëtar, mësues patriot i përkushtuar, un këmngul që ti të jesh pjesë e shkollës tonë kombëtare, sepse kjo shkollë ka nevojë për njerëz si ju dhe besoj që ftesa ime të pranohet*”<sup>355</sup>. I entuziazmuar për përgjigjen pozitive të Aleksandër Xhuvanit ai do të pohonte: “*Jam shumë i lumtur shkruante ai në letrën e datës 24 tetor 1909 që Aleksandri më dëgjoji arsyet e mia dhe që të jetë dhe ai pjesë e shkollës Normale*”<sup>356</sup>. Kështu, Aleksandër Xhuvani do të emërohet mësues i gjuhës shqipe në shkollën Normale të Elbasanit. Ai ishte diplomuar në shkencat filologjike, kishte punuar si profesor i gjuhës shqipe në kolegjin e Arbëreshëve të Italisë në San Dometrio Korone dhe ishte bërë i njohur në fushën e studimeve gjuhësore nëpërmjet botime të ndryshme në shtypin e kohës. Stafi pedagogjik i parë i Normales përfaqësohej nga intelektualë të shquar në fushën e kulturës dhe të arsimit kombëtar. Intelektualët e parë elbasanas që dhanë mësim në Normale përfaqësoheshin nga Aleksandër Xhuvani, Petër Dodbiba, Simon Shuteriqi, Hasan Mezja, Dhimitër Paparistoja.<sup>357</sup> Gjithashtu një nga mësuesit e shquar të shkollës Normale ishte dhe Sotir Peci i diplomuar në Greqi për matematikë – fizikë, i njohur si drejtor i gazetës “Kombi”<sup>358</sup>.

Si një institucion arsimor mbarëkombëtar, Normalja përfshiu në të nxënës nga të gjitha trevat shqiptare. Është i dukshëm fakti i rritjes së kapacitetit të Normales me nxënës të cilët braktisnin shkollat e mesme turke në Elbasan, Janinë dhe mbushnin radhët e saj. Shkolla Normale e nisi veprimtarinë e saj në mes shumë vështirësish të karakterit ekonomik, të mungesës së përvojës, të mungesës së bazës materiale si dhe shumë pengesa të natyrës sociale e politike.

Fillimisht Normalja u hap në ndërtesën e Servet Bej Zylfit, sikurse kishte vendosur Kongresi i Elbasanit dhe e filloi aktivitetin e saj me një kapacitet prej 50 nxënësish. Por, pas 3 muajsh konstatohet një dyfishim i numrit të nxënësve dhe në fund të vitit numri i tyre arriti në

<sup>355</sup> AQSH, Fondi L. Gurakuqi, Dos. 55, letër e datës 24 tetor 1909.

<sup>356</sup> Po aty.

<sup>357</sup> AQSH, Fondi. 102, Dos. 63, f. 4.

<sup>358</sup> “Dielli” nr. 40, Boston, 31 dhjetor 1909, f. 1-2.

150 nxënës. Një pjesë e këtyre nxënësve edhe pse mund të ishin në vitin e fundit në shkollat e tyre përsëri i braktisën ato për të kaluar në shkollën Normale<sup>359</sup>.

Në vendimet e Kongresit të Elbasanit dhe në rregulloren e shkollës Normale të miratuar prej tij parashikohej që kjo shkollë të kishte 6 klasë, ku tri klasë të ishin përgatitore dhe tri klasë thjesht normale. Por nga vendimi që u mor nga “Këshilli Mbikëqyrës” në vitin e parë u hapën katër klasë, ku tre prej të cilave ishin përgatitore dhe vetëm një ishte normale.<sup>360</sup> Kështu, në dhjetor të vitit 1909 Aleksandër Xhuvani shkruante: “*Mjerisht nuk gjetëm element për të parin rend të Normales u detyruam pra që të mbajmë sivjet vetëm tri rendet e shkollave premtare*” (përgatitore)<sup>361</sup>. Në momentin që erdhën nxënësit e parë u vu re që mund të hapeshin vetëm 3 klasa të kursit “premtar”. Në kursin “premtar” do të hynin nxënësit që kishin mbaruar vetëm shkollën fillore, ndërsa në klasën e dytë dhe të tretë do të hynin ato që kishin kryer edhe klasë më të larta në shkollat qytetare ose të mesme të huaja<sup>362</sup>.

Pavarësisht faktit se pjesa më e madhe e nxënësve që u regjistruan në Normale kishin studiuar më parë në shkolla të huaja, rezultonte se shumë prej tyre dinin të shkruanin dhe të lexonin në shqip. Por, kishte dhe nga ata nxënës që nuk kishin pasur mundësi që në mënyrë klandestine ta mësonin atë. Në këtë kuadër, për të krijuar kushte më të favorshme në mësimdhënie, “Këshilli Mbikëqyrës” vendosi që të hapte provizorisht një kurs të veçantë 3-4 mujor pikërisht për këto nxënës që të mësonin të shkruanin e të lexonin shqip, dhe më pas të kalonin në klasën e parë të “premtares”. Përveç nxënësve që erdhën nga të gjitha rrethet e vendit pati dhe shumë të tjerë që erdhën nga Kosova. Për të bërë të mundur ardhjen e këtyre nxënësve nga Kosova një ndihmë të madhe dha atdhetari i njohur Hasan Bej Prishtina i cili u përpoq gjatë tërë jetës së tij për Shqipërinë e bashkuar dhe gjuhën shqipe. Sikurse konstatohet nga burimet e kohës, një numër jo i vogël nxënësish shqiptarë, u larguan nga shkollat turke për të vazhduar Normalen, që gjatë vitit të parë mësimor të hapjes së saj. Ky largim evidentohet edhe nga Shkollat e Stambollit. Në këtë kontekst, informohemi se Ali Çausi rezulton të ketë qenë i pari elbasanas, i cili djalin e tij e largon nga gjimnazi turk i Elbasanit (megjithëse në klasë të fundit) dhe e regjistron në Shkollën Normale<sup>363</sup>.

---

<sup>359</sup> AQSH, Fondi. “Lef Nosi”, Dos. 50, f. 1.

<sup>360</sup> Gazeta “Bashkimi i Kombit”, nr.6, Manastir, 15 vjeshtë e II, 1909, f. 2

<sup>361</sup> AQSH, Fondi. “Lef Nosi”, nr. 32, Dos. 60/1, 20, letër e datës 26 dhjetor 1909.

<sup>362</sup> A. Xhuvani, “*Fjalim i mbajtur me rastin e 25 vjetorit të shkollës Normale*”, 5. A. Xhuvani, “*Historia e Normales së Elbasanit*”, në “Shkolla Kombëtare”, Tiranë: 1937, nr. 5, 13,

<sup>363</sup> AQSH, Fondi. 102, Dos. 50, f. 1.

Përmes faqeve të gazetës “Lirija” informohemi se në dhjetor të vitit 1910 për të vazhduar mësimet në shkollën Normale, u larguan nga Janina 8 nxënës, nga Delvina 2 nxënës dhe nga Përmeti 2 nxënës.<sup>364</sup> Gjithashtu edhe në një artikull botuar në gazetën “Zgjimi i Shqipërisë” thuhet: “Tetë djem shkuan nga idadija e Janinës për në Mësonjëtoren Normale të Elbasanit, pa dhe të tjerë përgatiten të shkojnë. Djemtë që iknë nga idadija iknë nga dëshira që patnë të venë ndë Shkollë Normale të Elbasanit”<sup>365</sup>.

Në këtë kuadër, në Shkollën Normale filluan studimet nxënës që vinin nga të gjitha trevat shqiptare si nga Prishtina, Gjakova, Peja, Prizreni, Mitrovica, Gjilani, Presheva, Shkupi, Dibra, Struga, Pogradeci, Shkodra, Kruja, Tirana, Gjirokastra, Përmeti, Delvina, Libohova etj.<sup>366</sup> Parë në këtë këndvështrim, sikurse ishte vendosur dhe nga Kongresi i Elbasanit, lindi si domosdoshmëri ngritja pranë saj e një konvikti që do të funksiononte me pagesë. Në Programin Shkollor të Normales për sa i përket administrimit të financave thuhej se: “Këshilli i Kontrollit ka në dispozicion 100 lira në vit që do t’i përdorë për të ndihmuar nxënësit ose kandidatët e vobektë. Ata nxënës që duan të banojnë në konviktin e shkollës, do të paguajnë 10 lira në vit. Por Këshilli i Kontrollit... mund edhe ta falë taksën për konvikt. Në këtë rast zbritja e pagesës së konviktit pjesërisht ose e tërë do të mbulohet prej atyre 100 lirave”<sup>367</sup>.

Kështu, nga 150 nxënës që kishte Normalja në vitin e parë, 71 prej tyre rezultonin të ishin konviktorë, ndërsa të tjerët të jashtëm. Një pjesë e tyre ishin me dhe pa pagesë. Për ta bërë sa më efektiv mësimin në konvikt u organizua edhe studimi i rregullt për studentët e brendshëm. Ndërkohë që nga të dhënat e marra përmes informacionit të konsullit austro-hungarez në Durrës rezulton se numri i nxënësve të Normales në vitin e parë ishte 160.<sup>368</sup>

Largimi nga shkollat e huaja dhe ardhja në Normale e nxënësve edhe nga skajet më të largëta të trevave shqiptare në fillimin e stinës së dimrit, ishte tregues jo vetëm i dëshirës së të rinjve shqiptarë dhe të prindërve të tyre për të mësuar në gjuhën amtare e për ti shërbyer arsimit kombëtar, por njëkohësisht evidentonte edhe përpjekjet e shumta dhe punën propagandistike të patriotëve të Rilindjes për forcimin e ndjenjave kombëtare dhe për rrënjosjen e dashurisë për gjuhën e shkollën shqipe.

---

<sup>364</sup> Gazeta “Lirija”, 19 shëndre 1909.

<sup>365</sup> Gazeta “Zgjim i Shqipërisë”, nr.53, Janinë, 30 vjeshtë III, 1909.

<sup>366</sup> Gazeta “Tomorri” nr. 2, Elbasan, 20 mars 1910, f. 2: “Lirija”, nr. 84, Selanik, 17 prill 1910, f. 2.

<sup>367</sup> HHSTA/PA. Raport i konsullit të Durrësit, Nr. 19. dt. 27 maj 1910. *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, vep. cit. 395.

<sup>368</sup> Po aty.



Përveç nxënësve që patën fatin të vazhdonin mësimet në Normale, pati edhe shumë nxënës të tjerë nga vise të ndryshme të Shqipërisë, që shprehën dëshirën dhe kërkuan të regjistroheshin në të, por që nuk u pranuan për shkak të pamundësisë për ti strehuar në Elbasan, prandaj mbetën për vitin e ardhshëm shkollor. Ja çfarë shkruan konsulli austriak i Durrësit për këtë problem : *“Numri i nxënësve sot është aq i lartë sa që në Elbasan nuk mund të gjenden as klasa mësimi të mëdha e të mjaftueshme, por as vende për vendosjen e bursistëve. Sikur të merreshin parasysh të gjitha lajmërimet, që vazhdojnë të bëhen gjithnjë, atëherë do të duhej që në fillim të vitit të ardhshëm shkollor të gjendej vend të paktën për 1000 nxënës, prej të cilëve 600 konviktorë”*<sup>369</sup>.

Kuptimplotë dhe me rëndësi është fakti që në vitin e parë shkollor të normales 50 nxënës ishin nga Kosova, pra pothuajse 1/3 e numrit të përgjithshëm të tyre. Duhet theksuar se një punë e madhe në këtë drejtim u bë nga klubet kombëtare dhe patriotët kosovarë e sidomos klubi shqiptar i Shkupit dhe Hasan Prishtina i cili nuk kursente “as kohën, as pasjen e tij” dhe zotohej se do të dërgonte në Normale edhe shumë “shumë të tjerë”<sup>370</sup>.

Hasan Prishtina e çmonte shumë Normalen jo vetëm si një vatër arsimit e kulture kombëtare, por ai e quante Normalen *“qendra e parë e vëllazërimit të rinisë shqiptare”*<sup>371</sup> duke e konsideruar edhe si një vatër politike ku nxënësit do të mbusheshin plot dashuri për atdheun. Sigurisht që këto nxënës, ashtu si dhe nxënësit e krahinave të tjera, nuk erdhën të tërë njëherësh, por në kohë të ndryshme, pothuajse gjatë tërë vitit shkollor. Nxënësit e parë që erdhën nga Kosova ishin 7 djem dhe më pas gjatë vitit u pasuan dhe nga shumë të tjerë.

Në shtypin shqiptar të kohës është pasqyruar ardhja e nxënësve nga Kosova si dhe pritja vëllazërore që u bëhej atyre nga mësuesit e Normales dhe nga popullsia e Elbasanit. Situata e ngrohtë në pritjen e nxënësve nga Kosova gjen shprehje përmes fjalëve të L. Gurakuqit i cili në atë kohë pohonte se: *“Nuk asht nevoja t'ua them me gojë, pse as nuk mundem t'ua rrëfenj me fjalë harenë e madhe, që na dëgjon zemra në ditë të sotme; ju vetë ta këndonit më mirë ndë sytë e fytyrat tona, mund ta kuptoni nga kjo shumicë njerëzish, prej më të parëve e më të mirëve t' Elbasanit, që ju kanë dalë përpara për t'u prituri...”*<sup>372</sup>.

---

<sup>369</sup> HHSTA/PA. Raport i konsullit Austo-Hungarez të Durrësit, Nr.19, dt.27 maj 1910. *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, vep. cit. 395.

<sup>370</sup> Gazeta “Dielli”, Nr.52, Boston, 25 mars 1910, f. 2. Pseudonimi ishte “Shkam i Letanit”.

<sup>371</sup> A. Haxhiu, “*Hasan Prishtina*”, Tiranë: 1964, 17.

<sup>372</sup> Murat Gecaj, *Normalja e Elbasanit, Universiteti i parë shqiptar vatër e zjarritë atdhetare për arsimin tonë kombëtar*, Tiranë: 2009, 30.

Gjithashtu edhe në faqet e gazetës “Dielli” L. Gurakuqi do të shprehej shprehej se: “ *Ka ardhun një ditë, dhe nuk ash e largët, kur me një dituri të vërtetë dhe me themel, me një arsim krejt kombëtar, do të dritësohet dhe do të marrë rrugën e qytetërimit gjithë ajo Kosovë burrërore, gjithë ai vend i atdheut të dashun, ku kanë shkëlqyer kurdoherë besa më e madhe dhe trimnia më e rrallë, me të cilat asht pajuar kombi shqipëtar*”<sup>373</sup>.

Ndërkaq, që pati një rritje të shpejtë të numrit të nxënësve në vitin e parë të saj, kërkesa të shumta kishte edhe për vitin e ardhshëm shkollor. Shumica e nxënësve që vinin nga vise të ndryshme të Shqipërisë nuk u pranuan në vitin e parë shkollor, pikërisht nga pamundësia për ti strehuar. Kjo pjesë e nxënësve do të përbënte kontingjentin e Normales për vitin e dytë.

Drejtuesit e shkollës Normale që në vitin e parë të krijimit të saj do të tregohen tepër të kujdesshëm në hartimin e një programi mësimor duke respektuar kriteret shkencore, metodike dhe pedagogjike. Fillimisht programi mësimor përfshinte këto lëndë mësimore; gjuhë e letërsi shqipe, diturinë mbi fenë( fe muhamedane, fe e krishterë), matematikë, histori, shkenca të natyrës, gjeografi, logjistikë, mësim gjanash, bukurshkrim, gjimnastikë, këngë. Nga gjuhët e huaja të detyrueshme përveç shqipes ishin: gjuha turke dhe gjuha frënge,<sup>374</sup> ndërsa greqishtja dhe anglishtja, sipas dëshirës së nxënësve.<sup>375</sup> Veç këtyre, që në klasën e parë të Normales mësoheshin edhe bazat e filozofisë dhe shkencat pedagogjike.

Me sugjerimin e Aleksandër Xhuvanit përveç lëndëve të planifikuara nga Komisioni i Normales, u konsiderua e nevojshme edhe përfshirja në programin mësimor të saj edhe disa lëndë të tjera sikurse ishin: morali i përfshirë te pjesa letrare, bujqësia e përfshirë tek pjesa shkencore, kaligrafia e përfshirë tek pjesa e artit si dhe shëndetësia<sup>376</sup>. Gjithashtu edhe në vitet në vazhdim programi mësimor i Normales do të pësojë ndryshime dhe modifikime në funksion të përshtatjes së tij me shkollat më të mira ekzistuese. Por kuptohet që nga cilësia e hartimit të tij që në vitin e parë të Normales do të varej më së shumti edhe funksionimi i kësaj shkolle dhe synimi për ta shndëruar atë në një shkollë të nivelit dhe standardeve të larta dhe për ta ngritur atë mbi nivelin e shkollave osmane.

Në vitin e parë mësimor të Shkollës Normale një kontribut të madh do të japin vetë mësuesit e shkollës, të cilët punuan me plane mësimore të veçantë të hartuar prej tyre duke u

<sup>373</sup> Gazeta “Dielli”, nr. 60, Boston, 20 mars 1910, f. 4.

<sup>374</sup> Gazeta “Tomori” nr. 11, Elbasan, 20 qershor 1910, f. 2.

<sup>375</sup> Gazeta “Korça” nr. 15, Korçë, vjeshtë e dytë 1909, f. 4.

<sup>376</sup> “Dielli”, Boston, 26 nëntor 1909, artikull i A. Xhuvanit nën pseudonimin Komneni.

mbështetur si në vendimet e Kongresit ashtu edhe në planet mësimore të shkollave perëndimore. Në kuadrin e kushteve specifike të funksionimit të Normales, mësuesit e shkollës me përvojën dhe kapacitetet e duhura më së shumti do të synonin në përshtatjen e planeve mësimore me nivelin e grupit të nxënësve që ishin paraqitur në vitin e parë të hapjes së shkollës Normale. Në këtë kuadër, për ti paraprirë problemeve që mund të lindnin për atë pjesë të nxënësve që kishin probleme me gjuhën shqipe, paralelisht u ngrit një shkollë fillore në gjuhën shqipe, posaçërisht për krijimin e kontigjentit të ardhshëm të shkollës.

Gjithashtu, që në vitin e parë të hapjes së shkollës Normale evidentohet gjithashtu mungesa e teksteve mësimore. Duhet thënë se Shkolla Normale u hap në një kohë kur nuk ekzistonte pothuajse asnjë tekst mësimor për lëndët që do të zhvilloheshin në të dhe kur ishte përpunuar vetëm pjesërisht terminologjia shkencore. Në këtë aspekt Normalja u shndërrua në një laborator për shqipërimin e përpunimin e terminologjive përkatëse, duke hedhur themelet për hartimin e teksteve të para për lëndët e ndryshme mësimore. Problemi i teksteve mësimore dhe i përpunimit të terminologjisë përkatëse shkencore sikurse shprehet studiuesi Mahir Domi, u bë duke ju referuar Kristoforidhit, Naimit, Samiut, me një kujdesje të madhe për pastërtinë e gjuhës sonë, duke krijuar fjalë të reja me brumin e shqipes<sup>377</sup>. Në këtë mënyrë gradualisht u plotësua mungesa e teksteve shkollore të Normales së Elbasanit gjatë vitit të parë shkollor dhe njëkohësisht u punua dhe për përgatitjen dhe botimin e teksteve të plota mësimore. Duke qenë se mësuesit e shkollës Normale rezultonin profesionalisht të kualifikuar nga ana shkencore dhe pedagogjike, ju ngarkua detyra e hartimit jo vetëm të teksteve për Normalen por edhe për shkollat e niveleve më të ulëta. Përveç teksteve shkollore, gjatë vitit të parë të saj Normalja u pajis edhe me mjete mësimore për lëndët shkencore duke konkurruar në këtë drejtim dhe gjimnazet turke. Një fakt i tillë e rriti dhe më tepër nivelin e Normales, duke e kthyer përveç të tjerave dhe si një qendër për përhapjen e metodave të reja pedagogjike<sup>378</sup>.

Duhet thënë se tipar i Normales ishte karakteri laik i saj, që gjente pasqyrim si në përmbajtjen e planit mësimor duke shprehur njëkohësisht frymën e bashkimit pa dallim feje dhe krahine, që përshkonte gjithë procesin mësimor-edukativ, ashtu edhe në faktin që për themelimin e mbajtjen e saj kontribuan shqiptarë të të gjitha besimeve fetare përfaqësues të të cilëve ishin dhe mësuesit dhe nxënësit e shkollës Normale. Një fakt i tillë konfirmohet edhe përmes

---

<sup>377</sup> Mahir Domi, *Shkolla Normale ...*, vepër e cituar, 11.

<sup>378</sup> V. Konomi, "Gjysem Shekulli", botuar në revistën "Nëntori", nr. 12, Tiranë: 1959, 108.

pohimeve të konsullit italian të Manastirit, ku sipas tij në mendimet e vetë themeluesve të saj kjo shkollë destinohet të ishte “*vatër e propagandës kombëtare shqiptare*”.<sup>379</sup> Anglezja Edith Durham, duke folur për Normalen e Elbasanit, thekson se ajo kishte “personel myslimanë e të krishterë” dhe kujton vargjet e njohura të vjershëtorit: “Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë! /S’na ndanë as kisha as xhamia/Feja e Shqiptarit është Shqiptaria”<sup>380</sup>.

Karakteri laik ishte një nga arsyet që qysh në fillim Normalja e Elbasanit nuk u pa me sy të mirë nga xhonturqit dhe nga elementët konservatorë e fanatikë. Me kontributin e tyre mësuesit patriotë të Normales jo vetëm realizuan programin e saj mësimor e shkencor, por e shndërruan këtë shkollë në një propaganduese të zjarrtë të ideve kombëtare, nevojës së bashkimit të popullit shqiptar, e shndërruan një vatër të forcimit të ndjenjave kombëtare dhe të shqiptarizimit. Ato punonin për të edukuar brezin e ri më frymën kombëtare kundër ndikimeve të propangandave të huaja kombëtare dhe fetare.

Kuptimplotë ishte dhe fakti që sipas vendimit të marrë nga “Këshilli Mbikqyrës” i Normales, në fillim të vitit 1910 nxënësit dhe mësuesit e kësaj përcaktuan edhe uniformën e shkollës, duke vënë qeleshe të bardha me qëllim që të ruhej tradita kombëtare në funksion të forcimit të ndjenjës kombëtare. Arritjet e shënuara gjatë vitit të parë në Normale përbënin një sukses të madh jo vetëm për mësuesit dhe nxënësit e saj por për të gjithë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Të gjitha këto përparime po bëheshin nën një presion të madh dhe në një kohë që dhe marrëdhëniet me xhonturqit sa vinin e ashpërsoheshin. Vetë themelimi i shkollës Normale kishte qenë, siç shkruan konsulli austriak i Manastirit: shprehje e “gatishmërisë” për sakrificë dhe e etjes për kulturë nga ana e shqiptarëve” dhe se të gjithë shqiptarët ishin “tepër kryelartë për shkollën e tyre Normale” dhe e shikonin atë “si një nga kështjellat e tyre të larta nacionaliste”<sup>381</sup>.

Në revistën Normalisti thuhej: “*Ishte hera e parë që të gjithë landët e mësimevet po baheshin në gjuhë shqipe, dhe e mbaj mend se kemi heqë munxë të madhe tue i hartue e tue i shkrue gjithë landët e mësimevet shqip e tue ua spjegue nxanësve*”<sup>382</sup>.

Viti i parë mësimor i shkollës Normale u mbyll me sukses në qershor të vitit 1910.<sup>383</sup> Përsa i përket entuziazmit që do të shoqërojë një eveniment të tillë Abedin Çausi do të shprehet: “*Oborri i shkollës Normale të Elbasanit gumëzhinte si bleta nga gjallëria e nxënësve fytyrë çelë,*

<sup>379</sup> Raport i konsullit Italian të Manastirit, Nr. 22/7 datë 10 shkurt 1910.

<sup>380</sup> Edith Durham, “*Njëzet vjet...*”, vepër e cituar, 207.

<sup>381</sup> Raport i konsullit austro-hungarez të Manastirit, 1910.

<sup>382</sup> Revista “*Normalisti*”, nr. Përkujtimor, Tiranë: 1909-1959, f. 27

<sup>383</sup> AQSH, F. 3, Dos. 53, f. 1.

*sy qeshur e buza gas që përgatiteshin e inkurajoheshin për të pritur të ftuarit. Ato ditët e para shkolla e mesme shqipe Normalja 1909, mbante ceremoninë e mbylljes së vitit shkollor 1909-1910. Duke i dhënë rastin të ftuarve të shohin nga provim-tip të lëndëve kryesore, kështu do të pasurohej i tan mundi e tan puna me përpjekje e sakrificë e personelit mësues si dhe nxënësve të atyne filizave që në të ardhmen e afërt do të ishin punonjësit e denjë të arsimit të popullit. Më tej A. Çausi vazhdonte të kujtonte çastin e përmbylljes së vitit mësues, kur “profesorët e nxënësit kishin veshur me rrobat e festës. Qeleshja e bardhë elbasanase mbi kokë ishte e vetmja divizë, që e karakterizonte se ishin misat e shkollës Normale shqipe”. A. Çausi kujton me nostalgji gjithashtu dhe fjalimin e Drejtorit të shkollës Normale L. Gurakuqi që i kishte lënë mbresa në memorjen e tij<sup>384</sup>.*

Gjithashtu në raportin që mësuesit e Normales i dërgojnë kryetarit të Komisionit Drejtues të saj në 30 qershor të vitit 1910, evidentohet një moment mjaft i rëndësishëm, ai i realizimit me sukses i provimeve të fundvitit pavarësisht se këto provime nga mësuesit paraqitnin një shkallë të lartë vështirësie<sup>385</sup>.

### **-Problemet arsimore në prefekturën e Elbasanit gjatë viteve 1910- 1912**

Normalja e Elbasanit është konsideruar në historinë e arsimit shqiptar si institucioni që hodhi themelet e një shoqërie të arsimuar dhe të kulturuar. Pavarësisht vështirësive ekzistuese, përfundimi i vitit të parë të Normales nga stafi pedagogjik i saj u konsiderua i suksesshëm.

Duhet thënë, se kërkesat e shumta për ta vazhduar Shkollën Normale evidentuan njëkohësisht edhe problemet më të rëndësishme që u shfaqën që në vitin e parë të funksionimit të saj dhe kërkonin zgjidhje në vitin në vazhdim. Një problematikë e tillë e cila u konstatua nga drejtuesit e Shkollës Normale, u shndërrua në problem shqetësues për Komisionin Drejtues të shkollës të përfaqësuar nga kryetari i tij Dervish Biçaku. Më së shumti problematika e parashtruar vinte si rezultat i përvojës së vitit të parë të Normales dhe shfaqej në disa drejtime kryesore:

*Së pari*, në vitin mësues në vazhdim, rezultonte si domosdoshmëri sigurimi i një godine më të gjerë si për shkollën Normale ashtu edhe për konviktin e saj, në funksion të kërkesave gjithnjë e në rritje të numrit të nxënësve. Një problem i tillë ishte evidentuar që gjatë vitit të parë

---

<sup>384</sup> AME, F. 38, Dos. 2, f. 3.

<sup>385</sup> AQSH, Fondi. 3, Dos. 53, f. 1.

mësimor të Normales, ku nuk kishin munguar edhe projektet në këtë drejtim. Në raportin vjetor të Normales për vitin shkollor 1909-1910, ndërtimi i një godine të re për Normalen konsiderohej nga Këshilli Mbikëqyrës si një detyrë tepër emergjente<sup>386</sup>. Një shqetësim i tillë, do të gjejë pasqyrim edhe në faqet e shtypit lokal të kohës që dilte atëherë në Elbasan. Kështu, në faqet e gazetës “Tomori” informohemi rreth iniciativës së Dervish Biçakut që pa mbaruar viti i parë i Normales, kishte planifikuar një udhëtim brenda dhe jashtë vendit me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme për ngritjen e një godine të shkollës Normale<sup>387</sup>.

Duke ju referuar burimeve të kësaj kohe konstatohet fakti se edhe nënkonsulli austro-hungarez në Durrës ishte i mirinformuar për problemin në fjalë. Në takimin që ai kishte patur me Dervish Biçakun në prill të vitit 1910, shprehej se : “... *Një plan për këtë shkollë është projektuar që tashi. Shpenzimet për zbatimin e tij pa orenditë e brendshme do të kapin shifrën 2000 lira turke. Ai Dervish Beu ka ndërmend të filloi mbledhje parash lidhur me sigurimin e kësaj shume*”<sup>388</sup>.

*Së dyti*, nga stafi drejtues i Normales për vitin e ri mësimor, kërkoheshin mësues të veçantë posaçërisht për ata nxënës që konsideroreshin të dobët në gjuhën shqipe. Gjithashtu, kërkohesh shtimi i numrit të mësuesve për dy rendet e para të premtares dhe për rendin e parë të Normales. Kërkesa të vazhdueshme bëheshin edhe për shtimin e mjeteve mësimore në funksion të rritjes së nivelit pedagogjik dhe shkencor<sup>389</sup>.

Por çështja më kryesore nga do të varej përmbushja e kërkesave të sipërpërmendura, konsistonte në sigurimin e ndihmave financiare të nevojshme për të vazhduar rregullisht procesi mësimor në shkollën Normale në vitin në vazhdim.

Problemet financiare me të cilat duhej të përballej mbajtja e Normales, do të pasqyrohen edhe përmes korrespondencës që Dervish Biçaku do të mbante në këtë kohë me patriotët shqiptarë sidomos jashtë vendit. Kështu, në një letër që Dervish Biçaku që në prill të vitit 1910 i dërgonte Jani Vruhos në Egjipt, evidentohet shqetësimi i tij për mungesën e fondeve duke shprehur besimin që ai kishte dhe shpresën që mbante për kontributin financiar të shqiptarëve jashtë vendit duke u shprehur se: “... *Shpresojmë se gjithë shqiptarët nuk do të kursehen me*

---

<sup>386</sup> Gazeta “Tomorri”, 31 mars 1910, f. 1.

<sup>387</sup> Po aty, nr. 6, 30 prill 1910, f. 1. Artikull i Simon Shuteriqit.

<sup>388</sup> HHSTA/PA, raport i nënkonsullit austro-hungarez të Durrësit nr. 19, 27 maj 1910.

<sup>389</sup> AQSH, F. 3, Dos. 53, fl. 2.

*ndihmat e tyre për një këso pune të shenjtë. Kësaj vere do t'ju vij t'ju shoh me qëllim të mbledh ndihma për shkollën*"<sup>390</sup>.

Në këtë kuadër, duhet thënë se veprimtaria e patriotëve elbasanas u përqendrua në përpjekjet e tyre për të sensibilizuar shqiptarët brenda dhe jashtë vendit, për nevojën jetike dhe domosdoshmërinë e mbështetjes financiare që do të garantonte dhe vazhdimësinë e Normales. Duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit, mundësinë më të mirë për sigurimin e fondeve financiare patriotët elbasanas e shikonin tek diaspora shqiptare në mërgim. Por, nuk mungojnë në këtë periudhë edhe projektet e diplomatëve Austro-Hungarezë në Shqipëri drejtuar Vjenës zyrtare për të siguruar mbështetje financiare dhe për t'i dhënë shumën e nevojshme prej 2 mijë lirash Dervish bej Biçakut në funksion të ngritjes së një godinë të re për Normalen. Por një veprim i tillë, sipas Baronit Bornemizha duhej të kryhej në kushtet e një fshehtësie të plotë jo vetëm ndaj autoriteteve osmane por dhe ndaj vetë Dervish bej Biçakut, duke u shprehur se: "*Dervish beu të udhëtojë për në Vjenë dhe të ngarkojë dy gjer më tre nga Shqiptarët që jetojnë atje që të bëjnë mbledhjen për këtë qëllim. Këta Shqiptarët e mbledhin shumën prej 2000 lirash, ose më pakë, pa e ditur Drevish beu dhuruesin e tyre*"<sup>391</sup>. Ndërkaq, zbatimi i një plani të tillë nga diplomatë të tjerë vjenezë jo vetëm nuk do të konsiderohej si i përshtatshëm, por mund të sillte edhe kompromentimin e politikës Austro-Hungareze në Shqipëri<sup>392</sup>.

Ndërkaq, duhet thënë se në vitin 1910 patriotët shqiptarë u përballën me një problem tjetër po aq të rëndësishëm, që kishte të bënte posaçërisht me çështjen e mbrojtjes së shkrimit të shqipes me alfabetin latin. Në këtë kuadër acarimet midis shqiptarëve dhe xhonturqve për problemin e alfabetit që ishin shfaqur që gjatë vitit 1909, në këtë kohë arrijnë kulmin e tyre duke pasur gjithashtu edhe mbështetjen e disa deputetëve shqiptarë midis të cilëve edhe atyre elbasanas.

Shprehje e këtyre acarimeve do të jenë mitingjet e organizuar me nxitjen e xhonturqve në disa qytete kundër përdorimit të alfabetit me germa latine. Në këtë propagandë, kundër përdorimit të alfabetit latin ata u përpoqën të shfrytëzojnë sidomos elementin fanatik mysliman, duke e lidhur përdorimin e alfabetit arab në shkrimin e gjuhës shqipe me çështjen fetare dhe duke i konsideruar si të pafë ata që do të shkruanin me shkronjat e të pafeve(latine). Një

<sup>390</sup> AQSH, Fondi "Jani Vruho", Dos. 7, fl. 82. Letra mban datën 3 prill 1910.

<sup>391</sup> HHST/PA. Letër dërguar Vjenës nga Baroni Bornemizha 11 qershor 1910.

<sup>392</sup> Po aty, letër dërguar kontit fon Erental, Vjenë, korrik 1910.

konstatim i tillë bëhet prezent në këtë kohë edhe në raportet e konsujve austro-hungarezë në Shqipëri, të cilët shpreheshin se: “.. qëllimi i tyre[xhonturqve] i padeklaruar është që duke ndezur fanatizmin fetar të myslimanëve të ushtrojnë një ndikim paralizues mbi përparimin kulturor të shqiptarëve”<sup>393</sup>.

Në këtë kuadër, që në fillim të vitit 1910, me përkrahjen e disa deputetëve shqiptarë midis tyre, Mahmut Bedriu nga Peja, Haxhi Ali Elbasani, Fuat Pashai nga Prishtina, Sait Efendiu (Idrizi) nga Shkupi, Riza Efendiu nga Shkodra, xhonturqit do të kërkojnë në parlamentin turk shkrimin e shqipes me germa arabe<sup>394</sup>. Për këtë problem në faqet e gazetës “Dielli” thuhej: “Haxhi Aliu[Elbasani] me 13 deputetë të tjerë fanatikë, na kërkoi nga guvernata zyrtarisht të shkruhet shqipja me shkronja arabishte, se ndryshe ka me u prishun feja”<sup>395</sup>. Kështu, pas miratimit të ligjit në parlament, xhonturqit, nëpërmjet klubit “Bashkim e Përparim” që kishte degë në shumë qytete shqiptare dhe përfaqësuesve mbështetës të klerit mysliman, nuk vonuan për të vënë në zbatim përdorimin e këtij alfabeti në mësimin e gjuhës shqipe.

Përmes dokumentacionit të kohës konstatohet fakti se në Elbasan si përkrahës i alfabetit me shkronja arabe përmendet kleriku mysliman Haxhi Afës Sulejman Kungulli, i cili duke gëzuar mbështetjen e plotë të deputetit të Elbasanit Haxhi Aliut do të cilësohet si organizatori i një mitingu kundër alfabetit me bazë shkronjat latine. Një qëndrimi i tillë i Hafëz Kungullit pasqyrohet në faqet e gazetës “Dielli” në një artikull nën titullin: “Tradhëtori Hafës Kungulli dhe mitingu i fanatikëve në Elbasan”<sup>396</sup>. Gjithashtu, konsulli austro-hungarez në Durrës rreth organizimit të këtij mitingu do të shprehë: “Elbasani një nga pikat e zjarra të përpjekjeve kombëtare, ku elementi tolerant në pikëpamje fetare ballancohet së paku me elementin fanatik, do të formojë gjithmonë objektin e sulmevet antishqiptare të xhonturqve”<sup>397</sup>.

Kështu, në 3 shkurt të vitit 1910, do të organizohet në Elbasan një miting në mbështetje të alfabetit me germa arabe. Sipas informacionit të nënkonsullit austriak në Durrës në këtë miting nuk kishte më shumë se 200 vetë, ndërsa përse i përket përbërjes së pjesëmarrësve rezultonte se pjesa më e madhe e tyre ishin fshatarë nga Çermenika.<sup>398</sup> Në fjalimin e mbajtur nga Afëz

<sup>393</sup> Po aty, letër dërguar Ministrisë së P. Jashtme Vjenë. Durrës 11 mars 1910.

<sup>394</sup> AME, Marrë nga studimi – Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll, i Hasan Kaleshit, gazeta “Shqiptari” e enjte 18 shkurt 1910.

<sup>395</sup> “Dielli”, Boston, 25 mars 1910.

<sup>396</sup> Po aty.

<sup>397</sup> HHSTA/PA. Raport i konsullit të a-h, Durrës 11 mars 1910. *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, vepër e cituar, 394.

<sup>398</sup> HHSTA/PA Arkivi i Vjenës, informacion i nënkonsullit të Durrësit, 11 prill 1909.



Kungulli në këtë miting thuhej se: “ *Nuk lypset të lamë Haxhi Alian, babën tonë vetëm, ç’ të bajë ai, neve lypset ta ndëgjojmë. Sot po na kërkon myhyrët qi të vulosim këto dy letrat, (nga të cilat njana ju çu Haki Pashës e tjetra Haxhi Aliut), kët dy harzullahe për me u shkrujtë shqipja me Harfe tyrçe*”<sup>399</sup>. Qëndrimi i deputetit të Elbasanit Haxhi Aliut do të pasqyrohet edhe në një artikull të botuar në gazetën “Bashkimi i Kombit” në të cilin thuhej: “... *Po zoti Haxhi,*<sup>400</sup> *dhiplomati nga Elbasani vate edhe më tej, kërkoi kartëra dëshmimi, artifikacia nga çermenikasitë, edhe këtu u mblodhnë mbë një faltore edhe vunë vulat e tyre përmbi nja kartë, të cilënë vetë ua kishte dërguarë, që t’ia dërgoninë si telegram qeverisë.*”<sup>401</sup> Sikurse konstatohet në këtë dokument, nxitje për kundërvënie ndaj përdorimit të germave latine në shkrimin e gjuhës shqipe, u bë posaçërisht apeli i senatorit dhe deputetit të Elbasanit Haxhi Aliut, drejtuar hoxhallarëve e myslimanëve fanatikë duke gjetur mbështetjen e plotë të Haxhi Afës Sulejman Kungullit dhe gjithashtu të mbështetur edhe nga anëtarë të klubit “*Bashkim e Përparim*” që bënin propagandë përmes fjalëve : “... *tue ju thanë se shqiptarët do të bëheshin të pa fe në qoftëse gjuhën e tyre ato do ta shkruanin me shkronjat e të pafeve dhe jo me germat e shenjta të Kuranit*”.

Një muaj pas kësaj ngjarje në Elbasan, deputeti i Elbasanit Haxhi Ali Elbasani do të drejtojë shoqërinë me emrin “Mahfeli” që krijohet në Stamboll në mars të vitit 1910, me qëllimin e vetëm shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja arabe<sup>402</sup>. Ndërkohë në faqet e gazetës “Dielli” zgjedhja e tij si deputet konsiderohej si një gabim i elbasanasve<sup>403</sup>. Organizimi i mitingut për mbrojtjen e alfabetit me germa arabe nuk kishte se si të mos shkaktonte reagimin e popullit të Elbasanit dhe të patriotëve të krahinave të Gramshit, Shpatit, Çermenikës etj. Duhet thënë se aq i shpejtë qe ky reagim, sa “*dy ditë më vonë, – pohon nënkonsulli i Durrësit – bejlerët e Elbasanit dhe patriotët e grumbulluar për rreth klubeve të atjeshëm organizuan një kundërmanifestim publik me një frekuentim të madh i cili përfundoi me dërgimin e telegrameve kryeministrit dhe deputetëve shqiptarë*”<sup>404</sup>. Pjesëmarrjen në këtë miting ai e vlerëson me rreth 2000 manifestues.

---

<sup>399</sup> Korça”, Korçë, nr. 34, 12 shkurt 1910, autori: Krasta.

<sup>400</sup> Haxhi Ali Elbasani ishte deputet i Elbasanit në parlamentin turk. Ai ishte kryetar i shoqërisë Mahfeli, e cila u organizua në fillim të vitit 1910 në Stamboll, që bë qendër e propagandimit të alfabetit arab për shkrimin e shqipes. Sipas Sejfi Vllamasit ky klub(shoqëri) u hap në Aksaraj të Stambollit.

<sup>401</sup> “Bashkimi i Kombit”, Manastir, nr.27, mars 1910. *Mendimi Politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, përmbledhje artikujsh nga shtypi, Tiranë: 8 nëntori, 1976, 550.

<sup>402</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 421.

<sup>403</sup> Gazeta “Dielli”, Boston, 25 mars 1910.

<sup>404</sup> HHSTA/PA, informacion i nënkonsullit të Durrësit, 11 prill 1909.

Kështu, populli i Elbasanit i mbështetur masivisht nga popullsia e krahinës së Gramshit dhe trevave të tjera do të dalin në mbrojtje të shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetin latin. Ndër organizatorët e mitingut përmenden emrat e Lef Nosit, Beqir Plangaricës, Muç Shqiptarit, Ali Çiftes, Ali Celiramës, Nexhip Haxhiademit etj. Ndërsa në rolin drejtues të pleqësisë së mitingut rezultonin Dervish Biçakçiu, Galip Beu, sheh Mahmud Guma, Beqir Mezja, Emin Haxhiademi etj<sup>405</sup>.

Një ngjarje me përmasa të tilla gjen pasqyrim edhe në një artikull titulluar “Mitingu i Atdhetarëve n’Elbasan” botuar në faqet e gazetës “Dielli”, ku midis të tjerave vlerësohej roli dhe kontributi në këtë miting i bejlerëve të Elbasanit duke pohuar se: “... u bashkuan me gas dhe bejlerët e nderëshme të qytetit, të cilët po thuaj qenë shpirti dhe zëmra e lëvizjes kombëtare të këtyre ditëve”<sup>406</sup>.

Edhe në faqet e gazetës “Lirija” të Selanikut gjen pasqyrim mitingu i organizuar në Elbasan kundër përdorimit të alfabetit arab për shkrimin e shqipes duke shkruar se: “*Tejshkrimet që na vijnë nga qeveria thonë: Mbaskëndaj gjuha shqipe do të mësohet me shkronja arabishte vetëm atyne qi kanë dëshirë me mësumë shqip... ene në mos dashçin, sa ma mirë*”. Sipas këtij informacioni mitingu për mbrojtjen e alfabetit me germa latine është mbajtur në datë 4 shkurt të vitit 1910<sup>407</sup>.

Gjithashtu, për çështjen e alfabetit të shkrimit të gjuhës shqipe, Edvin Zhak (Edwin E. Jacques) në monografinë “Shqiptarët” do të shkruajë: “Në atë kohë askush nuk mund ta imagjinonte se më 1928( pra 18 vjet më vonë – shën. i ynë) Mustafa Qemali do të kërkonte që Turqia të shkruante gjuhën e vet me germa latine duke ndjekur kështu shembullin e dikurshëm të vasalit të saj”<sup>408</sup>.

Duhet thënë se përmes përfaqesjes së dokumentacionit përkatës rreth mitingut në fjalë, burime të ndryshme japin të dhëna të ndryshme përsa i përket; së pari datës së zhvillimit të mitingut në përkrahje të shkronjave latine dhe së dyti numrit të pjesëmarrësve në të. Në disa prej prej këtyre burimeve si datë e organizimit të mitingut jepet 4 shkurti i vitit 1910, ndërsa burime të tjera japin datën 5 shkurt 1910<sup>409</sup>. Gjithashtu edhe për sa i përket numrit të pjesëmarrësve në

---

<sup>405</sup> Elbasani - Enciklopedi, vepër e cituar, 117.

<sup>406</sup> “Dielli”, Boston, 25 mars 1910.

<sup>407</sup> “LIRIJA”, Selanik, nr. 75, shkurt 1910. Autori me initiale: B.R.

<sup>408</sup> Edwin E. Jacques, *Shqiptarët*, vëll. II, Botim i Fondacionit Abraham Linkoln, Tiranë: 1995, 449.

<sup>409</sup> Gazeta “Lirija” e Selanikut si datë të organizimit të tij jep 4 shkurtin 1910, ndërsa gazeta “Tanin” që botohej në Stamboll jep datën 5 shkurt 1910.

këtë miting, ekziston i njëjti problem që pasqyrohet në mospërputhje të dhënave. Kështu, në informacionin e nënkonsullit të Durrësit për numrin e pjesëmarrësve në këtë miting, jepet një shifër afërsisht rreth 2000 pjesëmarrës, ndërsa gazeta “*Shqiptari*” jep një shifër rreth 10 000 vetë,<sup>410</sup> ndërkohë që burime të tjera sikurse dhe gazeta “*Dielli*” e Bostonit jepet një shifër pjesëmarrësish rreth 7 000 vetë. Gjithashtu, në telegramin dërguar nga klubi “*Bashkimi*” dhe botuar në gazetën “*Tanin*” të Stambollit më 20 shkurt, pohohej se: “*Më 5 shkurt e gjithë paraia, shehlerët, tregtarët, dhe esnafët si dhe popullsia e katundeve e mbajtën një miting në të cilin u zotuan se do ta ruajnë alfabetin shqip të përdorur prej 40 vjetësh...*”<sup>411</sup>.

Por pavarësisht një problematike të tillë që është evidente në burimet e kohës, duhet thënë se ky miting për nga përmasat që mori dhe jehona që pati brenda dhe jashtë vendit mund të konsiderohet si më i madhi i organizuar ndonjëherë në Elbasan dhe i pari e ndër më masivët, që u bënë për mbrojtjen e alfabetit latin në shkrimin e shqipes. Jehona e kësaj proteste, u përhap me shpejtësi jashtë trevës së Elbasanit dhe në diasporë.

Përsa i përket jehonës që ky miting pati, në 11 shkurt të vitit 1910, gazeta “*Shqiptari*” e Stambollit, duke vlerësuar veprimtarinë e popullit të Elbasanit do të shkruante: “*Sjellja e elbasanasve na nderon shumë.... Drit e Shqipërisë si dhe zemra e të gjithë dëshirave të saj asht ai vend i shenjtëruar*”<sup>412</sup>.

Gjithashtu, edhe konsulli austro-hungarez Pallavicini në informacionin dërguar Vjenës në shkurt të vitit 1910 midis të tjerave shprehej se : “*... Edhe organi xhonturk “Tanin” e pa veten të detyruar të shprehte mendimin se e drejta për të përdorur gërmat latine për gjuhën shqipe duket e justifikueshme për arsye teknike gjuhësore. Nëse kjo formalisht paraqet pikpamjen zyrtare të Komitetit Xhonturk, atëherë artikulli i gazetës “Tanin” do ta zgjidhte përkohësisht konfliktin e alfabetit në favor të gërmave latine*”<sup>413</sup>. Gjithashtu, në faqet e gazetës “*Dielli*” vlerësohet edhe pjesëmarrja në këtë miting e nxënësve të shkollës Idadije të Elbasanit duke përmendur emrat e nxënësve të “*rrjeshtës së pestë*” e më konkretisht emrat e Emin Haxhiademit, Kamber Dardhës dhe Kostandin S. Cipos<sup>414</sup>.

---

<sup>410</sup> Më 11 shkurt 1910 patrioti Dervish Hima shkruan në gazetën “*Shqiptari*” i Stambollit “*Nga Elbasani me teleg. na lajmërojnë që atje u bë një miting i madh për të mbrojtur shkronjat shqip. Për mbi 10 000 vetë qenë mbledhur dhe u folën shumë fjalë...*”

<sup>411</sup> AME, Hasan Kaleshi, “*Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll*”.

<sup>412</sup> Gazeta “*Shqiptari*” e Stambollit, 11 shkurt 1910, biblioteka e shtetit Elbasan.

<sup>413</sup> HHSTA/PA. Raport i konsullit Pallavicini, Stamboll shkurt 1910. *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, vepër e cituar, 391.

<sup>414</sup> “*Dielli*”, Boston, 25 mars 1910.

Duhet thënë se edhe në përgjigjen që patriotët gramshiakë i dhanë kërkesës së këshillit turkoman për mbështetjen e shkronjave arabe thuhej se: *“Me kënaqësi të madhe parashtrojmë se këtu nuk ka njerëz që të marrin pjesë për sa kërkohet, prandaj ua kthejmë prapë këtë propozim”*<sup>415</sup>.

Ndërkaq, qëndrimi që mbajtën shqiptarët dhe popullsia e trevës së Elbasanit në mbrojtje të alfabetit me shkronja latine, përfaqësonte njëkohësisht edhe përpjekjen e patriotëve elbasanas për mbrojtjen e shkollës Normale. Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi në informacionin e pasqyruar në periodikët e asaj kohe, ku për problemin në fjalë në një artikull botuar në gazetën “Dielli” nga Simon Shuteriqi thuhej: *“... Qëllimi ma i parë i xhonëve dhe i Hafëz[if] [Hafëz Kungulli nxënës besnik i Haxhi Aliut]... paska qenë me na rrethumun Shkollën Normale dhe me kërkumun me të fortë prej mytesarifit mbylljen e saj”*<sup>416</sup>.

Gjithashtu, në faqet e shtypit të kohës pasqyrohen protestat dërguar nga përfaqësues shqiptarë jashtë vendit, deputetëve të parlamentit osman kundër orvatjeve të tyre për të imponuar alfabetin arab. Një protestë e tillë e dërguar në emër të shoqërisë së shqiptarëve të Kostancës gjen pasqyrim në faqet e gazetës “Shqiptari” që botohej në Stamboll dhe në faqet e gazetës “Bashkimi i Kombit” që botohej në Manastir<sup>417</sup>.

Kështu, në një kontekst të tillë sa të rëndësishëm aq dhe të vështirë kur marrëdhëniet me xhonturqit po vinin duke u acaruar, u pa si domosdoshmëri organizimi i një kongresi që do të trajtonte probleme jo vetëm të natyrës arsimore por njëkohësisht edhe çështje me karakter politik. Një kongres i tillë ku do të përfaqësohen patriotë nga të gjithë trevat shqiptare do të mbledhet në Manastir 2-3 prill të vitit 1910 duke u cilësuar Kongresi i dytë i Manastirit. Vendimet më të rëndësishme të tij do të përmbledhen në një program prej 10 pikash dhe në një promemorje prej 4 pikash. Ndër problemet më kryesore që do të trajtohen veçanërisht nga përfaqësuesit e Kosovës në kongres do të rezultojë edhe hapja në Shkup e një shkolle Normale në gjuhën shqipe<sup>418</sup>.

Kështu, si hallka kryesore në funksion të plotësimit të vendimeve të parashtruara në këtë kongres do të konsideroheshin klubet patriotike shqiptare, duke patur si qëllim forcimin e lidhjeve dhe koordinimin e veprimtarisë midis tyre. Në këtë kuadër, funksionet e klubeve

---

<sup>415</sup> “Lirija”, Selanik, dt. 10 maj 1910.

<sup>416</sup> Gazeta “Dielli”, 25 mars 1910, f.1. Pseudonimi i Simon Shuteriqit ishte Shkam’ i Letanit.

<sup>417</sup> *Akte të Rilindjes kombëtare shqiptare ...*, vepër e cituar, 207-208.

<sup>418</sup> Hysni Myzyri, *Shkolla Normale ...*, vepër e cituar, 255.

patriotike u përcaktuan përmes miratimit të një kanonizmë(rregullore) të përbashkët dhe të detyrueshme për të gjithë klubet shqiptare, që do të shkruhej në turqisht dhe në shqip dhe do t'i bëhej e njohur edhe qeverisë. Në funksion të reformimit dhe funksionimit e klubeve shqiptare ekzistuese, fillimisht nga delegatët e kongresit u konsiderua si zgjidhja më e pranueshme që qendra e klubeve shqiptare të ishte Stambolli dhe si klub qendror të caktohej klubi i shqiptar i Stambollit. Pranë këtij klubi do të ngrihej edhe një komision arsimor-kulturor që do të quhej Akademi. Përveç Klubit Qendror të Stambollit, u vendos që çdo vilajet do të kishte një klub qendror nga i cili do të varehin klubet e sanxhaqeve, të kazave dhe të nahijeve. Klubi qendror i vilajetit do të kishte lidhje të drejtpërdrejtë me klubin qendror të Stambollit i cili do të caktonte dy përfaqësues për të kontrolluar aktivitetin e klubeve në Shqipëri dhe shoqërinë “Përparimi” në Korçë<sup>419</sup>.

Në përfundim të punimeve të tij, delegatët e kongresit të dytë të Manastirit do të hartonin edhe një promemorie proteste që do t'i drejtohej qeverisë në përmbajtjen e së cilës më së shumti parashtroheshin vendimet më të rëndësishme në mbrojtje të shkrimit të shqipes me alfabetin latin dhe mbështetjen që përfaqësuesit e kongresit kërkonin nga qeveria xhonturke<sup>420</sup>.

Në Kongresin e dytë të Manastirit u diskutuan edhe çështje të natyrës politike, midis të cilave organizimi i një kryengritje të përgjithshme që do të mbështetej në intensifikimin e veprimtarisë së komiteteve të fshehta që vepronin në Shqipëri, por për këtë problem nuk u kalua në vendime konkrete, ndonëse ka të dhëna që flasin në favor të faktit se kongresi i dytë i Manastirit doli edhe me një program politik të fshehtë që u quajt “Platforma e autonomisë së Shqipërisë”, ku midis të tjerave parashikohej edhe njohja zyrtare e kombit shqiptar<sup>421</sup>. Kështu, duhet thënë se në kohën kur mbahej kongresi i dytë i Manastirit në Kosovë do të shpërthejë kryengritja shqiptare e vitit 1910.

Duhet thënë se pavarësisht vendimeve të Kongresit të dytë të Manastirit dhe protestave e mitingjeve kundër reaksionit xhonturk, pavarësisht përpjekjeve për mbrojtjen e shkrimit të shqipes me alfabetin latin dhe megjithë arritjet që pati Normalja që në vitin e parë të hapjes së saj, projektet përparimtare dhe të rëndësishme që patriotët shqiptarë kishin hartuar mbetën në letër. Ekspedita xhonturke e verës së vitit 1910 jo vetëm që nuk lejoi zbatimin e tyre, por solli

---

<sup>419</sup> *Akte të Rilindjes kombëtare shqiptare ...*, vepër e cituar, 208. Vendimet e Kongresit të dytë të Manastirit, 3 prill 1910.

<sup>420</sup> Protesta është botuar në gazetën “Tomorri”, 14 prill Elbasan.

<sup>421</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, vepër e cituar, 425.

edhe mbylljen në mënyrë arbitrare të Normales në shtator të vitit 1910, me motivin se aktiviteti i saj ishte “i rrezikshëm për fenë dhe kushtetutën”<sup>422</sup>. Nëpërmjet një veprimi të tillë, vetëm duke përdorur forcën dhe dhunën xhonturqit do të arrijnë përkohësisht të frenojnë lëvizjen arsimore në Shqipëri, ndërkohë që një situatë e tillë do të shërbejë si katalizator përshpejtues drejt organizimit të kryengritjeve shqiptare.

Në këtë kuadër, në shtator të vitit 1910 në Elbasan ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme dhe qyteti mbahej i rrethuar nga regjimenti. 7 i korparmatës parë<sup>423</sup>. Burimet e kohës na informojnë për faktin se prifti unit i Elbasanit që ishte larguar për në Greth të Kavajës do të sillet në Elbasan si i kërkuar, por që u la i lirë kundrejt një garancie tregtare<sup>424</sup>.

Si rezultat i një situatë të tillë, shumica e patriotëve elbasanas dhe mësuesve të shkollës Normale, për ti shpëtuar reprezaljeve të ekspeditës së Turgut Pashës u larguan jashtë vendit. Të tillë ishin Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Dervish Biçaku, Aqif Pashë Elbasani etj. Ata që mbetën u keqtrajtuat fizikisht ose u internuan në Anadoll. Lef Nosi drejtuesi i gazetës “Tomori” u internua në Brusë, ndërsa Simon Shuteriqi u keqtrajtua fizikisht. Përveç tyre edhe patriotë të tjerë të Elbasanit pësuan të njëjtin fat<sup>425</sup>.

Pikërisht, për largimin e një pjese të patriotëve shqiptarë dhe elbasanas që ishin njëkohësisht edhe mësues të Normales informohemi nëpërmjet një letre që A. Xhuvani i dërgon në gusht të vitit 1910 Jani Vruhos drejtues i gazetës “Rrufeen”. Përmes kësaj letre, informohemi jo vetëm për aktivitetin e A. Xhuvanit në vitet 1908-1910, por njëkohësisht informohemi edhe për zhvillimet e ngjarjeve në Elbasan gjatë ekspeditës së Turgut Pashës. Në të njëjtin burim, A. Xhuvani i konsideronte “xhonët” si përgjegjësit kryesorë në ndërprerjen e misionit madhor dhe të shenjtë të Normales, duke e konsideruar atë si një vatër ku po gatuhej bashkimi i toskëve dhe i gegëve dhe njëkohësisht po konsolidohej ideja e bashkimit kombëtar.

Kështu, në të njëjtin burim informohemi për mbylljen e shkollës Normale njëkohësisht dhe për fatin e mësuesve dhe patriotëve elbasanas që sikurse shkruante A. Xhuvani për ti shpëtuar persekutimeve dhe burgosjes u detyruan të largohen jashtë vendit. Patriotët shqiptarë si Aqif Pasha, Dervish Beu, Shefqet Beu dhe Luigj Gurakuqi u detyruan të largohen jashtë vendit për në Itali. Për vendodhjen e tyre informohemi nëpërmjet një letre që mban datën 14 nëntor

---

<sup>422</sup> Gazeta “*Bashkimi i Kombit*”, nr. 26, Manastir, 4 mars 1910, 2.

<sup>423</sup> HHST/PA. nr. 39, raport i konsullit austro-hungarez të Durrësit, 25 shtator 1910.

<sup>424</sup> Po aty.

<sup>425</sup> AQSH. F. 3, Dos. 45, f. 9.

1910, sipas së cilës në këtë kohë Luigj Gurakuqi ndodhej në Itali së bashku me Dervish Bej Elbasanin.

Ndërkohë, A. Xhuvani në kohën e ekspeditës së Turgut Pashës rezultonte në Manastir ku po përpiquej të shtypte një gramatikë të gjuhës shqipe. Pas largimit nga Manastiri ai u vendos në Selanik dhe në 7 gusht 1909 rezulton të ketë arritur në Aleksandri<sup>426</sup>.

Në këtë kudër, duhet thënë se gjatë viteve 1910-1911, veprimtaria e patriotëve elbasanas u përqendrua më së shumti në përpjekjet për rihapjen e shkollave shqipe të mbyllura dhe sidomos të Shkollës Normale të Elbasanit edhe nëse do të duhej të mbështeteshin vetëm në kontributet financiare të vetë popullit të Elbasanit. Por problemi më kryesor, konsistonte në sigurimin e lejes nga Ministria turke e Arsimit, e cila deri në vjeshtë të vitit 1911 me gjithë premtimet e bëra shqiptarëve, nuk e kishte bërë një gjë të tillë.

Ndërkohë, patriotët shqiptarë që ishin larguar jashtë vendit pas mbylljes së Normales po shikonin mundësinë e hapjes së saj në një vend të Evropës. Ja si shprehet Luigj Gurakuqi për këtë problem: “ ... *Po përpiqemi që t'a hapim jashta..., kemi shpresë t'a mbarojmë qëllimin t'onë; të hapunit e Shkollës Normale do t'i zbardhë faqen të gjithë shqiptarëve*”<sup>427</sup>. Gjithashtu të njëjtin mendim me Luigj Gurakuqin shfaqte në këtë kohë edhe Fan Noli, i cili si pengesë kryesore për hapjen e Normales në Shqipëri shikonte veprimtarinë antikombëtare të xhonturqve. Në këtë kuadër, Noli nuk e përjashtonte Elbasanin si qytetin e hapjes së Normales por shfaqte mendimin që fillimisht Normalja të hapej në Maltë ose në Zvicër dhe më pas të dërgohej përsëri në Elbasan<sup>428</sup>.

Gjithashtu, patriotët shqiptarë mundësinë e hapjes së shkollës Normale e shikonin jo vetëm në një nga shtetet e Evropës, por pse jo edhe në një nga vendet jashtë saj. Si vende të tilla të mundshme konsideroheshin Zvicra, Malta, Bosnja apo Egjipti. Për realizimin e një qëllimi të tillë patriotët shqiptarë dhe më konkretisht L. Gurakuqi dhe Dervish Biçaku nuk nguruan të kërkonin edhe mbështetjen dhe ndihmën financiare të ambasadës austro-hungareze në Romë. Pikërisht në këtë kohë, konstatojmë përpjekjet e Dervish Biçakut për hapjen e shkollës Normale në Egjipt. Pavarësisht këmbënguljes së tij për të hapur një shkollë Normale në Egjipt, hapja e një shkolle të tillë në një vend të huaj rezultonte mjaft e vështirë dhe konsiderohej ndoshta e

---

<sup>426</sup> AQSH, F. 3, Dos. 45, f.10. Letra i drejtohet Jani Vruhos dhe mban datën 7 shtator 1910. Në këtë letër A. Xhuvani përmend edhe pseudonimin e tij që ishte “Dokë Sula”.

<sup>427</sup> AQSH, F. 2, Dos. 74/1, f. 566.

<sup>428</sup> Bedri Dedja, “*Luigj Gurakuqi*”, Elbasan: 1981, 173.

pamundur. Të njëjtin mendim për pamundësinë e hapjes së Normales në Egjipt, shprehte edhe ambasadori austro-hungarez në Romë i cili nga takimet që kishte pasur me Dervish Biçakun, ishte i mirinformuar për këtë problem<sup>429</sup>.

Në këtë kuadër vështirësitë më të mëdha për hapjen e Normales në një vend të huaj lidheshin më së shumti me përshtatjen me legjislacionin e vendit ku do të hapej Normalja dhe njëkohësisht edhe me pamundësitë për dërgimin e nxënësve atje dhe njëkohësisht me probleme të natyrës financiare.

Por në fund të vitit 1911 qeveria xhonturke në funksion të përmbushjes së premtimeve në fushën e arsimit do të vendosë që një pjesë e shkollave turke në Shqipëri të ktheheshin në shkolla shqipe dhe të dërgoheshin në Shqipëri dy nëpunës të lartë të Ministrisë turke të Arsimit, të cilët do të ishin Hamit dhe Xhevdet Beu. Njëri prej tyre do të dërgohej në Shqipërinë e Sipërme (vilajeti i Shkodrës dhe i Kosovës), ndërsa tjetri në Shqipërinë e Poshtme (vilajeti i Manastirit dhe ai i Janinës). Qëllimi i dërgimit të tyre do të ishte sikurse thuhej “këqyrja e situatës”, për të vendosur lidhur me shkollat. Ndërkaq, vendimi i qeverisë ishte që gjuha shqipe të mësohej “me ato shkronja që të dojë populli”, d.m.th. me shkronja shqip atje ku e duan kështu dhe me arabisht, në qoftë se e duan me këto shkronja”. Këto premtime u transmetuan në Shqipëri nëpërmjet një letër qarkore, që u dërgoi patriotëve shqiptarë kryetari i klubit shqiptar të Stambollit Abdyl Ypi<sup>430</sup>.

Në kuadrin e këtyre premtimeve e një rëndësie të veçantë për patriotët shqiptarë rezultonte premtimi i qeverisë turke për riçeljen e Shkollës Normale të Elbasanit. Përveç lejes për hapjen e saj qeveria turke kishte akorduar dhe një fond prej 7000 groshësh (baras me 70 lira turke një vlerë më tepër simbolike) për Shkollën Normale gjithashtu edhe pagesat e mësuesve që do të jepnin mësim në shkollat shqipe<sup>431</sup>. Kështu, në këtë kohë nuk do të mungojnë përpjekjet e klubit “Bashkimi i ri” që ishte krijuar në Elbasan, për rihapjen e Normales, por problemi kryesor qëndronte në mungesën e mjeteve financiare. Në këtë kuadër, sigurimi i ndihmave nga të gjitha krahinat dhe klubet e tjera brenda e jashtë vendit, shfaqej si domosdoshmëri e ngutshme. Në Elbasan klubi “Bashkimi i ri” arriti të sigurojë një ndihmë prej rreth 200 lirash.<sup>432</sup> Edhe klubi shqiptar i Janinës iu përgjigj thirrjeve të bëra nga shtypi i kohës për të mbështetur financiarisht

---

<sup>429</sup> HH STA/PA, Raport i ambasadës austro-hungareze në Romë, 4 tetor 1910.

<sup>430</sup> H. Myzyri, *Shkolla Normale...*, vepër e cituar, 269.

<sup>431</sup> Po aty, 271.

<sup>432</sup> “Drita”, nr. 48, Manastir, 1911, f. 1.



rihapjen e Normales, përmes sigurimit të ndihmave edhe të nxënësve shqiptarë të gjimnazit turk të Janinës. Ndihma financiare që dha ky klub së bashku me nxënësit shqiptarë të shkollave të Janinës arrinte në shifrën 2300 groshë<sup>433</sup>.

Çështja e rihapjes së Normales gjeti pasqyrim në faqet e shtypit të kohës. Në një nga artikujt kryesorë të gazetës “Drita” të Manastirit bëhej thirrje për të ndihmuar në rihapjen e Normales duke u shprehur se: *“Kush nuk dëshiron të shohë Shkollën Normale të çelur? A presim nga Perëndia nga qielli të na dërgojë ndonjë torbë me florinj që të mbarojmë qëllimin tonë? Apo presim nga pashallarët dhe shqiptarët e pasur që janë në Stamboll? Komb nuk domethënë 5, 10 apo 100 njerëz të pasur”*<sup>434</sup>.

Rihapja e Shkollës Normale sipas mendimit të konsullit austro - hungarez të Manastirit cilësohej mjaft e rëndësishme, por vështirësia më e madhe sipas tij lidhej me prapambetjen kulturore të shqiptarëve dhe rrezikun e shkombëtarizimit të tyre. Nga ana tjetër ndihmën e akorduar nga qeveria turke ai e cilësonte si të pamjaftueshme, duke parashtruar një alternativë tjetër, që konsistonte në një ndihmë financiare sekrete nga ana e Vjenës. Këtë ndihmë ai e cilësonte si mjaft emergjente dhe të rëndësishme<sup>435</sup>.

Ndërkohë, në fillim të vitit 1912 kontradiktat midis shqiptarëve dhe qeverisë xhonturke erdhën duke u acaruar. Nga ana tjetër xhonturqit në luftë me opozitën brenda vendit po përjetonin një situatë tepër kritike. Duke shfrytëzuar rivalitetet midis tyre për të përfituar nga situata e krijuar, patriotët shqiptarë u përpoqën të realizonin planet e tyre në aspektin arsimor. Kryetari i Klubit të Stambollit, Abdyl Ypi lajmëronte se Ministria turke e Arsimit do të jepte 600 lira, dhe e kishte ngarkuar vetë atë për t’u kujdesur për rihapjen e Normales. Kontaktin e parë Abdyl Ypi do ta ketë me anëtarët e klubit **“Bashkimi i ri”** në mars të vitit 1912. Nga 600 lirata e premtuara nga qeveria turke, komisionit që u ngrit për hapjen e Normales ju dha më pak se gjysma e tyre rreth 250 lira<sup>436</sup>.

Ceremonia zyrtare për hapjen e Normales do të organizohet në 19 mars 1912, ndërsa më 1 prill 1912 pasi kishin kaluar rreth 6 muaj nga fillimi i vitit mësimor rihapet përfundimisht Normalja e Elbasanit, në shtëpinë e Qemal Karaosmanit. Stafi pedagogjik që u caktua përbëhej nga: Fazlli Frashëri drejtor dhe si mësues Simon Shuteriqi, Hafiz Ibrahim Dalliu, Petër Dodbiba,

<sup>433</sup> “Koha”, nr. 2, Korçë, 13 janar 1912, f. 2.

<sup>434</sup> Po aty.

<sup>435</sup> HHSTA/PA, Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, nr. 2, 1912.

<sup>436</sup> “Drita”, nr. 59, Manastir, 15 mars 1912, f. 1.

Hasan Mezja dhe Dhimitër Papparisto. Ndërkaq, duke ju referuar burimeve austro – hungareze informohemi rreth faktit se Abdyl Ypi ua ndaloi mësuesve të shkollës përdorimin e alfabetit latin, pavarësisht kërkesës së patriotëve elbasanas për përdorimin e alfabetit të Manastirit<sup>437</sup>. Por, hapja e shkollës Normale u prit me kritika nga përfaqësuesit më në zë të patriotëve shqiptarë, për faktin e mosbesimit që ata kishin ndaj Abdyl Ypit dhe mospërfsirjes në stafin pedagogjik te saj të figurave të njohura arsimore si Aleksandër Xhuvani, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci etj<sup>438</sup>.

Ndërkohë, në 3 prill të vitit 1912 Ministri i Brendshëm osman Haxhi Adil Beu në kuadrin e një udhëtimit që kishte ndërmarrë në trevat shqiptare, bëri një vizitë të shkurtër në trevat shqiptare. Një pritje e ftohtë dhe jo në pak raste edhe armiqësore ju bë Haxhi Adil Beut në qytetet shqiptare e veçanërisht në Kosovë<sup>439</sup>. Në vizitën që Ministri i Brendshëm do të bëjë në Elbasan i shoqëruar nga Esad Pashë Toptani, sikurse raportohet nga konsulli austro - hungarez në Durrës, përveç disa bejlerëve që dolën e pritën, populli i Elbasanit nuk u kushtoi rëndësi vizitës së tij. Pas vizitës që do të bëjë në një shkollë turke të qytetit, do të jetë mytesarifi i Elbasanit që do të pengojë vizitën e tij në shkollën e re shqipe, duke e justifikuar me faktin se shkolla nuk kishte nxënës<sup>440</sup>. Ndërkohë në vizitën që Haxhi Adil Beu bëri në shkollën Normale të Elbasanit, ai u premtoi drejtuesve të shkollës se do t'i kërkonte qeverisë osmane akordimin e një shume prej 500 lira turke në funksion të ngritjes së një godine të re shkollore dhe se do të ndikonte që të parashikohej në buxhet shuma 1200 lira turke për mbajtjen e Shkollës Normale.<sup>441</sup> Ndërkohë, që në qershor të vitit 1912, sipas raportimeve të konsullit austro-hungarez Halla numri i nxënësve nga 80 kishte vajtur në 125 nxënës<sup>442</sup>.

Por në të njëjtën kohë me hapjen e Normales situata politike në Kosovë veçanërisht në muajt mars – prill të vitit 1912, erdhi duke acaruar, sidomos edhe pas ndërhyrjeve të shumta dhe presioneve që u bënë për zgjedhjet në parlamentin osman, ku një rol tepër negativ pati posaçërisht edhe komisioni qeveritar i drejtuar nga Ministri i Brendshëm Haxhi Adil Beu.

---

<sup>437</sup> HHSTA/PA, rapor I konsullit austro – hungarez të Durrësit , nr. 16, 29 mars 1912. H. Myzyri, Shkolla ..., vepër e cituar, 280.

<sup>438</sup> AQSH, Fondi. 32, Dos. 60/1. f. 124. Letër dërguar në maj 1912 nga Nikolla Nosi.

<sup>439</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 466.

<sup>440</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. II, përgatitur nga Ferid Duka, Dritan Egro, Sokol Gjermani, Tiranë: Botimet Toena, 2012, 114. Letër e Konsulli Rudnay, drejtuar ambasadorit Pallavicini në Stamboll.

<sup>441</sup> Po aty, f. 292. Raport i konsullatës austro - hungareze në Manastir, dërguar autoriteteve në Vjenë.

<sup>442</sup> Po aty, 75. Letër e Konsulli austro - hungarez Halla drejtuar kontit Leopold fon Berchtold.

Ndërkaq, në gusht të vitit 1912 Fan Noli konsideronte si qytetin më të përshtatshëm për shkollën Normale, Vlorën ose Durrësin për shkak të pozicionit të tyre bregdetar dhe njëkohësisht ekzistencës në këto dy qytete të përfaqësive të huaj konsullore<sup>443</sup>.

## **KAPITULLI. III. LËVIZJA E ARMATOSUR NË TREVËN E ELBASANIT NË VITET 1911-1912**

### **III. 1. Kryengritja e vitit 1911 dhe Elbasani**

Kryengritja që shpërtheu në Shqipërinë e veriut në qershorin e vitit 1910 nuk mundi të përmbushë objektivat më kryesore të saj, sepse u shtyp dhunshëm nga autoritetet osmane. Sidoqoftë ajo la pas një përvojë në qëndresën e armatosur antiosmane, jehona e së cilës u konstatua edhe në vitet e mëvonshme. Në këtë kontekst, pa u shuar ende pasojat e saj, në fillim të vitit 1911 në rrethet patriotike shqiptare po përvijohesh gjithnjë e më shumë ideja për përgatitjen dhe shpërthimin e një kryengritjeje të re<sup>444</sup>. Kjo kryengritje do të kishte si synim madhor plotësimin e kërkesës kryesore që shtronte aso kohe lëvizja patriotike, sigurimin e autonomisë së Shqipërisë<sup>445</sup>. Ndërkaq, përvoja e fituar në kryengritjet e mëparshme shërbente si një premisë më shumë në mirorganizimin e qëndresës së armatosur antiosmane përgjatë vitit 1911 e në vijim.

Në këtë kuadër, para patriotëve shqiptarë dilte si domosdoshmëri krijimi i një qendre organizative, mundësia e krijimit të së cilës shikohej jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij.

---

<sup>443</sup> Dielli, nr. 161, Boston, 8 gusht 1912.

<sup>444</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 442.

<sup>445</sup> Po aty.

Në rrethanat e atëhershme krijimi i një qendre të tillë jashtë vendit shihej me të drejtë si një zgjidhje e përshtatshme. Kjo qendër do të kishte si mision kryesor organizimin e një kryengritjeje të re antiosmane, programi i së cilës do të shtronte sërish kërkesën për autonomi të Shqipërisë.

Përmbushja e një programi të tillë do të mbështetej më së shumti në strategjinë e krijimit të komiteteve shqiptare jashtë territoreve të Perandorisë Osmane duke i konsideruar ato si një hallkë e rëndësishme në procesin e bashkëveprimit me komitetet brenda vendit. Pikërisht, mundësinë e krijimit të një qendre të tillë bashkërenduese patriotët shqiptarë për shumë arsye e shikonin krahas kontekstit të hapësirës ballkanike edhe në Italinë fqinje. Ndërkaq, një program i tillë gjen pasqyrim edhe në faqet e shtypit kombëtar jashtë vendit, i cili u shndërrua në tribunë të kërkesave më kryesore që shtronte për zgjidhje Lëvizja Kombëtare Shqiptare. Një kërkesë e tillë në funksion të përmbushjes së platformës së autonomisë gjen pasqyrim në një memorandum në titullin “Kërkimet e kryengritësve shqiptarë”, botuar në janar 1911 në faqet e gazetës “Zgjimi i Shqipërisë”, që në thelb shprehte kërkesat e popullsisë dibrane për krijimin e një province autonome shqiptare<sup>446</sup>.

Kështu, në funksion të organizimit të një kryengritjeje të re me iniciativën e patriotëve shqiptarë dhe atyre arbëreshë, u krijua në Bari të Italisë Komiteti “*Pro Albania*”, i cili arriti të krijojë edhe degë të tij në qytete të tjera të Italisë. Qëllimi më kryesor i tij konsistonte në regjistrimin e vullnetarëve dhe mbledhjen e ndihmave financiare në mbështetje të kryengritjes që pritej të shpërthente në Shqipëri. Anëtarë të këtij Komiteti rezultonin edhe përfaqësues të forcave politike të Italisë si republikanë, socialistë, demokratë duke përfshirë rreth 60 deputetë<sup>447</sup>.

Në pamje të parë të krijohet përshtypja se një pjesëmarrje e tillë shkon në favor të pikëpamjes se qeveria italiane e mbështeti kryengritjen e vitit 1911. Mirëpo rrjedha e mëpasme e ngjarjeve konfirmon faktin, se qeveria italiane përmes ndërhyrjes në shkurt të vitit 1911 do të ndërpresë veprimtarinë e mbledhjes së ndihmave dhe dërgimit të vullnetarëve në dobi të kryengritjes.

Ndaj në këtë kontekst, mendimi ynë nuk përputhet me atë të studiueses franceze Nathalie Clayer e cila shprehej se: “*Kryengritja e vitit 1911 ishte e shtyrë nga Italia dhe Anglia*”<sup>448</sup>.

---

<sup>446</sup> Gazeta “*Zgjimi i Shqipërisë*”, Janinë 3/16 janar 1911. Disa nga kërkesat e paraqitura janë botuar edhe në gazetën “*Times*” të Londrës, në Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, Tiranë: 8 nëntori, 1978, 219.

<sup>447</sup> Historia e Popullit Shqiptar, vepër e cituar, 442.

<sup>448</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 607.

Ndërkohë, përse i përket kohës së fillimit të kryengritjes ndër rrethet patriotike shqiptare ekzistonte mendimi që sipas rrethanave të krijuara kryengritja mund të fillonte në pranverën e vitit 1911. Kështu, kryengritja do të fillojë pikërisht në muajin mars të vitit 1911, fillimisht nga malësorët e Hotit të drejtuar nga Dedë Gjo Luli<sup>449</sup>.

Për rrjedhojë, në fillim të vitit 1911 në funksion të përpjekjeve për organizimin kryengritjes, çetat e Elbasanit hyjnë në fazën e riorganizimit, si një domosdoshmëri për të sinkronizuar veprimtarinë e tyre me qëndresën e armatosur antiosmane në shkallë kombëtare. Njëkohësisht ky proces riorganizimi shkonte sinkron edhe me udhëzimet e dhëna nga Komiteti i Manastirit në fillim të vitit 1911 enkas për zhvillimin e kryengritjes.

Në trevën e Elbasanit gjatë kësaj kohe vepronin disa çeta të armatosura antiosmane. Si të tilla përmenden: çeta antiosmane me komandant Gani Bungën, e cila aktivitetin e saj e kishte përqendruar në periferi të Elbasanit. Në përbërje të kësaj çete rezultonin si luftëtarë Kodhel Dedja, Lim Skënderi, Xhafë Malehoxha e Selman Blloshmi<sup>450</sup>.

Gjithashtu, është për t'u përmendur fakti se në të njëjtën kohë, edhe në zonën e Shpatit vepronin disa çeta antiosmane. Të tilla burimet e kohës përmendin disa prej tyre, të cilat si rreze veprimi kishin fshatrat Shelcan, Bujaras, Kuqan, Lleshan, me komandant Jonuz Topuzin, në përbërje të së cilës rezultonin 35 luftëtarë. Një ndër çetat që aktivitetin e saj e kishte shtrirë në fshatrat Valësh, Bizhdan, Llukan, Jeronisht rezultonte të ishte çeta me komandant Asllan Dervishin, e cila përbëhej nga 23 luftëtarë<sup>451</sup>.

Një çetë mjaft e rëndësishme antiosmane, që vepronte në fshatrat Gjinar, Trepsenisht, Kryezjarrth, Mlizë në përbërjen e saj kishte 32 luftëtarë dhe drejtohej nga komandanti Selim Shqahu. Çeta të tjera më të vogla vepronin në Pashtresh drejtuar nga Isuf Muça, në Zavalinë me komandant Xhepë Skënderin dhe një çetë që vepronte në fshatrat Seltë e Nezhan, e cila drejtohej nga Lef Nosi.<sup>452</sup>

Kështu, në pranverë të vitit 1911 me iniciativën e patriotëve elbasanas, do të krijohet në Shtërmen një "*Komitet i Fshehtë*", drejtues të të cilit rezultonin patriotët Nexhip Haxhiademi, Refik Myftiu, Hysen Ceka, Ymer Dervishi etj. Gjithashtu, në përbërje të Komitetit të Elbasanit një rol të rëndësishëm kanë patur edhe patriotët Simon Shuteriqi, Fetah Ceka dhe Irfan Ohri.

---

<sup>449</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 442.

<sup>450</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, 101.

<sup>451</sup> AME.

<sup>452</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, 102-103.

Qëllimi kryesor i këtij komiteti konsistonte në organizimin dhe koordinimin e veprimeve luftarake të çetave ekzistuese që vepronin në trevën e Elbasanit duke synuar bashkërendimin e veprimtarisë së tyre edhe me çetat dhe komitetet e qyteteve të tjera veçanërisht me komitetet e krahinës së Korçës e të vilajetit të Manastirit, në mbështetje të kryengritjes që kishte filluar<sup>453</sup>.

Ndërkaq, nga burimet e kohës konstatohet fakti se përgjatë muajve mars-qershor 1911 kryengritja shqiptare gjeti mbështetje dhe u përhap në krahinat e tjera të Malësisë së Mbishkodrës ku konstatohen përlëshje të ashpra me ushtrinë turke. Në këtë kuadër, u bënë përpjekje për zgjerimin e kryengritjes dhe njëkohësisht të përfshirjes në të edhe të popullsisë së Kosovës në veri dhe atyre në jug të Shqipërisë. Pikërisht, në kuadrin e përpjekjeve për të vendosur kontakte me trevat në jug të vendit, e një rëndësi të veçantë konsiderohet përpjekja për krijimin e komiteteve të fshehta të cilat u morën me organizimin e popullsisë së këtyre zonave në përkrahje të kryengritjes së popullsisë së veriut. Një funksion të tillë mendojmë se do ta përmbushë më së miri edhe komiteti i fshehtë i Elbasanit, ndërkohë që mjaft aktiv konsiderohet në këtë periudhë edhe roli i komitetit të fshehtë që njihej me emrin “*Shoqëria e Zezë për Shpëtim*”<sup>454</sup>.

Aktiviteti i komiteteve të fshehta brenda vendit fillimisht do të përqendrohej në armatosjen e asaj pjese të popullsisë që rezultonte e çarmatosur nga ekspedita ndëshkimore osmane e vitit 1910. Pas thirrjes që kryengritësit e veriut i drejtuan shqiptarëve të jugut për tu bashkuar me ta, filloi organizimi i shpërndarjes së armëve në Korçë, Elbasan, Dibër etj<sup>455</sup>. Në Elbasan në krye të një veprimtarie të tillë do të jetë klubi shqiptar i Elbasanit “Bashkimi i Ri”, i cili që në fillim të vitit 1911 do të merret me shpërndarjen e armëve jo vetëm në trevën e Elbasanit por edhe në krahinën e Dibrës. Ja si shprehet Nathalie Clayer në një nga studimet e saj: “*Kështu, që nga muaji dhjetor 1910, krerët e krahinës së Dibrës bënë të ditur kërkesat e tyre, që nuk ishin ruajtja e privilegjeve, por ishin të një natyre nacionaliste. Krerët lokalë u shtynë drejt kësaj nga klubi shqiptar i Elbasanit, i cili, në fillim të vitit 1911, shpërndau armë në krahinë*”<sup>456</sup>. Duhet thënë se detyra e klubit shqiptar të Elbasanit nën mbështetjen e Komitetit të Fshehtë të kësaj zone, ishte përqendruar gjithashtu edhe në bashkërendimin e veprimtarisë së komiteteve dhe çetave të trevave të jugut dhe të veriut me qendrën kryengritëse.

---

<sup>453</sup> Po aty, 101.

<sup>454</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 446.

<sup>455</sup> Po aty.

<sup>456</sup> Nathalie Clayer, *vepër e cituar*, 625.

Sikurse dihet, në 16 prill të vitit 1911 u organizua në Manastirin e Cepos një mbledhje me krerët kryengritës të trevave jugore, por për shkak të qëndrimit pritës të elementëve të moderuar dhe të trysnisë së faktorit të jashtëm, Komiteti i Manastirit i shtyu përgatitjet për fillimin e kryengritjes për një periudhë të pacaktuar, por gjithnjë brenda vitit 1911<sup>457</sup>. Ndërkaq, përmes burimeve të kohës informohemi edhe për ngritjen e flamurit shqiptar në Kimë të Mirditës në 27 prill 1911 dhe krijimin e një qeverie “provizore të Shqipërisë”, nga një avokat nacionalist italo-shqiptar Dr. Terence Toci duke gjetur mbështetjen e parisë shqiptare të Mirditës, Dukagjinit, Matit dhe Dibrës. Një akt i tillë parakuptonte shpalljen e një shteti të lirë dhe të pavarur shqiptar<sup>458</sup>. Ndërkohë, duhet thënë se lëvizja kombëtare shqiptare në këtë kohë shtronte kërkesa autonomiste.

Kështu, në muajt prill-maj të vitit 1911 shtypi shqiptar i kohës përmes botimit të memorandumeve të shumta bënte thirrje për mbështetjen e kryengritjes. Një pjesë e këtyre memorandumeve, që në thelbin e tyre shprehnin kërkesën për autonomi i drejtoreshin edhe qeverisë xhonturke.

Në këtë kuadër, një thirrje e Komitetit Qendror Shqiptar të kryengritjes, drejtuar shqiptarëve për tu bashkuar në luftën për vetqeverimin e Shqipërisë, gjen pasqyrim në faqet e shtypit të kohës që botohej jashtë vendit. Në të shprehej kërkesa për një Shqipëri vetqeveritare në garancinë e shteteve të mëdha por sikurse thuhej: “... nën hijen e Turkiës”<sup>459</sup>. Gjithashtu, po në faqet e gazetës “Dielli” që botohej në Boston, gjen pasqyrim edhe një thirrje e kryengritësve shqiptarë në Malin e Zi drejtuar qeverisë xhonturke nëpërmjet së cilës shpreheshin kërkesat për krijimin e një shteti autonom shqiptar<sup>460</sup>.

Në një situatë të tillë, në maj të vitit 1911 përleshje të ashpra do të zhvillohen midis kryengritësve shqiptarë dhe forcave osmane të drejtuar nga Shefqet Turgut pasha. Duhet thënë se me kryengritësit shqiptarë u bashkuan edhe vullnetarë nga Italia e Bullgaria. Gjithashtu edhe kolonitë shqiptare në mërgim u shprehën në mbështetje të kryengritësve, mbështetje kjo që u shfaq nëpërmjet ndihmës financiare, dërgimit të vullnetarëve, por njëkohësisht edhe nëpërmjet

---

<sup>457</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 446.

<sup>458</sup> Stavro Skëndi, vepër e cituar, 373. Në nismën e tij Terence Toci mendohej se kishte edhe mbështetjen e gjeneralit Ricciotti Garibaldi.

<sup>459</sup> *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ...*, vepër e cituar, 221. Thirrja është botuar në gazetën “Dielli” të Bostonit në 19 maj 1911, në gazetën “La nazione Albanese”, në fund të thirrjes është vënë vula e “Shoqërisë së Zezë për Shpëtim” e cila në mes të fushës ka një shpatë të kryqëzuar dhe një kobure.

<sup>460</sup> Po aty.

përpjekjeve të tyre për të siguruar ndihmën e fqinjëve ballkanikë<sup>461</sup>. Në këtë kohë u krijua edhe një çetë me emigrantë të ardhur nga Amerika të cilët mbanin një veshje me ngjyrat e flamurit shqiptar, në kapelet e të cilëve paraqitej motoja që do t'i udhëhiqte ata “Liri ose vdekje”<sup>462</sup>.

Në këtë kohë patriotët shqiptarë Ismail Qemali, Themistokli Gërmenji, Pandeli Cale, do të krijojnë në Korfuz një degë të komitetit shqiptar të Barit, duke intensifikuar përpjekjet për zgjerimin dhe shtrirjen e kryengritjes në jug të vendit. Pas dështimit të përpjekjeve të Turgut Pashës në muajin maj për të shtypur kryengritjen me forcë, do të dështojnë gjithashtu edhe përpjekjet e tij për të hyrë në bisedime me krerët e kryengritjes. Pikërisht, në 23 qershor 1911 në Kuvendin e Greçës do të miratohet Memorandumi i Greçës (Libri i Kuq), kërkesat e të cilit përmbledheshin në 12 pika kryesore, thelbi i të cilave më së shumti shtronte kërkesat për autonomi<sup>463</sup>. Ka mendime se në hartimin e Memorandumit të Greçës, Ismail Qemali është konsultuar edhe me ambasadorin grek në Stamboll i cili mendohet se ka bërë disa ndryshime, në këmbim të premtimit për mbështetje financiare të kryengritjes shqiptare<sup>464</sup>.

Në lidhje me këtë dëshmi pohojmë se në procesin e konsultimit me dokumentacionet e kohës për këtë periudhë vërejmë se një fakt i tillë nuk rezulton i pasqyruar në asnjë burim tjetër dokumentar.

Kështu, pas kuvendit të Greçës dhe shpalljes së vendimeve të tij, është më se evident fakti i bashkëpunimit midis komitetit të fshehtë të Elbasanit dhe atij të Korçës. Në këtë të fundit rolin kryesor e luante Themistokli Gërmenji e Ferid Frashëri, ndërkohë që në qershor të vitit 1911 kishte dalë në mal çeta e Korçës me komandant dr. Haki Mborjen<sup>465</sup>.

Veprimtaria në fjalë midis këtyre dy komiteteve rezulton të jetë kryer përmes patriotit shpatarak Kodhel Dedja. Në kujtimet e tij ai tregon se në qershor 1911 përfaqësuesit e Komitetit të Elbasanit e kishin ngarkuar si ndërmjetës për të kontaktuar me komitetin e Korçës duke i thënë se: “Do të japim postën t’ia çosh Komitetit të Korçës”. Më tej informacioni vazhdon me përgjigjen e vetë Kodhel Dedes, i cili e pranon një detyrë të tillë, por duke u shprehur se ai vetë nuk kishte njohje me përfaqësuesit e Komitetit të Korçës duke thënë: “E baj”, i thashë unë, “por

---

<sup>461</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 447. Fan Noli u përpoq për të siguruar ndihmën e Greqisë.

<sup>462</sup> Valentina Duka, *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: SHBLU, 2008, 80.

<sup>463</sup> *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së Imperializmit*, përgatitur nga Arben Puto, vëll. I, Tiranë: 1984, 364.

<sup>464</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 605.

<sup>465</sup> Po aty, 448.



nuk i njoh ata të Komitetit të Korçës”.<sup>466</sup> Në rrethana të tilla, Kodhel Dedja udhëzohet nga komiteti i Elbasanit për mënyrën e kontaktit me përfaqësuesit e Komitetit të Korçës duke u shprehur se: “ *Kur të vesh në Korçë, kërko zyrën e Themistokliut. Ne do të japim një yll të vogël sermi me një brimë me spango të lidhur aty. Kur të shkosh te Themistokliu e Ferid Frashëri, vije spangon në gishtat dhe ata do ta njohin*”. Kjo ishte parulla e njohjes së dy komiteteve ndërmjet tyre.

Dokumentacioni i kohës konfirmon faktin e përmbushjes së një misioni të tillë nga Kodhel Dedja, madje dhe përcaktimin e një date për një veprim të përbashkët midis dy komiteteve, që rezultoi të ishte data 2 gusht e vitit 1911. Por, sikurse konstatohet Komiteti i Korçës e filloi aksionin 4 ditë përpara datës së parashikuar, pikërisht në 29 korrik 1911, duke mos u koordinuar me komitetin e Elbasanit. Në këtë kuadër, informohemi për sulmin e çetave të Qamil Panaritit dhe Spiro Bellkamenit në natën e 29 korrikut në depot e armëve në Korçë<sup>467</sup>.

Sipas një tjetër burimi, fillimit më herët i sulmit nga ana e Komitetit të Korçës shpjegohet me faktin se çeta e Korçës u kap në befasi nga trupat osmane në afërsi të Korçës në kohën kur ajo donte të çlironte të burgosurit. Si rezultat i luftimeve që zgjatën disa orë rezultoi të jenë vrarë edhe gjashtë të rinj shqiptarë.<sup>468</sup> Pas një ngjarje të tillë, Komiteti i fshehtë i Elbasanit filloi të vetëveprojë duke gjetur mbështetje tek çetat ekzistuese, që vepronin në zonën e Shpatit të Elbasanit<sup>469</sup>.

Gjithashtu, në të njëjtën kohë komiteti i fshehtë i Elbasanit mbante kontakte të vazhdueshme edhe me Komitetin e fshehtë të Manastirit. Pikërisht, në kuadrin e veprimtarisë së Komitetit të Elbasanit dhe me udhëzim nga Komiteti i Manastirit, filluan përgatitjet për të kryer një aksion ndaj postës që do të nisej nga Manastiri. Ky aksion u përballua me sukses nga çeta e Elbasanit, që vepronte në zonën Polis-Shpat, e drejtuar nga Sadik Zharri. E gjithë posta që u mor në dorëzim përmbante 2500 lira angleze e turke. E rëndësishme është të përmendet fakti se kryetari i çetës i dorëzoi postaxhiut (Cen Haxhimusajt) një letër për mytesarifin e Elbasanit, i cili njoftojte se aksioni u krye për qëllime kombëtare, arsimore e kulturore<sup>470</sup>.

---

<sup>466</sup> Sh. Demiri, *Elbasani, qendër...*, vepër e cituar, 14.

<sup>467</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 455.

<sup>468</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, 600.

<sup>469</sup> Bëhet fjalë për çetën e drejtuar nga Sadik Zharri.

<sup>470</sup> Sh. Demiri, *Elbasani, qendër...*, vepër e cituar, 15.

Vetëm një shumë e vogël u përdor në të vërtetë nga Komiteti i Elbasanit. Ky aksion patriotik, që njihet në histori me emrin “Aksioni i gurrave të zeza”, bëri bujë të madhe në të gjithë Shqipërinë. Edhe sot në Shpat këndohet kënga e postës:

*Mu në Qukës n'Elbasan*

*Na kanë marrë postën tonë*

*Mytesarifi qan me lot*

*Na kanë marrë postën sot*

.....

Në fillim të shek. XX, është evident fakti se në trevën e Elbasanit, numri i çetave të armatosura antiosmane po vinte duke u rritur. Ndërkohë në Martanesh, në vitin 1911 filloi veprimtarinë një çetë antiosmane me komandant sheh Hysen Sulovën nga Elbasani, por me prejardhje nga Sulova e Gramshit. Radhët e saj shtoheshin çdo ditë me të arratisur nga Elbasani<sup>471</sup>.

Në kuadrin e përgjithshëm të kryengritjes së vitit 1911, duhet thënë se pas bisedimeve të Podgoricës, Abdullah Pasha, komandanti i ri i trupave osmane, shpalli një amnisti për malësorët që u njihte atyre vetëm disa privilegje dhe nuk përmendej çështja e autonomisë. Për këtë arsye dhe qëndresa e kryengritësve nuk u ndërpre. Porse, duke ju referuar gjendjes së vështirë në të cilën ndodheshin kryengritësit, ku kërkesat e tyre për armë municione dhe ushqime ishin të shumta dhe kundrejt presioneve të bëra edhe nga Mali i Zi i cili fillimisht i mbështeti ata, zjarri i kryengritjes gradualisht do të shuhej. Fillimisht do të nënshkruhet marrëveshja e malësorëve kryengritës me përfaqësuesit e qeverisë xhonturke dhe më pas edhe marrëveshja me kryengritësit e Shqipërisë së jugut<sup>472</sup>.

Pavarësisht faktit se kryengritja e vitit 1911, për arsye të shumta nuk arriti të krijojë një qendër të përbashkët organizative për të gjithë trevat shqiptare, ajo përbën një moment të rëndësishëm në kuadrin e Lëvizjes për autonomi të popullit shqiptar duke krijuar premisat për kryengritjet e mëvonshme.

### **III. 2. Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 në trevën e Elbasanit.**

---

<sup>471</sup> AME. Kutia. 2, D. 6, f. 7.

<sup>472</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 457-458.

Në kuadrin e kryengritjeve të viteve 1910-1911, duhet thënë se kryengritja e vitit 1912, zë padyshim vendin qendror. Një fakt i tillë ndër të tjera është rezultat i përpjekjeve të shumta të rretheve patriotike shqiptare të kohës, të cilat duke shfrytëzuar përvojën e pasur që lanë dy kryengritjet e mëparshme u munduan që dobësitë organizative të vërejtura në to, të mos përsëriteshin në kryengritjen e 1912-ës. Duke u nisur nga ky këndvështrim, theksojmë se në këtë kryengritje në dallim nga ato të mëparshmet, u evidentuan këto dukuri kryesore:

*Së pari:* Në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912 u krijua një qendër e vetme udhëheqëse e lëvizjes, në krye të së cilës u vu Hasan Prishtina.

*Së dyti:* Kjo kryengritje, ndryshe nga të parat, filloi me një program të qartë politik, pavarësisht se presioni i madh i itilafistëve e krerëve turkomanë shqiptarë çoi në një ndryshim taktik të tij në korrik 1912.

*Së treti:* Kryengritja e vitit 1912 mori karakter të përgjithshëm, duke përfshirë gati të gjitha viset shqiptare, nga Çamëria në jug e deri në Mitrovicë në trojet verilindore të vendit<sup>473</sup>.

Kështu, përmes deklaratës së Hasan Prishtinës në Parlamentin Osman në janar të vitit 1912, parakuptohej fakti se shumë shpejt në Shqipëri do të shpërthente një kryengritje e përgjithshme, duke u shprehur se: “ .. një ndër të parët që do të marrë në dorë flamurin e revolucionit, ndofta i pari ndër të parët, do të jem unë”.<sup>474</sup> Një deklaratë e tillë do të shërbejë si një sinjal drejt organizimit të një kryengritjeje të përgjithshme në trevat shqiptare. Në takimin e fshehtë organizuar në lagjen “Taksim” të Stambollit midis Hasan Prishtinës, Myfid Libohovës, Esad Toptanit, Syrja Vlorës,(deputetë në parlamentin Osman) dhe Ismail Qemalit u diskutuan planet për të ardhmen e Shqipërisë. Në kuadrin e pikpamjeve që shfaqën përfaqësuesit në këtë takim, duhet thënë se grupi i përfaqësuar nga Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina mbështetnin platformën që shtronte kërkesat për autonomi politike, ndërkohë që përfaqësuesit e tjerë nuk shkonin më larg se sa kërkesat për një autonomi administrative<sup>475</sup>. Kështu, Hasan Prishtina do të marrë përsipër organizimin e një kryengritjeje në Kosovë, Esad Pasha në Shqipërinë e Mesme e Mirditë, ndërsa Myfid Libohova, Azis Vrioni e Syrja Vlora në Shqipërinë e Jugut. Hapësira e

---

<sup>473</sup> Liman Varoshi, *Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 dhe veçoritë e zhvillimit të saj në trevën e Elbasanit*, botuar në “*Normalja në Traditë*”, Elbasan 1995, 17.

<sup>474</sup> Kristo Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912*, Tiranë: Kristalina K-H, 2008, 63-64

<sup>475</sup> Po aty, 64.

gjerë e shtrirjes së kësaj kryengritjeje kurrsesi nuk mund të linte jashtë sferës së përfshirjes edhe trevën e Elbasanit.

Duhet thënë se situata politike në trevat shqiptare në muajt mars-prill të vitit 1912 dhe veçanërisht në Kosovë erdhi duke acaruar. Një situatë e tillë, përveç të tjerave ishte rezultat edhe i presioneve dhe manipulimeve të drejtpërdrejta që u bënë gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të prillit të vitit 1912. Sikurse konstatohet nga burimet e kohës një rol përcaktues në këtë drejtim do të ketë Komisioni Qeveritar i drejtuar nga ministri i Brendshëm osman Haxhi Adil Beu, që njihet me emrin “*Komisioni i Reformave*”. Gjatë muajit mars e në vazhdim ky Komision ndërmori një udhëtim nëpër qytetet shqiptare, me motivin e zbatimit të reformave të parashikuara në katër vilajetet. Por, në të vërtetë qëllimi i këtij udhëtimi më së shumti kishte të bënte me angazhimin e tij në procesin e zgjedhjeve për në parlamentin osman në favor të deputetëve osmanë. Një qëllim i tillë pasqyrohet qartë përmes informacionit të parashtruar në raportin e konsullit të Francës në Shkup në të cilin thuhej se: “... *por Ministri, siç thuhet, është përpjekur sidomos të bindë popullatën që të mos i rizgjedhë deputetët e vjetër shqiptarë Hasan Beun dhe Nexhip Bej Dragën*”<sup>476</sup>.

Ndërkohë, mospjesëmarrja e bejlerëve shqiptarë të Shkupit në takimin e organizuar prej Ministrisë të Brendshme ishte konfirmim i qëndrimit mosbesues që shqiptarët kishin shprehur kundrejt një komisioni të tillë. Duhet thënë se pritje armiqësore ju bë këtij komisioni veçanërisht në Kosovë, në Pejë, Prizren e në Krumë. Ndërsa, në Gjakovë Komisioni i reformave u prit me luftë në hyrje të qytetit, një sulm organizuar nga forcat kryengritëse shqiptare, të cilat në situatën e krijuar po përgatiteshin për shpërthimin e një kryengritjeje të përgjithshme<sup>477</sup>. Kështu, nëpërmjet informacioneve të konsujve a-h, konstatohet fakti se në 10 prill 1912 popullsia e krahinave të Gashit, Bytyçit, Krasniqit, Hasit kishin lidhur besën duke ftuar edhe krahinat e Malësisë së Gjakovë, Mirditës, Shkodrës për tu bashkuar me Lidhjen e tyre<sup>478</sup>.

Ndërkaq, në këtë kohë në raportet e nën/konsullit a-h të Durrësit flitet edhe për zhvillime luftimesh në Elbasan, pikërisht në prill të vitit 1912 duke pohuar se: “*Arnautët e Krujës dhe*

---

<sup>476</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, vëll. II, përgatitur nga Muhamet Shatri, Tiranë: Botimet Toena, 2012, 30. Raport i konsullit francez në Shkup, më 5 mars 1912.

<sup>477</sup> *Po aty*, 40. Raport i konsullit francez në Shkup, më 14 mars 1912.

<sup>478</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. III, përgatitur nga Hamit Kaba, Beqir Meta Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012, 115. Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Prochaska.

*Elbasanit posejdojnë pushkë “Gras”, “Mauzer” dhe “Maliher” të marra pjesërisht prej shtetit*”<sup>479</sup>.

Kështu, në kuadrin e udhëtimit të këtij Komisioni dhe ndalesave të tij në qytetet shqiptare, një pritje aspak e këndshme ju bë edhe Elbasan në 3 prill 1912, ku sikurse thuhej përveç disa bejlerëve dhe Esad Pashës që e shoqëronin atë [Ministrin e Brendshëm] nuk doli njeri për ta pritur<sup>480</sup>.

Përmes dokumentacionit përkatës të kësaj periudhe, konstatohen përpjekjet e Komisionit të Reformave të mbështetur nga krerët drejtues të administratës osmane për të kushtëzuar zgjedhjet parlamentare. Në këtë kuadër, në një takim të fshehtë të organizuar në Strugë midis Valiut të Manastirit dhe një prej përfaqësuesve të Komisionit të Reformave Hajdar Beut, rezulton të jetë diskutuar strategjia zgjedhore e Qeverisë Osmane në vilajetin e Manastirit. Në këtë kuadër, burimet e kohës flasin edhe për pjesëmarrjen në këtë takim të Myftiut të Elbasanit<sup>481</sup>.

Raportet zyrtare të konsujve francezë, japin të dhëna interesante rreth kandidatëve përfaqësues të sanxhakut të Elbasanit në zgjedhjet parlamentare të kësaj kohe. Kështu, në listën e kandidatëve për deputetë në Parlamentin osman të Sanxhakut të Elbasanit rezultojnë emrat e Dervish Bej Biçakut dhe Shefqet Bej Vërlacit, të cilët sipas pohimit të nënkonsullit të Francës në Manastir rezultonin në krahun e opozitës. Ndërkohë, për sa i përket pozicionit të Aqif Pashës ai shprehet se: “... *përkrahet pakëz nga Komiteti*”<sup>482</sup>. Gjithashtu, në të njëjtin burim konsulli francez përmend edhe mundësinë e kandidimit të Dervish Himës, duke u shprehur se: “*Me gjasë, do të paraqitej edhe Dervish Hima; është e mundshme që Shefqet Beu të shtyhet para tij*”<sup>483</sup>.

Ndërkohë, figura e Shefqet bej Vërlacit përmendet edhe në burimet austro-hungareze. Sipas raportimeve të konsullit austro-hungarez në Manastir konstatohet fakti se ai ishte kandidat i partisë nacionale shqiptare dhe emri i tij gjendej në listën e re të rekomanduar nga Dervish Hima. Sipas këtyre konstatimeve, informohemi për faktin se Shefqet beu nuk kishte hequr dorë

---

<sup>479</sup> Po aty, 71. Raport i konsullit A-H në Durrës, Rudnay, dërguar kontit Berchtold në Vjenë. Letra është dërguar në 10 prill 1917.

<sup>480</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vepër e cituar, 114. Raport nën/konsullit austro-hungarez të Durrësit Rudnay, drejtuar Ambasadorit Pallavicini në Stamboll.

<sup>481</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, vëll. II, përgatitur nga Muhamet Shatri, Tiranë: Botimet Toena, 2012, 50. Raport i nën konsullit francez në Shkup, më 29 mars 1912.

<sup>482</sup> Po aty, 52. Raport i nën konsullit francez në Shkup, më 29 mars 1912.

<sup>483</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë ...*, vepër e cituar, 50. Raport i nën konsullit francez në Shkup, më 29 mars 1912.

nga kandidatura për deputet pavarësisht presionit të bërë nga Ministri i Brendshëm Haxhi Ali Beu, duke e shpjeguar këtë rezistencë të tij më tepër me karakterin oportunist të Shefqet Vërlacit dhe duke u shprehur njëkohësisht se: “Ai[Shefqet Beu] ndoshta do të bëhet një opozitar që do të lundrojë në ujërat e Esad Pashës”.<sup>484</sup> Ndërkohë, informohemi se në Elbasan ishte krijuar një Komitet, porse roli i Shefqet beut në strukturat e këtij komiteti nuk kishte qenë i dukshëm<sup>485</sup>.

Në këtë kuadër, nisur nga sa parashtruam më lart mendojmë se Shefqet bej Vërlaci përmes adoptimit të strategjisë së oportunitetit në thelb reflektonte pragmatizmin e tij politik, i cili për hir të së vërtetës do ta shoqëronte atë përgjatë gjithë karrierës së tij politike. Madje, nuk e teprojmë nëse pohojmë se interesi i tij individual do të dominojë mbi atë kombëtar. Pikërisht, përfundimi i zgjedhjeve parlamentare të prillit të vitit 1912 do të sjellë fitoren e Shefqet Bej Vërlacit si deputet i sanxhakut të Elbasanit në parlamentin Osman.

Ndërkaq, duhet thënë se situata në Shqipërinë e Veriut gjatë muajit prill kishte ardhur duke u acaruar dhe përleshjet midis kryengritësve shqiptarë dhe garnizoneve turke në Krumë e Has pasqyroheshin në raportet që konsulli i Francës në Shkup u dërgonte eprorëve të tij.<sup>486</sup> Në muajt maj-qershor 1912, kryengritja në Kosovë mori përmasa të gjera duke përfshirë jo vetëm viset e tjera të saj, por veçanërisht pas Kuvendit të Junikut duke u shtrirë edhe në Shqipërinë e Mesme dhe duke marrë përmasat e një kryengritjeje të përgjithshme.

Duke ju referuar përvojës së kryengritjeve të tjera natyrshëm lind pyetja nëse pati sadopak mbështetjen e faktorit ndërkombëtar kryengritja e vitit 1912 ?

Duhet thënë se sikurse edhe në kryengritjet parardhëse, edhe në periudhën e zhvillimit të kryengritjes së vitit 1912, koniunkturat ndërkombëtare nuk rezultojnë në favor të çështjes shqiptare. Në këtë kohë, Fuqitë e Mëdha pavarësisht krijimit të aleancave rivale vazhdonin të respektonin parimin e ruajtjes së një ekuilibri relativ. Kështu, nëse do të referohemi qëndrimit të Anglisë burimet e kohës flasin në favor të faktit se diplomacia angleze vazhonte të qëndronte në pozita neutrale, qëndrim që më së shumti pasqyrohet nëpërmjet përgjigjes që Konsulli britanik në Shkup i jep Hasan Prishtinës duke i pohuar se: “ ... vendi i tij[Britania] nuk kishte interesa në Ballkan, prandaj as nuk do ta kundërshtonte, as nuk do ta përkrahte kryengritjen kundërosmane

---

<sup>484</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vepër e cituar, 130. Raport i konsullit Halla

<sup>485</sup> Po aty.

<sup>486</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë ...*, vepër e cituar, 60. Raport i nën konsullit francez në Shkup, më 25 prill 1912.

të shqiptarëve”<sup>487</sup>. Një qëndrim i tillë i diplomacisë britanike, pasqyron njëkohësisht edhe qëndrimin zyrtar të diplomacisë evropiane përfshirë këtu edhe A-H, të cilët akoma në verën e vitit 1912 respektonin me fanatizëm parimin e ruajtjes së status quo-së në Ballkan.

Në këtë kuadër, qëndrimi zyrtar i Austro-Hungarisë ndaj kryengritjes shqiptare rezultonte në union me atë të fuqive të tjera evropiane. Por, nënvizojmë se qëndrimi i Vjenës zyrtare pavarësisht se nuk rezultoi i drejtpërdrejtë në aspektin e përkrahjes u reflektua në trajta të tërthorta e më konkretisht, përmes presionit që ajo do të ushtrojë kundrejt Portë së Lartë për t’i mundësuar sa më shumë lëshime shqiptarëve në drejtim të autonomisë së kërkuar. Pikërisht një realitet të tillë e pasqyron edhe ambasadori francez në Stamboll, ndonëse në informacionin e tij nuk përmendet në formë eksplicite autonomia<sup>488</sup>. Më tej, në raportet e konsullit francez përmendej gjithashtu edhe hyrja kontrabandë në trevat shqiptare e municioneve dhe armëve Austro-Hungareze. Në këtë kuadër, konsulli i Francës në Shkodër raportonte lidhur me kontrabandën e armëve që vinin me anijet Austriake dhe shkarkoheshin në portin e Shëngjinit. Në 14 maj 1912, ai raportonte për 70 pushkë dhe një sasi të madhe fishekësh të tipit “dum-dum” të cilat ishin zënë në portin e Shëngjinit duke u shprehur se: “*Këto armë dhe municione vijnë nga fabrika “Anniger” dhe Kompania e Triestes*” të firmave austriake.<sup>489</sup> Ndërsa ambasadori i Francës në Stamboll raportonte për ndalimin e anijeve me flamur austriak të cilat mendohej se transportonin dhe sillnin armë e municione në Shqipëri<sup>490</sup>.

Duhet thënë që përkundrejt qëndrimit të Austro-Hungarisë, Rusia do të shfaqet si kundërshtari më i fortë ndaj lëshimeve të mundshme që Porta e Lartë mund tu bënte shqiptarëve. Në funksion të përmbushjes së synimeve të saj, Rusia do të gjejë edhe mbështetjen e plotë të aleates së saj Francës, në kuadrin e aleancave që ishin formësuar në këtë periudhë në Evropë. Një qëndrimi i tillë i Ruisë pasqyrohej përmes raportit të konsullit të Francës në Shkup, i cili në 4 gusht 1912 shprehej se: “*Mua më është dukur që në interes të paqes që është interesi francez si dhe për shkak të aleancës sonë me Rusinë, duhet që unë .... të japë ndihmën time kolegut tim rus, që madje edhe më ka kërkuar, për të larguar Portën që t’u bëjë lëshime të tepërta shqiptarëve në pikpamje të autonomisë*”<sup>491</sup>.

---

<sup>487</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 464.

<sup>488</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë ...*, 100. Raport i Ambasadorit të Francës në Stamboll, 4 gusht 1912.

<sup>489</sup> Po aty, f. 68. Raport i nën konsullit francez në Shkup, për Shkëlqesinë e tij zotin Poincare, Shkup, më 14 maj 1912.

<sup>490</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë ...*, vepër e cituar, 102.

<sup>491</sup> Po aty, 100. Raport i Ambasadorit të Francës në Stamboll, 4 gusht 1912.

Duhet thënë se fillimisht edhe Italia rreshtohet përkrah fuqive evropiane që zyrtarisht nuk e përkrahën kryengritjen e vitit 1912. Qëndrimi i saj ndaj kryengritjes së vitit 1912 do të jetë në union me qëndrimin e Fuqive e tjera të Evropiane. Pikërisht, një pozicionim i tillë i diplomacisë italiane ndaj kryengritjes shqiptare konstatohej edhe në një letër të Fadil pashë Toptanit i cili pas një bisede që kishte pasur me Ismail Qemalin shprehej se: “*Ismail Qemal beu duket se nuk pret shumë gjëra prej italianëve. Në Korfuz ai bisedoi shumë herë më konsullin italian të Janinës që gjendet atje. Qëllimi i Italisë është ti mbaj shqiptarët me shpresë, deri sa të kapërcej telashet që ka sot*”<sup>492</sup>.

Gjithashtu, në kuadrin e veprimtarisë për të siguruar aleatë duhen evidentuar edhe përpjekjet e krerëve drejtues të kryengritjes për krijimin e një aleance shqiptaro-bullgare. Porse këto përçapje nuk rezultuan të sukseshme, për faktin e vetëm se Bullgaria dhe shtetet ballkanike tashmë kishin hyrë në fazën e përfundimit të marrëveshjeve midis tyre në funksion të krijimit të një aleance Ballkanike.

Nga ana tjetër, Mali i Zi dhe Serbia nisur nga interesat e tyre tipike pragmatiste u treguan të gatshëm për të furnizuar kryengritësit shqiptarë me armë. Mbështetja e Malit të Zi evidentohet përmes letrës që Hasan Prishtina nga Selaniku do t’i dërgonte në 15 maj 1912 Ismail Qemalit, ku midis të tjerave thuhej se: “*Mali i Zi ka dhënë armë e municion për një kryengritje në Kosovë, por duhen të holla për ushqime dhe nevoja të tjera*”<sup>493</sup>.

Ndërkohë, gatishmëria e Serbisë në funksion të përmbushjes së një premtimi të tillë për mbështetje ndaj kryengritësve do të rezultonte e vlefshme vetëm në këmbim të plotësisht prej kryengritësve të disa kërkesave të parashtruara prej saj, midis të cilave kërkesa që i drejtohej kryengritësve shqiptarë për të hequr dorë nga drejta e autonomisë, duke kushtëzuar njëkohësisht edhe kohën e fillimit të kryengritjes. Pavarësisht kundërshtimit të një kërkesë të tillë, në 23 qershor të vitit 1912, Idriz Seferi, Hasan Balanca nga Dibra dhe Mehmet Zajmi nga Peja do të shkojnë në Serbi për të përfunduar një marrëveshje midis Serbisë dhe Shqipërisë. Pas dy ditësh Hasan Balanca do të gjendet në Sofje të Bullgarisë, e më pas në Rumani e Malin e Zi. Qëllimi kryesor i këtij udhëtimi konsistonte më së shumti jo vetëm në përpjekjet për të siguruar aleatë në vendet fqinje, (pavarësisht qëndrimit indiferent të tyre), por njëkohësisht edhe në

---

<sup>492</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vepër e cituar, 252.

<sup>493</sup> Po aty, 252. Përkthim i një letrë të Fadil pashë Toptanit, Nicë 5 maj 1912.



sigurimin e furnizimeve me armatimeve përmes kontakteve me shoqëritë dhe komitetet e fshehta shqiptare dhe të huaja që vepronin në këto vende<sup>494</sup>.

Në këtë kontekst, përta i përket qëndrimit të komiteteve të fshehta bullgare, konsulli austro-hungarez Kral shprehej se: *“Me revolucionarët bullgarë nuk ekzistojnë akoma marrëveshje të plota, por ka shenja për një gjë të tillë”*<sup>495</sup>.

Ndërkaq, duhet thënë se një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e kryengritjes së pranverës të vitit 1912, do të japin komitetet shqiptare që ushtronin veprimtarinë e tyre jashtë Shqipërisë. Ndër to më aktivë rezultojnë komiteti italo - shqiptar i formuar në Itali, shoqëritë patriotike në Rumani, Angli, Amerikë etj. Ndiha e tyre më së shumti konsistonte në mbështetjen financiare, në funksion të sigurimit dhe furnizimit të kryengritjes me armë dhe municione, sikurse pohohet edhe në informacionin e konsullit austro - hungarez Kral, i cili shprehej se: *“Kolonitë shqiptare jashtë vendit e ndjekin me interes të gjallë lëvizjen në mëmëdhe. Duket se ato do të ishin të gatshme të bënin për këtë edhe sakrificë materiale”*<sup>496</sup>.

Duhet thënë se një rol të rëndësishëm në funksion të mbështetjes financiare të kryengritjes së vitit 1912, ka dhënë Komiteti Ballkanik i Londrës, me përfaqësuesit e të cilit Ismail Qemali mbante kontakte të drejtpërdrejta.<sup>497</sup>

Pikërisht, rreth takimit të tij me përfaqësuesit e Komitetit Ballkanik në Londër, informohemi përmes një informacioni të përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vjenës dërguar eprorëve të tij i cili raportonte për një marrëveshje midis Ismail Qemalit, Komitetit Ballkanik të Londrës dhe disa personaliteteve kompetente të Anglisë duke u shprehur: *“Me kusht që të vijë në fuqi Qamil Pasha dhe Ismail Qemalit i jepet një post me rëndësi, ky i fundit u mori para anglezëve me detyrimin që të punojë për të dërguar në Londër një delegacion qeveritar turk, i cili pjesërisht të përbëhet prej klerikësh”*.<sup>498</sup> Ndërkohë, në favor të mbështetjes financiare që vinte nga Londra në 25 qershor të vitit 1912 konsulli austro-hungarez Kral pohonte se: *“ ... janë përhapur fjalë se në Shqipëri vjen flori edhe me anën e Komitetit Ballkanik të Londrës”*<sup>499</sup>.

---

<sup>494</sup> Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912, vëll. II, vepër e cituar, 135.

<sup>495</sup> Po aty, 156.

<sup>496</sup> Po aty, 155.

<sup>497</sup> Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912, vëll. II, vepër e cituar, 325. Letër e Fadil pashë Toptanit, Paris 24 maj 1912.

<sup>498</sup> Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912, vëll. IV, përgatitur nga Ana Lalaj, Eriketa Kambo, Sonila Boçi, Botimet Albanologjike, Tiranë: 2012, 151.

<sup>499</sup> Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912, vëll. III, vepër e cituar, 155.

Në këtë kuadër, do të jetë Ismail Qemali në cilësinë e përfaqësuesit të komitetit shqiptar, aktiviteti i të cilit do të konsistojë në përpjekjet drejt intensifikimit të procesit të koordinimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së komiteteve dhe shoqërive brenda dhe jashtë vendit në favor të çështjes shqiptare. Por, në të njëjtën kohë veprimtaria më e rëndësishme e Ismail Qemalit do të konsistojë në përpjekjet e pandërprera të tij për të siguruar mbështetje diplomatike në qarqet e diplomacisë Europiane, mbështetje e cila historikisht i kishte munguar Lëvizjes Kombëtare Shqiptare<sup>500</sup>.

Duke vlerësuar rrethanat e cituara më lart, mendojmë se drejtuesit e kryengritjes u përpoqën së tepërmi të shfrytëzonin situatën e krijuar në Perandorinë Osmane dhe kontradiktat që ekzistonin midis qeverisë osmane dhe opozitës. Në këtë kontekst, përpjekjet e tyre u përqendruan në gjetjen e aleatëve të mundshëm në radhët e kësaj opozite. Një aleat i tillë në këtë periudhë konsiderohej partia opozitare turke “*Liri dhe Marrëveshje*”. Në të njëjtën kohë kryengritësit shqiptarë vendosën kontakte edhe me shoqëritë e fshehta që vepronin në radhët e ushtrisë osmane [që konsideroheshin kundërshtarë të qeverisë xhonturke] dhe gjithashtu me komitetin Bashkim dhe Përparim. Një organizatë [Ligë] e fshehtë që drejtohej nga “*Grupi i oficerëve shpëtimtarë*”, njihej me emrin “Hifzi Vatan” (Ruajtja e Atdheut), në të cilën përveç oficerëve osmanë, anëtarë të saj rezultojnë edhe pjesa më e madhe e oficerëve shqiptarë në ushtrinë osmane<sup>501</sup>. Shfrytëzimi i mundësive të tilla nga krerët e kryengritjes deri diku rezultoi i sukseshmën. Produkti i një politike të tillë evidentohet dukshëm fillimisht në dezertimet në masë që u konstatuan në radhët e ushtrisë osmane duke shfaqur edhe shenjat e para të një situate të trazuar në Perandorinë Osmane.

Ndërkaq, në Elbasan në qershor 1912 filloi riorganizimin e saj çeta e Bushekut (e njohur më parë me emrin çeta e Funarit). Kjo çetë kishte në përbërjen e saj 50 luftëtarë. Një rol të rëndësishëm në këtë çetë ka luajtur dhe Irfan Ohri, njëherësh dhe komandant i saj. Nga dokumentacioni i kohës rezulton se veprimtaria e kësaj çete ka vazhduar deri në shtator 1912<sup>502</sup>. Në rrezen e aksioneve të saj u përfshinë krahinat e Elbasanit, duke e detyruar ushtrinë turke t’i mbajë forcat e saj të shpërndara e duke mos qenë në gjendje t’i dërgojë ato në Kosovë për shtypjen e kryengritjes së atjeshme, me të cilën kishin lidhje edhe çetat e Elbasanit. Radhët e

---

<sup>500</sup> Po aty, 177. Letër e Fadil Toptanit, dërguar nga Nica në 5 maj 1912. Gruaja e Sherif pashës redaktori i gazetës “Meshruriet” në Paris vuri në dispozicion për kryengritjen 15 mijë franga.

<sup>501</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, vepër e cituar, 474.

<sup>502</sup> AME, Kutia. 2, Dos. 6, f. 8.

kësaj çete u mbushën me ushtarë shqiptarë të cilët dezertonin nga radhët e ushtrisë osmane. Dezertime të tilla konstatohen që në maj të vitit 1912, ndërkohë që një muaj më vonë ato kishin marrë karakter masiv duke përfshirë jo vetëm shqiptarët që shërbenin në ushtrinë osmane po edhe bullgarë apo maqedonas<sup>503</sup>.

Në këtë kuadër, një informacion i plotë përsa i përket dezertimeve në radhët e ushtrisë osmane, na vjen përmes raportimeve të rregullta që konsujt austro-hungarezë në Shqipëri u drejtonin Vjenës zyrtare gjatë muajve qershor-korrik të vitit 1912. Përmes këtyre informacioneve konstatohet faktin se dezertimet e para të ushtarëve shqiptarë në radhët e ushtrisë osmane evidentoheshin në Manastir, Dibër, Korçë, Kruçev, ku sipas informacioneve të marra ushtarët që dezertonin transportonin me vete armë dhe municione. Në këtë kontekst, vetëm në Dibër brenda një nate rezultojnë të jenë arratisur nga korpusi VI i ushtrisë osmane rreth 50 ushtarë shqiptarë dhe disa oficerë<sup>504</sup>. Ndërkohë që sipas të dhënave të konsullit austro-hungarez në Manastir në 25 qershor 1912 kryengritësit në Dibër kishin filluar përsëri kontaktet me Elbasanin.<sup>505</sup> Nga po i njëjti burim informohemi edhe për faktin e rritjes së numrit “të fisnikëve” nga Shqipëria e jugut dhe e veriut, të cilët ishin bashkuar me trupat e arratisura duke pohuar se: “... *Kjo vlen për sanxhakun e Ohrit, të Elbasanit, Dibrës, ndërsa nga Korça nuk kemi akoma lajme*”<sup>506</sup>.

Në këtë kuadër, pohojmë se kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 edhe në trevën e Elbasanit do të gjejë një mjedis ku kishte kohë që ishte ndezur qëndresa e armatosur dhe e organizuar antiosmane. Duhet thënë se në verën e vitit 1912, në trevën e Elbasanit vërejmë se janë të pranishme përpjekjet e patriotëve elbasanas për të induktuar në kryengritjen e përgjithshme veprimet e armatosura që zhvilloheshin asokohe në këtë zonë. Konkretisht, në fillim të qershorit 1912, në shtëpinë e Ali Agjahut në kryesinë e Aqif Pashës, zhvillohet mbledhja që vendosi shpërthimin e kryengritjes në trevën e Elbasanit ku si pjesëmarrës aktive rezultojnë figura të tilla si : Lef Nosi, Ahmet Dakli, Hysen Sulova, Ali Çelimara, Ali Çausi, Ahmet Isai, Irfan Ohri etj. Duke ju referuar dokumentacionit të kohës rezultojnë fakti se Irfan Ohri u zgjodh në krye të Komitetit Organizator Revolucionar të kryengritjes për Elbasanin<sup>507</sup>. Në

---

<sup>503</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëll. III, vepër e cituar, 93. Relacion i konsullit austro-hungarez Halla në Manastir drejtuar kontit Berchtold.

<sup>504</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, vepër e cituar, 474. Burimet austro-hungareze evidentojnë faktin se dezertimet janë konstatuar jo nga korpusi VI sikur thuhet në Historinë e Popullit Shqiptar, por nga korpusi i VII.

<sup>505</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. III, vepër e cituar, 150. Letër e konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla drejtuar kontit Berchtold në 25 qershor 1912.

<sup>506</sup> Po aty, 171. Letër e konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla drejtuar kontit Berchtold në 27 qershor 1912

<sup>507</sup> AQSH. Fondi. Lef Nosi, (nr. 32), Dos. 132, 3-4.

pamje të parë të bie në sy fakti se në krye të kryengritjes së Elbasanit vihet një jo elbasanas. Duke ju referuar studiuesve një fakt i tillë është produkt i këtyre faktorëve:

Së pari: Irfan Ohri ishte i nipi i Aqif Pashës dhe si i tillë ai përfaqësonte autoritetin e Pashës i pamundur për të ndjekur veprimet konkrete të kësaj kryengritjeje

Së dyti: Nga pikëpamja e origjinës Irfan Ohri rridhte nga një familje me tradita patriotike<sup>508</sup>.

Kështu, pas përfundimit të mbledhjes pjesëmarrësit e saj u shpërndanë në krahina të ndryshme të Elbasanit për organizimin dhe mobilizimin e patriotëve deri në zonat më periferike të Elbasanit. Më konkretisht, rezulton se Lef Nosi shkoi në Shpat, Ahmet Dakli e Ali Çausi në Martanesh dhe Asllan Shahini në zonën e Gramshit, që prej kohësh konsiderohej si një qendër e rëndësishme e lëvizjes kombëtare shqiptare. Pikërisht, nëpërmjet një artikulli botuar në gazetën “Drita” informohemi se në qershor të vitit 1912, nga Elbasani kishin dalë në mal me dhjetëra luftëtarë, për të organizuar dhe mbështetur kryengritjen e përgjithshme, duke shkruar “...*Po në Gramsh ç’bëhet? Në Gramsh kanë ikur më shumë njerëz. krahinat e Gramshit, Vërçës dhe Sulovës janë krejt në këmbë*”<sup>509</sup>. Nëpërmjet informacionit të kësaj gazete, pasqyrohet njëkohësisht edhe vlerësimi real që i bëhet gjendjes së gatishmërisë dhe pjesëmarrjes së Gramshit në kryengritjen e përgjithshme dhe kontaktet e shpeshta të patriotëve gramshakë me Aqif Pashë Elbasanin.

Në kryengritjen e vitit 1912, Gramshi u angazhua me dy çeta, të cilat në përbërjen e tyre rezultonin të kishin disa qindra luftëtarë të drejtuar nga patriotët Qazim Dyrmyshi dhe Asllan Shahini. Ja si e pasqyron këtë ngjarje një gazetë e kohës: “*Ditën që do të hapej mbledhja (në fshatin Kryezjarrth), arritën prej çdo katundi përfaqësorës, si dhe z. Asllan Shahini dhe Qazim Dyrmyshi me çetat e tyre prej Gramshi*”<sup>510</sup>.

Në komisionin e posaçëm të krijuar për të njoftuar me telegram Hasan Prishtinën në Kosovë, se e ngarkonin edhe përfaqësues të Elbasanit në komisionin shqiptaro-turk, bënte pjesë dhe përfaqësuesi i Gramshit, Asllan Shahini<sup>511</sup>. Ndërkohë, Elbasani do të dërgojë përfaqësuesit e vet, ndër të cilët përmenden Lef Nosi dhe Ahmet Dakli<sup>512</sup>. Përveç tyre sipas burimeve austro-

---

<sup>508</sup> Liman Varoshi, Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 dhe veçoritë e zhvillimit të saj në trevën e Elbasanit, në “*Normalja në Traditë*”, vepër e cituar, 19.

<sup>509</sup> Gazeta “Drita”, 19 korrik 1912.

<sup>510</sup> Gazeta “Drita”, 2 gusht 1912.

<sup>511</sup> Po aty, 16 gusht 1912.

<sup>512</sup> S. Skëndi, vepër e cituar, 388.

hungareze rezultonte se në 30 korrik 1912 edhe Irfan Ohri ishte nisur si përfaqësues i Elbasanit në bisedimet që do të zhvilloheshin në Prishtinë midis kryengritësve shqiptarë dhe komisionit qeveritar osman<sup>513</sup>.

Pikërisht, në të njëjtën kohë në trevën e Elbasanit vepronin disa çeta të armatosura, radhët e të cilave u mbushën me ushtarë që dezertonin nga garnizonet turke dhe arratiseshin në male. Ndërkohë, që në qershor të vitit 1912, kishte filluar riorganizimin e saj çeta e Bushekut (e njohur më parë me emrin çeta e Funarit). Kjo çetë kishte në përbërjen e saj 50 luftëtarë. Ndërkaq një rol të rëndësishëm në këtë çetë ka luajtur dhe Irfan Ohri, njëherësh dhe komandant i saj. Gjithashtu, duhet thënë se edhe konsujt e huaj ishin të mirinformuar për veprimtarinë e Irfan Ohrit duke u shprehur se: “*Irfan Beu së bashku me 30 vetë ka shkuar në male*”<sup>514</sup>. Veprimtaria e çetës së udhëhequr nga Irfan Ohri ka vazhduar deri në shtator 1912.<sup>515</sup> Në rrezen e aksioneve të saj u përfshinë krahinat e Elbasanit, duke e detyruar ushtrinë turke t’i mbajë forcat e saj të shpërndara e duke mos qenë në gjendje t’i dërgojë ato në Kosovë për shtypjen e kryengritjes së atjeshme, me të cilën kishin lidhje edhe çetat e Elbasanit. Ndërkohë, në korrik të vitit 1912, kryengritësit elbasanas dogjën prefekturën dhe prenë rrugën që lidhte Elbasanin me Tiranën<sup>516</sup>.

Pikërisht, në fillim të muajit korrik të vitit 1912 nën/konsulli austro-hungarez i raportonte Ministrisë së jashtme të Vjenës rreth dezertimit në masë jo vetëm të ushtarakëve por njëkohësisht edhe të nëpunësve lokalë në Elbasan, duke u shprehur: “*Në Elbasan dezertoi majori Qamil Beu me një oficer, 20 ushtarë dhe tetë nënpunësa të qeverisë*”<sup>517</sup>.

Ndërkohë në fund të muajit korrik, konsulli a-h në Manastir na paraqit një panoramë të plotë të dezertimeve në Elbasan. Nëpërmjet këtij informacioni drejtuar Vjenës zyrtare pasqyrohet edhe një listë e parisë shqiptare të arratisur nga Elbasani, midis të cilëve pothuajse të gjithë rezultojnë nga treva e Elbasanit. Pikërisht të arratisur nga Elbasani në 22 korrik 1912 rezultojnë:

1. Irfan Beu
2. Hasan Beu
3. Abdullah Beu

---

<sup>513</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, përgatitur nga Ana Lalaj, Eriketa Kambo, Sonila Boçi, Botimet Albanologjike, Tiranë: 2012, 158.

<sup>514</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. III, vepër e cituar, 309. Raport i konsullit Pollanz dërguar Pallavicinit në Stamboll. Letra mban datën 12 korrik 1912.

<sup>515</sup> AME. Kutia. 2, Dos. 6, f. 8.

<sup>516</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 482.

<sup>517</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. III, vepër e cituar, 340.

4. Gani Beu
5. Baba sheh Hyseni
6. Ismail Hakiu
7. Ahmet Dakli
8. Beqir Plangarica
9. Lef Nosi
10. Nexhip Terxhari
11. Naxhi Adem Shijaku
12. Kasem Haxhi Hyseni
13. Tohsun Lutfi Zade
14. Ali Aga <sup>518</sup>

Gjithnjë duke u bazuar në dokumentacionin e kohës, krijojmë një vizion të qartë në lidhje me përpjekjet e shumta që patriotët elbasanas zhvillojnë për të shtrirë organikisht veprimet e armatosura që kryhen në trevën e Elbasanit me ato shkallë kombëtare, në kuadrin e kryengritjes së përgjithshme. Në funksion të kësaj ideje, në dy nga telegramet që kryesia e Elbasanit i dërgoi kryesisë qendrore në Prishtinë gjejmë të konfirmuara dy fakte:

*Së pari*, besimin absolut që kjo kryesi ka tek Hasan Prishtina, saqë e autorizon atë të flasë dhe të shkruajë në emër të saj.

*Së dyti*, vendosmërinë e realizimit të katërbëdhjetë pikave, miratuar në kuvendin e Ferizajt në 6 gusht të vitit 1912, i cili përfaqësonte kërkesat e të gjithë shqiptarëve, duke marrë edhe autorizimet nga komitetet e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, që në thelb përfaqësonin programin politik të kryengritjes së vitit 1912<sup>519</sup>.

Ndërkohë, veprimtaria e patriotëve elbasanas ishte shtrirë deri në krahinat më të thella të kësaj treve. Pikërisht, në 4 gusht të vitit 1912, rezulton se në zonën e thellë të Shpatit do dërgohen përfaqësuesit e Komitetit Revolucionar të Elbasanit, Ahmet Dakli e Ali Efendiu. Në një letër drejtuar patriotëve në krahinën e Shpatit nga kryetari i komitetit drejtues të kryengritjes së Elbasanit Irfan Ohri shkruhej: “ *Shokëvet të nerçëm në Shpat. Punët qi na qëllun më shtrëngun të nalem nga ardhja atje. Po çoj shokët ma të nerçëm zotnit Ahmet Dakli e Ali Efendiun e të*

---

<sup>518</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, vepër e cituar, 94. Raport i konsullit Halla drejtuar kontit Berchtold.

<sup>519</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 489.

tjerë. Këto zotni kan me ju rëfymun shkakun e naljes teme e atëherë shpresoj se do t'më falni. U lutem lidhni fjalën mirë e bani gajret për mbledhjen qi kanë me ju thanë këto zotni”<sup>520</sup>.

Në këtë kuadër, duke ju referuar burimeve austro-hungareze, mendojmë se mosvajtja e Irfan Ohrit në zonën e Shpatit lidhet me faktin se ai së bashku me Hasan Beun dhe Sheh Hysenin nga Elbasani do të udhëtojnë për në Prishtinë. Qëllimi i këtij udhëtimit, më së shumti lidhet me përfaqësimin e tyre në kuadrin e një komisioni, që së bashku me një pjesë të parësisë nga Korça dhe Kolonja do të kërkojnë përkrahjen dhe mbështetjen e parisë shqiptare të Kosovës për memorandumun e miratuar në kuvendin e mbajtur në Vlorë në 4 gusht 1912<sup>521</sup>.

Ndërkaq, në kuadrin e zhvillimeve në Perandorinë Osmane rezulton se në 5 gusht 1912 qeveria do të shpërndajë parlamentin. Në 6 gusht krerët kryengritës nën drejtimin e Hasan Prishtinës, në kuvendin e organizuar në Ferizaj do të dalin me një program më të moderuar që njihet me emrin “*Katërmbëdhjetë pikat e Hasan Prishtinës*”. Në thelbin e tij miratimi i këtij programi ishte një hap prapa në krahasim me programin autonomist, por konsiderohej si një mundësi reale e cila do ti paraprinte autonomisë.

Në një raport të konsullit të Francës dërguar Parisit për gjendjen në Shkup në këtë periudhë, informohemi se situata në këtë qytet paraqitej mjaft e tensionuar. Sipas këtij informacioni, në 7 gusht 1912 në Shkup rezultonin rreth 600-700 shqiptarë të armatosur dhe rreziku i ardhjes së kryengritësve të tjerë shqiptarë pavarësisht shpërndarjes së parlamentit osman ishte prezent. Ja si shprehej konsulli i Francës në Shkup për këtë problem: “*Në të vërtetë, nuk dihet se ç'mund të ndodhë nëse bandat shqiptare të armatosura hyjnë në qytet*”<sup>522</sup>, duke shfaqur njëkohësisht edhe shqetësimin për sigurinë e francezëve dhe të huajve të tjerë që ndodheshin në qytet.

Por bisedimet midis krerëve shqiptarë për miratimin e katërmbëdhjetë pikave u zvarritën nga përfaqësuesi i komisionit osman Ibrahim Pasha. Në bisedimet midis tyre, e një rëndësie të veçantë nga pala shqiptare konsiderohej miratimi e kërkesës së kryengritësve në lidhje me amnistinë e përgjithshme dhe shërbimin ushtarak në Shqipëri. Vetëm në rast të mospranimit të këtyre kërkesave kryengritësit shqiptarë do t'i drejtoheshin qytetit të Shkupit<sup>523</sup>.

---

<sup>520</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), D. 132, datë 22 korrik 1328/4 gusht 1912, f. 3. Përkthim nga turqishtja.

<sup>521</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, vepër e cituar, 223. Letër e konsullit austro – hungarez në Manastir në 8 gusht 1912.

<sup>522</sup> *Dokumente Franceze për Shqipërinë ...*, vepër e cituar, 104. AMA E, Turquie, Guerres Balkaniques, IV, Vol. 232, 1-20 aout 1912.

<sup>523</sup> Po aty, 106. Shkup, 8 gusht 1912.

Pikërisht në këtë kohë, veprimet e armatosura në trevën e Elbasanit ishin në pikën e tyre kulmore. Në favor të këtij fakti flasin edhe dy tubimet e organizuara njëri në Kryezjarrth, me pjesëmarrjen e çetave kryengritëse që numëronin 3 mijë luftëtarë, e tjetri në Bushek, ku kryengritësit ishin vendosur që në 25 korrik dhe sipas udhëzimeve të marra nga Hasan Prishtina pritnin në gatishmëri urdhrin për t'u futur në qytet<sup>524</sup>.

Në këtë kuadër, në propozimin e tyre paraqitur mytesarifit të Elbasanit, kryengritësit e Elbasanit do të kërkojnë të lidhen telegrafisht nga qyteti i Elbasanit me komisionin qeveritar në Prishtinë dhe Hasan Beun. Delegacioni prej tetë vetash përfaqësues të kryengritësve të Elbasanit që do të shkojë në zyrën telegrafike të qytetit të Elbasanit përbëhej prej:

1. Irfan Beut
2. Abdullah Beut
3. Gani Beut
4. Ahmet efendi Daklit
5. Lef Nosit
6. Asllan Shahinit prej Gramshi
7. Ali Çaushtit
8. Hysen agë Bajraktarit.<sup>525</sup>

Në telegramin e parë që dërgohet në 10 gusht 1912, nga zyra telegrafike e Elbasanit thuhet : *“Ndiçmë e mendojmë njësoj me të mbledhunit e Shqipnis së Veriut. Të drejtat tona kombëtare ia kena shpjegue Hasan bej Vuçiternit, ish deputet i Prishtinës dhe kena autorizue atë me folë ose me shkruë në emër të komitetit të Elbasanit. Lutemi ta pranoni këtë cilësi dhe të na lajmëroni”*<sup>526</sup>.

Ndërsa, në telegramin e dytë thuhet: *“Ju lutena të na njoftoni se në ç’shcallë kanë mërrijtë bisedimet prej 14 pikash qi do të jenë një mjet shpëtimi për kombin tonë. . . Mbi ç’pika janë tue vijne bisedimet dhe cilët janë tue u pranue? Lutena na jepni shpjegime dhe na caktoni qëndrimin që duhet të mbajmë na”*<sup>527</sup>. Theksojmë se të dyja telegramet mbajnë nënshkrimin e Irfan Ohrit në cilësinë e drejtuesit të Komitetit Revolucionar të Elbasanit.

---

<sup>524</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), D. 106, datë 28 korrik1328/10 gusht 1912, 46. Letra është dërguar në orën 7 të mbrëmjes.

<sup>525</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, vepër e cituar, 291-292. Letër e konsullit austro - hungarez në Manastir, Halla.

<sup>526</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, f. 43.

<sup>527</sup> Po aty, Dos. 132, nr. 9054, përkthim nga turqishtja, f. 44.



Gjithashtu, në 10 gusht 1912, një delegacion i përfaqësuesve të komitetit revolucionar të Elbasanit rezultoi në kontakt me Ismail Qemalin, sikurse thuhet në raportimet e konsullit austro-hungarez “... për të rënë në ujdi me të”.<sup>528</sup> Delegacioni në fjalë, përbëhej prej sekretarit të nën/prefekturës së Gramshit Arsllan dhe tregtarit Haxhi-Adem-Nexhip efendiut<sup>529</sup>.

Ndërkohë, dokumentacioni i kohës flet në favor të faktit se Komiteti Revolucionar i Elbasanit mbante korrespondencë të rregullt me grupin revolucionar të Shqipërisë së Jugut me qendër në Fier, kryetar i të cilit rezultonte Islam Beu. Pikërisht, në 14 gusht të vitit 1912 në përgjigjen që Irfan Ohri i kthen komitetit revolucionar me qendër në Fier, konstatohet se komiteti revolucionar i Elbasanit e informonte atë rregullisht për zhvillimin e ngjarjeve duke u shkruar se: “*Jena korespondue me Hasan Begun. Na lajmëron se kërkimet përmbledhen ndër 14 pika ndër të cilat ato ma me randësi janë shërbimi ushtarak mu krye në Rumeli, me u dhanë armët, me u përdorë nëpunësa qi njoftin gjuhën e vendit dhe gjuha e vendit me u mësue ndër të tana shkollat. Dhe që ka shpresë të plotë që këto pika të pranohen të gjitha. Veçanërisht urdhënin me i shpërnda çetat e Itihalcevetëve( ihtilafisteve) në qoftë se ka çeta të tilla dhe ju me ndenjë të mbledhun dhe me rujte qetësinë deri në një njoftim të dytë. Janë rrena fjalët e hapuna rreth kundërshtimit*”<sup>530</sup>. Ndërkohë në 14 gusht, kryengritësit shqiptarë vazhdonin të qëndronin me vendosmëri në Shkup, por duke ruajtur qetësinë dhe disiplinën në qytet.<sup>531</sup>

Ndërkaq, diplomacia vjeneze nëpërmjet propozimit që do të bëjë Fuqive të Mëdha do të kërkojë ndërmarrjen e një akti diplomatik kolektiv ndaj Turqisë, pikërisht në funksion të pranimit të politikës së decentralizimit.<sup>532</sup> Një propozim i tillë i Austro-Hungarisë ju bë i njohur kryeministrit francez nga i ngarkuari me punë i Ambasadës Austro-Hungareze në Paris, konti Somsshiq dhe Londrës zyrtare nga i ngarkuari me punë i Ambasadës Austro-Hungareze në Londër.<sup>533</sup> Por, duhet thënë se një propozim i tillë i Austro-Hungarisë nuk do të gjejë përkrahjen unanime të diplomacisë evropiane duke e konsideruar këtë akt si tepër të rrezikshëm dhe të papranueshëm jo vetëm për interesat evropiane por edhe për shtetet ballkanike. Sipas pohimeve

---

<sup>528</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, vepër e cituar, 293.

<sup>529</sup> AQSH, Fondi .Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, nr. 9053, përkthim nga turqishtja, f. 43.

<sup>530</sup> AQSH, Fondi .Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, përkthim nga turqishtja, f. 6.

<sup>531</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë ...*, vepër e cituar, 113.

<sup>532</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 493.

<sup>533</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë ...*, vepër e cituar, 119. Telegram i të ngarkuarit të me punë të Francës në Londër.

të ambasadorit francez në Stamboll, realizimi i politikës së decentralizimit të propozuar nga konti Berchtold, parakuptonte krijimin e një entiteti shqiptar apo të vetë Shqipërisë<sup>534</sup>.

Përsa i përket Gjermanisë, pohojmë se pranimi i politikës së decentralizimit të Perandorisë Osmane, nuk rezononte me përmbushjen e interesave të saj në Ballkan dhe më gjerë. Në gusht të vitit 1912, Gjermania parimisht do ta mbështesë aleaten e saj Austro – Hungarinë për këtë problem, por duke shfaqur një qëndrim kundërshtues ndaj akordimit të autonomisë shqiptarëve dhe duke kërkuar edhe nga Vjena zyrtare një prononcim të tillë<sup>535</sup>. Një qëndrim të tillë të diplomacisë gjermane e përforcon më së miri edhe deklarimi i ambasadorit gjerman në një takim me ambasadorin francez Pera në Stamboll. Në raportin që ai i dërgonte eprorëve francezë thuhej se: *“Kolegu im gjerman mendon se është i dëmshëm propozimi i Berchtoldit ngase mendimi i tij do të ishte më me vend në këtë moment që të mbahej Qeveria Osmane në gjendjen e decentralizimit se sa të vazhdonte”*. Duke vazhduar më tej ambasadori Pera shprehej se: *“Ai mendon[ambasadori gjerman] se Qeveria e tij ka të njëjtin mendim dhe se pritja e përzemërt nga shtypi gjerman propozimit të Bechtoldit është vetëm një shenjë mirësjelljeje ndaj një aleati. Ai nuk beson se ky propozim do të përkrahet”*<sup>536</sup>.

Në një tjetër burim për këtë problem thuhej se: *“... përçapja austriake e ka befasuar qeverinë gjermane dhe se ajo nuk ka qenë e kënaqur”*<sup>537</sup>. Në këtë kuadër, pranimi i politikës së decentralizimit të mëtejshëm nga diplomacia gjermane konsiderohej si faktori kryesor që mund të përshpejtonte shpërbërjen e vetë Perandorisë Osmane. Një prononcim i tillë i ambasadorit gjerman në Stamboll përfaqësonte njëkohësisht edhe qëndrimin zyrtar të qeverisë gjermane.

Në një kontekst të tillë, sikurse konstatohet nga burimet e kohës bisedimet ndërmjet komisionit qeveritar dhe Hasan Prishtinës që kryesonte delegacionin shqiptar, përfundojnë me pranimin e 12 kërkesave, nga 14 të parashtruar në programin e Hasan Prishtinës. Një informacion i tillë i bëhet i njohur Elbasanit nëpërmjet një telegrami drejtuar Irfan Ohrit, në të cilin midis të tjerave thuhej se: *“... ato[vendimet] do të përfshinin të gjithë Shqipërinë”*, duke i kërkuar njëkohësisht edhe shpërndarjen e kryengritësve nëpërmjet fjalëve *“... Tash me*

---

<sup>534</sup> *Dokumente franceze për Shqipërinë...*, vepër e cituar, 153. Ambasadori Pera, 21 gusht 1912.

<sup>535</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, vepër e cituar, 310.

<sup>536</sup> Po aty, 153-154.

<sup>537</sup> Raymond Poincaré, *Lufta e parë dhe e dytë ballkanike si dhe Konferenca e Londrës(1912-1913)*, Shkup-Prishtinë- Tiranë: 2006, 147.

*shpërndamë të grumbulluemit*”<sup>538</sup> Ndërkohë nga kontaktet telegrafike midis Hasan Prishtinës dhe Irfan Ohrit informohemi se me pranimin e kërkesave nga Porta e Lartë, përfitonin si oficerët e ushtarët ashtu edhe nëpunësit, duke i bërë të ditur se Vilajeti i Manastirit ishte i informuar për këtë problem<sup>539</sup>.

Në 18 gusht 1912, sikurse në të gjitha trevat ku u shtri kryengritja e përgjithshme e vitit 1912, dhe në Elbasan u përhap lajmi se qeveria turke kishte pranuar kërkesat e kryengritësve shqiptarë të formuluar në 12 pika dhe me disa ndryshime. Porse, sikurse pohonte dhe atashehu austro-hungarez në Stamboll, në kërkesat e tyre shqiptarët nuk arritën të realizojnë atë më kryesoren njohjen e nacionalitetit, duke u shprehur se: *“Dokumentet personale të tyre do të vazhdojnë të mbajnë si deri më sot shënimin, si: myslim(mysliman), rum(ortodoks) dhe latin(katolik). Kërkesa e shqiptarëve për të shtuar kombësinë, që është fjala “arnaut” iu refuzua prerazi atyre”*<sup>540</sup>. Në po të njëjtin burim për sa i përket arritjeve më kryesore të shqiptarëve nëpërmjet kryengritjes së vitit 1912 ai do t’i përmbledhte në tri pika: armët, nëpunësit dhe shkollat.

Pas miratimit të 12 pikave, Komiteti Revolucionar i Elbasanit duke qëndruar në gatishmëri të plotë, kishte planifikuar dhe organizuar në detaje edhe planin e hyrjes së kryengritësve në qytetin e Elbasanit. Për këtë veprim, kryesia e Komitetit Revolucionar të Elbasanit në 18 gusht 1912 njofton Hasan Prishtinën se, sipas urdhrin të tij në 19 gusht kryengritësit e Elbasanit do të futeshin në qytet dhe më pas do të shpërndareshin.

Duke ju referuar dokumentit përkatës në të cilin parashtrohet plani i kryengritësve elbasanas përcaktohet edhe itinerari i lëvizjes së kryengritësve, të cilët do të niseshin nga Busheku duke kaluar urën e Shkumbinit për të ndaluar në Namazgjah. Ja përmbajtja e dokumentit në fjalë: *“... . Si të mbarohen fjalët në Namazgjah nga Shoseja do të shkohet ke Zyhni Efendiu si të qëndrohet pak atje do të shkohet nga krithnat e nga Bezistani drejt në hyqymet”*<sup>541</sup>. Duke qenë të mirinformuar rreth një plani të tillë, rezulton se në godinën e klubit “Bashkimi i Ri” u bënë përgatitjet e duhura nga parësia e Elbasanit në drejtimin e Aqif Pashës për një pritje sa më dinjitoze të kryengritësve. Kështu, takimi ndërmjet kryengritësve elbasanas të kryesuar nga Irfan Ohri dhe parisë së Elbasanit me në krye Aqif Pashën do të bëhet pranë urës

<sup>538</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, përkthim nga turqishtja, f. 5. Letra mban datën 1 gusht 1328/ 14 gusht 1912,

<sup>539</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, përkthim nga turqishtja, f. 5.

<sup>540</sup> Po aty, 100.

<sup>541</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, përkthim nga turqishtja, f. 7.

së Shkumbinit. Një fakt i tillë pasqyrohet edhe në faqet e gazetës “Drita” të Manastirit në të cilën thuhej se: *“Sa po dilte turma prej qytetit veç kur dhanë ball për së largu parësia e kryengritësve Irfan Beu me shokë. U përqaftuan me një simpati të madhe kur u takuan dy parësitë dhe muarën udhën për të ardhur...”*<sup>542</sup>.

Në të njëjtën kohë, një pjesë e çetës së Bushekut kishte kaluar Shkumbinin dhe kishte arritur deri në Rrapishtën e Elbasanit. Në shtator të vitit 1912 kjo çetë, e udhëhequr nga Ali Çelirama, Ali Çausi, sheh Hysen Sulova me shokë, hyn e armatosur brenda në qytet. Ali Çausi me flamurin e kryengritjes në dorë do të drejtohet në Namazgja<sup>543</sup>. Një fakt i tillë gjen pasqyrim edhe në raportin e konsullit austro-hungarez Halla i cili pasi përshkruan entuziazmin e banorëve të qytetit të Elbasanit për ardhjen e kryengritësve në qytet shprehet se: *“Një pjesë e popullsisë kishte vrapuar për t’i dalë përpara dhe pjesa tjetër i priti ata në hyrje të qytetit, ku mbajtën fjalime në sheshin e madh të rrethuar me selvi shekullore”*<sup>544</sup>. Sipas burimit në fjalë, në priten që ju bë kryengritësve elbasanas para lokalit të klubit shqiptar “Bashkimi” kishin ardhur mytesarif, paria me Aqif Pashën, korporatat e Elbasanit me flamujt e tyre si dhe fëmijët e shkollës. Sipas informacionit të pasqyruar në gazetën “Drita” thuhej se: *“Klubi Bashkimi”, ishte mbushur tund më tund...prishin një fytyrë të naltë, një atdhetar të flaktë që nderoi me një ksi kryengritje të madhe tanë Elbasanin... S’modhi si ma, po urdhnoi Aqif Pasha”*<sup>545</sup>. Kryengritësit e Elbasanit e të Gramshit, mbi 2 mijë luftëtarë më 6 gusht të 1912, hynë triumfalisht në qytetin e Elbasanit<sup>546</sup>. Porse, numri i kryengritësve të ardhur në qytet që ishte rreth 2000, dukej paksa i ekzagjeruar nga konsulli austro - hungarez. Ndërkohë që në po të njëjtin burim, përgënjeshtrohet edhe një lajm i dhënë në disa gazeta se kryengritësit nga Elbasani në kthim kanë plaçkitur depon e atjeshme të armëve, duke dhënë sqarimin se ata kishin dëbuar xhandarët prej tri karakollëve të vendosura në rrugën e tyre dhe u kanë marrë rreth 20 armë<sup>547</sup>.

Në kuadrin e veprimeve të ndërmarra pasi kryengritësit hyjnë në Elbasan, rëndësi paraqet edhe fjalimi që Irfan Ohri do të mbajë sikurse thuhet në burimet përkatëse “në ballkonin

---

<sup>542</sup> Gazeta “Drita”, Manastir, 16 gusht 1912, 1-2.

<sup>543</sup> AME. Kutia. 2, Dos. 6, f. 17.

<sup>544</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. V, përgatitur nga, Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Fatmira Musaj, Botimet Albanologjike, Tiranë: 2012, 80.

<sup>545</sup> Gazeta, “Drita”, korrik, Nr.18, 16 gusht 1912

<sup>546</sup> Gazeta, “Drita”, korrik, 1912

<sup>547</sup> Po aty, 81.

e pallatit qeveritar”<sup>548</sup> duke u shprehur se: “*Falendëroj bashkëatdhetarët që u treguan sinqerisht të flaktë me pritjen që na ban tue çmue se revolucioni ynë ishte një iniciativë për çlirim kombëtar...*”<sup>549</sup>.

Nëpërmjet burimeve të kësaj kohe konstatohet fakti se aktiviteti i Komitetit Revolucionar të Elbasanit nuk përfundon me shpërndarjen e kryengritësve të Elbasanit. Në këtë kuadër, veprimtaria e tij do të evidentohet në disa drejtime kryesore:

Së pari, në informimin e qyteteve të tjera për pranimin e kërkesave dhe për shpërndarjen e kryengritësve, sikurse konstatohet në telegramin që Irfan Ohri i dërgon Abdurraman Agës në Strugë për shpërndarjen e të mbledhurve edhe atje.<sup>550</sup> Gjithashtu, në 20 gusht të vitit 1912, një letër që mban nënshkrimin e kryetarit të grupit Revolucionar të Elbasanit Irfan Ohrit, informon Abdi Beun, Masar Beun dhe Hamid Beun në Tiranë, për pranimin e 14 pikave<sup>551</sup>.

Së dyti, në kërkesat e vazhdueshme që Irfan Ohri i dërgonte Hasan Prishtinës, për të përfituar nga shpallja e amnistisë jo vetëm të burgosurit në burgjet e Kosovës por edhe në vilajetet e tjera shqiptare. Kështu, në 18 gusht 1912 në letrën që Irfan Ohri i dërgonte Hasan Prishtinës përse i përket çështjes së amnistisë shprehej se: “... *Përfitojnë vetëm ata të burgosur në burgje të Kosovës dhe janë lanë jashtë e janë dënue të arratisunit në mungesë. Çashtja ti parashtrohet mareshallit Ibrahim Pashës për të marrë masa të shpejta*”<sup>552</sup>.

Së treti, në kërkesat për të përfituar nga amnistia e shpallur jo vetëm ata që kishin marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1912, por edhe ata që kishin marrë pjesë në kryengritjet paraardhëse.

Në këtë kuadër, në dokumentacionin e kohës përmendet emri i Selman Blloshmit nga Bërzeshta i cili ishte burgosur nga autoritetet osmane që në vitin 1911, me akuzën e pjesëmarrjes në aksionin që u bë në vitin 1911 për rrëmbimin në afërsi të Elbasanit të postës që vinte nga Manastiri. Në një raport dërguar Vjenës zyrtare konsulli austro-hungarez Halla, duke e konsideruar Selman Blloshmin si një person bashkëpunues me Austro-Hungarinë dhe pasi paraqet edhe përpjekjet e konsullit Kral për muaj të tërë për shpalljen e pafajësisë së tij, raporton për lirimin e tij pas shumë përpjekjesh<sup>553</sup>. Pikërisht, duke ju referuar burimit në fjalë,

---

<sup>548</sup> Pallati qeveritar që jepet në dokument mendojmë se është godina e Bashkisë së Elbasanit, në sheshin e prefekturës së vjetër.

<sup>549</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr.32), Dos. 132, f. 712.

<sup>550</sup> Po aty.

<sup>551</sup> Po aty. Letra mban datën 7 gusht 1328/20 gusht 1912.

<sup>552</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi (nr. 32), Dos. 132, f. 711.

<sup>553</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. V, vepër e cituar, 82.

konstatojmë faktin se sa e vështirë rezultonte lirimi i të burgosurve shqiptarë që kishin marrë pjesë në lëvizjet antiosmane të mëparshme.

Në këtë kuadër, zhvillimi i mëvonshëm i ngjarjeve konfirmoi faktin se kryengritja e përgjithshme e vitit 1912, ishte kryengritja më e madhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ndonëse e tronditi nga themelet sundimin osman në Shqipëri, nuk mundi t'i shkëpusë Stambollit të drejtën e autonomisë territoriale-administrative të Shqipërisë. Pavarësisht një fakti të tillë arritja më kryesore qëndron në faktin se shqiptarët të bashkuar nga veriu në jug u përballën së bashku dhe luftuan për plotësimin e kërkesave të tyre.

Një pohim i tillë gjen pasqyrim edhe në raportet që diplomatët austro-hungarezë i dërgonin Vjenës zyrtare duke u shprehur se: *“Për herë të parë kundër qeverisë turke luftuan së bashku myslimanët, ortodoksët dhe katolikët, për herën e parë erdhën nga të gjitha anët e Shqipërisë kërkesa gati të njëjlojta në Kostandinopojë dhe për herë të parë u bashkuan bajraktarët dhe udhëheqësit e Shqipërisë së Veriut dhe të Shqipërisë së Mesme e të Jugut për bisedime të përbashkëta në Prishtinë. Me këtë kryengritje Shqipëria pushoi së qeni vetëm një nocion gjeografik”*<sup>554</sup>. Sikurse shihet nga ky dokument hapësira gjeografike e shtrirjes së kryengritjes së përgjithëshme të vitit 1912 rezulton mjaft e gjerë. Për më tepër, kjo shtrirje konfirmon një realitet shumë domethënës sepse për herë të parë qëndresa antiosmane është e evidente në të njëjtën kohë në të gjithë trevat shqiptare.

Ndaj me të drejtë dimensionin kombëtar që përvijoi kryengritja e përgjithshme e vitit 1912, përbën tiparin më dallues të saj krahasuar me kryengritjet paraardhëse. Në hapësirën e gjerë të kësaj shtrirjeje pa dyshim që Elbasani dhe trevat e tij do të pasqyronin me dinjitet identitetin e tyre të formuar historikisht.

---

<sup>554</sup> Po aty, 100. Raport i Atasheut ushtarak austro-hungarez në Stamboll. 31 gusht 1912.

### **III. 3. Shpallja e Pavarësisë dhe ngritja e flamurit në Elbasan**

Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912, pavarësisht faktit se nuk përmbushi qëllimin më themelor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, mbi të gjitha evidentoi dukshëm dobësimin e Perandorisë Osmane. Një situatë e tillë do të shfrytëzohej më së miri nga shtetet ballkanike, të cilat jo vetëm kishin filluar tentativat e para në arritjen e marrëveshjeve midis tyre por pas përfundimit të kryengritjes së vitit 1912 ishin në fazën e përfundimit të një lige ballkanike, e konceptuar fillimisht si një mjet presioni ndaj Turqisë rreth çështjes së ndërmarrjes së reformave<sup>555</sup>. Ndërkaq një aleancë e tillë më së shumti do të rrezikonte drejtpërsëdrejti trevat shqiptare. Një realitet i tillë në këtë kohë, gjen shprehje përmes fjalëve të E. Durham e cila shkruante se: “*Efekti i këtij grushti shqiptar në Ballkan ish i elektriktë. Secili shtet ballkanas kish*

---

<sup>555</sup> Jacob Gould Schurman, *Luftërat Ballkanike (1912-1913)*, Tiranë: 2006, 49-50.

*shënuar për vete një thellë nga tokat shqiptare. Delenda est Albania[Që të djegim Shqipërinë], ishte e vetmja pikë ku të gjithë ata pajtoheshin*”<sup>556</sup>.

Kështu, në mars të vitit 1913 me ndryshimin e koniukturave politike në Bullgari pas shumë diskutimesh do të arrihet nënshkrimi i një aleance ofensive midis Serbisë dhe Bullgarisë. Një aleance të tillë të njohur si marrëveshja serbo-bullgare do ti bashkëngjitet edhe një aneks sekret<sup>557</sup>. Kjo marrëveshje u pasua nga një tjetër aleancë mbrojtëse midis Greqisë dhe Bullgarisë në maj të vitit 1912. Ndërkohë që në vjeshtë të vitit 1912 diskutohej rreth mundësisë së arritjes së një marrëveshjeje të mundshme midis Perandorisë Osmane dhe Greqisë, pikërisht në 5 tetor 1912 do të nënshkruhet marrëveshja greko-bullgare që do të pasohet në 6 tetor nga nënshkrimi i aleancës midis Serbisë dhe Malit të Zi.

Në një kontekst të tillë, fuqitë evropiane rezultuan tepër të vonuara për të frenuar krijimin e një aleance të tillë midis shteteve ballkanike, përpos faktit se një pjesë e tyre ishin më se të interesuara për krijimin e një aleance të tillë. Gatishmëria e tyre për të frenuar një konflikt të pritshëm midis ligës ballkanike dhe Perandorisë Osmane, u reflektua në përpjekjet diplomatike të tyre për hartimin e një rezolute të përbashkët me konsensusin dhe miratimin e të gjitha Fuqive të Mëdha në 7 tetor të vitit 1912<sup>558</sup>. Por për shumë arsye një tentativë e tillë e Fuqive të Mëdha rezultoi tepër e vonuar, kur një ditë më pas shteti më i vogël Ballkanik, Mali i Zi do të fillojë operacionet ushtarake në kufirin e saj me Perandorinë Osmane. Një veprim i tillë nga diplomatët e kohës justifikohet me faktin se kërkesat e Malit të Zi ishin të një natyre tjetër nga ato të fuqive të tjera ballkanike. Një realitet i tillë - sikurse shprehet edhe Raymond Poincare – “nuk ishte as i pakuptim as i pabesueshëm; por nuk ishte po aq e pamundur që e vërteta të qe shumë e ndryshme. Mbreti Nikolla ashtu si vetë Mali i Zi ishte i pasur me të papritura dhe me plot humnera.”<sup>559</sup>. Përmes një pohimi të tillë mendojmë se diplomati francez në këtë rast aludonte për mbështetjen që gëzonte Mali i Zi, mbështetje që më së shumti i vinte nga Rusia.

Kështu, në kuadrin e aleancës ballkanike të shoqëruar njëkohësisht me barrën e rivaliteteve dhe kontradiktave, shkëndijën e parë të shpërthimit të luftës do ta japë Mali i Zi, duke i shpallur luftë Turqisë në 8 tetor të vitit 1912. Një akt i tillë u pasua nga Serbia e Bullgaria dhe në 18 tetor edhe nga Greqia. Disfatat ushtarake që pësoi ushtria osmane në të gjitha frontet e

---

<sup>556</sup> Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa Ballkanike*, Tiranë: 1994, 224.

<sup>557</sup> Valentina Duka, *Çështje të Historisë Bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: Kristalina, 2008, 186.

<sup>558</sup> Raymond Poincare, vepër e cituar, Shkup- Prishtinë-Tiranë: 2006, 231.

<sup>559</sup> Po aty, 236.



luftimeve që në ditët e para të fillimit të Luftës Ballkanike u shoqëruan me përparimin e shpejtë të ushtrive ballkanike në brendësi të trevave shqiptare.

Ndërkaq, në koniunkturën e reja politike të krijuara në vjeshtën e vitit 1912, lëvizja kombëtare shqiptare për herë të parë në historinë e saj do të gjente mbështetje ndërkombëtare. Ndryshimi i kësaj koniukturë nisi të krijohet dhe do të përvijohet që në vitet e fundit të qeverisjes autoritare të Otto Fon Bismarkut. Në rrethanat e atëhershme, me ardhjen e kajzerit Vilhelmit të II-të, Gjermania promovoi strategjinë globale të njohur ndryshe me emërtimin “Welt politika”. Një strategji e tillë kushtëzohet nga të qenit e Gjermanisë si aktore e ardhur rishtazi në skenën e politikës botërore. Pikërisht këtij qëllimi do t’i shërbente dhe ndërtimi i hekurudhës Berlin-Bagdat. Ndërtimi i kësaj linje hekurudhore dosmosdoshmërisht kalonte nga Ballkani, i cili në atë kohë ishte shndërruar në një arenë të ndeshjes së interesave ndërmjet Rusisë dhe Monarkisë Habsburge. Është e kuptueshme se në një koniukturë të tillë Gjermania do të mbështeste Monarkinë dualiste dhe jo Rusinë. Ndër të tjera, kjo mbështetje konfirmonte faktin se si Gjermania konservatore tejkalonte urrejtjen ndaj kozmopolitizmit që vërehet në perandorinë Habsburge për hir të interesave strategjike. Për rrjedhojë realiteti i zgjerimit të influencës së perandorisë austro-hungareze në Ballkan u bë edhe më konkret.

Në një kontekst të tillë historik, duhet parë dhe mbështetja që iu ofrua Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Por kuptimi i kësaj rrethane mbështetëse duhet bërë mbi bazën e përcaktimit se në politikë nuk ka humanizëm por pragmatizëm. Kështu në kuadrin e pragmatizmit habsburg Lëvizja Kombëtare Shqiptare, në vjeshtën e vitit 1912 do të fitonte aleatin e kërkuar potencial. Ndaj pikërisht në këtë kohë u mundësua kalimi nga platforma e autonomisë në atë të pavarësisë. Një mbështetje e tillë ju dha Ismail Qemalit në kontaktet e para diplomatike në Budapest e më pas në Vjenë. Më konkretisht përfaqësuesi i diplomacisë vjeneze konti Berchtold, do të garantojë Ismail Qemalin për përkrahjen e plotë të Austro-Hungarisë edhe nëse shqiptarët do të përpiqeshin të krijonin një shtet të pavarur shqiptar.

Në këtë kontekst, në telegramin e parë dërguar nga Vjena, Ismail Qemali njoftonte parinë e Vlorës për mbledhjen e një Kuvendi Kombëtar, duke u shprehur se: “*E ardhmja e Shqipërisë është e sigurtuar, mbani gjakftohtësinë dhe brenda dhjetë ditëve të ndodhmi në Vlorë*”.<sup>560</sup> Ndërkohë në telegramin tjetër dërguar nga Triestja në 18 nëntor, Ismail Qemali njoftonte Vlorën

---

<sup>560</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, Përgatiti Marenglen Verli, Ledia Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë: 2012, f. 164. Telegram i nën/konsullit austro - hungarez në Durrës, Rudnay, 12 nëntor 1912.

duke u shprehur se: “... *E mbledhura e përfaqësuesve në Durrës ose në Vlorë është krejt e nevojshme, çështja jonë politike u siguroa fare*”<sup>561</sup>.

Ndërkohë, duhet thënë se Ismail Qemali nuk ishte i vetmi në përpjekjet e tij për organizimin e një kuvendi kombëtar në Shqipëri. Ndërkohë që ai ishte në Vjenë, Syrja bej Vlora dhe i biri i tij Eqerem bej Vlora kishin nisur përpjekjet për të organizuar një kuvend kombëtar në një nga qytetet e Shqipërisë, sikurse thuhet në burimet austro-hungareze në Vlorë ose në Tiranë, në Krujë ose në Durrës<sup>562</sup>. Në këtë kuadër, në 13 nëntor 1912 një pjesë e parisë shqiptare duke pasur mbështetjen edhe të përfaqësuesve të familjes Toptani, ishin mbledhur në Tiranë në pritje të delegatëve të tjerë që së bashku me Eqerem bej Vlorën mendohej se do të vinin nga Elbasani dhe Berati. Këtyre delegatëve do t’u bashkoheshin edhe një pjesë e atyre përfaqësuesve që së bashku me avokatin Bexhet Efendiu do të vinin nga Tepelena, Gjirokastra, Delvina e Përmeti, duke u përpjekur për t’i dhënë këtij kuvendi karakter mbarë kombëtar<sup>563</sup>.

Por, situata në Durrës në 13 nëntor të vitit 1912 nuk paraqitej e favorshme për mbajtjen e një kuvendi Kombëtar. Sipas informacioneve të nën/konsullit austro-hungarez në Durrës Rudnay, popullsia e Durrësit veçanërisht klerikët myslimanë dhe fanatikët e qytetit kishin protestuar kundër mbajtjes së një Kuvendi Kombëtar duke u shprehur se donin të qëndronin nën sundimin e Kalifit. Në të njëjtin raport, nënkonsulli austro-hungarez i Durrësit shkruante se: “*Hoxhallarët kanë kërkuar pranë mytesarifit, nxjerrjen jashtë të delegatëve të huaj [të qyteteve të tjera] prej Durrësi*”<sup>564</sup>. Një situatë e tillë i raportohej Vjenës zyrtare një ditë më pas. Gjithashtu, duke paraqitur si alternativë të mundshme edhe mbajtjen e një Kongresi në Elbasan, konsulli austro-hungarez do të shprehej: “*Qëllimi është që kongresi të mbahet në Elbasan, Ftesa në këtë drejtim janë bërë. Në qoftë se gjendja qetësohet ndofta ka për të pasur mundësi që kongresi të mbahet, prapseprapë në Durrës. Toptanasit janë tepër të shqetësuar për shkak të qëndrimit të popullsisë*”<sup>565</sup>. Gjithashtu, për këtë problem ishte informuar edhe Esad Pashë Toptani i cili kishte dhënë edhe miratimin e tij, duke udhëzuar në të njëjtën kohë edhe

---

<sup>561</sup> K. Frashëri, *Shpallja e Pavarësia ...*, vepër e cituar, 81.

<sup>562</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze(1912)*, vëll. VI, vepër e cituar, f. 170. Raport i konsullit austro - hungarez në Vlorë, Lejhanec 13 nëntor 1912.

<sup>563</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze(1912)*, vëll. VI, vepër e cituar, f. 170. Raport i konsullit austro - hungarez në Vlorë, Lejhanec 13 nëntor 1912.

<sup>564</sup> Po aty, 172. Durrës 13 nëntor 1912.

<sup>565</sup> Po aty, 191. Njoftim nga Durrësi i nënkonsullit austro - hungarez Rudnay, Durrës, 14 nëntor 1912.

grumbullimin në Tiranë të mbështetësve të kësaj ideje<sup>566</sup>. Porse një përpjekje e tillë nuk solli asnjë rezultat të pritshëm.

Në këtë kuadër, në një situatë të tillë në 22 nëntor të vitit 1912, Ismail Qemali do të arrijë në Durrës me qëllimin për ta shpallur në këtë qytet Pavarësinë e Shqipërisë. Por, si rezultat i pengesave dhe kundërshtive që ekzistonin edhe më parë në Durrës nuk u bë e mundur ngritja e flamurit.

Ekziston mendimi që, pengesa kryesore në shpalljen e Pavarësisë në Durrës erdhi si rezultat i veprimtarisë së Dhespot Jakovit i cili bëri përpjekjet maksimale për të mos lejuar ngritjen e flamurit në Durrës<sup>567</sup>. Por, sikurse e parashtruam më lart, në Durrës edhe më parë përpjekjet për organizimin e një Kuvendi Kombëtar kishin dështuar.

Kujtimet e Ismail Qemalit evidentojnë qartë faktin se një pjesë e popullit të Durrësit, veçanërisht kleri mysliman dhe pjesa më fanatike e popullsisë, duke mbajtur një qëndrim të dukshëm konfliktual iu drejtuan grupit të Ismail Qemalit me fjalët: “... *Ju jeni tradhtarë, ju kërkoni humbjen e vatanit, prishjen e mbretërisë. Ju gënjeni sepse Turqia nuk ka humbur e nuk humbet...*”<sup>568</sup> Sikurse u konstatua më pas, ata përfaqësonin myslimanët me origjinë bosnjake të Durrësit, që ishin vendosur në sanxhakun e Durrësit; në rajonin e Durrësit, Kavajës dhe Shijakut rreth viteve 1879-1880.<sup>569</sup> Në një kontekst të tillë, alternativa tjetër e Ismail Qemalit do të jetë nisja e tij për në Vlorë në 23 nëntor 1912.

Burimet e kësaj periudhe, janë tregues i një korespondence të rregullt midis Ismail Qemalit qysh me mbërritjen e tij në Durrës dhe patriotëve Elbasanas. Në këtë kuadër, do të jetë Ismail Qemali që përmes një telegrami dërguar nga Durrësi në 22 nëntor 1912 do të ftojë në kongresin kombëtar që do të mbledhej në Vlorë patriotët elbasanas, Aqif Pashën, Shefqet Beun dhe Irfan Ohrin. Duke e konsideruar si të domosdoshme veçanërisht praninë e Aqif Pashës dhe Shefqet Beut ai shprehet se :“ ... *Në një mbledhje ku do të bisedohen masa të jashtëzakonshme e do t,epet një vendim i premë, e gjindmja e Shkëlqesës së Tijë Aqif Pashës dhe e Shevqet Beut asht e domosdoshme, edhe për këtë nuk mund të mendohet as ndonji shkak e arsye ndalimi. Prandaj i*

---

<sup>566</sup> Po aty, 195.

<sup>567</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vepër e cituar, 509.

<sup>568</sup> K. Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë ...*, vepër e cituar, 85. Mendohet se ata që ju kundërvunë I. Qemalit ishin emigrantë boshnjakë të vendosur në rrethinat e Durrësit në kohën e luftës së fundit ruso-turke.

<sup>569</sup> Nathalie Clayer, *vepër e cituar*, 85.

*shtërguem nga nevoja e punës e i shtym nga detyra patriotike, lutem qi t'urdhëroni të dy edhe pres përgjegjen tuaj*<sup>570</sup>.

Nëse do të bëjmë një panoramë të situatës politike në Elbasan në këtë kohë, duhet thënë se gjendja nuk paraqitej e qetë. Administrata e vjetër osmane vazhdonte të funksiononte akoma dhe ushtria turke nuk ishte larguar nga qyteti. Gjithashtu, lajmet rreth përparimit të ushtrisë serbe kishin krijuar në Elbasan një situatë tepër të tensionuar, veçanërisht midis popullsisë myslimane të qytetit, ndërsa sikurse shprehej nënkonsulli austro-hungarez në Durrës: “*Ajo ortodokse kuçovllahe rezultonte më e kënaqur me përparimet serbe*”<sup>571</sup>. Kështu, në emër të bejlerëve të Elbasanit, papa Germanos i kishte kërkuar nënkonsullit a-h, Rudnay të dërgonte në Elbasan një nëpunës konsullor së bashku me flamurin e konsullatës, me qëllim që në rast të një okupimi serb të qytetit Sinodi të vihej nën mbrojtjen e konsullatës a-h në Durrës<sup>572</sup>.

Pikërisht, një situatë e tillë tensioni dhe frike që ekzistonte në Elbasan në këtë kohë evidentohet edhe në telegramin dërguar nga Aqif Pasha në 25 nëntor 1912, Aziz Pashë Vrionit në Berat ku ndër të tjera thuhet se: “... *Popullit tonë[të Elbasanit] iu ka thye edhe morali keq. Paniku mbretnon edhe këtu. Zoti na ndimofte*”<sup>573</sup>. Ndërkohë, në rrethanat e krijuara nga humbjet e shumta të ushtrisë turke, ushtria serbe po përparonte me shpejtësi drejt tokave shqiptare.

Në këto momente kritike paria e Elbasanit do ta konsiderojë të domosdoshme organizimin e një mbledhjeje më 25 nëntor 1912 në shtëpinë e Aqif Pashës.

Në një telegram që i dërgohet Ismail Qemalit posaçërisht për aktin e mësipërm në emër të popullit të Elbasanit, të nënshkruar nga Aqif Pasha, Abdulla bej Tirana, Ali Agjahu, Refik Myftiu, sheh Mahmut Guma, sheh Hysen Sulova, Ruzhdi Alushi, Alush Saraçi, Veniamin Deliana, Veniamin Nosi, Kolë Papajani, Emin Haxhiademi Shijaku, Ymer Peni, Hysen Dakli, Hysen Hostopalli, Serafinë Jorgaqi, Dhimitër Papparisto e shumë të tjerë, shprehimisht thuhet: “*Gjithë populli ynë, myslimanë e të krishterë, me një za kanë pranue Indipendencën e Shqipërisë*”<sup>574</sup>.

Fakti që Elbasani prononcohet i pari në mbështetje të pavarësisë që pritej të shpallej në Vlorë nuk ishte rastësi. Si çdo ngjarje e madhe historike, edhe kryerja e këtij akti nga patriotët e

---

<sup>570</sup> *Lef Nosi dokumente historike*, depozituar në AME, Dos. 8, fl.1.

<sup>571</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, vepër e cituar, 320. Radiogram i datës 25 nëntor 1912.

<sup>572</sup> Po aty.

<sup>573</sup> *Lef Nosi Dokumente historike (1912-1918)*, Botim i Institutit të Historisë, Tiranë: Nënë Tereza, 2007, 81.

<sup>574</sup> Po aty, 80

trevës së Elbasanit ka parahistorinë e vet të largët e të afërt, që për mendimin tonë konsiston në këto aspekte kryesore:

Së pari, rreziku që përfaqësonte përparimi i rrufeshëm i ushtrisë serbe në drejtim të Elbasanit, i vuri rrethet patriotike të këtij qyteti përballë detyrës urgjente për të deklaruar pranimin e pavarësinë, me qëllimin e vetëm që të vinin autoritetet ushtarake serbe përpara faktit të kryer.

Së dyti, në popullsinë e trevës së Elbasanit tashmë ishte formuar një ndërgjegje patriotike e tillë, që ishte e vetëdijshme për detyrat dhe të drejtat e saj dhe e vendosur për t'i fituar e mbajtur ato me çdo kusht.

Së treti, në Elbasan ekzistonte një rreth patriotik i tillë që me në krye Aqif Pashën, Lef Nosin, Irfan Ohrin, Dervish Biçakun të cilët kishin kohë që ishin frymëzuar nga një patriotizëm i flaktë dhe një besim i patundur ndaj triumfit të çështjes kombëtare.

Porse shpallja e pavarësisë në qytetet shqiptare midis 26-28 nëntorit të vitit 1912, për shkak të situatës së krijuar do të ketë përmasa lokale. Qëllimi i këtyre akteve të pavarësive lokale, më së shumti do të konsistonte në ngritjen e flamurit shqiptar në qytetet shqiptare si një akt simbolik me vlera patriotike, por njëkohësisht duke krijuar një realitet të ri politik me të cilin duhej të përballëshin ushtritë e shteteve ballkanike në nëntor të vitit 1912.

Për këtë problem, në shkrimet për pavarësinë e Elbasanit ndër vite gjen përcaktime të tilla si: Elbasani e shpalli i pari pavarësinë dhe ngriti flamurin në 25 nëntor 1912, ose Elbasani e ngriti i pari flamurin në 25 nëntor dhe shpalli pavarësinë. Kështu, 25 nëntori i vitit 1912 deri më sot konsiderohet nga studiuesit shqiptarë si data e shpalljes së Pavarësisë së Elbasanit.

Porse, duke ju referuar analizës së burimeve arkivore, rezulton se dokumenti që deri më sot konfirmon faktin e ngritjes së flamurit në Elbasan dhe formimin e Qeverisë së Përkohshme të Elbasanit me kryetar Aqif Pashën, përfaqësohet nga një bisedim telegrafik i drejtpërdrejtë midis Elbasanit dhe Vlorës në 28 nëntor të vitit 1912<sup>575</sup>. Për vetë vlerën që mbart një dokument i tillë, përmbajtjen e dokumentit në fjalë po e analizojmë me hollësi si më poshtë vijon.

Çfarë konstatojmë nga një dokument i tillë:

*Së pari*, personat që flasin nga zyra telegrafike të Vlorës janë delegatët përfaqësues të Elbasanit në Kuvendin e Vlorës Shefqet Daiu dhe Lef Nosi.

---

<sup>575</sup> Ky dokument me nr.50.382, gjendet në Arkivin Qëndror Shtetëror, por më i detajuar është në botimin *Lef Nosi, Dokumente historike (1912-1918) vepër e cituar*. Dokumenti mban datën 15 Vjeshta e Tretë 1328/ 28 nëntor 1912

Së dyti, duke gjykuar nga përmbajtja e këtij dokumenti, kjo bisedë telegrafike bëhet në momentet kur në Vlorë po çelej Kuvendi Kombëtar, sikurse thotë Lef Nosi: “*Kongresi nuk ka fillue, ndashti do të hapet*”. Sikurse dihet, Kongresi Kombëtar në Vlorë është hapur në orën 4 pasdite të dt. 28 nëntor 1912.

Së treti, përmes kërkesës së Shefqet Daiu dhe Lef Nosit, për të ngritur sa më shpejt flamurin në Elbasan, gjejmë të pasqyruar faktin se deri në pasditen e 28 nëntorit 1912 flamuri në Elbasan akoma nuk ishte ngritur. Një fakt tillë konfirmohet përmes fjalëve :“ *Ndashti po e ngremë [Flamurin], Qeveria e Përkohëshme u ngref...*”<sup>576</sup>.

Pra, nëse bëjmë një paralelizëm me ngjarjet në Vlorë, pohojmë se kur në Vlorë po po çelej Kuvendi Kombëtar, në Elbasan u formua Qeveria e Përkohshme e Elbasanit dhe po ngrihej flamuri. Nëse Kuvendi i Vlorës u hap pasditen e 28 nëntorit, edhe flamuri në Elbasan është ngritur pikërisht mbasditen e 28 nëntorit. Njëkohësisht nëpërmjet këtij dokumenti, Lef Nosi dhe Shefqet Daiu informohen edhe për kryetarin e Qeverisë së Përkohshme të Elbasanit, pra Aqif Pashën. Ndërkaq, telegrafistët që komunikojnë nga Elbasani me Vlorën sipas këtij dokumenti janë Mahmud Nedim Hakani[Pavarësisht se në një telegram tjetër thuhet telegrafisti, mendojmë që aty ai është edhe në cilësinë e përfaqësuesit të parësisë së Elbasanit dhe është një ndër firmëtarët e dokumentit të dt. 25 nëntor] dhe telegrafisti tjetër është Hasan Osmanai.

Gjithashtu, një tjetër dokument që mbështet faktin se flamuri në Elbasan është ngritur në 28 nëntor 1912 dhe njëkohësisht është formuar Qeveria e Përkohshme e Elbasanit, [ku tashmë përmendet edhe shpallja e pavarësisë së Elbasanit], përfaqësohet nëpërmjet një telegrami drejtuar Vlorës posaçërisht rreth pyetjes që i bëhet nga Ohri, nëse Elbasani do ti dorëzohet apo jo ushtrisë serbe<sup>577</sup>.

Kështu, në përgjigjen që Elbasani do t’i japë Ohrit në natën e 28 nëntorit 1912 dhe gjithashtu edhe Vlorës, shprehimisht thuhet se: “*Elbasani shpalli Independencën n’emën të Shqipniës, ngriti flamurin edhe Turqit i përzuni krejt. Këtu ndashti asht formue një Qeverrië Shqiptare e Përkohshme e cila ka fillue nga detyra. T’a lajmërojmë kryetarin e Qeverriës edhe Komisionin apo jo? Sepse këtu në zyrët telegrafike nuk ka njiri*”<sup>578</sup>.

---

<sup>576</sup> Lef Nosi, *Dokumente historike (1912-1918)*, vepër e cituar, 103.

<sup>577</sup> Ky fjalim telegrafik midis Elbasanit dhe Ohrit është bërë në orën 3.40 të natës të dt. 28 nëntor.[*Sqarim, kur thuhet ora 3.40 e natës e dt. 28 nëntor rezulton ora 3.40 e mëngjesit e dt. 29 nëntor*]

<sup>578</sup> A.Q.H.i R.P.SH. F. 71, D. 1, Dok. Nr. 8122, kopje përkthim nga Tuqishtja, në Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914), Tiranë: 1963, 38.

Një përgjigje e tillë, së pari është tregues i faktit se shpallja e Pavarësisë së Elbasanit është e lidhur me ngritjen e flamurit dhe së dyti, shpallja e pavarësisë, ngritja e flamurit dhe formimi i Qeverisë lokale në Elbasan konsiderohen si evenimente të njëkohshme në 28 nëntor 1912<sup>579</sup>.

Kështu, pasi Ismail Qemali informohet për shpalljen e Pavarësisë së Elbasanit, do ti referojë parisë së qytetit udhëzimet përkatëse për qëndrimin që do të mbahej ndaj kërkesave të ushtrisë serbe nëpërmjet fjalëve: “*Kopjen e telegramës qi i dërgon komandanti i ushtëriës serbe general Metoviqi kryesiës së Bashkiës Elbasan e këndova... Pra ti jepet përgjigje se nuk është e drejtë të vazhdojë armiqësia e Qeverisë Sërbe kundër shqiptarëve, që s’kanë provokuar ndonjë farë armiqësie me qeverinë në fjalë, dhe në qoftë se nuk dëgjon, atëherë thoni që Qeveria Shqiptare për të mbrojtur të drejtat e saja proteston dhe shtoni se do të jetë e detyruar t’i drejtohet mbrojtjes dhe drejtësisë së Fuqive të Mëdha*”<sup>580</sup>. Gjithashtu, përmes dokumentacionit përkatës të kohës, konstatohet fakti se duke filluar nga 29 nëntori 1912, në telegramet që i Ismail Qemali do t’i dërgojë Elbasanit, tashmë i drejtohet organit përfaqësues lokal, Qeverisë së Përkohshme të Elbasanit dhe konkretisht Aqif Pashës në cilësinë e kryetarit të kësaj qeverie të Elbasanit.

Themi që nga ky moment, sepse burimet historike dokumentojnë faktin, se Ismail Qemali konkretisht në pasditen 28 nëntorit, pasi kishte mbaruar Kuvendi i Vlorës dhe ishte ngritur flamuri në Vlorë, në një telegram dërguar Bashkisë së Elbasanit do t’i kërkonte të shpallej Pavarësia<sup>581</sup>.

Pra, sikurse konstatohet nga ky telegram, në pasditen e datës 28 nëntor 1912, Ismail Qemali nuk kishte dijeni për atë që konsiderohet deri më sot si “Shpallja e Pavarësisë” në Elbasan në 25 nëntor 1912.

Pikërisht për këtë problem studiuesi Stefanaq Pollo në një botim të Drejtorisë së Arkivit Qendror në parathënien e tij do të shprehet se: “*Sic del nga dok. Nr. 6, [i dt. 25 nëntor], i pari që shpalli Pavarësinë në 25 nëntor ka qenë Elbasani. Megjithatë, nga Dok. Nr. 15 [ i dt. 28 nëntor] del se në Elbasan ka qenë zgjedhur Qeveria lokale, por akoma nuk ishte ngritur flamuri, kurse nga Dok. Nr. 19 [telegram I. Qemalit] Ismail Qemali nuk ka dijeni për shpalljen e*

<sup>579</sup> Përgjigja e Elbasanit jepet në orën 3. 40 të natës të dt. 28 nëntor {që është ora 3.40 e mëngjesit e dt. 29 nëntor}.

<sup>580</sup> Lef Nosi, *Dokumente historike (1912-1918)*, vepër e cituar, 95. Telegrami është dërguar në orën 4 të natës të dt. 28 nëntor 1912 (ora 4 e mëngjesit e dt. 29 nëntor)

<sup>581</sup> Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914), vepër e cituar, f. 35. Lef Nosi, *Dokumente historike 1912-1918*, vepër e cituar, 98.

*Pavarësisë në Elbasan pra [ të dt. 25 nëntor] dhe kërkon që ajo të shpallet edhe atje. Me qenë se nuk ka asnjë dyshim mbi autenticitetin e këtyre dokumentave,[ vazhdon S. Pollo], duhet të besojmë se Ismail Qemali ose nuk e ka marrë telegramin e dërguar nga Elbasani [të dt. 25 nëntor] ose nuk e ka konsideruar të vlefshme shpalljen e Pavarësisë për deri sa kjo nuk ka qenë e shoqëruar me ngritjen e flamurit kombëtar*<sup>582</sup>.

Në këtë kontekst ajo që pranohet dhe pohohet nga S. Pollo është fakti se flamuri në Elbasan nuk është ngritur në 25 nëntor 1912 dhe në konceptin e Ismail Qemalit nuk mund të kishte pavarësi pa flamur.

Ndërkohë, burimet e kohës flasin në favor të faktit se; Ismail Qemali gjatë udhëtimit të tij nga Durrësi për në Vlorë ishte informuar për shpalljen e pavarësisë në Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Mendojmë se këtë informacion Qemali fillimisht e ka marrë nëpërmjet lajmëtarëve apo delegatëve që rrugës janë bashkuar me grupin e Ismail Qemalit. Një fakt i tillë, konfirmohet përmes pohimeve të konsullit austro-hungarez në Vlorë në takimin që ai pati me Ismail Qemalin në natën e 26 nëntorit. Kështu, Ismail Qemali ishte mëse i informuar edhe për zhvillimet në Elbasan në 25 nëntor 1912<sup>583</sup>. Me mbërritjen e tij në Vlorë në natën e 26 nëntorit Ismail Qemali është informuar personalisht edhe nga delegatët e Elbasanit për zhvillimin e ngjarjeve në Elbasan në 25 nëntor 1912 duke u informuar edhe për faktin se në 25 nëntor në Elbasan nuk ka ndodhur ngritja e flamurit.

Parë në këtë këndvështrim, mendimi ynë përse i përket ngritjes së flamurit në Elbasan rezonon me atë të studiuesit S. Pollo, duke pranuar faktin se flamuri në Elbasan nuk është ngritur në 25 nëntor 1912 por në 28 nëntor 1912. Por nuk biem dakord me përcaktimin e studiuesit Pollo se në këtë datë në Elbasan është shpallur pavarësia.

Gjithashtu, nëse do ti referohemi përsëri burimeve austro - hungareze, por tashmë raporteve që konsulli a-h në Durrës i dërgonte Vjenës zyrtare, rezulton se të parët qytete që shpallën pavarësinë për ta vënë para faktit të kryer ushtrinë serbe ishin Durrësi dhe Tirana, duke pohuar se: “...qytetet e Tiranës dhe të Durrësit ishin të parët, që pavarësisht zhvillimeve në Vlorë, proklamuan lirinë e Shqipërisë dhe ngritën flamurin kombëtar shqiptar. ... me këtë lëvizje

---

<sup>582</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj...*, vepër e cituar, 8. Stefanaq Pollo dhe nuk ka bërë asnjë lloj interpretimi të dokumentit nr.25, i datës 28 nëntor, në të cilin jepet edhe ngritja e flamurit edhe Shpallja e Pavarësisë në Elbasan sikurse thuhet në këtë dokument. dokument gjendet në botimin e drejtorisë së Arkivave krahas tre dokumentave të tjerë që i është referuar Studiuesi Pollo.

<sup>583</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, vepër e cituar, 346. Telegram i konsullit austro – hungarez në Vlorë, 27 nëntor 1912.



janë bashkuar të gjitha zonat e rrethit të Durrësit dhe të Elbasanit. Mytesarifi i këtushëm[në Durrës] një shqiptar që urrehej shumë si dhe ai i Elbasanit, një turk u zëvendësuan”<sup>584</sup>.

Gjithashtu, nëse i referohemi pohimit të studiuesit Stefanaq Pollo i cili shprehet se : “... ose[Ismail Qemali] nuk e ka konsideruar të vlefshme shpalljen e pavarësisë në Elbasan, përderisa kjo nuk ka qenë e shoqëruar me ngritjen e flamurit shqiptar”, gjejmë të konfirmuar një fakt mjaft domethënës pikërisht atë që, Ismail Qemali Pavarësinë e identifikonte me ngritjen e flamurit, pra ngritja e flamurit faktikisht(de facto) përfaqësonte sipas tij shpalljen e Pavarësisë dhe pikërisht një ngjarje e tillë në Elbasan ka ndodhur në pasditen e 28 nëntorit.

Pranim i pavarësisë apo shpallje e pavarësisë në 25 nëntor 1912 ??

Dokumenti që deri më sot konsiderohet si dokumenti i shpalljes së Pavarësisë në Elbasan në 25 nëntor 1912, është telegrami që i dërgohet Ismail Qemalit nga paria e Elbasanit në 25 nëntor të vitit 1912, në orën 1.25 të natës ku shprehimisht thuhet: “Gjithë populli ynë, myslimanë e të krishtenë, me një **kan pranue** independencën e Shqipniës”<sup>585</sup>.

Ndërkohë i njëjti dokument, në botimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të vitit 1963, paraprihet nga shënimi: “Telegram i parësisë së Elbasanit, drejtuar Ismail Qemalit në Vlorë me anën e të cilit e njoftojnë se populli i Elbasanit **e pranoi** Shpalljen e Pavarësisë”. Ndërkaq, ky është dokumenti në të cilin është mbështetur Stefanaq Pollo në vitin 1963, kur shkruan fillimisht se Elbasani ishte i pari që shpalli pavarësinë. Sipas tij akti i pranimit të pavarësisë në 25 nëntor është konsideruar si akti i shpalljes së pavarësisë së Elbasanit.

Ndërkohë që një pohim të tillë për Elbasanin nuk e gjejmë të pasqyruar as në kujtimet e protagonistëve kryesorë në ngjarjet e pavarësisë në Elbasan, sikurse ishin Aqif Pasha, Shefqet Vërlaci apo edhe në dokumentacionin e akumuluar nga Lef Nosi.

Më konkretisht, në 26 nëntor Refik Bej Toptani dhe Myslim Agë Beshiri nga Tirana, i drejtohen Shefqet Bej Vërlacit [emri i të cilit rezulton në telegramin e dt. 25 nëntor që figuron si dokumenti i pavarësisë së Elbasanit] nëpërmjet fjalëve: “Po ndëgjojmë se keni shpallë

---

<sup>584</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, vepër e cituar, 420. Raport i nënkonsullit Rudnay nga Durrësi për kontin Berchtold, Durrës, më 3 dhjetor 1912.

<sup>585</sup> I njëjti telegram gjendet edhe në botimin Lef Nosi Dokumenta Historike edhe në botimin e Drejtorisë së Arkivave në vitin 1963.

*independencën. Vallë a mund të përfitohet prej këtij veprimi, po qe i vërtetë; dhe a mun't a sigurojë vendin, qi ka ngelun pa mprojtje, nga shkëlja e anmikut, i cili munt edhe të vijë...*"<sup>586</sup>.

Në përgjigjen që Shefqet Bej Vërlaci i kthen po në të njëjtën datë Refik bej Toptanit, jo vetëm që nuk konstatohet të jetë bërë ndonjë prononcim rreth shpalljes së pavarësisë në Elbasan apo ngritjes së flamurit, por njëkohësisht sqarohet edhe më tej qëllimi i mbledhjes së organizuar në 25 nëntor në Elbasan. Sipas tij mbledhja e 25 nëntorit 1912, konsiderohej si një përgjigje ndaj ftesës që Ismail Qemali i kishte drejtuar Elbasanit për në Kuvendin e Vlorës pikërisht në përgjigjen që ai jep shprehimisht përmes fjalëve: “ Populli i Elbasanit **pranon ftimin[apo ftesën]** që Ismail Beu i ka bërë për në Vlorë dhe u dërguan përfaqësuesit”<sup>587</sup>.

Ndërkaq, duhet thënë se ekziston edhe një dokument që ka disa vite që disa historianë e kanë cilësuar si dokumentin e shpalljes së pavarësisë së Elbasanit. Një dokument i tillë gjendet edhe në Arkivin Qëndror të Tiranës<sup>588</sup>. I njëjti dokument është botuar edhe nga historiani shqiptaro-maqedonas Skënder Hasani në vitin 2008 si një zbulim i tij për herë të parë, gjetur në një mikrofilm në arkivat e Beogradit. Nga analiza që i është bërë të dy dokumenteve të sipërpërmendur pohojmë se përmbajtja e tyre është e njëjtë, porse në to duken qartë gjurmët e disa ndërhyrjeve që mund të jenë bërë. Kështu, në njërin prej tyre është e dukshme data 25 nëntor dhe në tjetrin kjo datë nuk ekziston. Në këtë kuadër mendojmë se të dy këto dokumente mbeten për tju nënshtuar një analize të gjatë e të hollësishme nga specialistët e fushës përkatëse për të vërtetuar fillimisht besueshmërinë e tyre dhe më pas për të kaluar në interpretimin e përmbajtjes së tyre.

Përfundimisht, duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës arkivor krijojmë një panoramë të ngjarjeve që kanë ndodhur në Elbasan në këtë kohë. Kështu mendojmë se në Elbasan në natën e 25 nëntorit të vitit 1912 është organizuar një mbledhje e parësisë së Elbasanit në të cilën personat pjesëmarrës janë shprehur në emër të popullit të Elbasanit për pranimin e pavarësisë. Ndërsa në mbasditen e 28 nëntorit të vitit 1912 në Elbasan është krijuar Qeveria lokale e Përkohëshme dhe është ngritur flamuri. Një evoluim i tillë i ngjarjeve në Elbasan duke kaluar fillimisht nga akti i pranimit të pavarësisë në 25 nëntor dhe më pas në shpalljen e

---

<sup>586</sup> *Lef Nosi, Dokumente historike (1912-1918)*, vepër e cituar, 82. Ky telegram është dërguar në orën 3.40 të natës.

<sup>587</sup> Po aty, 84

<sup>588</sup> Ky dokument nuk gjendet në ndonjë fond të veçantë, por sipas drejtoreshës së AQSH, dokumenti i është dorëzuar Arkivit të Shtetit në vitin 2006 nga Ramiz Avduli (një ish profesor i Skënder Hasanit).

pavarësisë në 28 nëntor mendojmë se lidhet me faktin se elita drejtuese e këtij qyteti e kishte të qartë se nuk mund të kishte pavarësi lokale para asaj kombëtare.

Ndërkohë, kontaktet telegrafike midis Elbasanit dhe Vlorës rezultojnë të jenë mjaft të shpeshta. Nëpërmjet informacioneve telegrafike që vinin nga Elbasani, patriotët shqiptarë të përfaqësuar në Vlorë nga e gjithë Shqipëria dhe vetë Ismail Qemali, informoheshin në mënyrë sistematike për gjendjen dhe situatën jo vetëm në Elbasan por nëpërmjet Elbasanit edhe për zhvillimet politike në qytetet e tjera, ndërkohë që rrezikshmëri më të madhe paraqiste përparimi i ushtrisë serbe drejt Qukësit, Gramshit, Peqinit dhe vetë Elbasanit.

Për sa i përket Peqinit, mund të themi se kontaktet midis patriotëve të këtij qyteti dhe atyre të Elbasanit ishin të vazhdueshme. Më konkretisht, në 23-24 nëntor 1912, nëpërmjet burimeve të asaj kohe informohemi për bisedat telegrafike midis Dervish Biçakut dhe Aqif Pashës, Shefqet Beut, Emin Haxhiademit etj. Përmbajtja e këtyre bisedave kishte të bënte më së shumti me parashtrimin e vështirësive dhe situatës së krijuar në zonën e Peqinit, duke përcaktuar njëkohësisht edhe veprimtarinë në ditët në vazhdim<sup>589</sup>.

Sipas dokumentacionit të kohës, populli i Peqinit e ngriti flamurin kombëtar dhe e shpalli Pavarësinë në mbrëmjen 26 nëntorit të vitit 1912.<sup>590</sup> Në telegramin e datës 27 nëntor 1912, që populli i këtij qyteti i dërgon Ismail Qemalit dhe përfaqësuesve të tjerë në Vlorë, ndër të tjera thuhet: “...*Ju bajmë të ditur se mbramë më gjashtë ora e natës, me dëshirën e gjithë popullit, Nënprefektura e Peqinit shpalli Pavarësinë n’ emën të Shqipniës. Flamuri Kombëtar u ngrit nëpër ndërtesat zyrtare dhe po merremi me emnimin e ndëpunsvet të nevojshëm... të kërkonte me të shpejtë nga Mbretit e Mbëdha mos-cënimin e independencës tone, zotënia e juaj bani si ta dini. ...*”

Telegrami në fjalë rezulton i nënshkruar në emër të popullit të Peqinit nga: Kadri beu i Demir pashës, Izet Beu, myftiu Abdyl Baki, sheh Tahsin Gjinishi, Myderris Sulejman Kuçi, kryetari i bashkisë Ahmet Kaziu, Asllan Ballhysa. Në të njëjtën ditë (26 nëntor), nëpërmjet një telegrami nga Elbasani drejtuar konsullit të Austrisë informohemi se ushtria serbe ishte e pozicionuar në Strugë dhe po i drejtohej Qukësit<sup>591</sup>.

Gjithashtu edhe Dervish Biçaku në cilësinë e përfaqësuesit të Peqinit dhe njëkohësisht dhe të Elbasanit, që do të lajmërojë nënprefekturën e Elbasanit për shpalljen e Pavarësisë në

---

<sup>589</sup> *Lef Nosi, Dokumente historike (1912-1918)*, vepër e cituar, 78-80.

<sup>590</sup> Po aty, 88.

<sup>591</sup> Po aty, 89.

Vlorë duke u shprehur se: *“Ju apim lajmen e gëzushme se Shqipnia ia ndjefi independencës së plotë edhe anmiku me as ndonji mënyrë nuk do mund të mësyjë vendin. Ju porosisim qi gjithë ndëpunësit të vazhdojnë në detyrët edhe t’i kujdeseni si duhet qetësiës e mbledhjes së taksave”*<sup>592</sup>.

Ndërkohë, në udhëzimet që Dervish Biçaku do t’i dërgonte nga Vlora nënprefekturës së Peqinit kërkohet ruajtja e vazhdimësisë së kontakteve me prefekturën e Elbasanit, duke i sqaruar njëkohësisht edhe qëndrimin zyrtar në rast të shfaqjes aty të ushtrisë serbe përmes fjalëve: *“... Edhe në qoftëse se vjen aty ushtëria Serbe ju porosisim që ta pritni si mik edhe të na njoftoni herë pas here si rrjedhin punët”*<sup>593</sup>. Në këtë kuadër, udhëzimi i Dervish Biçakut për të mos i bërë rezistencë ushtrisë serbe, përfaqësonte orientimin që Ismail Qemali i kishte dhënë edhe Elbasanit në 29 nëntor 1912 për të mos i pritur serbët me luftë.

Parë nga sa parashtroam më lart pohojmë se kontributi i Prefekturës së Elbasanit në ngjarjen e Pavarësisë konsiderohet tepër i rëndësishëm por gjithnjë duhet parë nën dritën e burimeve të reja historike dhe duhet vlerësuar me objektivitet.

### **III. 4. Elbasani dhe Kuvendi i Vlorës**

Për organizimin dhe lajmërimin e delegatëve për në Kongresin Kombëtar në Vlorë ishte krijuar një Komitet Organizator që drejtohej nga Xhemil bej Vlora. Duke ju referuar udhëzimeve të Komitetit Organizator të Vlorës, rezulton se përfaqësuesit e Elbasanit për në Kuvendin Kombëtar ishin paracaktuar që në 19 nëntor të vitit 1912. Në favor të këtij fakti flet edhe telegrami që Aqif Pasha i dërgon Xhemil Beut në Vlorë duke u shprehur se: *“Përfaqësuesit u sgjodhën. Nesër do të nisen për Vlonë. Siguroni punën nëpër qytetet e tjera”*<sup>594</sup>.

Ndërkohë, rezulton se nisja e tyre u shty edhe dy ditë të tjera. Në favor të këtij fakti, flet një telegram që Mid’hat Frashëri i dërgon Xhemil Beut në Vlorë nëpërmjet të cilit shpjegon edhe shkakun e vonësës së nisjes së delegatëve të Elbasanit duke u shprehur: *“Pasi bashkë me përfaqësuesit e Dibrës do të vijnë edhe Mehmet Pashë Derralla, Ajdin Bej Draga e Isa Bej*

---

<sup>592</sup> *Dokumenta historike për t’i shërbye historiës tonë kombëtare*, botues Lef Nosi, nr. 6, gusht 1924, 170.

<sup>593</sup> Po aty, nr. 9, nëntor 1924, 279. Telegram dërguar Peqinit nga Dervish Biçaku.

<sup>594</sup> *Dokumenta historike ..., vepër e cituar*, nr. 1, mars 1924, 6. *Lef Nosi, dokumente historike (1912-1918)*, vepër e cituar, 70.

*Buletini, e nismja jonë u shtyrë. Të Hanën do të nisemi së bashku*".<sup>595</sup> Duhet thënë se Elbasani ka meritë të veçantë për pritjen e ngrohtë dhe përcjelljen e sigurt për në Vlorë, që u bëri figurave të tilla të lëvizjes kombëtare, si Isa Boletini e Mehmet pashë Deralla, Myfit Efendiut si delegat i Dibrës etj.<sup>596</sup>.

Në këtë kuadër, përfaqësuesit e Elbasanit së bashku me delegatët e Ohrit dhe të Strugës rezultojnë të jenë nisur për në Vlorë në 23 nëntor të vitit 1912. Nisja e tyre në këtë datë, konfirmohet nëpërmjet një telegrami që i dërgohet Dervish bej Biçakut në Peqin në 25 nëntor 1912, përmes së cilit ai lajmërohej për emërimin si delegatë të Elbasanit për në Kuvendin e Vlorës të Midh'hat Bej Frashërit, Shefqet Daiut e Lef Nosit, duke u shprehur se: "*pardje u nisën për në Vlonë*". Gjithashtu, ai informohet edhe për emërimin e tij si përfaqësues të Elbasanit në Kuvendin Kombëtar, duke u udhëzuar për të bashkëpunuar së bashku me delegatët e tjerë të Elbasanit. Në fund të telegramit i kërkohej Dervish Biçakut të nisej sa më shpejt për në Vlorë.<sup>597</sup>.

Duhet thënë se deri në 25 nëntor 1912, Dervish Biçaku akoma nuk ishte nisur për në Vlorë. Duke vijuar në këtë linjë, nënvizojmë se nuk është e sigurt data e nisjes së tij për në Kuvendin e Vlorës. Por jemi të sigurt për faktin se emri i tij nuk dëshmohet si nënshkrues i aktit të pavarësisë krahas firmëtarëve të tjerë të Shqipërisë dhe të Elbasanit. Një realitet i tillë na mundëson përfundimin se Dervish Biçaku nuk ka arritur në kohë për të qenë i pranishëm në hapjen e punimeve të Kuvendit historik të Vlorës, si dhe në çastet e nënshkrimit të aktit të pavarësisë së Shqipërisë. Në kujtimet e Isa Boletinit përsa i përket udhëtimit të tij për në Vlorë, informohemi se në natën e 27 nëntorit 1912, ai është takuar me Dervish Biçakun në Fier duke u shprehur se: "Tej lumit na priste Sami bej Vrioni e Dervish bej Biçaku"<sup>598</sup>.

Në favor të këtij fakti, flet edhe një informacion i konsullit a-h të Vlorës në raportet që i dërgonte Vjenës zyrtare(kontit Berchtold), në të cilën paraqitej lista e plotë e delegatëve shqiptarë që ishin prezent në hapjen e Kuvendit Kombëtar në Vlorë. Përbri emrit të Dervish Beut [Biçakut] ishte vënë shënimi (jo i pranishëm)<sup>599</sup>.

Pikërisht burimet e kohës konfirmojnë prezencën e Dervish Biçakut dhe delegatit të Peqinit Mahmud Efendi Kaziut në Vlorë në 30 nëntor të vitit 1912, duke qenë pjesëmarrës në

---

<sup>595</sup> *Dokumenta historike ..., vepër e cituar*, nr. 4, Qershuer 1924, f. 102.

<sup>596</sup> Po aty, f. 79-80

<sup>597</sup> *Lef Nosi, Dokumente dokumente historike*), vepër e cituar, 79. Dervish Biçaku ishte zgjedhur fillimisht si përfaqësues i Peqinit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës.

<sup>598</sup> Tafil Boletini, *Pranë Isa Boletinit, Kujtime(1892-1916)*, Përshtati dhe përgatit për botim Maringlen Verni, Tetovë: Album, 1996, 155.

<sup>599</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, vëll. VI, vepër e cituar, 379.

mbledhjen e dytë të Kuvendit të Vlorës.<sup>600</sup> Gjithashtu, konstatohet fakti se Ismail Qemalin e shoqëruan për në Vlorë Adem Gjinishi e Muharrem Spahiu<sup>601</sup>.

Ndërkaq, delegati tjetër përfaqësues i Elbasanit në Vlorë dhe njëkohësisht edhe shoqëruesi i Ismail Qemalit do të jetë Qemal Karaosmani. Mandatin e përfaqësimit në emër të Elbasanit ai e merr në 26 nëntor 1912, nëpërmjet një telegrami që i dërgohet Vlorës, nëpërmjet të cilit informohemi për vendimin e parisë së këtij qyteti që emëron edhe një delegat tjetër si përfaqësues të Elbasanit në Vlorë, pikërisht Qemal Beun (Karaosmanin), telegram ky që shoqërohet me emrat tashmë të 30 përfaqësuesve të parisë së Elbasanit.

Në këtë mënyrë, në hapjen e Kuvendit të Vlorës në 28 nëntor 1912, Elbasani do të përfaqësohet nga Lef Nosi, Shefqet Daiu, Mid'hat Frashëri, Qemal Karaosmani, të cilët konsiderohen si firmëtarët e Elbasanit në dokumentin ekzistues të pavarësisë.

Kështu në dokumentin e Pavarësisë së Shqipërisë, lexohet qartë emri i Lef Nosit, emri i Shefqet Daiut i cili ka firmosur nën emrin Shefqet Daji dhe emri i Qemal Karaosmanit i cili ka firmosur nën emrin Qemal Elbasani.

Gjithashtu, në aktin e Pavarësisë së Shqipërisë gjendet edhe emri i Mit'had Frashërit i cili sipas burimeve vendase rezulton përfaqësues i Elbasanit në Kuvendin Kombëtar në Vlorë<sup>602</sup>. Ndërkohë, në listën e delegatëve në hapjen e Kuvendit të Vlorës që konsulli austro - hungarez i dërgon Vjenës, emri i Mit'had Frashërit nuk figuronte përkrah delegatëve të Elbasanit, por emri i tij paraqitej përkrah delegatëve të Përmetit dhe të vilajetit të Kosovës<sup>603</sup>. Sidoqoftë informacioni i këtij konsulli nuk mund të mohojë faktin që Mit'had Frashëri gëzonte edhe statusin e mandatit të përfaqësimit të Elbasanit, sepse në atë kohë lejohej që një kandidat të përfaqësonte edhe më shumë se një krahinë.

Në Kuvendin Kombëtar të Vlorës u përzgjedhën nga Gramshi e Tomorrica si delegatë Asllan Shahini dhe Xhile Liçi, por në pamundësi të përfaqësimit të tyre atje këto dy krahina u përfaqësuan nga Ismail Qemali. Në kujtimet e Xhile Liçit për këtë ngjarje të madhe ndër të tjera thuhet: “...nga lumenjtë që kishin ardhur, lamë përfaqësonjës Ismail Qemalin”, mbasi nuk patëm

---

<sup>600</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj...*, vepër e cituar, 45. Procesverbal i mbledhjes së dytë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës.

<sup>601</sup> I. Salliu, *Peqini*, Durrës: 2005, 37.

<sup>602</sup> Gazeta “*Përlindja e Shqipniës*”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, viti II, Nr. 6,7, dt. 31 janar – 4 shkurt 1914. *Qeveria e përkohshme e Vlorës ...*, vepër e cituar, 32.

<sup>603</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, vepër e cituar, 379.

*mundësi të shkonim në Vlorë në kohë*<sup>604</sup>. Që nga Berati delegatët e Gramshit dhe Tomorricës do ti telegrafojnë Vlorës si vijon: “*Shkëlqesisë së tij Ismail Qemal Beut –Vlorë. Sado që kemi tri ditë që kemi ardhur këtu, nga shkak i dimrit nuk kemi mujt me ardhë aty. Lutemi pranoni përfaqësimin e krahinave tona. Në qoftë nevoja për ne na lajmëroni. Përfaqësuesi i nënprefekturës së Gramshit Asllan Shahini*”<sup>605</sup>.

Një fakt i tillë dokumentohet edhe në procesverbalin e mbledhjes së dytë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës të datës 30 nëntor 1912, ku pasi flitet për ardhjen e disa përfaqësuesve të tjerë, shkruhet: “...*me telegram u emërua Ismail beu nga Gramshi e Tomorrica*”<sup>606</sup>.

Në këtë kuadër, Ismail Qemali duke marrë në konsideratë përparimin e shpejtë të ushtrive ballkanike vendosi mbledhjen e Kuvendit Kombëtar në 28 nëntor 1912, pa pritur ardhjen e të gjithë delegatëve nga qytetet shqiptare. Sikurse dihet Kuvendi Kombëtar nisi punimet në shtëpinë e Xhemil Bej Vlorës. Pas zbatimit të procedurës së konfirmimit të mandatit të delegatëve dhe fjalimit të Ismail Qemalit u vendos unanimisht proklamimi i Independencës së Shqipërisë, nën fjalët: “SHQIPËRIA TË BËHET QË SOT MË VEHTE, E LIRË, E PAMVARUR NËN NJË QEVERI TË PËRKOHSHME”<sup>607</sup>. Në Arkivin Qendror Shtetëror në Tiranë ruhet një telegram urimi që mban firmat e L. Gurakuqit, Pandeli Cales dhe Lef Nosit, telegram që i dërgohet Pretorit t’Elbasanit Aqif Pashës në mbasditen e datës 28 nëntor 1912 me këtë përmbajtje: “*Në këtë ditë fatbardhë në të cilën u ngrit flamuri kombëtar iu dërgojmë urimet t’ona të nxehta*”<sup>608</sup>.

Ismail Qemali u zgjodh kryetar i qeverisë së Përkohshme duke u ngarkuar me detyrën e formimit të kabinetit qeveritar, si shkronjës i parë u emërua Luigj Gurakuqi dhe si shkronjës i dytë Shefqet Daiu.

Në mbledhjen e dytë të Kuvendit të Vlorës që u mbajt në 30 nëntor 1912 u votua krijimi i Pleqësisë i përbërë nga 18 anëtarë, kryetar i së cilës u caktua Myfti Vehbi Efendiu dhe nënkryetar fillimisht Lef Nosi.

Në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Vlorës të mbajtur në 3 dhjetor 1912, Ismail Qemali prezanton emrat paraprakë të ministrave të Qeverisë së Vlorës. Por, sikurse u konstatua nga një

---

<sup>604</sup> AQSH, Fondi Lef. Nosi, (nr. 32), Dos. 50. Materiale depozituar në AME.

<sup>605</sup> *Lef Nosi Dokumente historike...*, vepër e cituar, 109.

<sup>606</sup> AME, “*Dokumente historike*”, Elbasan, 1924, nr. 48, f. 233-234.

<sup>607</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj...*, vepër e cituar, 45. Procesverbal i mbledhjes së dytë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës.

<sup>608</sup> AQSH. Fondi. 68, Dos. 5, f. 63, 63/1.

pjesë e delegatëve, në këtë listë nuk kishte asnjë përfaqësues të krishterë. Ndër delegatët që konstatuan dhe diskutuan rreth një fakti të tillë ishte edhe Qemal Bej Elbasani(Karaosmani).<sup>609</sup> Në këtë kuadër, krijimi i qeverisë u la për në mbledhjen tjetër të Kuvendit.

Në mbledhjen e katërt të Kuvendit, nga 63 përfaqësues ishin prezent 57 delegatë. Me kërkesën e Ismail Qemalit, u vendos zgjedhja e 8 ministrave me votim nga Kuvendi i Vlorës, duke ruajtur raportet fetare katër myslimanë dhe katër të krishterë.<sup>610</sup>

Qeveria e dalë nga kuvendi i Vlorës kishte në përbërje të saj patriotë elbasanas si Lef Nosin ministër të postë-telegrafëve, i cili mori 20 vota nga votimi që u bë në Kuvend në 4 dhjetor 1912. Gjithashtu, përfaqësues i Elbasanit në Vlorë do të jetë edhe Ahmet Dakli i cili pavarësisht se nuk figuronte si delegat i Elbasanit në Kuvendin e Vlorës, do të thirret në Vlorë dhe do të mbajë postin e këshilltarit në Ministrinë e Financës. Ahmet Dakli do të japë dorëheqjen në nëntor të vitit 1913.

Edhe Qemal Karaosmani si përfaqësues i Elbasanit në Vlorë do të jetë një ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të Ismail Qemalit në cilësinë e kryesekretarit të Ismail Qemalit. Në fund të vitit 1913, ai do të emërohet ministër i bujqësisë.

Ky përfaqësim i delegatëve të Elbasanit, ishte një nder që i bëhej Elbasanit, por njëkohësisht një e drejtë legjitime që buronte nga vendi që zuri dhe roli që luajti Elbasani në shpalljen e pavarësisë. Shpallja e Pavarësisë ishte një fitore e përbashkët e të gjithë shqiptarëve, kurorëzim i të gjitha përpjekjeve për liri e pavarësi. Me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar krijoheshin premiset edhe për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare.

---

<sup>609</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj...*, vepër e cituar, 52. Procesverbal i mbledhjes së dytë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës.

<sup>610</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 52. Procesverbal i mbledhjes së dytë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës.



## IV. ELBASANI DHE QEVERIA E VLORËS

### IV.1. Prefektura e Elbasanit dhe Qeveria e Ismail Qemalit

Situata në të cilën filloi aktivitetin Qeveria e Vlorës ishte mjaft e vështirë. Në fillim të dhjetorit Kosova, Shqipëria Veriore, Lindore e ajo e Mesme ishin të pushtuara nga ushtritë serbe e malazeze. Shkodra gjendej e rrethuar nga trupat malazeze, ndërkohë që edhe trupat greke vazhdonin të përparonin me shpejtësi drejt Shqipërisë së Jugut dhe flota greke kishte bllokuar gjithë bregdetin e Jonit. Në këto kushte, zona e administrimit nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës fillimisht përfshinte trekëndëshin Vlorë-Berat-Lushnjë.<sup>611</sup> Ndërkohë, pas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, autoriteti i saj do të shtrihet edhe në Shqipërinë e Mesme.

Duhet thënë se në muajt e parë të krijimit të saj Qeveria e Përkohshme e Vlorës nuk pati as njohjen ndërkombëtare, fakt ky që nuk e pengoi atë për të vazhduar aktivitetin e saj në funksion të realizimit dhe përmbushjes me sukses të objektivave që rezultonin si më të rëndësishme në atë kohë. Si më emergjente për situatën e krijuar në vitin 1912 rezultonin ndërmarrja e reformave me karakter; organizativ, ushtarak, politik e diplomatik.

Duhet thënë se në vazhden e kontakteve telegrafike midis Ismail Qemalit dhe kryesisë së Elbasanit fill pas shpalljes së Pavarësisë, problemi më imediat që konstatohej nga të dyja palët, konsistonte në rrezikshmërinë që paraqiste përparimi i ushtrisë serbe drejt qytetit të Elbasanit. Në udhëzimet që Ismail Qemali i jepte Aqif Pashës për këtë problem, insistohej në krijimin e një Komisioni Përfaqësues, i cili duhej t'i parashtronte serbëve situatën e re politike të krijuar në Shqipëri dhe në Elbasan pas shpalljes së Pavarësisë<sup>612</sup>. Serbët do të hyjnë në Elbasan në ditët e fundit të nëntorit 1912. Fillimisht konstatohet të ketë ardhur pararoja e ushtrisë e përfaqësuar nga një kapiten serb me disa kalorës. Në telegramin që Aqif Pasha i dërgonte Ismail Qemalit në 29 nëntor thuhej se: “ ... ushtëria serbe asht tuke hymë në qytet tonë [Elbasanit]. Prandaj nuk ka

---

<sup>611</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Botimet Toena, Tiranë 2002, 39.

<sup>612</sup> *Lef Nosi Dokumente historike..., vepër e cituar*, 104.

*dyshim që pas një ore korespondenca do të pritët. Ju bajmë me ditë se protesta e duhun e të tjerat asht nevoja t'i epen komandantit ndashti telegrafisht nga Shk. Tuej”*<sup>613</sup>.

Por është më se evident fakti i pushtimit të dhunshëm të territoreve shqiptare nga ushtria serbe, të cilën e dëshmojnë masakrat e shumta ndaj popullsisë në trevën e Elbasanit. Ndërkaq, përparimi i ushtrisë serbe në drejtim të jugut rezulton të mos ketë kaluar përtej luginës së Devollit dhe Holtës, lumenj që kufizojnë territorin e rrethit të Gramshit. Mendojmë se dy janë arsyet kryesore që konfirmojnë një dukuri të tillë:

**Së pari**, siç del nga të dhënat e asaj kohe, Gramshi ishte territor i pretendimeve greke, me të cilët serbët ishin aleatë në Luftën Ballkanike dhe kishin bërë marrëveshje midis tyre për ndarjen e Shqipërisë.<sup>614</sup>

**Së dyti**, vendosmëria e popullsisë së Gramshit për t'i bërë rezistencë ushtrisë serbe.

Janë të pranishme në këtë kohë pikëpamjet e kundërta që shfaqin patriotët gramshakë, pikëpamje të cilat konsistojnë në qëndrimin që do të mbahej ndaj ushtrisë serbe, duke u shfaqur në koherencë me qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Vlorës. Ky qëndrim iu deklarua patriotëve gramshakë nëpërmjet prefektit të Elbasanit (Aqif Pashës). Përkrahës të kësaj pikëpamjeje, si Kamber Dyrmyshi e të tjerë, ishin të bindur se serbët do t'i largonin Fuqitë e Mëdha dhe diplomacia evropiane.

Por duhet thënë se pjesa tjetër e patriotëve gramshakë ishin përkrahës të idesë së rezistencës me armë ndaj ushtrisë serbe në trevën e Elbasanit. Në këtë kuadër, pas debatesh të gjata u vendos që luftëtarët gramshakë të qëndronin në gatishmëri të plotë, për të mos lejuar depërtimin e mëtejshëm të ushtrisë serbe, ndërkohë që ushtria greke mbante të pushtuar fshatrat e Gorës, Oparit, Korçës, Tomoricës, të cilat kufizoheshin me fshatrat e Gramshit.

Në ditët e para të dhjetorit të vitit 1912, komandanti i ushtrisë serbe në Elbasan mblodhi një numër të madh burrash myslimanë e ortodoksë të kalasë në Kishën e Shën Mërisë. Qëllimi i tij konsistonte në nxitjen e konfrontimeve midis popullsinë e krishterë dhe asaj myslimane të qytetit. Të dhënat na konfirmojnë faktin e një konflikti të drejtpërdrejtë midis Xhaferr Pasmaqit dhe vetë gjeneral Metoviqit, ku ai shprehet se: *“Tash ju ka ardhur koha të hakmerreni kundër turqve” (u referohej shqiptarëve myslimanë)*<sup>615</sup>. Përgjigjja që mori, vazhdon informacioni, reflektoi qartazi replikën e drejtpërdrejtë të Veniamin Nosit i cili theksonte: *“Zoti kolonel!... për*

<sup>613</sup> Lef Nosi, *Dokumente historike...*, vepër e cituar, 109.

<sup>614</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria ...*, vepër e cituar, 14.

<sup>615</sup> Lef Nosi, *Dokumente historike ...*, vepër e cituar, 110.

sa u përket myslimanëve ne me ta jemi vëllezër të një gjaku, kemi një gjuhë, hyjmë e dalim tek njëri-tjetri si për Bajram e për Pashkë..., prandaj mes tonë nuk ekziston ndonjë mëri, kështu kemi qenë e kështu do të vazhdojmë”<sup>616</sup>. Kjo përgjigje ishte tregues i qartë i bashkëjetesës në tolerancë të besimeve fetare në popullsinë e Elbasanit dhe në tërë Shqipërinë.

Ndërkaq, përmes ndodhive të ndryshme dhe të dhënave dokumentare vërejmë episode të konfrontimit të popullsisë së trevës së Elbasanit ndaj ushtrive serbe. Njëpërmjet tyre informohemi për rezistencën me armë të popullsisë vendase para se serbët të futen në Xibrakë dhe Allajbeg, luftime vazhduan për pothuajse dy orë rresht. Ndërsa, pushtimi i Belëshit nga serbët do të shoqërohet me ekzekutimin e 35 djemve belshakë, në vendin e quajtur lugu Allajbeg. Qëllimi ishte, vazhdon informacioni “Për t’i kallë datën popullatës”<sup>617</sup>. Një ngjarje e tillë konsiderohet si masakra më e madhe e kryer nga serbët në këtë zonë.

Veprime të kësaj natyre ata kryen në fshatin Shtëpanjë të Shpatit të Dytë. Popullsia e këtij fshati me ndihmën edhe të asaj të fshatit Vërçë, do të vrasin 16 ushtarë serbë. Në shkallë prefekturë rezulton që në luftime me serbët të jenë vranë rreth 300 vetë<sup>618</sup>.

Në të njëjtën kohë, në dhjetor 1912 në emër të popullit të Peqinit, i dërgohet një telegram komandës së ushtrisë serbe, ku shprehimisht thuhet : “...Shqipëria që u nda kryekëput nga Turqia dhe shpalli Pavarësinë do të mundohet të sigurojë e të shkojë mirë me shtetet fqinjë. Në emër të popullsisë myslimane e jo myslimane të qytetit tonë të Peqinit, të mos shkelë ushtria serbe ...”<sup>619</sup>.

Kauzën e tij patriotike popullsia e Peqinit e dëshmoi përmes sulmeve sistematike ndaj ushtrisë serbe, që çeta e Ramazan Canit dhe e Adem Gjinishit ndërmorën në vitet 1912-1913. Rezultati i një veprimtarie të tillë konfirmohet nga fakti i shpërnguljes së komandës qendrore të ushtrisë serbe nga Peqini në zonën e Darsisë.<sup>620</sup>

Mirëpo krahas pasqyrimit të ngjarjeve të mësipërm, mendojmë se mjedisin në tërësi të trevës së Elbasanit në këtë kohë e plotësojnë edhe tregues të tjerë të natyrave të ndryshme. Ndaj për këtë arsye më poshtë do të përpiqemi që të trajtojmë ata tregues të cilët rezultojnë me ndikim më të dukshëm në përfitim të profilit politik dhe më gjerë të trevës së Elbasanit.

---

<sup>616</sup> Po aty.

<sup>617</sup> Po aty, f. 40.

<sup>618</sup> K. Musaj, *Gramshi në shekuj për liri*, Tiranë: 2005, 135-137.

<sup>619</sup> I. Salliu, *Peqini*, vepër e cituar, 38.

<sup>620</sup> AME. Dorëshkrim i Shyqyri Demirit. P. Kito, *Elbasani në luftë për çlirim*, Tiranë: 1974, 36.

Kështu, në Elbasan Qeveria e Vlorës e shtriu pushtetin vetëm pjesërisht, sepse në dhjetor të vitit 1912, qarku i tij u pushtua nga ushtria serbe. Ndërkohë, në 17 dhjetor 1912 filloi punimet edhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër, në të cilën çështja shqiptare për kompleksitetin që ofronte meritoi një vëmendje të posaçme. Problemi i caktimit të kufijve dhe ai i kompensimit të shteteve ballkanike në kurriz të trojeve shqiptare shërbeu si motiv për lindjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet fuqive të mëdha. Në të njëjtën kohë, këto fuqi për të përshtatur zgjidhje në përputhje me interesat e tyre aplikuan edhe strategjinë e marrëveshjeve të fshehta.

Përmes burimeve britanike fillimisht informohemi për një fakt sa domethënës aq dhe interesant.

Kështu, më 18 janar 1913, në një nga takimet e fshehta midis diplomatëve rusë dhe atyre italianë informohemi për ekzistencën e një marrëveshje midis tyre sipas së cilës Elbasani paracaktohej si kryeqytet i Shqipërisë. Në këtë takim, përfaqësueshin Ministri i Punëve të Jashtme të Rusisë dhe i ngarkuari italian me punë lidhur me kufijtë veriorë dhe jugorë të Shqipërisë e të Malit të Zi. Lidhur me këtë problem ministri fuqiplotë britanik në Sofje shkruante se: *“Të dy qeveritë janë marrë vesh që po të jetë e mundshme, Elbasani të zgjidhet si kryeqyteti i Shqipërisë”*<sup>621</sup>.

Pyetja që shtrohet në këtë rast ka të bëjë me atë se përse Elbasani përzgjidhet si kryeqytet i Shqipërisë?

Duke ju referuar burimeve dokumentare mendojmë se faktorët që mundësuan një përzgjedhje të tillë në rezultatën e përgjithshme konsistojnë:

Së pari, treva e Elbasanit për nga pozicioni i gjeografik i shtrirjes nuk përfshihej në pretendimet e asnjërës prej këtyre dy fuqive. Sikurse Rusia ashtu edhe Italia në projektet e tyre ishin për krijimin e një Shqipërie të vogël me qendër Shqipërinë e Mesme. Për më tepër interesat italiane ishin për Vlorën dhe ato sllave për trevat veriore dhe qytetet bregdetare portin e Durrësit apo Shëngjinit

Së dyti, ky kompromis mes tyre konceptohej i domosdoshëm në rrethanat e rivalitetit që kishin këto dy fuqi me Austro-Hungarinë, qendra e aktivitetit të së cilës ishte Shkodra e cila përfshihej edhe në sferën e interesave Malit të Zi.

---

<sup>621</sup> *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913*, përgatitur nga Muhamet Shatri, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë: Botimet Toena, 2012, 228. Telegram konfidencial i Ministrisë fuqiplotë britanik në Sofje, 18 janar 1913.

Në këtë kuadër, diplomacia ruse i paraprinte faktit se nëse Elbasani do të shpallej kryeqytet i Shqipërisë, Shkodra do ta humbte rëndësinë e saj. Në këtë rast, mundësia që Austro-Hungaria ta përdorte Shkodrën si mjet kompensimi për territoret në Kotorr e Cetinë, [të cilat për A-H kishin një rëndësi më të madhe strategjike sesa Shkodra] do të ishte më e madhe<sup>622</sup>.

Në të njëjtën, kohë kuadri për zgjedhjen e Elbasanit si kryeqytet plotësohet edhe përmes deklarimit që Ismail Qemali i bën në muajin tetor 1913 Aqif Pashës për ta shpallur Elbasanin si kryeqendër të Shqipërisë<sup>623</sup>.

Por duhet thënë se rëndësia e Elbasanit nuk konsistonte vetëm në aspektin gjeopolitik. Në këtë kuadër, pas largimit të ushtrisë serbe në 4 maj 1913, në një letër që prefekti i Elbasanit i dërgonte Gramshit informohemi për krijimin e një komision qeveritar nacional (qeveria e përkohshme), duke udhëzuar edhe parësinë e Gramshit për të ndërmarrë të njëjtin veprim<sup>624</sup>.

Kështu, përmes dokumentacionit të kohës evidentohet qartë një bashkëmarrëdhënie në vijimsi midis Qeverisë së Vlorës dhe Prefekturës së Elbasanit, bashkëpunim ky që pasqyrohet nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve të ndërsjella përmes telegrameve dhe letërkëmbimeve të vazhdueshme midis Qeverisë së Vlorës, vetë Ismail Qemalit dhe Prefektit të Elbasanit. Veprimtaria e drejtuesve të prefekturës së Elbasanit konsistonte në disa drejtime:

- Në organizimin e xhandarmërisë dhe forcimin e fuqisë mbrojtëse të qarkut të Elbasanit
- Në krijimin dhe funksionimin e njësive të reja vendore dhe njëkohësisht të organeve të administratës vendore, jo vetëm në zonën e Elbasanit, por njëkohësisht edhe në rajonet e tjera
- Në përgatitjet për çlirimin e zonave të pushtuara dhe marrjen e masave për organizimin e tyre, sapo të largoheshin ushtritë e huaja.
- Në mbështetjen e plotë që i dha kryengritjes antiserbe që shpërtheu në Dibër në shtator të vitit 1913.
- Në qëndrimin e prerë që mbajti ndaj përpjekjeve të Esad Pashës për ta tërhequr mbas vetes Aqif Pashën dhe Prefekturën e Elbasanit.

---

<sup>622</sup> Po aty.

<sup>623</sup> AME, Kutia 14, Dosja.9, nr.13, f. 3-4. Letër dëguar Aqif Pashës nga Ismail Qemali, 24 tetor 1329/ 1913.

<sup>624</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 2, Dok. Nr. 11.167, kopje përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj* ..., vepër e cituar, 130.

- Me mjaft vlerë ishin dhe mendimet e sugjerimet e Aqif Pashës për probleme nga më të rëndësishmet organizative dhe juridike që herë pas here përfaqësuesit e Qeverisë së Vlorës kërkonin prej tij.

Në funksion të organizimit të brendshëm shtetëror, veprimtaria e Qeverisë së Vlorës, u përqendrua edhe në krijimin e strukturave përkatëse për të siguruar mbrojtjen e vendit. Kështu u krijua “Zyra e Shtatmadhorisë” që përmes “Rregullores së Milicisë Shqiptare”, do të parashtronte kriteret bazë të organizimit të milicisë shqiptare mbështetur në parimin e detyrimit të përgjithshëm derisa të krijohej një ushtri e rregullt shqiptare<sup>625</sup>. Ndërkohë duhet thënë se milicitë lokale përbënin mbështetjen bazë të Qeverisë së Vlorës. Kështu, me largimin e ushtrisë serbe nga Elbasani, Aqif Pasha e konsideronte si detyrë emergjente formimin e milicisë, që përbënte njëkohësisht edhe fuqinë mbrojtëse më kryesore në vend. Në këtë kuadër, në 7 maj të vitit 1913 në një letër që Aqif Pasha i dërgonte Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, kërkohej miratimi për të emëruar oficerë, xhandarë dhe nëpunës shtetërorë në qarkun e Elbasanit, duke u shprehur se: “... rroga e të cilëve, natyrisht do t’u sigurohet me anë të vergjive(taksë që paguhet për shtëpi, dyqane)<sup>626</sup>”.

Në të njëjtën kohë Qeveria e Vlorës njoftohej edhe për masat e marra në Elbasan për forcimin e xhandarmërisë dhe fuqisë mbrojtëse të vetë qarkut të Elbasanit. Pikërisht nëpërmjet këtij burimi informohemi për krijimin e një batalioni të gjindarmërisë së Elbasanit i përbërë nga 33 ushtarë të armatosur dhe një pjese tjetër të parmatosur.

Burimet e kohës, na informojnë për kërkesën që Aqif pasha në 7 maj 1913 do t’i drejtojë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Vlorës për emërimin si komandant batalioni të Ismail Haki Efendiut nga Delvina dhe emërimin në detyrën e sekretarit të batalionit të Kamber Efendiut nga Elbasani, i cili për pak kohë kishte qenë komandant i batalionit të xhandarëve në Elbasan.<sup>627</sup> Personat në fjalë gëzonin reputacionin dhe vlerësimin e Aqif Pashës për pozicionet përkatëse.

Në funksion të organizimit të xhandarmërisë, Aqif Pasha në 26 prill/9 maj 1913, do t’i kërkojë Esad Pashë Toptanit në cilësinë e komandantit të korparmatës turke, furnizimin e Elbasanit me armë dhe municione dhe njëkohësisht dërgimin në Elbasan të 300 mavzerëve(armë) bashkë me municionet përkatëse.(Po aty) [Sikurse dihet, Esad Pasha për të arritur ambiciet e tij

<sup>625</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 40.

<sup>626</sup> A.Q.H i R.P.SH. F. 71, D. 2, dok. Nr. 1180, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 132.

<sup>627</sup> A.Q.H i R.P.SH. F. 71, D. 2, dok. Nr. 11.182, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 132.

politike në prill 1913, i dorëzoi malazezëve Shkodrën prej së cilës u largua me pjesën e mbetur të ushtarëve turq dhe shqiptarë bashkë me armatimet dhe me premtimet e bëra nga malazezët për ta mbështetur në ambiciet e tij për tu vënë në krye të shtetit shqiptar. Ndërkohë, ai po përgatitej për t'ju kundërvënë Qeverisë së Vlorës. Këtij qëllimi do ti shërbejë edhe Kongresi që me iniciativën e tij do të mbledhet në muajin maj 1913 në qytetin e Krujës.

Në këtë kuadër, informohemi mbi përpjekjet e Esad Pashë Toptanit, me mbështetjen e prefekturës së Durrësit për organizimin e Kongresit të Krujës,. Një informacion i tillë na vjen nëpërmjet një letre që Ahmet Dakli në 1/13 maj 1913 i drejton Qeverisë së Vlorës. Burimet e kohës flasin në favor të faktit se Aqif Pashë Elbasani, jo vetëm që nuk do të jetë dakord me organizmin e këtij kongresi, por gjithashtu nuk do të pranojë të shkojë si përfaqësues i Elbasanit në të duke u shprehur se: “ ... ne jemi me Qeverinë e Vlorës. Kongresi nëse është për shpëtimin e Atdheut, duhet bërë në Vlorë që është kryeqendra ”<sup>628</sup>.

Në Kuvendin e Krujës morën pjesë vetëm delegatë nga Durrësi, Kavaja, Tirana, Leshi dhe Kurbini, ndërkohë që vetë Esad Pasha ndoqi taktikën e mos përfaqësimit të tij në këtë kuvend. Ky kongres, sipas delegatëve përkrahës të Esad Pashës, kishte si qëllim ngritjen e flamurit kombëtar në Krujë. Por, sikurse konstatohet kuvendi i Krujës më së shumti do të do të synojë forcimin e pozitës së Esad Pashës. Një fakt i tillë konstatohet edhe në përmbajtjen e tri kërkesave më kryesore që nënprefekti i Tiranës Myftiu Musa Efendiu u parashtrroi për miratim delegatëve të kuvendit. Pikërisht, në njërin prej tyre kërkohej që Esad Pasha përkohësisht të pranonte kryesinë e qeverisë për të mbajtur rregullin në Gegëri derisa të zgjidhej princi<sup>629</sup>.

Në po të njëjtin burim, informohemi se pa dijeninë e prefekturës së Elbasanit, në kuvendin e Krujës ka marrë pjesë edhe Kadri Beu, i biri i nënprefektit të Peqinit Demir Pashë Bonatit. Pikërisht, për të justifikuar një veprim të tillë që binte ndesh me qëndrimin e Aqif Pashës, Demir Pasha kishte patur një takim me Aqif Pashën, porse ky veprim nga Ahmet Dakli konsiderohej vetëm si justifikim, duke u shprehur se: “*Sjellja e tij me dy faqe, më ka bërë ta humb besimin për ta lënë si nënprefekt të Peqinit. Do t'ish mirë të caktohej Fuad Beu nga*

---

<sup>628</sup> Po aty, dok. Nr. 101.503, origjinal, përkthim nga turqishtja. Në *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 134.

<sup>629</sup> Po aty, dok. Nr. 11.203, kopje, përkthim nga turqishtja. *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 136.

*Elbasani. Megjithkëtë Aqif Pasha, si për prefekturën e Elbasanit ashtu dhe për Matin e malësinë e Dibrës do pregatisë një projekt dhe do ta dërgojë*<sup>630</sup>.

Ndërkohë, që pas kuvendit të Krujës në kërkesën që Esad Pasha i drejtonte Elbasanit më së shumti do të kërkonte nga Elbasanit kthimin e 30 mavzerëve(armëve) që ai i kishte dhënë në emër të ushtrisë turke një javë më parë. Një kërkesë e tillë e Esad Pashës, do të gjejë kundërshtimin e Qeverisë së Vlorës duke u shprehur përmes fjalëve se: “... për këtë çështje Qeveria do të merret vesh me Kryekomandën turke”<sup>631</sup>.

Kuadrin e bashkëpunimit midis Prefekturës së Elbasanit dhe Qeverisë së Vlorës, e plotëson më së miri një telegram që Myfid bej Libohova, në maj të vitit 1913, do t’i dërgojë prefektit të Elbasanit, përmes të cilit i kërkonte mendimin e tij për organizimin e një nënprefekturë në Dibër me territoret rreth saj, duke u shprehur se: “Me pjesët e Dibrës së Poshtme e të Sipërme, që u çliruan e do të çlirohen, së bashku me krahinën e Matit dhe të Lumës kemi ndërmend të formojmë një prefekturë. Lutemi na njoftoni mendimin e Zotërisë Suaj rreth çështjes dhe qendrës së prefekturës ku duhet të caktohet”<sup>632</sup>.

Por sikurse konstatohet edhe nga letra e Ahmet Daklit, në përgjigjen që Aqif Pasha i kthen Qeverisë së Vlorës shprehet jo vetëm gatishmëria dhe mbështetja e tij e plotë, por njëkohësisht evidentohet fakti se Aqif Pasha ishte më se i informuar për problemin në fjalë, duke i paraprirë vendimit me krijimin e komisioneve që do të dërgoheshin nga Elbasani dhe duke u shprehur në përgjigjen e tij drejtuar Qeverisë së Vlorës se: “Do dërgohen komisione në viset e përmendura dhe do të dërgohen dhe në Gjakovë, Pejë e Prizren për të bërë organizimin lokal kur këto vise të jenë zbrazur. Komisionet që do të dërgohen në Gjakovë, Pejë, Prizren e në Malësinë e Dibrës, do të përgatiten e do të caktohen në Mat, për t’u vajtur në ndihmë Bajram bej Currit dhe shokëve të tij, të cilët kanë nevojë të madhe”<sup>633</sup>.

Kështu, duhet thënë se hapësira gjeografike e shtrirjes së veprimtarisë së Aqif Pashës përfshinte jo vetëm trevën e Elbasanit, por edhe zonat e tjera, veçanërisht Dibrën dhe Matin, për

---

<sup>630</sup> Po aty.

<sup>631</sup> Po aty, dok. Nr. 11.227, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 141. Letër e Minikstrit të Brendshëm Myfid Libohova drejtuar prefekturës së Elbasanit 10/23 maj 1913.

<sup>632</sup> Po aty, dok. Nr. 11.224, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 139. AME, dorëshkrim i Sh. Demiri, nr. 200. Telegrami mban datën 21 maj 1913.

<sup>633</sup> A.Q.H i R.P.SH. F. 71, D. 2, dok. Nr. 11.235, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 143. AME. Dorëshkrim i Sh. Demirit, nr. 206. Telegrami mban datën 26 maj 1913.



t'i lidhur këto zona me Qeverinë e Vlorës. Vlerësimi rreth një veprimtarie të tillë të Aqif Pashës do të shprehet përmes fjalëve të Myfid bej Libohovës në 22 maj 1913 i cili shprehej se: *“Përprjekjet e Zotërisë Suaj për realizimin e kësaj pike shkaktuan kënaqësi dhe gëzim në qeveri. Ahmet Efendiu[Dakli] të studiojë çështjet financiare”*<sup>634</sup>.

Gjithashtu, në muajt maj-korrik përprjekjet e Qeverisë së Vlorës për të zgjeruar zonën e administrimit prej saj u intensifikuan edhe më shumë. Autoriteti i saj shtrihej më së shumti në Vlorë, Berat, Elbasan, ndërkohë që Shkodra pas largimit të trupave malazeze në mesin e muajit maj, kaloi në kontrollin ndërkombëtar të Fuqive të Mëdha. Duhet thënë se një ndër nismat e Qeverisë së Vlorës në këtë periudhë delikate, kishte të bënte me shtrirjen e autoritetit të saj në zonën e Mirditës dhe të Malësisë së Madhe. Një detyrë e tillë do ta marrë përsipër Luigj Gurakuqi, i cili në kontaktet që do të ketë me krerët e Mirditës do të arrijë të sigurojë edhe premtimin e kapedanit të Mirditës dhe të parisë së Malësisë së Madhe për të bashkëpunuar me Qeverinë e Vlorës<sup>635</sup>.

Në këtë kontekst, në një letër që Luigj Gurakuqi i dërgonte nga Shkodra Ismail Qemalit shprehej se: *“Popullsia e Shkodrës me rrethe janë të frymëzuara nga ndjenja shumë të mira. Besoj për një bashkëpunim me Bib Dodën”*.<sup>636</sup> Për më tepër, që në këtë kohë vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër shkaktuan indinjatë të thellë në popullsinë shqiptare, reagimet e së cilës do të shpreheshin përmes memorandumeve dërguar Fuqive të Mëdha, por dhe nëpërmjet organizimit të mitingjeve dhe protestave popullore. Kështu, përmes protestës së organizuar nga populli i Peqinit në qershor të vitit 1913, midis të tjerave do t'i kërkohej Qeverisë së Përkohshme të Vlorës të ndërhynte pranë Konferencës së Ambasadorëve për të mos lejuar shkëputjen e Camërisë nga territori shqiptar<sup>637</sup>.

Ndërkohë, që në 4 qershor të vitit 1913, kur në Londër ishte duke u diskutuar forma e qeverisjes së Shqipërisë, konstatohen edhe përprjekjet e Ahmet bej Zogut për të mbledhur një kongres në Tiranë, sikurse thuhej: *“gjoja me qëllimin e mirë për të shqyrtuar disa çështje të*

---

<sup>634</sup> Po aty, dok. Nr. 11.223, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 140. Telegram i Ministrit të Brendshëm Myfid Libohova mban datën 9/22 maj 1913.

<sup>635</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë; Kristalina-KH, 2007, 46.

<sup>636</sup> A.Q.H i R.P.SH. F. 71, D. 3, dok. Nr. 103.510, kopje, përkthim nga turqishtja. *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 161. Letra mban datën 5 gusht 1913. Ndërkohë në 30 dhjetor Ismail Qemali e emëron Preng Bibë Dodën “zëvendëspresident të Qeverisë Provizore” dhe përfaqësuesin e saj Në Shqipërinë e Veriut.

<sup>637</sup> A.Q.H i R.P.SH. F. 71, D. 2, dok. Nr. 11.252, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 145. Telegrami mban datën 21/3 qershor 1913.

*mbetura varur dhe për të bashkuar më shumë toskët me gegët*”<sup>638</sup>. Pikërisht një informacion i tillë i dërgohej prefekturës së Elbasanit nga Ministri i Brendshëm në Vlorë, i cili udhëzonte Elbasanin që të tregoheshin të kujdesshëm në këtë drejtim.

Porse, duhet thënë se një rëndësi të madhe në ruajtjen e rendit dhe qetësisë në vend kishte pikërisht organizimi dhe funksionimi i xhandarmërisë. Pikërisht, në këtë periudhë konstatohen përpjekjet e Elbasanit për organizimin e gjindarmërisë në krejt prefekturën. Një pasqyrë të plotë përse i përket projekteve për organizimin e gjindarmërisë në Elbasan na jep një “Promemorie” e komandantit të gjindarmërisë së Elbasanit, Ismail Hakiut drejtuar prefektit Aqif Pasha, në të cilën paraqitet një informacion i detajuar përse i përket strukturave të xhandarmërisë në Elbasan, Dumre, Shpat, Çermenikë, Kërrabë, Peqin e Gramsh<sup>639</sup>.

Gjithashtu, në kuadrin e funksionimit të strukturave lokale të shtetit shqiptar do të evidentohen edhe reformat e ndërmarra në fushën juridike, duke vendosur për herë të parë jurinë në gjykatoren e noterisë<sup>640</sup>. Veprimtaria e “Gjykatës së Shëmtimevet” në Elbasan në vitin 1913 pasqyrohet në faqet e gazetës së Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës. Në këtë kuadër, në rubrikën e lajmërimeve të kësaj gazete nën titullin “Letërfitim”, lajmëroheshin persona të kërkuar nga qeveria lokale për vepra penale, vrasje apo arratisje për tu paraqitur para kësaj gjykate brenda dhjetë ditëve dhe për të dalë para gjykatores. Kështu, përmes këtij njoftimi përmendeshin emrat e disa të kërkuarve për vrasje sikurse ishte; Pasha Zyfeli, Hasani Reshid, Dimitri Merdani të cilët akuzoheshin për vrasjen e Naun dhe Nangjeli në Katundin Shtërmën, kërkohej edhe Mustafa Hyka nga katundi Gurazez i cili rezultonte i arratisur<sup>641</sup>.

Por duhet thënë se Qeveria e Vlorës gjatë muajve gusht-shtator po përballej gjithnjë e më shumë me veprimtarinë separatiste të Esad Pashë Toptanit. Pas dështimit të Kuvendit të Krujës në maj 1913 dhe duke mos gjetur mbështetjen që priste në Shqipërinë e Mesme, në qershor 1913 ai do të pranojë postin e Ministrit të Brendshëm në Qeverinë e Vlorës, në vend të Myfid Libohovës që mori postin e Ministrit të Jashtëm. Pasi largohet për në Europë për një periudhë të shkurtër në cilësinë e Ministrit të Brendshëm, duhet thënë se ai siguroi mbështetjen e Romës dhe të Vjenës dhe në 1 gusht të vitit 1913 Esad Pasha, do të kthehet në Shqipëri. Për më tepër, me

---

<sup>638</sup> Po aty, dok. Nr. 11253, origjinal, përkthim nga turqishtja. *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... vepër e cituar*, 150.

<sup>639</sup> Po aty, dok. Nr. 11224, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... vepër e cituar*, 150-151.

<sup>640</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, 60.

<sup>641</sup> Gazeta “Përlindja e Shqypniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, Vit’I, Nr. 35, 27 dhjetor 1913. Korrespondent i Elbasanit Emin Matraxhiu,

kthimin e tij Esad Pasha u vendos në Durrës ku me pretekstin se po kryente detyrën e ministrit të brendshëm të Qeverisë së Vlorës, po përpiqej të krijonte rrethanat e favorshme për tu shkëputur përfundimisht prej saj<sup>642</sup>.

Duhet thënë se në këtë periudhë koniukturat e brendshme nuk paraqiteshin të favorshme për Qeverinë e Vlorës dhe Ismail Qemalin. Brenda vendit ishte forcuar një opozitë konservatore që përfaqësonte interesat e pronarëve e feudalëve të mëdhenj dhe klerikëve myslimanë. Të pakënaqur nga reformat e Qeverisë së Vlorës ata ishin grupuar rreth Esad Pashës.<sup>643</sup>

---

<sup>642</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, vepër e cituar, 46.

<sup>643</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 47.

## IV. 2. Elbasani dhe kryengritja anti serbe e Dibrës e vitit 1913

Në verën e vitit 1913, situata ndërkombëtare nuk paraqitej e favorshme për shtetin shqiptar dhe Qeverinë e Vlorës. Vendimet përfundimtare të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, lanë jashtë kufijve të shtetit shqiptar afro gjysmën e trevave shqiptare. Ndaj popullsisë shqiptare në trevat e pushtuara u vendos një regjim ushtarak dhune dhe terrori, sikurse thuhej në atë kohë, me qëllimin e vetëm që të mos kishte kush të luftonte më kundër serbëve<sup>644</sup>. Një fakt i tillë, gjen pasqyrim edhe në faqet e shtypit të kohës, ku konstatohej fakti se në Kosovë dhe viset e tjera të aneksuara nga Serbia u përsëritën të gjitha persekutimet më barbare të njohura nga historia botërore<sup>645</sup>. Në këtë kuadër, popullsia e këtyre trevave të shkëputura nga trangu shqiptar duke përjetuar një situatë të tillë persekutimesh, pa kaluar shumë kohë do të reagoonte me forcë ndaj një realiteti të tillë. Reagimi i parë do të evidentohet në zonën e Dibrës ku, në mesin e muajit shtator të vitit 1913 do të shpërthejë një lëvizje e armatosur, e cila brenda disa ditëve do të marrë përmasat e një kryengritje masive duke përfshirë Lumën, Ohrin, Strugën, Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Malësinë e Gjakovës, rrethinat e Prizrenit, fshatrat e Rekës, të Mavrovës e deri në Shkup<sup>646</sup>.

Në këtë kontekst, luftimet e para midis forcave serbe dhe atyre shqiptare nisën në 17 shtator të vitit 1913, fillimisht në veri-perëndim të pllajës së Dibrës duke përfshirë Peshkopinë dhe zonën rreth saj e cila në 22 shtator do të bjerë në duart e malësorëve shqiptarë<sup>647</sup>. Në këtë kuadër, në Dibrën e Madhe do të krijohet një qeveri provizore me në krye Sejfidin Sulejman Pustinën, ndërsa në Dibrën e Poshtme(Peshkopi) do të krijohet një Komision me funksione

---

<sup>644</sup> “Jehona”, nr. 6, Shkup, Nova Makedonija, 1993, 40. Genadi i Lesko-Brodarski. Mojot zivot, Skopje.

<sup>645</sup> Po aty, 12. Les Atrocites des coalises Balkaniques, Nr. 1, Costantinople 1913.

<sup>646</sup> Kristaq Prifti, “Kryengritja antiserbe e shtatorit të vitit 1913 dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës”, në Studime Historike, Nr 1-2, Tiranë: 2004, 155.

<sup>647</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll I, përgatiti Valentina Duka, Tiranë: Botimet Toena, 2012, 125. Me emrin Dibra e Poshtme njihej Peshkopia.

organizative. Kështu, në 27 shtator 1913, serbët do të largohen nga Ohri dhe Struga pa ndonjë rezistencë duke marë me vete edhe armatimet e rënda, ndërkohë që pritej që të çlirohej Resnja ku ishin përqendruar trupa të shumta serbe<sup>648</sup>.

Përmes korrespondencës së kohës krijojmë një panoramë të plotë e të qartë të rolit dhe kontributit që treva e Elbasanit do të ketë në këtë ngjarje kaq të rëndësishme për popullsinë e trevave që mbetën jashtë kufirit të përcaktuar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Kështu, kryetari i Qeverisë së Përkohshme të Dibrës Sejfidin Pustina, në 25 shtator 1913 informonte Aqif Pashën për dëbimin e ushtrisë serbe nga Dibra, duke parashtruar edhe kërkesën më kryesore të kryengritësve që ishte furnizimi me armë<sup>649</sup>.

Një situatë e tillë do t'i raportohet Vlorës zyrtare nga Aqif Pasha në telegramin e datës 26 shtator 1913, përmes së cilit parashtroheshin njëkohësisht edhe propozimet në funksion të mbështetjes imediate të kryengritësve me armatime. Ndërkohë, zhvillimi i luftimeve në terren konstatohet përmes fjalëve: “ *Shqiptarët janë ndarë në tre krahë, nga të cilët ai që i është drejtuar Gostivarit, pushtoi Mavrovën. ... Krahu që marshon për Kërçovë kaloi matanë Loposhin dhe krahu i tretë i është afruar Strugës. Shkëlqesia Juaj çfarë mendon*”<sup>650</sup>. Nëpërmjet kërkesës për armë që Aqif Pasha i dërgonte Vlorës gjejmë të pasqyruar edhe një fakt tjetër, atë të mospërbushjes së premtimit të dhënë nga Qeveria e Vlorës për dërgimin e armëve deri në 26 shtator 1913.<sup>651</sup> Ndërkaq, në raportet e kryetarit të komunës së Qukësit në 29 shtator 1913 informohemi për luftime të ashpra të kryengritësve shqiptarë në zonën midis malit Petrina dhe Resnjës, duke u përballur me sukses me ushtrinë serbe shumë herë më të madhe në numër<sup>652</sup>.

Kështu, shpërthimi i kryengritjes anti serbe të shtatorit konsiderohet si reagimi i parë i popullsisë së këtyre trevave kundër vendimit për ndarjen e padrejtë të kufijve shqiptare të vendosur të Konferencën e Ambasadorëve në Londër me shpresën për bashkimin me shtetin shqiptar. Studiuesit shqiptarë të kësaj periudhe, shprehin mendimin se Qeveria e Vlorës pavarësisht akuzave të palës serbe, nuk ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në shpërthimin e

---

<sup>648</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 4. Dok. Nr. 11750, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 205.

<sup>649</sup> Po aty, dok. Nr. 11724, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 201.

<sup>650</sup> Po aty, dok. Nr. 11733, kopje, përkthim nga turqishtja.

<sup>651</sup> Po aty, dok. Nr. 11733, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 201-202.

<sup>652</sup> A.Q.H. i R.P.SH. D. 4, Dok. Nr. 11778, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 207.

kryengritjes së shtatorit, duke mbajtur fillimisht edhe një qëndrim të rezervuar për shkak të koniukturave të brendshme e të jashtme. Ndërkohë, Qeveria e Përkohshme e Vlorës kishte njohur dhe pranuar vendimet e Konferencës së Ambasadorëve dhe kufijtë e përcaktuar në të. Por nuk do të mungojnë nga ana e saj ndërhyrjet diplomatike pranë Fuqive të Mëdha dhe njëkohësisht përpjekjet e saj nëpërmjet prefekturës së Elbasanit për ta mbështetur materialisht kryengritjen.

Gjithashtu, burimet e kohës flasin në favor të faktit se Qeveria e Vlorës në fshehtësi do të përkrahë forcat irredentiste që vepronin në Shqipëri në mbështetje të kryengritjes dhe njëkohësisht indirekt do të mbështesë kryengritësit në furnizime me armatime. Shkaqet që mundësuan një qëndrim të tillë të Qeverisë së Vlorës paraqiten tepër komplekse dhe nuk duhen parë të shkëputura nga koniunkturat politike të brendshme apo të jashtme të asaj kohe.

Kështu, që në gusht të vitit 1913 konstatohen kontaktet e para të Elez Isufit nga Dibra, Rexhep Bajraktarit nga Hasi e shumë përfaqësues të tjerë me Ismail Qemalin në Vlorë. Bisedat e tyre më së shumti kishin të bënin me situatën në trevat jashtë kufirit të vendosur në Londër dhe masat që duheshin marrë për sundimin e tyre<sup>653</sup>. Por një takim i tillë sikurse konstatohet nga burimet e kohës nuk shoqërohet me ndonjë marrëveshje midis tyre për organizimin e një kryengritjeje.

Gjithashtu, një ndër krerët organizatorë të kryengritjes Hasan Prishtina ishte njëkohësisht edhe ministër i Qeverisë së Vlorës, ndërkohë që Isa Boletini që në gusht të vitit 1913 ishte larguar nga Shkodra për në Malësinë e Gjakovës<sup>654</sup>. Hasan Prishtina së bashku me Bajram Currin vepronin në rrafshin e Dukagjinit duke mbajtur kontakte edhe me Ismail Qemalit pasi kishin marrë premtime prej tij për mbështetje në ndihma materjale<sup>655</sup>. Në një letër që Isa Boletini dërgonte nga Malësia e Gjakovës informonte Ismail Qemalin rreth situatës së vështirë në këto treva duke i kërkuar atij ndihmë dhe mbështetje.<sup>656</sup>

Në këtë kontekst, ndër studiues të tjerë ekziston mendimi se shpërthimit të kryengritjes anti serbe të Dibrës i paraprinë veprimtaria e çetave kaçake shqiptare që komandoheshin nga krerët drejtues shqiptarë dhe që vepronin në zonën e Dibrës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit që në

---

<sup>653</sup> Gazeta "Përlindja e Shqipërisë, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, 14 gusht 1913.

<sup>654</sup> AQSH. Fondi. 165, Dos. 6, fl. 7.

<sup>655</sup> *Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentash*, përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë: 1982, dok. 328, 347-348.

<sup>656</sup> Po aty, dok. nr. 292, 331.

mars të vitit 1913. Kështu, veprimtaria e tyre kundër ushtrisë serbe erdhi duke u intensifikuar në muajt prill-maj 1913<sup>657</sup>.

Gjithashtu, gjatë muajve të verës të vitit 1913 si rezultat i represioneve serbe situata në Maqedoninë Perëndimore vështirësohej gjithnjë e më shumë. Në një situatë të tillë, rezistenca kundër serbëve do të vazhdonte nëpërmjet organizimit të grupeve të kaçakëve nëpër shumë rajone. Përmes burimeve të kohës ndërsa planifikohej përgatitja dhe fillimi i shpejtë i një sulmi në Maqedoni dhe Kosovë, situata më kritike paraqitej në zonën e Dibrës dhe liqenit të Ohrit, ku kishin filluar aksionet e çetave dhe grupeve të tjera<sup>658</sup>.

Përmes dokumentacionit të arkivit ushtarak të Beogradit, raportohej se kryengritja nuk qe e rastësishme dhe as e përnjëhershme por ishte e përgatitur për një kohë relativisht të gjatë dhe ishte në vijimësi të luftës për çlirimin e viseve shqiptare të okupuara që gjatë Luftërave Ballkanike<sup>659</sup>. Më konkretisht, në korrik të vitit 1913, burimet serbe do të raportnin për lëvizjet e Bajram Currit dhe Isa Boletinit, me qëllim organizimin e një kryengritjeje, duke konstatuar faktin se: *“ata kishin blerë shumë armë e municione midis tyre edhe topa”*<sup>660</sup>.

Përsa i përket shkaqeve të fillimit të kryengritjes së shtatorit, të njëjtin mendim me studiuesit shqiptarë e gjejmë të pasqyruar edhe në raportimet që konsujt e huaj në Shqipëri sistematikisht i dërgonin eprorëve të tyre. Kështu, në një raport që z/konsulli britanik në Manastir i dërgonte Londrës zyrtare, konstatohet fakti se kryengritja antiserbe e shtatorit ishte produkt i drejtpërdrejtë i copëtimit të trevave shqiptare dhe ndarjes së kufirit shqiptar, duke e konsideruar një akt të tillë si të pajustificueshëm. Në të njëjtin dokument z/konsulli britanik shprehet se *“... Pa asnjë justifikim të arsyeshëm strategjik, etnografik apo ekonomik, ky kufi do të priste lidhjet e njerëzve të Matit, Lurës, Kalisit, Dardhës dhe, madje edhe një pjese të Lumës me qytetin e Dibrës. Do ti përjashtonte ata nga aksesit në vendet e shenjta dibrane... vende të shenjta ku zakonisht shehelerët drejtues zgjidhnin konfliktet e të gjitha llojeve, pa ankimime të mëtejshme”*<sup>661</sup>. Ndërkohë, që në raportimet që konsujt britanikë në Shqipëri i dërgonin Londrës

---

<sup>657</sup> Halim Purellku, *Kryengritja e shtatorit e vitit 1913*, në *“Jehona”*, nr. 6, Shkup: 1993, 45.

<sup>658</sup> Fejzulla Shabani, *Aspekte të kryengritjes së shtatorit*, në revistën *“Jehona”*, Nr. 6, Shkup 1993, 77.

<sup>659</sup> Arkivi ushtarak i Beogradit, *“Ballkanski Rat 1912-1913”*, në revistën *“Jehona”*, vepër e cituar, 95.

<sup>660</sup> Limon Rushiti, *Disa të dhëna nga Dokumentacioni i Ushtrisë serbe-Armata III, mbikryengritjen shqiptare të shtatorit të vitit 1913*, Arkivi Ushtarak i Beogradit, *“Ballkanski Rat 1912-1913”*, në revistën *“Jehona”*, vepër e cituar, 94-95.

<sup>661</sup> *Dokumete britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. I, Përgatiti Valentina Duka, Botimet Toena, Tiranë: 2012, 126.

zyrtare, nuk raportohet për ndonjë përfshirje të mundshme të Qeverisë së Vlorës në kryengritjen antiserbe të Dibrës.

Përsa i përket zhvillimi të situatës në terren në 29 shtator 1913, Aqif Pasha informohej për lëvizjet e Elez Isufit që së bashku me një forcë të madhe shqiptarësh ishin nisur drejt Gostivarit, ndërkohë që trupat serbe kishin kaluar kufirin shqiptar mes Dibrës dhe Ohrit, për të zënë rrugën tërheqjes së shqiptarëve përtej Dibrës<sup>662</sup>. Në deklaratat e Ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë, pohohej se shkelja nga trupat serbe e kufirit të vendosur në Londër nuk do të kishte si synim pushtimin e ndonjë pjese të Shqipërisë, por do të kishte karakter të përkohshëm deri në vendosjen e rendit publik brenda Shqipërisë dhe mbi të gjitha deri në arritjen e paqes midis Greqisë dhe Turqisë. Një deklaratë e tillë parakuptonte faktin se trupat serbe mund të pushtonin edhe pozicione strategjike në perëndim të Drinit të Zi, për të shtypur përfundimisht revoltën shqiptare.

Ndërkohë, padrejtësitë rreth çështjes së kufirit të vendosur në Londër do të konsiderohen si burim i krijimit të situatave të pritshme konfliktuale në trevat e prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ndarja e kufijve. Një problem i tillë gjen pasqyrim të vazhdueshëm në raportin z/konsullit britanik Peckham i cili do të shprehej: *“Ajo që kam dëgjuar dhe kam parë vetë, më ka forcuar dhe konfirmuar besimin se kufiri i vendosur në Londër, përveçse e vështirë të jetë vendimtar, do të jetë një burim i vazhdueshëm fërkimesh dhe përplasjesh”*, duke dhënë një sërë argumentesh etnikë, historikë dhe ekonomikë në favor të popullsisë shqiptare të mbetur jashtë kufirit.<sup>663</sup>

Ky vlerësim objektiv nga ana e tij, është tregues i njohurive që ai zotëronte për çështjen shqiptare. Përmes një pohimi të tillë, që më së shumti ishte rezultat i informacioneve të drejtpërdrejta të marra në terren, z/konsulli britanik shfaqte edhe një qëndrim kritik ndaj vendimeve të padrejta të Koncertit të Evropës rreth çështjes shqiptare<sup>664</sup>. Ndërkohë, përsa i përket pikëpamjeve të tij rreth çështjes së ndarjes së kufijve shqiptarë, nënkonsulli britanik në Shkup Peckham kishte informuar Londrën zyrtare që në shkurt të vitit 1913, përmes fjalëve: *“Nacionalizmi shqiptar momentalisht është vetëm gacë, po erërat e persekutimit do ta nxisin atë*

---

<sup>662</sup> Po aty, raportime të bëra nga konsulli britanik Z.Crackanthorpe, në 29 shtator 1913.

<sup>663</sup> Po aty, 120-121.

<sup>664</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. I, vepër e cituar, 120-121.



të bëhet zjarr<sup>665</sup>. Nëpërmjet një pohimi të tillë z/konsulli britanik në shkurt të vitit 1913 parakuptonte komplikacionet e mundshme që mund të sillte në rajonin e Ballkanit një ndarje e padrejtë e kufirit.

Të shumta rezultojnë në këtë kohë telegramet e ndërsjella midis prefekturës së Elbasanit dhe Qeverisë së Vlorës, përmes të cilave evidentohet qartë roli i kësaj prefekturë në organizimin e vullnetarëve të armatosur në ndihmë të kryengritësve dhe në mbështetjen në ndihma, armë e municione. Në letrën që Aqif Pasha i dërgonte Ismail Qemalit në 26 shtator të vitit 1913 shprehimisht thuhet: *“Ajo sasi armësh që zotëria Juaj do të na i dhuroni andej dhe këto që do të mundemi të mbledhim ne këtej nuk mjaftojnë për të mbaruar punë”*<sup>666</sup>.

Në korrespondencën e ndërsjellët midis komunës së Qukësit dhe prefekturës së Elbasanit në kuadrin e kësaj ngjarje, evidentohet qartë pjesëmarrja në përkrahje të kryengritësve e popullsisë së trevës së Elbasanit dhe njëkohësisht kërkesat e tyre për vullnetarë të armatosur. Në letrën që kryetari i komunës së Qukësit do t’i dërgojë Aqif Pashës thuhet se : *“Në se në sajë të zotërisë suaj do të dërgoheshin këto forca[kërkohej një forcë e armatosur prej 500 ushtarësh në Mokër, Bërzeshtë e Çermenikë] suksesi do të jetë i sigurtë. Çetat shqiptare dhe bullgare po veprojnë së bashku. Kemi filluar ta ndreqim vijën telegrafike të Dibrës dhe tashti e kompletuam”*<sup>667</sup>.

Gjithashtu, kalimi i sigurve i Halim Tetovës dhe Munip Beut, bij të Mehmet Pashë Dërrallës, nga Elbasani për në Tetovë e Gostivar për t’u bashkuar me atdhetarët e tyre e për të marrë pjesë në luftën kundër pushtuesve serbë në Pollog, do të përfaqësonte një ndër kërkesat që Qeveria e Vlorës i drejtonte Aqif Pashë Elbasanit në 29 shtator të vitit 1913<sup>668</sup>.

Ndërkaq, duke ju referuar burimeve britanike, konstatohej fakti se në luftimet e shqiptarëve kundër trupave serbe në disa zona të caktuara ishin përfshirë edhe oficerë austriakë e bullgarë. Kështu në raportin që z/konsulli i Manastirit Greig i dërgonte Londrës zyrtare në 26 shtator të vitit 1913, përmendeshin emrat e disa vojvodëve bullgarë të cilët sikurse thuhet bashkë me bandat bullgare kishin kaluar në Shqipëri në rajonin e Strugës. Në këtë dokument, z/konsulli

---

<sup>665</sup> The Public Record Office-Foreign Office, 424/242, d. nr. 507, në revistën “Jehona”, nr. 6, Shkup: 1993, 111.

<sup>666</sup> A.Q.SH. F. 71, D. 4. Dok. Nr. 11733, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 201.

<sup>667</sup> Po aty, dok. Nr. 11750, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 205.

<sup>668</sup> Kristaq Prifti, *Kryengritja antiserbe e shtatorit...*, vepër e cituar, 161.

britanik do t'i referohet disa vojvodëve të mirënjohur bullgarë sikurse ishin Petre Culev, Pavlov dhe veçanërisht Milan Matovi (ish inspektor i bandave bullgare në vilajetin e Manastirit para luftërave ballkanike), i cili sipas tij thuhej se kishte qenë edhe në Elbasan. Në mendimin e tij diplomati britanik shkonte edhe më tej përmes pohimit se midis shqiptarëve të Manastirit ishte krijuar bindja se veprimi shqiptaro-bullgar kundër serbëve me siguri kishte mbështetjen turke<sup>669</sup>.

Ndërkaq, duke ju referuar informacioneve në faqet e gazetës “Përlindja e Shqypniës”, nuk përjashtohej mundësia e bashkëpunimit të shqiptarëve dhe bullgarëve duke e motivuar një bashkëpunim të tillë me situatën e njëjtë nën të cilën gjendeshin të dyja palët duke shkruar se: “Mundet që bashkë me kryengritësit shqiptarë të gjenden edhe bullgarë (maqedonas). S’ka dyshim që ata që vuajnë tok, ata që kanë armik të përbashkët, ata gjithmonë do të bashkëpunojnë”<sup>670</sup>.

Një konstatim i tillë pasqyrohet përmes një artikulli botuar në gazetën “Përlindja e Shqypniës” nën titullin “Shqiptarët janë bashkë me bullgarët”, ku midis të tjerave thuhej se: “Këtë besëlidhje e kanë bajraktarët shqiptarë: Ali Kaloshi, Maliq Kërcishta, Kurt Haxha me bullgarët Milan Matofin e Petrush Caulefin”<sup>671</sup>.

Gjithashtu, përmes informacionit të kryetarit të komunës së Qukësit drejtuar prefekturës së Elbasanit, raportohej për një bashkëpunim të forcave shqiptare me forcat bullgare përmes fjalëve: “Çetat shqiptare dhe bullgare po veprojnë së bashku”<sup>672</sup>.

Në këtë kuadër, për të përligjur një realitet të tillë në konstatimet e z/konsullit britanik në Manastir konsiderohej si i suksesshëm bashkëpunimi midis popullsisë myslimane dhe të krishtere jo vetëm në Dibër, por edhe në rajonet Derbatsa (në veri të Strugës), Demir –Hissar dhe Kërçovë, ku shumica e popullsisë përbëhej nga elementi bullgar.

Ndërkohë, zëvendëskonsulli britanik shprehej se: “Lëvizja shqiptare është diçka më tepër sesa një sulm kaçakësh”<sup>673</sup>.

Kështu, në pranverë të vitit 1913, ndër qarqet patriotike shqiptare mendohej se ekzistonin premisat e mundshme për krijimin e një aleance mes Turqisë dhe Bullgarisë e cila doli e pakënaqur nga përfitimet e Luftës Ballkanike. Sipas informacioneve të marra nga konsujt

---

<sup>669</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 126. Letër e zëvendëskonsullit Greig, Manastir, 26 shtator 1913.

<sup>670</sup> Gazeta “Përlindja e Shqypniës” botim i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, 25 vjeshtë e I, 1913.

<sup>671</sup> Po aty.

<sup>672</sup> A.Q.H. F. 71, D. 4. Dok. Nr. 11750, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorë dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 205.

<sup>673</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)* vepër e cituar, 123.

britanikë, thuhej se Bullgaria kishte lënë në Maqedoni dy batalione të maskuara si çetnikë<sup>674</sup>. Gjithashtu, në udhëtimin që Ismail Qemali pati në Evropë në muajt prill-korrik të vitit 1913, në funksion të rishikimit të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, në agjendën e tij një vend të konsiderueshëm zunë edhe bisedimet me diplomatët bullgarë. Në takimet me ta duke shfrytëzuar koniukturat e reja të krijuara në Ballkan, Ismail Qemali shpresonte ti bashkohej një aleance të mundshme që në të ardhmen mund të krijohej midis Turqisë-Bullgarisë por dhe Shqipërisë<sup>675</sup>. Por, në këtë drejtim nuk pati asgjë konkrete.

Ndërkaq, ekzistenca e bandave bullgaro-myslimane raportohej edhe në lokalitetin e Morihovës (në lindje të Manastirit), ku sikurse thuhej “*ka mbërritur një kavaleri prej 300 vetash nga Shkupi*”<sup>676</sup>. Kështu, nisur nga sa parashtruam më lart, mendojmë së në konstatimet për përfshirjen e bandave bullgare përkrah kryengritësve shqiptarë në kryengritjen anti serbe të shtatorit më së shumti parakuptohej fakti i bashkëpunimit të popullsisë shqiptare (myslimane) me atë bullgare (maqedonase).

Në një kontekst të tillë, nuk do të mungojë nga Qeveria e Vlorës aktiviteti diplomatik dhe thirrjet drejtuar Fuqive të Mëdha për të ndaluar masakrat e bëra nga serbët, duke sqaruar njëkohësisht edhe pozitën e saj në raport me kryengritësit dhe duke kërkuar që të përcaktohej sa më shpejt në terren kufiri i vendosur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër<sup>677</sup>.

Ndërkaq, krerët kryengritës në përpjekjet e tyre bashkërenduese u përpoqën që të siguronin edhe mbështetjen e Austro-Hungarisë. Kështu, përmes kërkesës drejtuar konsullit austro-hungarez në Vlorë në takimin që ai pati me të dërguarin e Bajram Currit, synohej më së shumti sigurimi i mbështetjes Austro-Hungareze. Porse një kërkesë e tillë nga Austro-Hungaria, do të konsiderohej e papranueshme duke mbajtur jo vetëm një qëndrim mospërfshirës, por në të njëjtën kohë duke e konsideruar fillimin e kryengritjes si të papërshtatshme në koniukturat e asaj kohe. Sipas pohimeve të konsullit austro-hungarez, një kryengritje e tillë nga shqiptarët më së shumti do të përbënte një pretekst nga pala serbe për të përparuar në drejtim të territorit shqiptar dhe do të kishte një kosto njerëzore për vetë shqiptarët<sup>678</sup>. Ngjarjet e mëvonshme vërtetuan saktësinë e parashikimeve të tij.

---

<sup>674</sup> Po aty.

<sup>675</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 55.

<sup>676</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 126.

<sup>677</sup> Gazeta “*Përlindja e Shqypniës*”, nr. 16, 4 tetor 1913. Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së Imperializmit, nga Arben Puto, vëll. II, Tiranë: 1987, 367-368.

<sup>678</sup> A. Puto, *Pavarësia shqiptare ...*, vepër e cituar, 441.

Ndërsa kryengritja anti serbe kishte marrë përmasa të mëdha, në 24 shtator Aqif Pasha, do t'i kërkonte Esad Pashë Toptanit, që të mos ekspozohet në zonat e kryengritjes, duke e konsideruar vajtjen atje si një veprim taktikisht të gabuar. Ndërkohë, që Esad Pasha nëpërmjet premtimeve të fshehta që u bënte serbëve, do të përpiqej që përmes kësaj kryengritje të arinte dy synime kryesore; Së pari komprometimin e Qeverisë së Vlorës dhe së dyti me ndihmën e serbëve në përmbysjen e Qeverisë së Vlorës.

Gjithashtu, në kërkesën drejtuar Esad Pashës në 24 shtator për të siguruar armë e municione në zonën e Durrësit Aqif Pasha do të shprehej se:“... *Tani këta[kryengritësit] kanë nevojë të ngutëshme për pushkë dhe municione, prandaj duhet t'u dërgohen sa që të jetë e mundur më shpejt dhe në rast se nuk ndodhen gati, duhet të mbliidhen dhe të blihen nga populli*”<sup>679</sup>. Një fakt i tillë gjen konfirmim përmes informacionit të z/konsullit Peckham drejtuar eprorëve të tij i cili shkruante se :“*Kohët e fundit kam dëgjuar se pushkët po shiteshin në Durrës për një shilingë copa. Në nivel lokal thuhet se shqiptarët kanë diçka më shumë sesa pushkë. Kam dëgjuar histori për mitraloza Maxim të montuar në motorë në ushtrinë e tyre. Kam shumë pak dyshime për faktin se ata kanë njerëz të aftë për ti përdorur ato.*”<sup>680</sup> Kështu, një fakti i tillë gjen konfirmim edhe në një nga telegramet që Aqif Pasha i dërgonte Vlorës përmes të cilit ai parashtronte kërkesën e tij për dërgimin në Dibër të një oficeri, që të mundësonte përdorimin e topave dhe mitralozave që kryengritësit shqiptarë i kishin marrë ushtrisë serbe. Gjithashtu në vazhdim të telegramit kërkohej që të nisej për në Dibër edhe një doktor, duke u shprehur se : “*Pa doktor, ilaçet që njoftuat se do t'i dërgoni, s'ka kush t'i përdorë*”<sup>681</sup>.

Ndërkaq, përveç nevojave të kryengritësve për armë dhe municione, në kërkesat që përfaqësuesi i qeverisë provizore të Dibrës Sefedin Sulejman Pustina i parashtronte prefektit të Elbasanit, më së shumti kërkohej arritja e një zgjidhje diplomatike midis qeverive përkatëse, duke deklaruar pamundësinë e një qëndrese të armatosur për një kohë të gjatë ndaj një ushtrie të organizuar<sup>682</sup>. Kërkesa të tilla nga Sulejman Pustina do të vazhdojnë të përsëriten edhe në

---

<sup>679</sup> A.Q.H. F. 71, D. 4. Dok. Nr. 11713, kopje, përkthim nga turqishtja. *Qeveria e përkohshme e Vlorë dhe veprimtaria e saj ..., vepër e cituar*, 200.

<sup>680</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 123.

<sup>681</sup> A.Q.H. F. 71, D. 4. dok. Nr. 11654, kopje, përkthim nga turqishtja, *Qeveria e përkohshme e Vlorës, dhe veprimtaria e saj ..., vepër e cituar*, 211.

<sup>682</sup> Po aty, 202.

letërkëmbimet që ai do të ketë me Aqif Pashën në datat 28-29 shtator 1913 duke u shprehur se :  
“*Natyrisht një popull nuk mund t’ja dalë dot të vazhdojë luftë shumë kohë me një mbretëri*”<sup>683</sup>.

Luftime të ashpra u zhvilluan në 1 tetor të vitit 1913 në Ohër, Bukovë dhe Zorovë ku kryengritësit udhëhiqeshin nga kapedan Petrushi. Pjesa më e madhe e kryengritësve të larguar nga Ohri u vendosën në zonën e Godoleshit duke zënë pozicionet në malin Petrin dhe në Stok. Nga informacionet që vinin nga nën/prefekti i Ohrit, rezultonte vija e tërheqjes së trupave serbe që ndodheshin në Korapiec-Qosbi, ishte ndërprerë nga çetat bullgare që vepronin në Zvisht, Koratice e Plaqe<sup>684</sup>. Në kundërofensivën e organizuar nga trupat serbe, në 2 tetor 1913, trupat serbe arritën të hyjnë në Ohër, prej të cilit mendohet se nga frika ishte larguar pjesa më e madhe e popullsisë<sup>685</sup>.

Në 3 tetor të vitit 1913, trupat serbe kishin pushtuar Dibrën, Strugën dhe Kërçovën. Duke ju referuar konstatimeve të konsullit britanik z. Crackanthorpe pohohej se : “ *Nuk evidentohet ndonjë përhapje e lëvizjes shqiptare në Shqipërinë Qendrore* ”<sup>686</sup>.

Kështu, kryengritja që shpërtheu në shtator të vitit 1913, nuk mundi të përmbushë objektivat e saj, sepse u shtyp dhunshëm nga autoritet serbe. Pavarësisht qëndresës së armatosur të kryengritësve shqiptarë dhe megjithë ndihmat e marra në këtë drejtim, në 3 tetor 1913 trupat serbe arrijnë të pushtojnë Dibrën, Strugën dhe Kërçovën duke përbërë një rrezik real edhe për kufijtë e përcaktuar në Konferencën e Londrës.

Ndërkohë, në 5 tetor 1913 Ismail Qemali siguronte prefekturën e Elbasanit, se Serbia nuk do ta kalonte kufirin e përcaktuar në Londër. Një siguri e tillë buronte më së shumti përmes garancisë që Qeveria e Vlorës kishte marrë nga konsujt austro - hungarezë dhe italianë në Vlorë. Ndërsa kryeministri serb në 6 tetor 1913 deklaronte i bindur se shumë shpejt rebelimi shqiptar do të shuhej.

Në këtë kontekst duhet thënë se qëllimi më kryesor i Serbisë ishte shfrytëzimi i kryengritjes anti serbe, në funksion të depërtimit në brendësi të territorit shqiptar duke kaluar vijën e kufirit strategjik të vendosur në Konferencën e Londrës dhe duke pretenduar në të njëjtën kohë edhe ndryshimin e kufirit në favor të Serbisë. Pretendimet serbe në këtë kohë, gjenin

---

<sup>683</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 4, dok. Nr. 11.771, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 206.

<sup>684</sup> Po aty, dok. Nr. 11.792, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 212.

<sup>685</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 4, Dok. Nr. 11.806, kopje, përkthim nga turqishtja. *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 215

<sup>686</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 110.

pasqyrim edhe në raportet e konsujve të huaj duke pranuar faktin se kufiri më strategjik që po përpiquej të arrinte Serbia përcaktonte si kufi natyral luginën e Drinit të Zi, në funksion të përmbushjes së pretendimeve më të hershme të saj që nuk gjeten zgjidhje në Londër, synimin për të siguruar një dalje në Adriatik<sup>687</sup>.

Të njëjtin mendim me konsujt e huaj sikurse konstatohet në burimet e kohës ndante edhe Aqif Pasha. Në përgjigjen ndaj akuzave të Esad Pashës për përfshirjen e Qeverisë së Vlorës në ngjarjet e Dibrës, pasi i sqaronte për mënyrën sesi filloi incidenti në Dibër, Aqif Pasha shprehej se: *“Tani Serbia duke gjetur pretext një ngjarje me të cilën Qeveria Shqiptare s’ka të bëjë, vjen e kapërcen kufirin e Shqipërisë duke marrë nëpër këmbë të drejtat ndërkombëtare dhe njerëzore”*<sup>688</sup>.

Një përgjigje e tillë në të njëjtën kohë është shprehje edhe e qëndrimit konsekuent të Aqif Pashës ndaj Qeverisë së Vlorës, ndërkohë që burimet e kohës konstatojnë përfshirjen e Esad Pashës në bisedime të fshehta me serbët. Kështu, në kërkesën e Esad Pashës drejtuar Qeverisë së Vlorës për të dalë në mbrojtje të hapur ndaj kryengritjes fshihej qëllimi i tij për ti dhënë shkas serbëve drejt pushtimit të Shqipërisë pse jo dhe rrëzimit të Qeverisë së Vlorës<sup>689</sup>.

Në këtë kuadër, burimet e kohës flasin në favor të faktit se në 8 tetor 1913 trupat serbe jo vetëm kishin bërë që shqiptarët të thyheshin por njëkohësisht sikurse pritej kishin shkelur pozicionet strategjike në perëndim të Drinit të Zi. Në 13 tetor 1913, burimet britanike raportonin për itinerarin e pritshëm të ekspeditës serbe që parashikohej të hynte në Shqipëri me tri njësi të dislokuara në Strugë, Dibër dhe Prizren<sup>690</sup>.

Në këtë kuadër, pa marrë parasysh kufirin e vendosur në Konferencën e Londrës dhe presionet e përsëritura të diplomacisë austro-hungareze dhe italiane, ushtria serbe do t’i mbajë të pushtuara territoret shqiptare për javë të tëra. Ndërkaq, në tetor 1913 presionet e Austro-Hungarisë drejtuar Serbisë për tërheqjen e trupave nga Shqipëria (duke patur edhe mbështetjen e Gjermanisë) do të finalizohen me dërgimin e një note të fortë proteste qeverisë serbe, duke i kërkuar respektimin e kufirit e vendosur në Londër<sup>691</sup>. Në këtë notë proteste që Legata perandorake dhe mbretërore në Beograd i dërgonte qeverisë mbretërore serbe midis të tjerave

---

<sup>687</sup> Po aty, 153.

<sup>688</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 4, Dok. Nr. 11.771, kopje, përkthim nga turqishtja. Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ..., vepër e cituar, 214.

<sup>689</sup> Gazmend Shpuza, *Kryengritja e shtatorit 1913 dhe lufta politike në Shqipëri*, në “Jehona”, Shkup: 1993, 34.

<sup>690</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 155. Raport i z. Crackanthorpe, 13 tetor 1913.

<sup>691</sup> Po aty, 175.

thuhej se: “*Qeveria perandorake dhe mbretërore[A-H] dëshiron të shpresojë se qeveria serbe nuk do të vonojë të kryejë zbrazjen e plotë të territorit shqiptar brenda një afati prej tetë ditësh*”<sup>692</sup>. Por, dyshimi i diplomacisë Vjeneze ndaj deklaratës së qeverisë serbe për të ndaluar përparimin e ushtrisë serbe në drejtim të territorit shqiptar, mbështetej në arsye tashmë të njohura diplomatike. Kështu, zgjidhjen e një situatë të tillë, diplomatët e Vjenës e shikonin më së shumti në presionin e ushtruar ndaj Serbisë përmes mobilizimit të trupave austriake në kufi me Bosnjën sikurse thuhej “*si një mjet i drejtpërdrejtë presioni si ndaj Serbisë ashtu dhe ndaj Rusisë*”<sup>693</sup>.

Në një kontekst të tillë, trupat serbe në 17 tetor 1913 kishin avancuar në thellësi të territorit shqiptar. Kolona e parë serbe ishte dislokuar në afërsi të Oroshit, kolona e dytë serbe gjendej rreth 30 kilometra në veri të Elbasanit dhe kolona e tretë në të njëjtën distancë në lindje të qytetit pranë luginës së Shkumbinit<sup>694</sup>.

Ndërsa pushtimi serb ishte evident, përgjatë muajve tetor - nëntor të vitit 1913 Shqipëria do të përballet me një valë dyndje të popullsisë shqiptare, që për shkak të djegies së fshatrave, persekutimeve dhe masakrave të kryera nga ushtria serbe ishin larguar nga trevat e tyre. Në këtë kohë, numri i shqiptarëve të larguar dhe që ishin strehuar në territorin shqiptar shkonte nga 60-100 mijë, pjesa më e madhe e të cilëve rezultonte të ishin nga Dibra, Kërçova, Gostivari. Rreth gjysma e refugjatëve të ardhur nga këto qytete afërsisht 30-40 mijë ishin vendosur në krahinën e Elbasanit, Tiranës, Durrësit etj.<sup>695</sup>

Ndërkohë, sipas të dhënave të marra përmes një thirrje të Aqif Pashës botuar në faqet e gazetës “*The Morning Post*”, rezultonte se rreth 10 mijë refugjatë ishin vendosur në Elbasan dhe rrethinat e tij<sup>696</sup>. Ndërsa në telegramin dërguar kontit Mensdorff në tetor të vitit 1913, rezultonte se në Elbasan ishin vendosur edhe refugjatë të ardhur nga Struga, Ohri dhe rrethinat e tyre, numri i të cilëve arrinte në më shumë se 2 mijë, pjesa më e madhe e të cilëve rezultonin gra dhe fëmijë. Përmes një telegrami të tillë synohej gjithashtu sensibilizimi i Komisionit Evropian duke synuar

---

<sup>692</sup> Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së Imperializmi*, vëll. II, Tiranë: 1986, 372. Documents Diplomatiques Français, 3 eme serie, t. VIII, d. n. 341, pp. 429-431.

<sup>693</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 175-176.

<sup>694</sup> Po aty, 175.

<sup>695</sup> Po aty, 153, 424.

<sup>696</sup> “*The Morning Post*”, 8 nëntor 1913.

garantimin e jetës dhe të pasurive të këtyre refugjatëve duke u shprehur: “... që ata të kthehen në shtëpi përpara dimrit”<sup>697</sup>.

Sipas vëzhgimeve të drejtpërdrejta të kolonelit britanik Granet, rreth 12-15 mijë refugjatë shqiptarë rezultojnë të vendosur në Durrës, Mat, Shkodër dhe Tiranë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin shpërndarë nëpër familjet shqiptare të këtyre qyteteve ndërsa, pjesa tjetër jetonin në kushte të papërshtatshme<sup>698</sup>.

Ndërkohë, nga burimet e huaja konstatohet fakti se nëpërmjet kontributeve financiare të qeverive austriake dhe italiane, rezultonte se rreth 1.000 sterlina ishin shpenzuar për refugjatët e vendosur në Elbasan, 20.000 franga për refugjatët e vendosur në Durrës dhe 6.000 franga për ata që ishin vendosur në Shkodër. Porse sipas llogaritjeve të bëra nevojiteshin të paktën 40.000 sterlina për t’i siguruar atyre ushqim dhe strehim të paktën deri në pranverë<sup>699</sup>.

Ndërkohë, sigurimi i strehimit të refugjatëve konsiderohej tepër emergjent dhe kërkonte zgjidhje të menjëhershme edhe në kushtet e afrimit të stinës së ftohtë të dimrit. Një situatë e tillë, vështirësohej akoma më shumë për faktin se një pjesë e refugjatëve të vendosur në Shqipëri për shkak të masakrave serbe, frikës dhe shkatërrimit së pronave të tyre, nuk mund të ktheheshin më në trevat e tyre.

Kështu, në kërkesën e përfaqësuesve të pushtetit vendor në qytetet kryesore ku konstatoheshin dyndje masive e refugjatëve drejtuar përfaqësuesve të KNK në Shqipëri, më së shumti synohej sensibilizimi i shteteve evropiane jo vetëm në sigurimin e një mbështetje të menjëhershme financiare, por njëkohësisht edhe zgjidhjen e këtij problemi nëpërmjet hartimit të projekteve afatgjata.

Një mundësi e tillë brenda vendit shikohej në integrimin dhe përfshirjen e refugjatëve në punëra publike. Një kërkesë e tillë që parashtronte mundësinë drejt një zgjidhjeje afatgjatë të problemit të refugjatëve do t’i parashtronte KNK në 21 nëntor 1913 në mbledhjen e njëzetënjë të saj pikërisht nga Aqif Pasha. Në mesazhin e tij drejtuar KNK jo vetëm do të paraqitej situata e vështirë e refugjatëve të shumtë që gjendeshin në prefekturën e Elbasanit, por do të parashtrohej edhe propozimi i Aqif Pashës rreth gjetjes së mundësive për t’u ardhur në ndihmë atyre. Një alternativë e mundshme sipas Aqif Pashës konsistonte në përfshirjen e tyre në ndërtimin e rrugës

---

<sup>697</sup> Telegrami është dërguar në 13 tetor 1913, për Komisionin Europian në emër të refugjatëve nga Ohri dhe Struga: Ahmet Hyseni, Hasan Tasini, Aguel Papavasilov, Dr. Myrtezai. *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 157.

<sup>698</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët*, vepër e cituar, 214.

<sup>699</sup> Po aty, 424-425.



Durrës-Elbasan<sup>700</sup>. Porse sipas përgjigjes së dhënë, shqyrtimin e një kërkesë të tillë KNK do ta ndërmernte në muajin dhjetor, vetëm pas inspektimit të situatës në qytetet ku ishin vendosur refugjatët.

Ndërkohë, burimet e kohës na informojnë rreth faktit se në janar të vitit 1914 prefekti i Elbasanit ishte angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në punësimin e refugjatëve në ndërtimin e rrugës Elbasan- Peqin duke konstatuar se: *“Aqif Pasha pretori ynë mejtoi që t’u gjejë punë këtyre të varfërve, dhe ka vënë një inxhinier e po ndreq urën Haxhi Beqari, dhe udhën e Peqinit në vend që i thonë Dervend. Me këtë mënyrë edhe këto Dibranë ushqehenë, edhe pak punë bëhet”*<sup>701</sup>.

Gjithashtu, në faqet e gazetës britanike *“The Morning Post”* gjen pasqyrim një thirrje e Aqif Pashës drejtuar popullit anglez, në të cilën publikoheshin masakrat e serbëve ndaj popullit të Dibrës. Përmes një deklarate të tillë, Aqif Pasha më së shumti synonte sensibilizimin e opinionit publik britanik duke kërkuar jo vetëm mbështetje morale por në të njëjtën kohë edhe ndihmë financiare për refugjatët. Një deklaratë e tillë parashtronte gjithashtu edhe kërkesën e Aqif Pashës, në funksion të ngritjes së komiteteve të pavarura ndërkombëtare të hetimit, me synimin kryesor gjykimin e përgjegjësve realë të një situatë të tillë<sup>702</sup>.

Ndërkohë, për këtë problem qëndrimi zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës do të bëhet i njohur në 5 nëntor 1913, përmes një deklarate të saj që garantonte lirinë e zgjedhjes së vendqëndrimit për refugjatët që gjendeshin në Shqipëri duke deklaruar se: *“Tani, çdo shqiptar që ndihmohesh prej qeverisë duhet të zgjedhë një prej këtyre tri rrugëve: Ja të kthehet në katundin e vet; ja në mos do që të kthehet, le të bëhet muhaxhir dhe të vendoset atje ku të dojë, në Shqipëri, ja le t’i shtrohet punës atje ku është dhe ta fitojë paren me djersën e vet”*<sup>703</sup>. Kështu, në 13 nëntor të vitit 1913 përmes një njoftimi të dhënë nga Myftiu i Dibrës konstatohet se rreth 100. 000 persona kishin braktisur shtëpitë e tyre si rezultat i masakrave serbe duke u shprehur se: *“... nuk do të kthehen në asnjë mënyrë në territoret serbe”*<sup>704</sup>.

Gjithashtu, edhe në faqet e shtypit të asaj kohe jepet një panoramë e plotë e situatës së vështirë në të cilën gjendeshin refugjatët e vendosur në Elbasan. Në këtë kuadër, ndërsa vlerësohej nisma e qeverisë së Elbasanit për të punësuar një pjesë të refugjatëve në ndërtimin e

---

<sup>700</sup> Po aty.

<sup>701</sup> *Liri e Shqipërisë, janar – prill (1914 -1915)*, nr. 20, 18 janar 1914.

<sup>702</sup> AQSH. Fondi. 68. Gazeta “Morning Post”, November 8<sup>th</sup> 1913.

<sup>703</sup> Gazeta “Përlindja e Shqypniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, vit’i I, Nr. 22, dt. 5 nëntor 1913. *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 247.

<sup>704</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët ...*, vepër e cituar, 154.

rrugëve, evidentohet gjithashtu edhe kontributi i misionit amerikan të vendosur në Elbasan. Një kontribut i tillë do të evidentohet jo vetëm në hapjen e një shkolle filltare - mestore në Elbasan, por më së shumti do të shfaqet në mbështetjen që ata do t'i jepnin refugjatëve të vendosur në këtë qytet. Ky mision do të kontribuojë nëpërmjet një projekti për punësimin e grave refugjate të cilat do të merreshin me zejen e qepjes. Si organizatore të një projekti të tillë në faqet e kësaj gazete përmendeshin zonjat Cilka dhe Kenedy, kontributi i të cilave nuk ka gjetur vlerësimin e duhur<sup>705</sup>.

---

<sup>705</sup> “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 dhjetor 1913.

### IV. 3. Zhvillimet politike në Elbasan në vitet 1913-1914

Me shtypjen e kryengritjes anti serbe të Dibrës trupat serbe do të nisin marshimin drejt Adriatikut duke krijuar një situatë tepër kritike për vetë shtetin shiptar. Në këtë kuadër, veprimtaria e Esad Pashës duke përfituar nga një situatë e tillë tepër favorizuese për të, do të njohë zhvillime të reja. Në rrethana të tilla mbështetëse përmes kërkesës për shpërndarjen e Qeverisë së Vlorës, fillimisht ai do të synojë krijimin e një qeverie të re të përbashkët me selinë në Durrës.<sup>706</sup> Në funksion të përmbushjes së synimeve të tij, përmes premtimeve demagogjike përkrah tij do të rezultojnë tashmë përfaqësues jo vetëm nga rradhët e feudalëve shqiptarë por dhe figura të rëndësishme ndërmjet të cilëve: Mit'hat Frashëri, Faik Konica, Mustafa Kruja, Dervish Hima, Dervish bej Biçaku, vëllezërit Toptani (Mazar Bej Toptani, Hamit Bej Toptani vëllezërit e Abdi bej Toptanit) etj.<sup>707</sup>

Në Arkivin Qendror Shtetëror ekzistojnë një sërë dokumentesh të përfaqësuar nga telegrame dhe letra të kësaj periudhe, përmbajtja e të cilave evidenton dukshëm veprimtarinë aktive të Dervish Biçakut për të shkëputur nga ndikimi i Qeverisë së Vlorës jo vetëm Elbasanin por edhe Peqinin dhe trevat përreth, duke krijuar njëkohësisht edhe trazira në Tiranë, Durrës dhe rrethinat e tyre.

Në këtë kuadër, veprimtaria e Dervish bej Biçakut kundër Qeverisë së Vlorës dokumentohet që në qershor të vitit 1913, përmes një informacioni që Aqif Pasha në 29 qershor 1913 do t' i dërgonte Ismail Qemali duke u shprehur se: “ *Dervish Beu Elbasani që ndodhet në Tiranë i ka dhanë vetes emënim kryetar.... bash si t' ishte një funksionar politik e zyrtar. Në një anë duket se asht me qeverinë e n' anë tjetër merr krahun e kundërt.*” Gjithashtu, nëpërmjet kësaj letre informohemi edhe për situatën e krijuar në trevën e Elbasanit dhe përpjekjet e Dervish Beut

---

<sup>706</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 49.

<sup>707</sup> “*Jehona*”, nr. 6, Shkup: 1993, 31.

për të krijuar trazira duke mbështetur sikurse thotë Aqif Pasha në “*kriminalët që kanë nevojë me i gjetë vetes strehë*”<sup>708</sup>.

Kështu, veprimtaria e Dervish Bej Elbasanit (Biçaku) si një ndër përkrahësit më aktivë të Esad Pashës, do të jetë evidente në disa drejtime:

Së pari, në përpjekjet e tij për të bashkuar rreth Esad Pashës figura të rëndësishme politike duke përfshirë edhe anëtarë të Qeverisë së Vlorës një pjesë e të cilëve kishin shfaqur pakënaqësi ndaj aktivitetit dhe veprimtarisë së saj.

Së dyti, nëpërmjet çetave dhe bandave të krijuara nëpër fshatra, premisa të favorshme për ta shkëputur Elbasanin nga ndikimi i Qeverisë së Vlorës, duke zgjeruar sa më shumë zonën e administrimit të qeverisjes së Esad Pashës. Krijimi i një situatë të tillë lidhej me përmbushjen e synimit të Esad Pashës që konsistonte në kompromentimin e Qeverisë së Vlorës deri në përmbysjen e saj.

Kështu, Aqif Pasha i konsideronte si tepër shqetësuese përpjekjet e Dervish Biçakut për instrumentalizimin e elementëve kriminalë të cilët po i grumbullonte rreth vetes. Një shqetësim të tillë ai do tja bëjë prezent edhe Vlorës zyrtare duke u shprehur se: “*Arif Hiqmeti, Komanovas, ngatrestar me famë, po sillet tash dy ditë nëpër Çermenikë t’ Elbasaniti endet në Tiranë ditën për diell dhe jo që nuk e kapë kush por i japin me vedi cuba e trimnojnë dhe e përkrahin, aq sa një ditë e shtyjnë me mësyë Kavajën e Peqinin. Cubi me famë Hasan Tafani i cili arratiset mbasi kryen krime n’Elbasan dhe shokët e tij katili Muhtar Zyberi e kompani e shumë të tjerë kriminelë shkojnë në Tiranë të armatosun dhe bredhin lirisht pa u hy ferë në kambë. Tirana bahet strehë për ta. Ragipi e Jusuf Hoxha me të nipat prej katundit Selishtë të Dibrës në za për cubnitë e tyre disa ditë ma parë ishin në Tiranë dhe mbas instruksionevet të marruna prej Dervish Beut çveshën para pes ditësh udhtarët që po kalojshin nëpër Babje një vend ky në medis t’Elbasanit e Qukësit dhe ju grabitën plaçkat e të hollat që kishin të holla që kalojshin shumë e 100 liravet*”<sup>709</sup>.

Në një situatë të tillë, Aqif Pasha do ta konsiderojë si domosdoshmëri krijimin e një apo dhe dy batalioneve xhandarësh që duhej të dërgoheshin në Elbasan nga Qeveria e Vlorës, duke konstatuar faktin se pjesa më e madhe e popullsisë së kësaj treve kishte refuzuar mobilizimin

---

<sup>708</sup> AME, Kutia. 8, nr 76, f. 4.

<sup>709</sup> AME, Kutia. 8, nr 76, f.4. *Elbasani në luftë për çlirim*”, vepër e cituar, 27.

duke mos pranuar të përfshiheshin në një luftë vëllavrasëse<sup>710</sup>. Ndërkaq, në këtë kohë Prefektura e Elbasanit shfaqte me insistimin më të madh edhe kërkesën për furnizime me armë të cilat sikurse thuhej: “*armët e municionet nuk u dërguan*”<sup>711</sup>.

Në rrethanat e atëhershme, një kërkesë e tillë e Aqif Pashës për dërgimin e dy batalioneve me xhandarë do të kishte si mision organizimin e një sulmi ndaj esadistëve në zonën e Tiranës, e më konkretisht ndaj Dervish Biçakut. Të njëjtin mendim me Aqif Pashën ndante në këtë kohë edhe Luigj Gurakuqi, i cili përmes një letre dërguar Lef Nosit në shtator të vitit 1913 do t'i parashtronte atij mundësinë e organizimit të një sulmi ndaj fuqisë së grumbulluar të Esad Pashës duke u shprehur se: “... nëse do na duhet të nisim sulmin kundër Esad Pashës, a do të ishin të gatshëm burrat e Shpatit e të Martaneshit të marshonin drejt Peqinit dhe Kavajës? Një sulm i organizuar në këtë kohë kundër esadistëve më së shumti do të synonte kufizimin e një lëvizjeje të tillë që në fillesat e saj, për të kufizuar zgjerimin e saj në të ardhmen.

Porse, qëndrimi i Lef Nosi nuk rezultoi drejtpërsëdrejti në mbështetje të një sulmi të tillë ndaj esadistëve, duke e konsideruar veprimtarinë e Esad Pashës në këtë periudhë si një rrezik që realisht nuk mund të cënonte ekzistencën e vetë Qeverisë së Vlorës dhe njëkohësisht për të shmangur gjakderdhjen. Një qëndrim i tillë i Lef Nosit shprehej përmes fjalëve: “... *qeverija jonë s' duhet të marrë përgjegjësinë mbi fillimin e gjakderdhjes e të një lufte vëllavrasëse. Me sa duket Esad Pasha nuk ka ndërmend të kthej armët kundra nesh por të fitojë autoritet në popull e të krijojë një qeveri të tij, qëllim që e ka shprehur edhe më parë*”<sup>712</sup>. Kështu, koha tregoi se disa nga parashikimet e Lef Nosit do të përmbusheshin shumë shpejt.

Gjithashtu, burimet e kohës dokumentojnë aktivitetin dhe veprimtarinë e vëllezërve të Abdi bej Toptanit në mbështetje të Esad Pashës. Kështu, në 8 tetor 1913 Aqif Pasha informonte Vlorën për mbështetjen që vëllezërit Toptani po i jepnin Esad Pashës përmes organizimit të grupeve të armatosura në zonën e Shëngjergjit për ti drejtuar kundër Elbasanit duke u shprehur se: “*I çova letër Abdi Beut ku kritikova veprën e Hamit Beut ma parë e mandaj të Mazar Beut[vëllezërit e Abdi bej Toptanit], të cilët më dolën nga fjala që më kishin dhanë, sidomos veprën e Mazar Beut që asht tue mbledhë njerëz prej Shëngjergjit kundra Elbasanit*”. Duke e siguruar për besnikërinë e tij Aqif Pasha shkruante se: “*Nga fjalët e mija do të ketë kuptue Abdi*

---

<sup>710</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 172. Telegrami mban datën 2 shtator 1913.

<sup>711</sup> Po aty, 172. Telegrami mban datën 2 shtator 1913.

<sup>712</sup> AME, Kutia. 20, Dos. 10, nr. 19, fl. 1.

*Beu se unë s'jam i gënjuem e se s'ka as nonjë njeri këtu që të gënjehet sikur të vijnë të gjithë Toptanët, veç shpisë së Dervish Beut*”.<sup>713</sup>

Në funksion të përmbushjes së synimeve të tij, Dervish Biçaku do të përdorte strategjinë e përçarjes fetare, që konfirmohej përmes fjalëve që ai propogandonte: “*Kush e don Kurandin, të vijë me mua, kush don Ungjillin të mos vijë, se Aqif Pasha do të na bëjë kaurrë*”<sup>714</sup>. Një lëvizje e tillë, përgjatë muajve tetor-dhjetor 1913 do të marrë përmasat e një kryengritje të armatosur, që do të drejtohet kundër emërimit të një princi të krishterë, por që më së shumti synonte përmbushjen e synimeve dhe ambicieve politike të tij përmes mbështetjes së Esad Pashë Toptanit..

Ndërkaq, hapësira e shtrirjes së një lëvizjeje të tillë do të përshinte pjesën më të madhe të fshatrave në Prefekturën e Elbasanit dhe nënprefekturën e Peqinit, në popullsinë e të cilëve elementi fanatik mysliman rezultonte në dominancë.

Kështu, duke ju referuar dokumentacionit përkatës rezulton se nënprefektura e Peqinit që përbënte edhe mbështetjen më kryesore të Dervish Biçakut, është shkëputur nga administrata e Elbasanit në 12 shtator të vitit 1913 duke ju bashkuar administratës së Durrësit. Prefektura e Elbasanit njoftohet për një veprim të tillë, përmes një telegrami dërguar nga nënprefekti i “vetëmëruar” i Peqinit Kadri Beu [i biri i Demir Beut ish nënprefekti i Peqinit]<sup>715</sup>. Si rezultati i një veprimi të tillë, do të dëshmojnë problemet e para në lëvizjen e udhëtarëve nga Elbasani në Durrës dhe anasjelltas, për faktin se tashmë udhëtarët duhej të pajiseshin me leje kalimi. Të drejtën për të lëshuar leje të tilla në Elbasan e kishin vëllezërit e Dervish bej Biçakut si dhe nënprefekti i Peqinit Kadri beu<sup>716</sup>.

Paralelisht me aktivitetin e bandave të Dervish Biçakut, nuk do të mungojnë gjithashtu edhe letërkëmbimet midis Esad Pashës dhe Aqif Pashë Elbasanit. Një korrespondencë e tillë dokumentohet në 8 shtator të vitit 1913 në një letër që ai do t'i drejtojë Aqif Pashës. Përmes kritikave kundrejt Ismail Qemalit dhe veprimtarisë së tij në krye të shtetit shqiptar, Esad Pasha

---

<sup>713</sup> AME, Kutia 14, Dosja 5, Nr. 75, f. 1. Letra është më shkrim dore në dialektin e Elbasanit. I njëti dokument gjendet edhe në botimin “*Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*”, 227.

<sup>714</sup> Pirro Kito, “*Elbasani në Luftë për çlirim*”, Tiranë: 1974, 27.

<sup>715</sup> Sqarojmë se Kadri Beu pas largimit të Demir Beut si nënprefekt e mori vetë postin e nënprefektit pa miratimin e Vlorës dhe të Elbasanit. Edhe përpjekjet e bëra nga Aqif Pasha me udhëzimin e Vlorës për të vendosur një nënprefekt tjetër nuk rezultuan të sukseshme. Gjithashtu Kadri beu ka marrë pjesë edhe në Kuvendin e Krujës që u organizua me iniciativën e Esad Pashë Toptanit.

<sup>716</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 3, Dok. Nr. 11629, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 178.

synonte të largonte Aqif Pashën nga Ismail Qemali në të njëjtën kohë edhe mbështetjen që ai që ofronte për Qeverinë e Vlorës<sup>717</sup>.

Sipas Esad Pashës, kuptimi i kësaj rrethane mbështetëse të prefekturës së Elbasanit e kishte burimin në premtimin që Ismail Qemali i kishte dhënë prefektit të Elbasanit për ta transferuar Qeverinë e Përkohshme të Vlorës në Elbasan. Duhet thënë se, në një premtim të tillë Esad Pasha shikonte rrezikun që ekzistonte për ta shpallur Elbasanin kryeqytet, duke e konsideruar një vendimarrje të tillë si kompetencë të Evropës dhe princit të ardhshëm dhe duke u shprehur se: “... *Ky njeri i ulët [Ismail Qemali] ndoshta asht tue ju gubue [ju mbush mendjen] tue ju sigurie se Elbasani do të bahet Qendër e Qeverisë. Vllai em kurkush nuk ka të drejtë me e caktue që tash Kryeqytetin e Shqipërisë. Këtë do ta mendojë Evropa dhe do ta dij princi qi do të vij, cilido qoftë*”<sup>718</sup>.

Në muajt tetor-nëntor, veprimtaria e bandave të udhëhequra nga Dervish Biçaku do të shfaqë karakter gjithnjë e më përfshirës. Përmes informacionit që Dervish Beu i dërgonte Esad Pashës në tetor 1913, rezultonte se fuqia e mbledhur prej tij i kishte kaluar të njëmijë vetat<sup>719</sup>. Rritja e tensionit në marrëdhëniet midis prefekturës së Elbasanit dhe esadistëve pasqyrohej edhe në raportimet që Aqif Pasha në tetor 1913 i drejtonte Qeverisë së Vlorës duke u shprehur se: “*Informohemi se Dervish beu ka krijuar çeta, ka ndërprerë komunikimin midis Vlorës dhe Elbasanit dhe vazhdon të bëjë grabitje*”<sup>720</sup>.

Ndërkaq, në 12 tetor 1913 Esad Pasha do të krijojë “Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme”<sup>721</sup>. Një fakt i tillë gjen pasqyrim edhe në faqet e gazetës “Përlindja e Shqypëniës”, në të cilën pasqyrohet krijimi i qeverisë së Esad Pashës që cilësohet: “*e dyta qeverie shqiptare*”, duke përmendur emrat e Esad Pashës por dhe të përkrahësve të tij sikurse ishin; Dervish Hima, Faik Konica, Fazlli Pasha<sup>722</sup>. Gjithashtu, në këtë kohë përkrahës të Esad Pashës rezultonin edhe Mustafa Kruja e Mit’hat Frashëri<sup>723</sup>. Mendojmë se rreshtimi i tyre përkrah Esad Pashë Toptanit motivohej jo vetëm për arsye personale por gjithashtu ishte shprehje e pakënaqësive që ata kishin

---

<sup>717</sup> A.Q.SH. F. 68, D. 5, f. 21/2 - 21/3. Letra mban datën 8 shtatuer 1329/1913, mban shënimin: Do të hapet nga ay vetë.

<sup>718</sup> Po aty, f. 21/1 – 21/2. Letra mban datën 8 shtatuer 329, 1913. Mban shënimin: Do të hapet nga ay vetë.

<sup>719</sup> Po aty, D. 4, dok. Nr. 11833, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 221.

<sup>720</sup> Po aty, dok. Nr. 11831.

<sup>721</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 49.

<sup>722</sup> Gazeta “Përlindja e Shqypëniës”, organ i përkohshëm i Qeverisë së Vlorës, 18 tetor 1913.

<sup>723</sup> *Gazmend Shpuza, Kryengritja e shtatorit 1913 ...*, vepër e cituar, 30.

ndaj qeverisjes së Ismail Qemalit. Ndërkohë, krijimi i qeverisë së Durrësit fill pas shtypjes së kryengritjes shqiptare anti serbe të Dibrës, sipas studiuesve shqiptarë lidhej me sinkronizimin e veprimeve politike të Esad Pashës me serbët, duke siguruar prej tyre edhe mbështetje për përmbushjen e ambicieve të tij politike. Krijimi i kësaj qeverie, bëhej në një kohë kur në Shqipëri pritej të vinte Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit<sup>724</sup>.

Kështu, përmes raporteve të konsullit britanik në Vlorë, Londra zyrtare do të informohet fillimisht për krijimin e qeverisë së Durrësit dhe gjithashtu rret ankesave që Esad Pasha i parashtronte konsullit britanik në lidhje me Ismail Qemalin. Problemi më shqetësues i parashtruar nga Esad Pasha, kishte të bënte më së shumti me koncesionet e akorduara nga Qeveria e Ismail Qemalit. Ndërkohë, për të përligjur një realitet të tillë Esad Pasha do të kërkonte edhe emërimin sa më shpejt të princit të ardhshëm të shqiptarëve, duke e konsideruar këtë akt si domosdoshmëri dhe emergjencë në kushtet e krijuara. Kërkesa të tilla nga konsulli britanik do të konsiderohen si të pranueshme dhe të justifikuara<sup>725</sup>.

Por ndërsa parashtronte kërkesa të tilla, Esad Pasha kishte filluar organizimin e një lëvizjeje në favor të një princi mysliman

Kështu, në një situatë të tillë përmes udhëzimeve që konsujt e huaj i jepnin Ismail Qemalit, më së shumti synohej në arritjen e një marrëveshjeje të mundshme midis tij dhe Esad Pashës që në situatën e krijuar, më së shumti do të rezultonte në favor të Qeverisë së Vlorës<sup>726</sup>.

Në një kontekst të tillë, në 15 tetor 1913 do të vijë në Shqipëri KNK(Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit) përfaqësuesit e të cilit do të vendosen në Vlorë, duke ushtruar më pas një autoritet vëzhgues dhe kontrollues ndaj Qeverisë së Ismail Qemalit. Në këtë kuadër, dy ishin problemet më të rëndësishme që kërkonin zgjidhje me ardhjen e KNK në Shqipëri.

Së pari, problemi më delikat që lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me Qeverinë e Vlorës ishte njohja e saj nga KNK. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në KNK, nuk ndanin të njëjtin mendim për sa i përket statusit të njohjes së kësaj qeverie. Në diskutimet e tyre në mbledhjet e para të KNK, përfaqësuesit austriakë dhe ata italianë ishin për njohjen e Qeverisë së Vlorës si të vetmin autoritet kombëtar në vend, duke deklaruar se edhe vendosja e KNK në një qytet “të padëshirueshëm” si Vlora kishte pasur si qëllim njohjen e Qeverisë së Vlorës si Qeveri

---

<sup>724</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. I, vepër e cituar, 162. Raport i konsullit të përgjithshëm Lamb, për Edëard Grey, dërguar në 14 tetor 1913.

<sup>725</sup> Po aty.

<sup>726</sup> Po aty, 159.



të Shqipërisë. Ndërkohë, përfaqësuesit e tjerë në KNK, në qëndrimin e tyre ishin për njohjen e Qeverisë së Vlorës si autoritet lokal krahas autoriteteve të tjera që ekzistonin në Durrës apo në Shkodër<sup>727</sup>. Divergjencat midis përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në KNK, ishin pasqyrë e kontradiktave dhe rivaliteteve të vjetra në kuadrin e përvijimit të aleancave dhe marrëveshjeve të reja të diplomacisë evropiane në fillim të shek. XX.

Gjithashtu, një problem tjetër që rezultoi i debatueshëm midis anëtarëve të KNK dhe Qeverisë së Vlorës kishte të bënte me caktimin e përfaqësuesit shqiptar në KNK. Ky problem, më së shumti lidhej me procedurën e caktimit të përfaqësuesit shqiptar, për faktin nëse ai do të emërohej nga KNK apo do të caktohej nga Qeveria e Vlorës sikurse ishte kërkuar nga Ismail Qemali. Fakti i ekzistencës së divergjencave midis anëtarëve të KNK për këtë problem lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me statusin e njohjes së Qeverisë së Vlorës. Nëse do të pranohej emërimi i tij nga Qeveria e Vlorës, kjo do të përcaktonte njëkohësisht edhe njohjen “de jure” të saj si i vetmi autoritet kombëtar në Shqipëri.

Në këtë kuadër, pas diskutimesh dhe debatesh të gjata në mbledhjet e KNK, kandidatura më e përshtatshme e paraqitur nga përfaqësuesi austro-hungarez dhe ai italian në KNK që më pas mori miratimin edhe të anëtarëve të tjerë të KNK por jo të Ismail Qemalit, u konsiderua kandidatura e Myfid Bej Libohovës ministër i jashtëm në qeverinë e Ismail Qemalit<sup>728</sup>.

Ndërkaq, zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri në muajin tetor, përplasjet midis bandave të Esad Pashës drejtuar nga Bektash Cakrani në Fier dhe Dervish bej Biçaku në prefekturën e Elbasanit deri në kufi më Lushnjën, ishin objekt i raportimeve sistematike që konsujt e huaj në Shqipëri u dërgonin eprorëve të tyre. Në mendimet e tyre, konflikti midis Esad Pashës dhe Ismail Qemalit shikohej si shprehje e rivaliteteve të Fuqive të Mëdha në kuadrin e aleancave të krijuara, duke e konsideruar Esad Pashën si përkrahës të politikës sllavo-ruse në Shqipëri, që synonte të krijonte paqëndrueshmëri politike dhe destabilitet në favor të një copëtimi të ri të Shqipërisë në të ardhmen. Një profil i tillë i Esad Pashës sipas burimeve britanike më së shumti do të konsiderohej si produkt i ambicjeve personale të tij<sup>729</sup>.

Kështu, për sa kohë nuk ishte përcaktuar përfundimisht princi i huaj, diplomacia evropiane e përfaqësuar nga Austro-Hungaria, Italia, Britania e Madhe e konsideronte si

---

<sup>727</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vepër e cituar, 208-209.

<sup>728</sup> Po aty, 314. Procesverbal i takimit të 9 të KNK.

<sup>729</sup> Po aty.

oportune ekzistencën e Qeverisë së Vlorës, duke e konsideruar atë si faktor ekuilibruës ndaj lëvizjes së Esad Pashës.

Një dukuri e tillë konfirmohej përmes telegramit që Ismail Qemali do t'i dërgonte prefektit të Elbasanit në 7 nëntor 1913 ku pohohej se: “ Komisioni i Kontrollit jo vetëm ishte shprehur për “mbetjen”(ekzistencën) e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, por gjithashtu kishte pranuar të ndihmonte Qeverinë e Vlorës në përpjekjet e saj për reforma të reja në qeveri”. Në vazhdim të këtij telegrami, Ismail Qemali për herë të parë do t'i kërkojë Aqif Pashës që për hir të interesave të atdheut t'i lërë mënjane konfliktet personale me Qemal Karaosmanin. Letra e Ismail Qemalit mbyllet me premtimin që ai i bën Aqif Pashës se së shpejti Elbasani mund të shpallej kryeqendër e Shqipërisë<sup>730</sup>.

Por duhet thënë se nuk mungojnë në këtë periudhë përpjekjet e Aqif Pashës për të ndërmjetësuar në sigurimin e një kompromisi të mundshëm midis Ismail Qemalit dhe Esad Pashës. Ndonëse Esad Pasha e miratoi ardhjen e princit të huaj në Shqipëri, ai do të cilësohej si organizatori i lëvizjes në favor të një princi mysliman. Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi edhe në informacionet që konsulli britanik i dërgonte Londrës zyrtare në nëntor 1913, i cili shprehej se: “*Duke parë këtë dhe duke qenë, kësisoj, i bindur se ardhja e Princ Vidit është e garantuar, Esat Pasha, i cili më së paku, dyshohet se po inkurajon lëvizjen në favor të një sovranit mysliman, me dinakërinë e tij të zakonshme, ka filluar të ushtrojë ndikimin e tij në mbështetje të asaj që ai mendon se mund të jetë pala fituese*”<sup>731</sup>.

Në këtë kuadër, duke ju referuar dokumenteve britanike, konstatojmë përpjekjet e konsullit italian sinjor De Facendis për të ndërmjetësuar me Esad Pashën, i cili sikurse thuhej pranonte të përmbushte premtimin e tij për tu dorëhequr menjëherë, nëse të njëjtin veprim do të bënte edhe Ismail Qemali. Në këtë rast, sipas informacionit të marrë nga konsulli britanik, Lamb parashikohej krijimi i një kabineti të ri qeveritar të përbërë prej gjashtë anëtarësh, dy nga Shqipëria e Veriut, dy nga Jugut dhe dy anëtarë të tjerë të zgjedhur nga Esad Pasha dhe Ismail Qemali. Sipas mendimit të konsullit britanik mendohej se përfaqësues i Jugut do të ishte Mehdi bej Frashëri dhe doktor Turtulli banor i Korçës, ndërsa një përfaqësues i Shqipërisë Veriore mendohej monsinjor Primo Doçi abat i Mirditës<sup>732</sup>.

<sup>730</sup> AME, Kutia 14, Dosja.9, nr.13, f. 3-4. Letra mban datën 24 tetor 1329/ 7 nëntor 1913.

<sup>731</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. I, vepër e cituar, 162. Raport i konsullit të përgjithshëm Lamb, për Edëard Grey dërguar në 23 nëntor 1913.

<sup>732</sup> Po aty, 389. Raport i konsullit të përgjithshëm Lamb, për Edëard Grey, dërguar në 14 nëntor 1913.

Në këtë kohë, përkrah Esad Pashë Toptanit do të rreshtohet edhe Hasan Prishtina. Një qëndrim i tillë, fillimisht do të evidentohet përmes përpjekjeve të tij për të nxitur bashkëpunimin midis Prefektit të Elbasanit dhe Esad Pashës. Ekziston mendimi se ky qëndrim i Hasan Prishtinës ishte rezultat i premtimeve demagogjike të Esad Pashës për të bashkuar Dibrën me shtetin shqiptar<sup>733</sup>. Nuk është rastësi fakti se në këtë trevë, Esad Pasha do të gjejë mbështetje më kryesore në krijimin e bandave në mbështetje të tij.

Kësaj periudhe i përkasin edhe përpjekjet e prefektit të Elbasanit në funksion të realizimit të një kompromisi midis Ismail Qemalit dhe Esad Pashës, duke i ofruar këtij të fundit postin e Ministrit të Luftës, me kushtin që Qeveria Qendrore e Vlorës brenda 10 ditëve të transferohej në Elbasan. Përmes një kompromisi të tillë garantohej së pari shuarja e konflikteve dhe së dyti vazhdimësia e qeverisjes, përmes fjalëve: *“Në rast se Qeveria Qëndrore transferohet këtu, mosmarrëveshja do të zhduket”*<sup>734</sup>. Mirëpo një bashkëpunim i tillë do të rezultojë i pamundur, për faktin se dhe vetë ekzistenca e Qeverisë së Vlorës do të përcaktohej nga ardhja e Princit të huaj. Në letrën që Ismail Qemali do t’i dërgonte Aqif Pashës shprehimisht thuhej: *“Vetëm në vonoftë ardhja e sovranit në Shqipëri, për ca dit do të vi( në tekst: do të shkoj) atje[Elbasan] sigurisht për me pa bashkatdhetarët e atjeshëm para se me lanë detyrën ashtu dhe për me bisedue me Shkëlqesin t’uej mbi ndërtimet dhe përgatitjet qi nevojiten për me u ba Elbasani kryeqytet”*<sup>735</sup>. Ndërkaq, në nëntor të vitit 1913 Ismail Qemali e konsideronte si të papërshtatshme kërkesën e Aqif Pashës për të transferuar qendrën e Qeverisë Kombëtare në Elbasan duke e konsideruar këtë veprim si një gabim politik të pafalshëm<sup>736</sup>.

Në këtë kuadër, pohojmë se Ismail Qemali e pranonte rëndësinë që shfaqte Elbasani si qendër e Shqipërisë dhe e shikonte si mundësi në të ardhmen transferimin e Qeverisë së Vlorës atje, porse një veprim të tillë në nëntor të vitit 1913 ai e konsideronte taktikisht si një lëvizje diplomatike të përshtatshme dhe të papërshtatshme. Transferimi i Qeverisë së Vlorës në Elbasan ishte edhe premtimi që Ismail Qemali i kishte bërë Aqif Pashës.

Ndërkohë, në nëntor të vitit 1913 situata në Vlorë nuk paraqitej e qetë. Një situatë e tillë bëhet prezente përmes letrës së dërguar nga Myfit Libohova në 22 nëntor 1913, ku konstatohej

<sup>733</sup> “Jehona”, vepër e cituar, 37.

<sup>734</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 4, Dok. Nr. 120 14, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 248. Letra mban datën 14 nëntor 1913.

<sup>735</sup> AME, Kutia 14, Dosja.9, nr.21, f. 7-8. Letra mban datën 10 Nanduer 329/23 nëntor 1913.

<sup>736</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 4, Dok. Nr. 120 31, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 248. Mbi zarfin e letrës ka këtë shënim: “ I parashtrohet të Shkëlqyeshmit Aqif Pashës në Elbasan”.

situata e rëndë në të cilën ndodhej Qeveria e Vlorës dhe situata pesimiste në të cilën gjendeshin ministrat e kësaj qeverie. Duke e konsideruar Aqif Pashën si të vetmin person që në këtë kohë gëzonte autoritetin, reputacionin dhe fuqinë e mundshme dhe që e bënte atë të ishte i suksesshmen jo vetëm në administrimin e Elbasanit por edhe të trevave të tjera të Shqipërisë Myfit Libohova do të shprehej se: “ ... *Harmonia midis katër a pesë administratave që janë formuar sot në Shqipëri(Vlorë, Durrës, Malësi, Shkodër) është në dorë të Shkëlqesis Suaj. Shkëlqesia Juaj, sipas rrethanave të sotme është në një pozitë që mund të dominojë në Shqipëri. Mos e humbi këtë rast. Fuqinë dhe zotësinë Tuaj ja kushtoni Shqipërisë dhe harxhojeni për shpëtimin dhe mbarëvatjen e saj. Bëhuni hero i një ngjarjeje historike*”<sup>737</sup>. Përmes një letre të tillë më së shumti Myfit Libohova synonte të nxiste ambiciet politike të Aqif Pashës në ndërmarrjen e iniciativës për tu vënë në krye të shtetit shqiptar, për faktin se ndërmarrja e një veprimi të tillë nga Aqif Pasha do të shënonte edhe fundin e Qeverisë së Vlorës.

Gjithashtu, Myfid Libohova duke shfaqur edhe pakënaqësinë që ekzistonte ndër një pjesë të ministrave të Qeverisë së Vlorës, do t'i kërkojë Aqif Pashës ndërmjetësimin midis Esad Pashës dhe Ismail Qemalit pikërisht në një vend të paanshëm sikurse ishte Elbasani, me qëllim pranimin e një programi të përgjithshëm dhe lidhjen e një bese. Ndërkohë, arritja e një kompromisi të tillë përbënte një ndër kërkesat e vazhdueshme të përfaqësuesve të KNK në muajt tetor-nëntor 1913, në arritjen e një paqeje të qëndrueshme.

Por në dhjetor të vitit 1913, një nga problemet më të rëndësishme që shtrohej për zgjidhje përpara Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, do të ishte marrja në dorëzim e Korçës dhe territoreve të tjera të okupuara nga grekët. Në këtë kuadër, Ismail Qemali duke u nisur nga rëndësia që kishte kjo krahinë për shtetin shqiptar, kishte paracaktuar Aqif Pashën si përfaqësues i Qeverisë së Vlorës në cilësinë e Komisarit të jashtëzakonshëm në Korçë me kompetenca të plota vendimmarrjeje, duke mbajtur njëkohësisht edhe detyrën e Prefektit të Elbasanit. Në dy telegramet e tij dërguar prefektit të Elbasanit, Ismail Qemali do të shprehej: “... *Nuk më erdhi ndër mend tjetër person veç Shkëlqesës Suaj që ta kryente këtë detyrë patriotike, duke mbajtur mbi vete gjithnjë edhe detyrën e prefektit të Elbasanit*”<sup>738</sup>.

---

<sup>737</sup> Po aty, dok. Nr. 120 30, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 254. Letra mban datën 23 nëntor 1913.

<sup>738</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, Dok. Nr. 12162, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 254. Letra mban datën 3 janar 1914.

Gjithashtu, në 3 dhjetor 1913 në takimin e 22-të të KNK, përfaqësuesi i KNK z. Petrajev informon Komisionin për caktimin nga Ismail Qemali të mytesarifit në Korçë, duke e konsideruar këtë veprim si të papërshtatshëm përderisa Ismail Qemali nuk ishte konsultuar më parë me përfaqësuesit e KNK<sup>739</sup>.

Ndërkohë, në muajt dhjetor-janar 1913/1914, përmes telegrameve të shumta që përfaqësuesit e krahinave të prefekturës së Elbasanit dërguar Aqif Pashës, konstatohen përpjekjet intensive të Esad Pashës dhe përkrahësve të tij për të vendosur autoritetin e qeverisë së Durrësit në zonën e Okshtunit, Klenjës, Qukësit, Hotolishtit, duke u përpjekur për të nxitur konflikte fetare midis myslimanëve dhe ortodoksëve përmes premtimit për ardhjen e një princi mysliman në Shqipëri.

Në këtë kohë, konstatohen gjithashtu përpjekjet e KNK në funksion të organizimit të xhandarmërisë shqiptare. Në projektet për krijimin e xhandarmërisë parashikohej fillimisht krijimi i një bërthame të përbërë nga një efektiv prej 750 xhandarësh të ndarë midis tetë sektorësh sipas qyteteve kryesore ku përfshiheshin: Shkodra, Durrësi, Elbasani, Berati, Dibra, Gjirokastra dhe Korça a Leskoviku<sup>740</sup>. Një strukturë e tillë do të drejtohej nga një grup oficerësh holandezë që kishin ardhur në Shqipëri që në 10 nëntor 1913. Për këtë problem, në 11 dhjetor 1913 konsulli anglez Lamb shprehej se: *“Oficerët holandezë e konsiderojnë të mundshme që të organizohet brenda tri javëve një xhandarmëri me 1.000 trupa, të cilët mund të jenë të mjaftueshëm për të ruajtur rendin, përveç rastit nëse do të ketë rezistencë të organizuar në shkallë të gjerë”*<sup>741</sup>.

Pra, sikurse konstatohet përmes këtij dokumenti duhet thënë se në kohën kur aktiviteti i bandave të Esad Pashës kishte marrë përmasa të konsiderueshme duke rrezikuar edhe vetë prefekturën e Elbasanit,[mbrojtja e së cilës bëhej nga milici lokale], xhandarmëria shqiptare që ishte kompetencë e oficerëve holandezë akoma nuk ishte krijuar. Por, qëllimi më kryesor i xhandarmërisë së organizuar nga oficerët holandezë do të ishte ruajtja e sigurisë dhe administrimi i atyre zonave nga të cilat do të evakuoheshin trupat greke, largimi i të cilave mendohej se mund të sillte edhe komplikacione të mundshme të shkaktuara nga vetë grekët. Kështu, në 10 dhjetor 1913, Aqif Pasha informonte Qeverinë e Vlorës për organizimin e çetave

---

<sup>739</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. I, vepër e cituar, 501.

<sup>740</sup> Po aty, 391

<sup>741</sup> Po aty, 502.

greke të shkëputura nga ushtria si vullnetarë, nga kapiteni grek Varda të cilat do të kishin si qëllim krijimin e një anarshie të plotë në vendet që do të zbrazeshin<sup>742</sup>.

Në këtë kuadër, për të marrë në dorëzim territoret që do të zbrazeshin nga grekët, sikurse ishin Korça, Gjirokastra, Kolonja, Leskoviku e Përmeti, konsulli britanik, Lamb nuk përjashtonte edhe mundësinë e dërgimit në këto zona të një force ndërkombëtare<sup>743</sup>. Territoret që do të zbrazeshin nga forcat greke do të kalonin në administrimin e Qeverisë së Vlorës, e cila do të financonte edhe shpenzimet e para të organizimit të xhandarmërisë<sup>744</sup>. Ndërkaq, edhe situata në kabinetin qeveritar në Vlorë nuk dukej e qetë. Në 30 dhjetor të vitit 1913, konsujt e huaj raportojnë për një ri kompozim të Qeverisë së Vlorës. Midis lëvizjeve të ministrave raportohej dorëheqja e ministrit të luftës Mehmet Pashë Derallës. Një veprim i tillë sipas konsullit britanik nuk vinte për motive patriotike, po më së shumti motivohej nga interesat e tij politike.

Gjithashtu, dorëheqja e Ministrit të luftës Mehmet Pashë Derrallës, pasqyrohet edhe në gazetën “Përlindja e Shqipniës” 27 dhjetor 1913. Kështu, një veprim të tillë vetë Mehmet Pasha e konsideronte si një reagim të natyrshëm ndaj rrugës despotike që po ndiqte Qeveria e Vlorës. Ndërkohë, raportohej se boshllëqet në kabinetin e Ismail Qemalit ishin plotësuar me emërimin e përkohshëm të Fejzi Beut dhe Qemal Beut [Karaosmanit], ky i fundit kishte qenë sekretar i Ismail Qemalit, ministër i Brendshëm në detyrë dhe ministër i Bujqësisë<sup>745</sup>. Gjithashtu, një emërim që nga konsujt e huaj konsiderohej “sensacional” përbënte ai i Preng Bibë Dodës në pozicionin e “zëvendëspresidentit të Qeverisë Provizore” dhe njëkohësisht edhe të “përfaqësuesit” të saj në Shqipërinë e Veriut, emërim ky i bërë pa miratimin e KNK.

Në janar të vitit 1914, rritja e tensionit në marrëdhëniet midis popullsisë së prefekturës së Elbasanit u reflektua në përplasjet dhe luftime të shumta midis esadistëve dhe milicisë së Prefekturës së Elbasanit. Në raportet e konsullit britanik Lamb në 2 janar të vitit 1913, pohohej se Dervish bej Elbasani në bashkëpunim me Esad Pashën po zhvillonin një agjitacion të fortë kundër njohjes së Princit të krishterë në krahinat e Mokrës dhe të Çermenikës në Veri-Lindje të Elbasanit. Sipas konsullit britanik, këto zona përfshiheshin në itinerarin e ekspeditës së batalionit të xhandarëve që do të nisej për në zonën e Korçës, duke rrezikuar një përplasje të mundshme

---

<sup>742</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, Dok. Nr. 12080, kopje, përkthim nga turqishtja. në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ... , vepër e cituar*, 289.

<sup>743</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. I, vepër e cituar, 525.

<sup>744</sup> Po aty, 543.

<sup>745</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janarr-dhjetor 1914)*, vëll. II, Përgatiti Valentina Duka, Tiranë: Botimet Toena, 2012, 39.

midis tyre. Për këtë problem konsulli britanik do të pohonte se: “... ai[Esad Pasha] ka propaganduar me përkushtim mes popullatave më të ashpra dhe më të largëta malore farën e një kryengritjeje kundër pranimet të një Sovrani të “pa fe”. Njëkohësisht, ky fakt nuk e ka ndaluar atë të dëbojë pa shumë ceremoni nga Durrësi, agjentët e dërguar nga Turqit e Rinj të Kostandinopojës për të njëjtin qëllim”.<sup>746</sup> Po në të njëjtën datë, komandantët e batalioneve të qarkut të Elbasanit njoftojnë prefektin e Elbasanit për shtypjen e kryengritjes së organizuar nga Dervish Biçaku fillimisht në zonën e Letëmit dhe të Zgozhdës, kryengritje e cila më pas ishte përhapur edhe në zonën e Mokrës nga fshati i Neshtit deri në Pishkash.<sup>747</sup>

Ndërkohë, më e rrezikuar prej sulmeve esadiste rezultonte krahina e Starovës dhe e Qukësit, ku si rezultat trazirave që kishin filluar efektivat e milicisë së atjeshëm kishin dezertuar dhe kaluar në anën e Mahmut Biçakut. Në një kontekst të tillë, për të mbajtur nën kontroll këto zona, Aqif Pasha shpresonte në mbështetjen e një batalioni xhandarësh nën drejtimin e major Mustafait që kishin ardhur nga Vlora. Porse, për të evituar gjakderdhjen, duhet thënë se zgjidhjen e një situatë të tillë Aqif Pasha e shikonte më së shumti në ndërmarrjen e veprimeve diplomatike sesa në përplasjen e armatosur duke u shprehur se: “... ka të ngjarë që të derdhet shumë gjak”.<sup>748</sup>

Kështu, në 8 janar 1914 luftime të ashpra midis bandave të Esad Pashës dhe xhandarëve të Elbasanit raportoheshin në vendin e quajtur Kodra e Polisit. Ndërkohë, në 9 janar 1914 bandat e Esad Pashës kishin nisur një sulm të përgjithshëm drejt Elbasanit të organizuar në tri kolona, duke kërcënuar drejtpërsëdrejti komunikimin e Elbasanit me trevat e tjera në zonën lindore dhe perëndimore<sup>749</sup>. Duke u nisur nga Tirana një kolonë ushtarake prej 7000-8000 efektivash do t'i drejtohet Çermenikës, ndërsa kolona tjetër e drejtuar nga Dervish Biçaku ishte nisur nga Peqini drejt Elbasanit, duke ndërprerë disa nga rrugët e komunikimit, sikurse ishte rruga Qukës-Starovë, rruga Lushnjë – Berat<sup>750</sup>. Në pamundësi të ndihmës edhe nga vetë Qeveria e Vlorës, një sulm me përmasa të tilla do të shënonte edhe rënien e Prefekturës së Elbasanit. Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi edhe në të dhënat e konsullit të përgjithshëm britanik Lamb i cili

---

<sup>746</sup> Po aty, 51.

<sup>747</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, Dok. Nr. 12159, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 306. Letra mban datën 20-21 shënëndre 1329 / 2 janar 1914.

<sup>748</sup> Po aty, dok. Nr. 12210, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 313.

<sup>749</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar - dhjetor 1914)*, vëll. II, vepër e cituar, 59.

<sup>750</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, dok. Nr. 12210, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 316-317.

shprehej se: “... *Aqif Pasha na bëri të kuptojmë se ai, me të gjithë gjasat, do të ishte i detyruar të dorëzohej, përveç nëse mund të bëhej diçka për ta ndihmuar atë*”.<sup>751</sup>

Për më tepër, duhet përmendur fakti se Qeveria e Vlorës në 24 dhjetor 1913 kishte shpallur shtetrrëthimin, duke i dhënë kompetenca gjindarmërisë hollandeze për sigurimin e vendit<sup>752</sup>.

Pavarësisht faktit se në janar të vitit 1914 në Elbasan ishte vendosur batalioni i xhandarëve të ardhur nga Vlora, burimet e kohës konfirmojnë qëndrimin refuzues të majorit të këtij batalioni për të mos u përfshirë në luftimet me bandat esadiste në mbështetje të prefekturës së Elbasanit. Një qëndrim i tillë motivohej me faktin se destinacioni i këtij batalioni nuk ishte Elbasani por Korça nga e cila pritej largimi i trupave greke.<sup>753</sup>

Një situatë e tillë është tregues i faktit se Prefektura e Elbasanit duhej të përballlej e vetme me rrezikun e bandave esadiste që falë mbështetjes financiare që kishin shtoheshin nga dita në ditë. Për më tepër, edhe ajo pjesë e xhandarëve të ardhur nga Vlora nën drejtimin e togerit Nuri Agajt në 10 janar të vitit 1914, nuk kishin pranuar të luftonin kundër esadistëve dhe kishin dezertuar duke u arratisur nëpër male, ndërsa pjesa tjetër që ishte kthyer në Elbasan deklaronte se: “... *ne nuk jemi shkruar gjindarmë për të luftuar me vëllezërit tanë, por për të shkuar në Korçë*”<sup>754</sup>. Në këtë kuadër, mendojmë se rezultati i një dezertimi të tillë do të ndikonte drejtpërsëdrejti në shmangien e gjakderdhjes dhe viktimave, numri i të cilëve mund të ishte i konsiderueshëm.

Parë në këtë këndvështrim, pohojmë se Prefektura e Elbasanit në këtë kohë përbënte mbështetjen më të sigurt të Qeverisë së Vlorës ndaj përpjekjeve të përkrahësve të Esad Pashës për ta shkëputur këtë zonë nga ndikimi i Qeverisë së Vlorës.

Mendojmë se këtu e ka burimin edhe fakti që Aqif Pasha nuk e pranoi postin e Komisarit të Jashtëzakonshëm në Korçë të ofruar nga Ismail Qemali duke ju përgjigjur atij me fjalët se: “... *Pra, pas largimit tim, qind për qind është e sigurt që Elbasani do të bashkohet me Durrësin. Kështu me keqardhje Ju lajmëroj se për mua nuk është e mundur ta marr mbi vete këtë detyrë që*

---

<sup>751</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar - dhjetor 1914)*, vëll. II, vepër e cituar, 99.

<sup>752</sup> Gazeta “Përlindja e Shqypniës”, organ zyrtar i Qeverisë së përkohshme të Vlorës, Vit I, Nr. 35, 27 dhjetor 1913. Korrespondent i Elbasanit Emin Matraxhiu.

<sup>753</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, Dok. Nr. 12210, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 316.

<sup>754</sup> Po aty, dok. Nr. 12217, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 320.



*do të më nderonte*<sup>755</sup>. Në të njëjtën kohë, rreziku i rënies së Elbasanit në duart e rebelëve esadistë, konsiderohej nga Aqif Pasha njëkohësisht si fundi i Qeverisë së Vlorës.

Duhet thënë se në muajt dhjetor 1913 / janar 1914 lëvizja esadiste ishte fuqizuar shumë duke marrë përmasat e një kryengritjeje të armatosur me karakter politik. Një lëvizje e tillë instrumentalizohej përmes aktivizimit të elementit fanatik mysliman duke u zhvilluar paralelisht edhe si një lëvizje me karakter fetar dhe që drejtohej gjithashtu edhe kundër vendimmarrjes së Fuqive të Mëdha dhe princit jo mysliman që pritej të vinte në Shqipëri.

Në një kontekst të tillë, mendojmë në këtë kohë në prefekturën e Elbasanit ekzistonin premisat për shpërthimin e një lufte civile. Kur bëjmë një pohim të tillë mbështetemi jo vetëm në burimet vendase por edhe në ato të huaja.

Kështu, konsulli britanik Lamb në janar të vitit 1914 pranonte faktin se në këtë kohë lëvizja e Esad Pashës përbënte një përpjekje të hapur për të përmbysur me forcë Qeverinë e Vlorës. Përmes një pohimi të tillë, evidentohej edhe qëllimi final i Esad Pashës që më së shumti synonte të arrinte dorëzimin e prefekturës së Elbasanit dhe shkëputjen përfundimtare të saj nga Qeveria e Vlorës. Me krijimin e një rrethane të tillë, Esad Pasha kishte planifikuar marshimin drejt Beratit dhe më pas drejt Fierit. Me dorëzimin e Fierit do t'i kërkonte Ismail Qemalit dorëheqjen në favor të Omer Pashë Vrionit. Në funksion të përmbushjes së një plani të tillë, Esad Pasha kishte arritur të siguronte mbështetjen e bejlerëve vendas të Beratit dhe të Fierit, që sipas pohimeve të konsullit britanik: “ ... *ishin blerë nga qeveria greke*”<sup>756</sup>. Për sa i përket bejlerëve të përmendur mendojmë se midis të tjerëve bëhet fjalë edhe për vëllezërit Cakrani të cilët ishin rreshtuar përkrah Esad Pashës që në tetor të vitit 1913.

Gjithashtu, në favor të një fakti të tillë flasin edhe informacionet e konsullit të përgjithshëm francez, sipas pohimeve të të cilit rezultonte se Esad Pasha kishte pasur kontakte të vazhdueshme edhe me qeverinë greke, prej nga kishte marrë një shumë prej 20 mijë sterlina.<sup>757</sup>

Ndërkohë, në panoramën që Aqif Pasha do t'i bëjë situatës në prefekturën e Elbasanit në janar të vitit 1914, do të përmenden luftime të përgjakshme midis popullsisë së kësaj prefekturë e cila sikurse pohonte Aqif Pasha; ndodhej në një gjendje anarkie të plotë<sup>758</sup>.

---

<sup>755</sup> Po aty, dok. Nr. 12174, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj* ..., vepër e cituar, 312. Letra mban datën 6 janar 1914.

<sup>756</sup> *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, vëll. II, vepër e cituar, 66.

<sup>757</sup> Po aty, 67.

<sup>758</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, Dok. Nr. 14,029, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj* ..., vepër e cituar, 382.

Përmes studimit të dokumentacionit përkatës të kësaj periudhe, të dhënat që disponojmë për sa i përket viktimave në luftimet e zhvilluara në këtë kohë apo dhe statistika të tjera të kësaj natyre janë të kufizuara. Kështu përmes një letre dërguar nga drejtuesi i krahinës së Okështunit Hasan Osmanai, Aqif Pasha lajmërohej për akte kërcënuese të mundshme të popullsisë së kësaj zone ndaj prefekturës së Elbasanit dhe gjithashtu edhe për viktima duke theksuar se: *“Zoti prefekt, këtu në krahinët tonë kanë fillue disa nga njerëzia e vendit t’onë duke bamun propaganda në mest popullit.*

*...Sot marrim vesht pas qeraxhisë se në fushë të Dibrës...plasi pushka në mest dy palëvet edhe flitet se u vranë dhiët (dhjetë) vetë... Të lutem ç’do far urdhëri qi të bajsh ma dërgo<sup>759</sup>. Drejtor i krahinës së Okështunit, Hasan Osman.*

Konfrontimi me armë për disa muaj, midis përkrahësve të Esad Pashës dhe milicisë apo vullnetarëve të prefekturës së Elbasanit që përfaqësonin autoritetin e Qeverisë së Vlorës, rezulton në funksion të përmbushjes së synimit më kryesor të Esad Pashës përmbysjes me forcë të qeverisë shqiptare të Vlorës. Ndërkohë, një situatë e tillë, është tregues i faktit se vendi po përfshihej dukshëm në vorbullën e një konflikti të armatosur.

Në këtë kuadër, duke qenë në goditjen e pandërprerë të bandave të Esad Pashës, në 17 janar 1914 Aqif Pasha do t’i drejtohet Kryesisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës me këto fjalë: *“Sikundër ju kemi parashtruar gjatë e gjerë me një telegram tjetër që ju hoqëm pak më parë, është e vërtetë se sonde ose nesër ka për të ndodhur një sulm nga ana e Peqinit, edhe Malësitë e Matit dhe të Dibrës kanë për ta sulmuar Elbasanin. Këshilli i Kontrollit ose nuk është kompetent ose nuk do ta marrë në dorë këtë punë. Njëren nga këto dy pikëpamje duhet ta pranojmë me doemos”<sup>760</sup>.*

Një informacion i tillë është tregues i faktit se në janar të vitit 1914 situata në Elbasan rezultonte tepër alarmante dhe e rrezikshme, sa që Aqif Pasha e konsideronte si domosdoshmëri për të sjellë në Elbasan një guvernator të huaj të emëruar nga KNK, i cili përkohësisht do të merrte përgjegjësinë e drejtimit të administratës civile.<sup>761</sup>

Në këtë kohë, përkrah lëvizjes Esadiste ishin grupuar edhe disa personalite të rëndësishme të kohës, sikurse ishin: Dr. Turtulli, Mit’hat Frashëri, Abdyl Ypi dhe Grigor Cilka,

<sup>759</sup> AQSH. Fondi. Aqif Pasha, Dos. 5, fl.32/2

<sup>760</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, dok. Nr. 14,029, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 324-325. Letra mban datën 17 janar 1914.

<sup>761</sup> Po aty.

në cilësinë e përfaqësuesve të Këshillit të Kontrollit për të ndërmjetësuar me Dervish bej Biçakun. Këta persona, do të konsiderohen nga Aqif Pasha si përgjegjësit më kryesorë në parashtrimin e një situatë politike jo reale në prefekturën e Elbasanit duke u shprehur se: “... *këta e kanë kthyer Këshillin e Kontrollit kundër nesh*”<sup>762</sup>.

Ndërkaq, pas dështimit të komplotit të Beqir Grebenesë, dhe përfshirjes së Qeverisë së Vlorës por dhe qeverisë së Durrësit në këtë komplot, Ismail Qemali do të deklarojë dorëheqjen dhe do të largohet nga Shqipëria pa pritur ardhjen e Princ Vidit. Një qëndrim i tillë do të përshëndetet edhe nga përfaqësuesit e Elbasanit duke e konsideruar një veprim të tillë të motivuar për hir të interesave kombëtare dhe si akt të lartë atdhetarie.

Në shkurt të vitit 1914 Dervish Biçaku do t’i kërkonte KNK largimin e Aqif Pashës nga posti i Mytesarifit të Elbasanit, në këmbim të premtimit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë. Në seancën e shtatëdhjetë të KNK, të mbajtur në 2 mars 1914 do të vendoset zëvendësimi i Aqif Pashës me Burhanedin Efendi Libohovën në cilësinë e prefektit të ri të Elbasanit. Ndërkohë, që veprimtaria e Aqif Pashës jo vetëm nuk do të ndërpritet por do të vijojë edhe në kuadrin e qeverisjes së Shqipërisë nga Princ Vidi.

#### **IV. 4. Arsimi në Elbasan në vitet 1912-1913.**

Në kuadrin e përpjekjeve për krijimin e shtetit shqiptar, një ndër objektivat më kryesore të Qeverisë së Vlorës që do të jetë edhe çështja e arsimit, duke e konsideruar atë si një problem mjaft delikat dhe të rëndësishëm për kohën. Për këtë problem, në vitin 1913 Ministri i Arsimit

---

<sup>762</sup> A.Q.H. i R.P.SH. F. 71, D. 5, Dok. Nr. 14,029, kopje, përkthim nga turqishtja, në *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 326. Letra mban datën 18 janar 1914.

Luigj Gurakuqi do të shprehej se: “Çështja e arsimit ka një randësi kryesore në rilindjen e Kombit Shqiptar, pse vetëm më një lirim të shëndoshë e me një arësim të vërtetë mund të ngjallet e mund të mëkambet kombi ynë e mund të fitojë të drejtën me hymun në rradhë të popujvet të qytetnuem”.<sup>763</sup>

Por duhet thënë se, trashëgimia që kishte lënë sundimi osman në arsimin shqiptar e vështirësonte edhe më shumë zgjidhjen e këtij problemi. Pas shpalljes së “Hyrjetit” në vitin 1908 u bënë përpjekjet maksimale nga patriotët shqiptarë në hapjen e shkollave të para në gjuhën shqipe, për futjen e gjuhës shqipe në shkollat e huaja dhe organizimin e kongreseve mbarë kombëtare për çështjen e alfabetit dhe mbarëvajtjen e shkollave shqipe etj. Një veprimtari e tillë, që do të përballej edhe me mjaft vështirësi dhe pengesa konsiderohej mjaft e rëndësishme për kohën, por nuk ishte e mjaftueshme. Kështu, në kohën e shpalljes së Pavarësisë në Shqipëri shkollat shqipe ishin të pakta në krahasim me shkollat e huaja shumica e të cilave punonin me programe fetare<sup>764</sup>.

Në këtë kuadër, duhet thënë se edhe pas shpalljes së Pavarësisë pengesat në arritjen e objektivave më kryesore në funksion të zhvillimit të arsimit në Shqipëri akoma ishin prezentë. Qeveria e Vlorës në muajt e parë të qeverisjes së saj administronte një territor të kufizuar, ndërkohë që pjesa më e madhe e trevave veriore dhe jugore qëndronin të pushtuara nga ushtritë e shteteve ballkanike. Një situatë e tillë, e vështirësonte akoma e më shumë organizimin e arsimit në Shqipëri, niveli i të cilit konsiderohej në standarde mjaft të ulëta, sikurse shprehej dhe Ministri i Arsimit, Luigj Gurakuqi në 6 shtator 1913 në faqet e gazetës “Përlindja e Shqipniës” : “Megjithë këtë nuk ka ndonji degë tjetër në të cilën Shqipnia të jetë ma e varfër se në degën e arësimit”.<sup>765</sup> Pavarësisht një situatë të tillë, nuk do të mungojnë përpjekjet e Ministrisë së Arsimit në funksion të zbatimit të një një programi arsimor me një pikësypnim të qartë, krijimin e një sistemi arsimor mbi baza kombëtare.

Kështu, në gusht të vitit 1913, Mihal Grameno do të deklaronte se Ministria e Arsimit po përgatiste programet për hapjen e tri shkollave normale.<sup>766</sup> Deklarata që ai bënte në faqet e gazetës zyrtare të Qeverisë së Vlorës se, Shqipëria do të qeverisej në gjuhën shqipe përbënte

---

<sup>763</sup> Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912 -22 janar 1914), vepër e cituar, 175.

“Përlindja e Shqipniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, Vit’i I. Nr. 8, dt. 6 shtator 1913.

<sup>764</sup> Historia e Popullit Shqiptar, vëll. III, vepër e cituar, 44.

<sup>765</sup> Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ..., vepër e cituar, 175. Gazeta “Përlindja e Shqipniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, Vit’i I. Nr. 8, dt. 6 shtator 1913

<sup>766</sup> “Përlindja e Shqipniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, Vit’I, Nr. 5, dt. 27 gusht 1913.

njëkohësisht edhe thirrjen drejtuar shqiptarëve për t'ju përkushtuar me të gjitha energjitë mësimin dhe shkrimit të gjuhës shqipe. Një thirrje e tillë i drejtohej veçanërisht nëpunësve në administratën ekzistuese duke u kërkuar: “ ... të vrapojnë të mësojnë gjuhën shipe në duan të mbajnë vëndet që kanë”<sup>767</sup>. Në qarkoren e shpallur nga Ministria e Arsimit shpallej programi për hapjen e shkollave të vogla fillore nëpër të gjithë vendin, duke deklaruar se një shkollë normale ishte gati të hapet në shtator të vitit 1913<sup>768</sup>.

Një akt i rëndësishëm i Qeverisë së Vlorës në 13 shtator të vitit 1913 do të rezultojë vendimi për njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare e vendit. Përmes një vendimi të tillë i bëhej me dije të gjithë atyre që kishin një farë arsimit dhe që kishin njohuri në shkrimin edhe leximin e shqipes, për të paraqitur kërkesat e tyre për punësim në administratë<sup>769</sup>. Një njoftim i tillë shërbente edhe si paralajmërim për administratën ekzistuese, që si kriter bazë për vazhdimësinë e punësimit do të ishin njohuritë që ata kishin në shkrimin e shqipes, duke u testuar nëpërmjet provimeve për njohuritë që zotëronin në shkrimin dhe leximin e shqipes por gjithashtu edhe në lëndë të tjera<sup>770</sup>. Ndërkaq, një vendim i tillë do të shoqërohet me një urdhëresë të Ministrisë së Arsimit, përmes së cilës njoftohej gjithashtu edhe koha e hapjes së shkollave fillore në të gjithë vendin, duke përcaktuar si afat kohor datën 16 të vjeshtës së parë dhe duke e shoqëruar me vendimin e frekuentimit të detyrueshëm rre tyre. Në faqet e shtypit të kohës informohemi gjithashtu edhe për kriteret e parashtruara nga Ministria e Arsimit, për hapjen e shkollave të tjera[private]. Kështu, si kriter kryesor për hapjen e tyre do të konsiderohej përdorimi i gjuhës shqipe në këto shkolla si mjeti mësimi. Në këtë kuadër mendojmë se vendimi për përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë kryesore në shkolla, më së shumti synonte reduktimin e shkollave të huaja që vepronin në këtë kohë në Shqipëri dhe që financoheshin nga të huajt. Një fakt i tillë gjen shprehje edhe në pohimin e Ismail Qemalit në shtator 1913 i cili shprehej se: “*Shqipëria do të bëjë çmos për të organizuar arsimin mbi baza kombëtare në të gjithë vendin*”.<sup>771</sup> Ndërkohë Ministria e Arsimit do t'i kushtojë një rëndësi të posaçme programeve me të cilat këto shkolla do

---

<sup>767</sup> Po aty, 21 gusht 1913.

<sup>768</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 176

<sup>769</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 40.

<sup>770</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 179-180.

<sup>771</sup> Hysni Myzyri, *Shkolla Normale ...*, vepër e cituar, 292.

të punonin, teksteve mësimore që do të përdornin dhe gjithashtu edhe diplomave të mësuesve që do të jepnin mësim në to.<sup>772</sup>

Në projektet për organizimin e arsimit në Shqipëri, Qeveria e Vlorës do të mbështetej në disa parime, që do të synonin të krijonin premisat e favorshme për krijimin e një sistemi arsimor me frymë kombëtare dhe laike.<sup>773</sup> Me iniciativën e Luigj Gurakuqit, do të ngrihet një komision që do të trajtonte dhe pasqyronte terminologjinë e gjuhës shqipe në të gjitha degët e administratës. Në nëntor 1913 u vendos të krijohet edhe një qendër shkencore për studimin e gjuhës shqipe të programeve e të teksteve shkollore.

Në kuadrin e organizimit të procesit mësimor, Ministria e Arsimit u kujdes për fillimin e vitit mësimor 1913-1914. Gjatë kësaj periudhe, në qytete dhe në fshatra u hapën rreth 64 shkolla shqipe, në programin e të cilave nuk rezultonin lëndë fetare<sup>774</sup>.

Sikurse e kemi përmendur, në Elbasan pas shpalljes së Hyrjetit u hap e para shkollë shqipe në 2 gusht 1908 nga Fejz Guranjaku. Si godinë e kësaj shkolle fillimisht u përdor godina e shkollës fillore që ai drejtonte në ish depon e kripës. Më pas, në 25 nëntor 1912 kjo shkollë u vendos në një godinë që ishte ngritur në bedenat e hyrjes lindore të kalasë së Elbasanit me nismën e Aqif Pashës dhe ndihmat e popullit të Elbasanit dhe u quajt shkolla “Qendrore”. Pranë saj kishte edhe një depo ushtarake, prandaj ndryshe kjo shkollë njihej edhe me emrin shkolla e Debojës. Në vitin shkollor 1913-1914, për mungesë godine ajo do të funksionojë në shtëpinë e Hashim Hakanit<sup>775</sup>. Sot kjo shkollë pavarësisht lëvizjeve që pësoi njihet me emrin “Naim Frashëri”.

Një shkollë tjetër, u hap në godinën treqindvjeçare të Medresesë, në vjeshtë të vitit 1913. Fillimisht shkolla njihej me emrin shkolla e “Qoshes” ndërsa më vonë me emrin “Agimi”.<sup>776</sup>

Në 22 nëntor 1913 në lagjen “Shën Koll” u hap një shkollë shqipe në strehën e kishës së kësaj lagjeje. Shkolla në fjalë kishte rreth 35 nxënës me drejtor Vasil Llapushin.<sup>777</sup> Sot kjo shkollë njihet me emrin “Ali Agjahu”.

---

<sup>772</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...*, vepër e cituar, 180. Urdhëresa mban datën 31 gusht 1913.

<sup>773</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, vepër e cituar, 44.

<sup>774</sup> Po aty, 45.

<sup>775</sup> Elbasani –Enciklopedi, vepër e cituar, 539.

<sup>776</sup> Po aty

<sup>777</sup> Po aty, 538.

Pas shpalljes së Pavarësisë një shkollë tjetër ka funksionuar në mesin ku gjendet sot shkolla “Kostandin Kristoforidhi”. Në të mësonin fëmijët e dy komuniteteve fetare në Elbasan myslimanë e të krishterë<sup>778</sup>.

Gjithashtu, në faqet e gazetës “Liri e Shqipërisë” pasqyrohet hapja në Elbasan e një shkolle nate në dhjetor të vitit 1913. Kjo shkollë frekuentohej më së shumti sikurse thuhej “... nga djelmosha dhe burra që kanë dëshirë të mos mbesin më pas se nga ata që janë më të lumtur dhe kanë mësuar të shkruajnë e të këndojnë”<sup>779</sup>. Gjithashtu, sipas informacionit të dërguar nga korrespondenti i Elbasanit Emin Matraxhiu, informohemi se ishte planifikuar edhe organizimi i konferencave sikurse thuhej: “... javë për javë mbi cilësitë e jetës”, ndërkohë mësuesit që jepnin mësim në të do të paguheshin nga komisioni i arsimit<sup>780</sup>.

Në faqet e gazetës “Përlindja e Shqipëniës” informohemi për ekzistencën në Elbasan edhe të një shkolle për vajza, që sipas informacionit të marrë do të mbyllet në dhjetor të vitit 1913. Arsyeja e mbylljes së kësaj shkolle shpjegohet me faktin se ndërtesa e godinës së shkollës do të përdorej nga xhandarmëria. Pikërisht, shqetësimi i drejtuesve të arsimit në Elbasan për një veprim të tillë do të pasqyrohet në kërkesën e drejtorit të arsimit të Elbasanit drejtuar organeve përkatëse për hapjen e shkollës së vajzave<sup>781</sup>.

Por në këtë periudhë në Elbasan sikurse edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë në shkollat fillore ndjehej mungesa e mësuesve shqiptarë. Përmes ankesës së mitropolitit të Durrësit në shtator të vitit 1913, informohemi se gjatë vitit 1913 prefekti i Elbasanit ia kishte dyfishuar rrogën mësuesve që jepnin mësim në shkollat fetare sikurse thuhej: ‘... vetëm për të dhënë mësim në shkollat shqipe të Elbasanit’<sup>782</sup>.

Kështu, nevoja të ngutshme për mësues konstatoheshin veçanërisht në zonat përreth Elbasanit, si në Qukës, Bërzeshtë etj. Kështu, burimet e kohës flasin në favor të faktit se drejtori i arsimit të Elbasanit, në dhjetor të vitit 1913 do të dërgojë si mësues në Rrajcë të Qukësit Xhaferr Velicanin. Gjithashtu një shkollë shqipe ishte hapur edhe në Belësh, me mësues Bedri Bejtjen.

Ndërkaq, evidentohet edhe veprimtaria e Qazim Matraxhiut në cilësinë e “Primarit” të Qukësit i cili u përpoq për hapjen e shkollave shqipe edhe në zonat më të thella të trevës së

---

<sup>778</sup> Po aty, 542.

<sup>779</sup> “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 24 dhjetor 1913. Hapja e shkollës së natës njoftohet edhe në gazetën “Përlindja e Shqipëniës” (në datë një të Shent-Andreut), 27 dhjetor 1913.

<sup>780</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Vit’I, Nr. 32, dt. 27 dhjetor 1913.

<sup>781</sup> Po aty, 20 dhjetor 1913.

<sup>782</sup> Mentar Belegu, “Aqif pashë Elbasani dhe Kongresi i Lushnjës”, material depozituar në AME

Elbasanit<sup>783</sup>. Po në të njëjtin burim informohemi se në këtë kohë në Elbasan po bëheshin përpjekje për hapjen e një shoqërie të rinjsh.

Në këtë kontekst, Ministria e Arsimit do të vendosë edhe hapjen në çdo prefekturë që ajo administronte të shkollave normale gatitore, që do të kishin formën e kurseve përgatitore disa mujore, rezultat i të cilave do të ishte përgatitja e mësuesve çdo katër muaj të aftë për të dhënë mësim në shkollat fillore<sup>784</sup>.

Në këtë kuadër, duhet thënë se përpjekjet për rihapjen e Normales së Elbasanit kishin filluar që në vitin 1912. Me përfundimin e kryengritjes së vitit 1912, Hasan Prishtina në njoftimin që i dërgonte Elbasanit për pranimin e kërkesave të përmbledhur në 14 pikat, i bënte të ditur patriotëve elbasanas se në veçanti do të përpiqej për hapjen e Normales<sup>785</sup>.

Por zhvillimet politike të brendshme pas shpalljes së Pavarësisë e bënë të pamundur hapjen e shkollës Normale për vitin mësimor 1912-1913. Kështu, në kuadrin e kërkesave emergjente për mësues e një rëndësie të veçantë do të konsiderohej edhe hapja e Normales në Elbasan. Pikërisht në këtë kohë në trevën e Elbasanit numëroheshin 11 shkolla fillore, nga të cilat 3 në qytet dhe 8 në fshatra. Për duhet thënë se për vetë nevojat që shtronte arsimit në atë periudhë këto shkolla më së shumti do të funksiononin si kurse mësimi të gjuhës shqipe. Nxënësit që u pranuan, duke qenë se kursi do të zgjaste vetëm një vit, duhet të plotësonin disa kritere pranimi, ndër të cilët pranoheshin edhe ato nxënës që kishin frekuentuar apo mbaruar edhe më përpara ndonjë shkollë tjetër<sup>786</sup>.

Kështu, në kuadrin e masave që do të ndërmarrë Ministria e Arsimit nën drejtimin e Luigj Gurakuqit, në shtator të vitit do të rihapet shkolla Normale, drejtor i së cilës do të jetë Aleksandër Xhuvani.<sup>787</sup> Kjo shkollë do të kishte një klasë përgatitore me 70 nxënës me një kurs një vjeçar. Në 27 shtator 1913 si mësues në këtë shkollë do të emërohet Sali Ceka, i sapo diplomuar në Institutin Pedagogjik 2 vjeçar në Bezanson të Francës. Gjatë vitit mësimor 1913-1914 ai do të japë tri lëndë të rëndësishme; lëndën e pedagogjisë, psikologjisë dhe logjikës<sup>788</sup>.

Futja e lëndëve të tilla në vitin mësimor 1913-1914 mendojmë se më së shumti synonte formimin e nxënësve të kësaj shkolle jo vetën në aspektin shkencor por gjithashtu edhe në

---

<sup>783</sup> Po aty,

<sup>784</sup> Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, vepër e cituar, 293.

<sup>785</sup> AQSH, Fondi. Lef Nosi, Dos. 132, fl. 705.

<sup>786</sup> Sul Dedej “*Shkolla Normale e Elbasanit vatër e edukimit politik e revolucionar*”, në “*Arsimi popullor*”, Tiranë: 1971, nr.3, 141.

<sup>787</sup> *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Tiranë: 2003, 282-283.

<sup>788</sup> *Në Panteon drejt Panteonit*, Elbasan: 2000, 192.



aspektin psiko-pedagogjik, në funksion të formimit të nxënësve me njohuri të përgjithshme të një niveli të tillë, që sapo të mbaronin Normalen të ishin të aftë në procesin e mësimdhënies. Gjithashtu si mësues të Normales në këtë kohë do të jenë edhe Josif Haxhimina që do të japë matematikë dhe Simon Shuteriqi që do të japë gjuhën shqipe.

Ndërkohë, drejtorisë arsimore të Elbasanit ju ngarkua detyra dhe përgjegjësia nga Qeveria e Vlorës dhe posaçërisht nga Ministria e Arsimit, për hartimin e programeve të shkollave fillore tre dhe pesë klasëshe, që u bë dhe me pjesëmarrjen e stafit pedagogjik të shkollës Normale<sup>789</sup>. Një përgjegjësi e tillë për Elbasanin do të përfaqësojë njëkohësisht edhe vlerësimin dhe besimin që Ministria e Arsimit dhe Qeveria e Vlorës kishte për intelektualët e këtij qyteti.

Por akoma pa përfunduar viti shkollor 1913-1914, shkolla Normale do të mbyllet përsëri në maj të vitit 1914, tashmë jo më nga xhonturqit por nga rebelët dhe “dumbabistët” e Haxhi Qamilit. Pavarësisht një fakti të tillë duhet thënë se Normalja që në vitet e para të funksionimit të saj dhe në vijimësi përgatiti breza të tërë arsimtarësh të pajisur me njohuri shkencore dhe pedagogjike, krijoi dhe nxorri një brez të tërë mësuesish dhe intelektualësh që u shndërruan në misionarë të arsimit jo vetëm në Elbasan por në mbarë trevat shqiptare. Për më tepër, vetë Normalja ishte produkt i përfutur nga mendimi intelektual, iluminist dhe idealist i dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XX.

---

<sup>789</sup> “Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj ...”, vepër e cituar, 175. Thirrje e Ministrit të Arsimit, 6 shtator 1913.

## **PËRFUNDIME**

Faktet, ngjarjet e situatat e krijuara në fund të shek. XIX e në fillimet e shek. XX në trevën e Elbasanit do të ofrojnë një panoramë mjaft interesante, që është shprehje e një realiteti të krijuar dhe të parapërgatitur. Ky realitet do të shfaqet qartë përmes kristalizimit të disa tipareve kryesore ku më të rëndësishmet për t'u përmendur janë:

- Duke kaluar nga fundi i shek. XIX drejt shek. XX, lëvizja kombëtare në trevën e Elbasanit shënon kalimin nga faza e një lëvizjeje me karakter spontan por me një qëllim dhe objektiv konkret, në koherencë me lëvizjen kombëtare shqiptare, drejt një lëvizjeje me karakter organizativ, e cila formësohet dhe shfaqet në kufij hapësinorë brenda dhe jashtë kësaj treve. Kontributi i kësaj treve është prezent pothuajse në të gjithë ngjarjet më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të përfshira në hapësirën kohore që trajton ky punim madje shpeshherë duke u vënë në krye të tyre.

- Në vitet '70 të shek. XIX, Lëvizja Kombëtare Shqiptare do të shënojë një fazë ngritjeje që kulmon me krijimin e Lidhjes së Prizrenit, që përfaqëson një moment të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar dhe njëkohësisht një ngjarje me përmasa mbarëkombëtare. Pavarësisht pozicionit gjeografik të trevës së Elbasanit larg zonës së zhvillimit të ngjarjeve më kryesore në kuadrin e Lidhjes së Prizrenit, interferimi i trevës së Elbasanit nëpërmjet krijimit të strukturave përkatëse të saj në këtë trevë, do të jetë prezent dhe i njëkohshëm duke përcaktuar njëkohësisht edhe rolin ndërmjetës të degës së lidhjes së Elbasanit midis degëve të veriut dhe atyre të jugut.

- Gjatë kësaj periudhe në Elbasan filloi të krijohet e të shfaqet qartë një mjedis intelektual, i cili në këtë kontekst kohor evidentohet shumëplanësh dhe multidimensional. Një tregues i tillë gjen shprehjen e vet nëpërmjet konfirmimeve të burimeve vendase, të huaja dhe njëkohësisht të bashkëkohësve që e kanë jetuar atë periudhë. Një mjedis i tillë do të gjejë shprehjen e vet përmes krijimit të vlerave patriotike, kulturore dhe qytetare në këtë qytet, jo vetëm nëpërmjet veprimtarisë së përfaqësuesve të shtresave konservatore feudale por me parime demokratike dhe përparimtare, por dhe më tej përmes kristalizimit të asaj shtrese të re sociale që ishte produkt i zhvillimeve të reja kapitaliste që përfshinë trevën e Elbasanit në fundin e shek. XIX dhe fillim të shek. XX.

- Mjedi social në Elbasan evidentoi gjatë kësaj periudhe elemente të qytetërimit, duke shfaqur përpjekjet e para për të krijuar marrëdhënie të reja, në themel të të cilave qëndronin normat e këtij qytetërimi. Shprehje e qartë e këtij qytetërimi gjatë kësaj periudhe cilësohet edhe ngritja dhe vlerësimi në majat më të larta i vlerave kulturore, por dhe i idhujve intelektualë të këtij qyteti. Mjedi intelektual dhe arsimor në Elbasan gjen një pasqyrim të gjerë në aspektin e prezantimit të këaj treve nëpërmjet krijimit të klubeve, shoqërive arsimore, bandave muzikore të cilat jo vetëm rezultojnë të shumtë, por me vlera të mëdha do të konsiderohet aktiviteti i tyre gjithëpërfshirës; kulturor, arsimor, politik e patriotik që nëpërmjet pasqyrimit dhe dokumentimit nga burimet e kohës rezultonte tepër aktiv dhe shumëplanësh.

- Në kuadrin e jetës politike, arsimore e kulturore në Elbasan shfaqen elementë me karakter demokratik, që shprehen qartë në një përfaqësim gjithëpërfshirës të shtresave sociale me përkatësi të ndryshme fetare në klube dhe shoqëri patriotike që u krijuan në këtë qytet pas shpalljes së "Hyrjetit". Përcaktimi i drejtuesve të këtyre klubeve dhe shoqërive, kalonte përmes një procesi zgjedhor të drejtë, që realizohej duke respektuar dhe zbatuar normat më demokratike

të shoqërisë . Një proces i tillë sikurse në qytetet e tjera edhe në Elbasan nuk kaloi pa vështirësi, për më tepër që në jo pak raste krijimi i klubeve apo hapja e gazetave rezultoi si nisma individuale, apo lokale. Porse, klubet dhe shoqëritë patriotike në Elbasan do të shndërroheshin në mjedise kulturore dhe intelektuale, në të cilat natyrshëm do të shfaqeshin rryma dhe korrente të ndryshme politike, arsimore apo dhe fetare, përplasje dhe luftë konceptesh dhe interesash që ishin mëse evidente. Pikërisht, në një mjedis të tillë intelektual një situatë e tillë duhet thënë se është mëse e pranueshme dhe shprehje e qartë e tipareve me karakter demokratik dhe qytetërues.

- Por duhet thënë se këto divergjenca bëheshin më se konfliktuale në momente të veçanta, nëpërmjet instrumentalizimit që u bëhej pjesës më fanatike të popullsisë së trevës së Elbasanit pikërisht nga xhonturqit. Kështu, pas vitit 1908 lëvizja politike dhe arsimore do të zhvillohej në kushte të reja të legalitetit, por duke vazhduar të përballet me taktikat e reja të vetë xhonturqve që u përpoqën me të gjithë mënyrat për të siguruar kontrollin e Lëvizjes patriotike shqiptare pse jo dhe drejtimin e saj. Xhonturqit nuk do të hiqnin dorë nga strategjitë dhe metoda të sofistikuara për ta penguar dhe ngadalësuar hovin që kishte marrë veçanërisht lëvizja arsimore pas vitit 1908, duke përdorur dasitë fetare, divergjenca social - politike, çështjen e alfabetit etj.

Në funksion të realizimit të një strategjie të tillë, xhonturqit do të krijonin një rrjet të gjerë klubesh xhonturke me synim frenimin dhe kontrollin e klubeve shqiptare pse jo dhe në shumë raste edhe mbylljen e tyre, apo organizimin e mitingjeve në favor të alfabetit me shkronja arabe etj. Një situatë e tillë rezultoi prezent në vitet 1909-1910 në trevën e Elbasanit nëpërmjet ekzistencës së dy klubeve xhonturke.

- Institucionalizimi i mjedisit arsimor në Elbasan gjen shprehje në funksionimin e mjaft shkollave dhe kurseve në gjuhën shqipe menjëherë pas shpalljes së “Hyrjetit”. Një mjedis i tillë kulmon me krijimin e Shkollës Normale, një institucion arsimor mbarëkombëtar me një kontribut të pazëvendësueshëm në fushën arsimit në gjysmën e parë të shek. XX dhe në vijimësi.

- Mjedisi intelektual në Elbasan do të evidentohet dukshëm nga prania dhe veprimtaria e korifenjve të arsimit dhe të dijeve, por njëkohësisht dhe nga veprimtaria e intelektualë të tjerë, kontributi i të cilëve krijoi themele të shëndosha dhe të qëndrueshme në këtë periudhë e në vazhdimësi. Veprimtaria e tyre nuk u zhvillua në kushte komode, por çau përmes sakrificave e rreziqeve të paparashikuara. Ky mjedis që mban emrin e Kristoforidhit, Aleksandër Xhuvanit, Simon Shuteriqit, Aqif Pashës, Petër Dodbibës, Dervish Biçakut, Shefqet Daiut, Josif

Haxhimimës, Fejzullah Guranjakut e shumë të tjerë, do të rezultojë për kohën dhe në vazhdimësi mjaft produktiv në krijimin e një plejade të tërë intelektualësh të rinj me përmasa kombëtare.

Kështu, përmasat e një aktiviteti të tillë do ta shndërrojnë Elbasanin në këto vite në qendrën e shqiptarizmit në funksion të formësimit të një identiteti kombëtar shqiptar. Ky është një pohim që nuk lind thjesht nga entuziazmi qytetar por nga studimi dhe analiza e materialeve, fakteve dhe dukurive të shumta që e mundësuan këtë kontribut dhe e përvijuan këtë traditë, jehona e së cilës u ndje jo vetëm në plan kombëtar, por edhe më gjerë.

- Ndërkaq, në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XX duke parë karakterin masiv dhe të organizuar që po merrte lëvizja kombëtare në trevat shqiptare, xhonturqit nuk do të ngurojnë të përdorin edhe ekspeditat ndëshkuese që do të organizoheshin qëllimisht për të krijuar situata terrori dhe frike me synim mbylljen e klubeve, shoqërive dhe të shkollave në gjuhën shqipe. Rezultat i një ekspedite të tillë të ndërmarrë në vitin 1910 pothuajse në të gjithë qytetet shqiptare do të jetë edhe mbyllja e Shkollës Normale në Elbasan.

- Por zhvillimi dhe synimet e politikës xhonturke në këtë kontekst të ri do të shërbejnë si një katalizator në precipitimin e një situatë të re në trevat shqiptare që do të shoqërohet me organizimin e lëvizjeve dhe kryengritjeve nëpërmjet të cilave lëvizja politike do të njohë një periudhë evoluimi drejt përmbushjes së qëllimeve më fundamentale të saj krijimit të një vilajeti shqiptar pse jo dhe të një shteti të pavarur shqiptar.

- Kryengritjet e mëdha shqiptare të viteve 1911-1912 dhe veçanërisht ajo e vitit 1912, e cila pa dyshim zë një vend qendror kurrsesi nuk mund të linin jashtë përfshirjes në to edhe trevën e Elbasanit. Ajo që të bie në sy në pamje të parë është fakti i sinkronizimit të lëvizjes politike në trevën e Elbasanit me atë të qendrës kryengritëse, duke krijuar premisat dhe duke krijuar shtegun e duhur drejt pavarësisë. Fakti që parësia e qytetit të Elbasani u shpreh fillimisht në mbështetje të aktit të pavarësisë nuk ishte diçka e rastit. Pavarësia me të vërtetë erdhi si domosdoshmëri politike, por në të njëjtën kohë konsiderohej edhe si një domosdoshmëri shpirtërore, ndërkohë që në popullsinë e trevës së Elbasanit tashmë ishte formuar një ndërgjegje politike e tillë që ishte e vetëdijshme për detyrat e të drejtat e saj dhe e vendosur për t'i fituar e mbajtur ato me çdo kusht. Për më tepër, në këtë kohë në Elbasan ekzistonte një rreth patriotik i tillë që me në krye Aqif Pashën kishin kohë që ishin frymëzuar nga një patriotizëm i flaktë dhe një besim i patundur ndaj triumfit të çështjes shqiptare.

Por çështja më e debatueshme jo vetëm në këtë punim shkencor, por ndoshta edhe për studiuesit dhe historianët elbasanas ka të bëjë me ngritjen e flamurit dhe shpalljen e pavarësisë në qytetin e Elbasanit, problem ky që në kuadrin e rishkrimit të historisë së Shqipërisë duhet vendosur në kontekstin e duhur. Në këtë kuadër, brenda mundësive që të lejon një punim i tillë kemi parashtruar një tezë të re që dokumenton shpalljen e pavarësisë dhe ngritjen e flamurit në Elbasan në 28 nëntor 1912 dhe jo në 25 nëntor 1912 sikurse është paraqitur deri më sot në historiografinë shqiptare.

- Ndërkohë, Elbasani ka dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm nëpërmjet përfaqësimit të figurave patriotike të kësaj treve në Kuvendin e Vlorës. Qeveria e dalë nga kuvendi i Vlorës kishte në përbërje të saj edhe Lef Nosin si ministër i Postë-telegrafëve, Shefqet Daiun si shkronjës të dytë, Ahmet Daklin si këshilltar në Ministrinë e Financës, Qemal Karaosmanin si kryekëshilltar i Ismail Qemalit dhe ministër në qeverinë e tij në muajt e fundit të vitit 1913

- Për më tepër kontributi i patriotëve elbasanas do të jetë evident më së shumti pas shpalljes së pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar nën Qeverinë e Vlorës, për faktin se kjo trevë do të përbëjë barrierën më të fortë kundrejt përpjekjeve separatiste të Esad Pashë Toptanit, ku nuk ngurojmë të pohojmë, duke u shndërruar në një ndër faktorët vendimtarë të vetë ekzistencës së Qeverisë së Vlorës përgjatë vitit 1913.

Në këtë kuadër, për periudhën që kemi marrë në studim duhet thënë se si veprimtarë aktivë në role drejtuese të strukturave organizative politike dhe arsimore në trevën e Elbasanit, pavarësisht përkatësisë sociale të tyre do të rezultojnë përfaqësues të familjeve të mëdha feudale të kësaj treve, sikurse ishin: Isuf bej Biçaku - Dervish bej Biçaku; Mahmud Pashë Biçaku - Aqif Pashë Biçaku; Shahzivar bej Karaosmani - Qemal bej Karaosmani; Ismail bej Vërlaci - Shefqet bej Vërlaci, Irfan Ohri nipi i Aqif Pashës etj. Ndërkohë, që përmes dokumentacionit përkatës profilizimi i disa prej këtyre figurave të shquara do të shfaqet në raport me qëndrimet që ato do të mbajnë në momente decizive të historisë. Kështu, sikurse kemi evidentuar kontributin e Dervish Biçakut në çështjen arsimi në trevën e Elbasanit kemi pasqyruar edhe qëndrimin e tij në kuadrin e organizimit të një lëvizjeje me karakter fetar në favor të një princi mysliman por me synime të qarta politike. Në këtë kuadër mendojmë se kjo lëvizje që do të marrë përmasat e një kryengritjeje, do të shënojë edhe fillimet e kryengritjes së “dumbabistëve” që do të përfshijë trevën e Elbasanit dhe Shqipërinë e Mesme në kohën e qeverisjes së Princ Vidit. Gjithashtu, sikurse kemi

evidentuar mbështetjen që Qemal Bej Karaosmani do ti japë Ismail Qemalit, gjithashtu kemi përmendur edhe faktin tjetër që i ati i tij Shahzivar bej Karaosmani konsiderohet i përfshirë në ngjarjen e arrestimit të Abdyl Frashërit.

Sikurse kemi vlerësuar kontributin e Mahmud Biçakut në vitet 1879-1880, ashtu kemi pasqyruar edhe rolin e Aqif Pashës veçanërisht në ngjarjet e viteve 1912-1914, i cili në momente të tilla të historisë diti të bëjë zgjedhjet e duhura duke u pozicionuar përkrah atyre patriotëve që jo vetëm kontribuuan, por bënë sakrifica sublime për çështjen shqiptare. Kontributi i tij sikurse e kemi parashtruar gjatë punimit rezulton shumë planesh; në përpjekjet e tij për zgjerimin e shtrirjes së autoritetit të Qeverisë së Vlorës në vitet 1912-1913, në nismën për ngritjen e gjykatores në Elbasan dhe vendosjen e jurisë (pavarësisht se për mjedisin shqiptar të kohës një nismë e tillë rezultonte e përshpejtuar), në organizimin e gjindarmërisë apo mbështetjen që i dha kryengritjes serbe të shtatorit të vitit 1913. Gjithashtu, gjatë viteve 1913-1914 Elbasani do të shndërrohet në një strehë për refugjatët e ardhur nga trevat që mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë. Duhet thënë, se përgjatë kësaj periudhe Aqif Pasha spikat si një figurë e rëndësishme politike me përmasa kombëtare por dhe më gjerë. Ndërkohë, duke ju referuar dokumentacionit vendas dhe të huaj për periudhën 1912-1913, figurën e Aqif Pashës e kemi parë edhe me dritë hijet që shfaqen në personalitetin e tij. Në një kontekst të tillë natyrshëm lind një pyetje që ka të bëjë me faktin se cila ishte ambicia më e madhe politike e Aqif Pashë në vitet 1912-1914?

Duke analizuar thellësisht dokumentacionin përkatës që pasqyron një problematikë të tillë, konstatojmë se në vitet 1912-1914 Aqif Pasha nuk e braktis për asnjë moment Elbasanin edhe në momentet më kritike kur dhe vetë jeta e Pashës rrezikohej seriozisht nga bandat e Dervish Biçakut. Në këtë kuadër pohojmë se ndër ambiciet politike të Aqif Pashës përfshihej më së shumti shpallja e Elbasanit kryeqendër e Shqipërisë. Porse rruga që Pasha do të zgjedhë në funksion të përmbushjes së një synimi të tillë do të jetë përmes qëndrimit bashkëpunues me Qeverinë e Vlorës dhe jo konfrontimit me të. Për më tepër, në formulimin e një teze të tillë mbështetemi edhe në premtimin që Ismail Qemalit i kishte bërë në nëntor 1913, për transferimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës në Elbasan, me synim shpalljen e Elbasanit kryeqytet të Shqipërisë. Një premtim i pa mbajtur nga Ismail Qemali, pavarësisht insistimit dhe presionit të drejtpërdrejt të Pashës në muajt e fundit të qeverisjes së Qeverisë së Vlorës. Por, në të njëjtën kohë pohojmë se në figurën e Aqif Pashës ndjenja patriotike ishte dominante në raport me ambiciet e tij politike.

Gjithashtu, evidente në zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1909-1913 do të jetë edhe kontributi që dhanë misionarët protestantë sikurse ishin; Erichson Telford, Fineas Kenedy, në funksion të përpjekjeve për mësimin e shqipes, apo zonjat Cilka dhe Qiriazhi. Duhet thënë se roli dhe kontributi i tyre për shumë arsye nuk është pasqyruar sa duhet në historiografinë e para viteve '90, qw shfaqet jo vetëm në kontributin humanitar në mbështetje dhe ndihmë të refugjatëve që gjendeshin në Elbasan në vitin 1913 por edhe në lidhje me ngjarje të tjera historike sikurse do të ishte përfaqësimi i misionarisë amerikane në Kongresin e Manastirit apo dhe Kongresin e Elbasanit. Ndërkohë, veprimtaria e tyre në Elbasan do të jetë evidente edhe në fushën e arsimit përgjatë vitit 1913. Në këtë kuadër, duhet thënë që për shkak të vetë kushteve të vështira në të cilat e ushtroi veprimtarinë e saj Qeveria e Vlorës dhe pavarësisht përpjekjeve të ndërmarra prej saj, duhet thënë se niveli i arsimit në këtë kohë në Elbasan nuk do të rezultojë fort i kënaqshëm, për faktin se edhe ato pak shkolla në gjuhën shqipe që ekzistonin më së shumti funksiononin si kurse përgatitore dhe kishin karakter të përkohshëm. Ndërkaq, një situatë e tillë shprehej përmes faktit se edhe mjedisi kulturor i qytetit të Elbasanit në këtë kohë rezultonte i varfër, ku evidentohesh mungesa e klubeve apo shoqërive kulturore të cilat më parë kishin qenë prezentë në këtë qytet.



## **BIBLIOGRAFIA**

### **I. Burimet arkivore**

#### **A. Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, (AQSH):**

- Fondi. “Lef Nosi”, nr. 32
- Fondi. “Aqif Pashë Biçaku”, nr. 68
- Fondi. “Dervish Biçaku”
- Fondi. “K. Kristoforidhi”
- Fondi. “Klubet dhe shoqëritë patriotike”, nr. 102
- Fondi “Klubi Bashkimi i Manastirit”
- Fondi, “Luigj Gurakuqi”
- Fondi “Jani Vruho”

B. Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë. Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vjenës, HH  
ST PA:

C. AME (Arkivi i muzeut Etnografik Elbasan).

D. Arkivi i bibliotekës së Elbasanit. Fondi i Albanologjisë

### **II. Dokumente të botuara, artikuj, kumtesa**

- Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912), Tiranë: 1978.
- Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Tiranë: 1972.
- Historia e Arsimit dhe Mendimit Pedagogjik Shqiptar, Vëll. 1, Tiranë: 2003.
- *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28 nëntor 1912-22 janar 1914)*, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Tiranë: 8 nëntori, 1963.
- Kryengritjet popullore në vitet 30 të shekullit XIX, dokumente osmane, përgatitur për botim nga Petrika Thëngjilli, botim i Institutit të Historisë, Tiranë: Shtypshkronja e Re, 1978.

- *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze (1878-1881)*, përpunuar nga Skënder Rizaj, Prishtinë: 1978.
- *Mendimi politik e shoqëror i lëvizjes kombëtare shqiptare*, Vëll. II, Tiranë: 8 nëntori, 1976.
- *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, dokumente arkivore franceze, përgatitur nga Ligor Mile, vëll. II, botim i Institutit të Historisë, Tiranë: Shtypshkronja e Re, 1986.
- Lef Nosi, *Dokumente historike 1912-1918*, përgatiti për botim Instituti i Historisë, Tiranë: Nënë Tereza, 2007.
- *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, Vëll.I, përgatiti Valentina Duka, Tiranë: Botimet Toena, 2012.
- *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, Vëll.II, përgatiti Valentina Duka, Tiranë: Botimet Toena, 2012
- *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëll. II, përgatitur nga Ferit Duka, Dritan Egro, Sokol Gjermani. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012.
- *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëll. III, përgatitur nga Hamit Kaba, Beqir Meta. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012.
- *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëll. IV, përgatitur nga Ana Lalaj, Eriketa Kambo, Sonila Boci. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012.
- *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëll. V, përgatitur nga Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Fatmira Musaj. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012.
- *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëll. VI, përgatitur nga Marenglen Verli, Ledia Dushku. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012.
- *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëll.II, përgatitur nga Muhamet Shatri. Tiranë: Botimet Toena, 2012.
- *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913*, përgatitur nga Muhamet Shatri. Tiranë: Botimet Toena, 2012.
- AIH, dokumente të Komitetit të Manastirit, dt. 21. 4. 1906.
- Studime Historike, nr 1-2, Tiranë: 2004.
- Studime Filologjike, nr. 1, 3, Tiranë: 8 nëntori, 1974.
- Belegu, Xh. *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë: 1939
- Dedej, S. Xhepa, Xh. Buletini Shkencor, Shkodër: 1975.
- Demiri, Sh. “*Aqif pashë Biçaku biografi e shkurtër*”, dorëshkrim në muzeun historik, Elbasan.

- Demiri, SH. “*Elbasani, qendër e Lëvizjes Kombëtare*”. Sesione, depozituar në muzeun historik, Elbasan.
- Demiri, Sh. “*Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*”. Materiale depozituar në muzeun historik, Elbasan.
- Domi, M. “*Të dhëna mbi lëvizjen arsimore e kulturore në trevën e Elbasanit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shekullit tonë*”. Buletini Shkencor, Shkodër: 1975.
- Domi, M. Alfabeti i gjuhës dhqipe dhe Kongresi i Manastirit, Tiranë: 8 nëntori, 1972.
- Haxhiu, A. “*Hasan Prishtina*”, Tiranë: 8 nëntori 1964.
- Osmani, T. Udha e Shkronjave Shqipe, Shkodër: 1999.
- Puto, A. *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëll. I*, Tiranë: 8 nëntori, 1984.
- Puto, A. *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëll. II*, Tiranë: 8 nëntori, 1987.
- Puto, A. *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: 8 nëntori, 1978.
- Puto, A. *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009.
- Prifti, K. *Kryengritja antiserbe e shtatorit të vitit 1913 dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës*, Shkup: 1993.
- Haxhimihali, T. *Aleks Buda Kujtime*, Tiranë: 2005
- Kaleshi, H. *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll*, materjal depozituar në AME.
- Katundi, Goni. *Kujtime nga Lëvizja për Çlirim Kombëtar*, Tiranë: 1962.
- Mitko, Thimi. *Vepra*, Tiranë: 1981.
- *Lufta për çlirim kombëtar në vitet 1787-1912*. Kujtime veteranësh, material depozituar në I. S. H-GJ, Tiranë, 1962.
- Musai, K. “*Popullsia e rrethit të Gramshit në luftë për pavarësi*. Material i depozituar në muzeun historik, Elbasan.
- Nikolaidou, E. *Kriptokristianët e Shpatit*, Arkivi i Etnografisë Janinë: 1979.
- Nosi, L. “*Dokumente historike*”, Elbasan: 1924.
- *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, (28 nëntor 1912 – 22 janar 1914)*, Tiranë: 8 nëntori, 1963.

- *Rregullore e shoqërisë "Afërdita"*, Elbasan, 2-15 maj 1909.
- Plangarica, T. *"Mjedisi intelektual në qytetin e Elbasanit në prag të Shpalljes së Pavarësisë"*. Botuar në Normalja në Traditë, Elbasan: 1995
- Varoshi, L. *Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 dhe veçoritë e saj në trevën e Elbasanit*. Botuar në "Normalja në traditë", Elbasan: 1995.
- Varoshi, L. *Vështrim i përgjithshëm mbi punimet e Kongresit Kombëtar të Elbasanit*. Botuar në "Normalja në traditë", Elbasan: 1995.
- Vendimet e Kongresit të Dibrës, Manastir, 1909.
- Shabani, Fejzulla. *Aspekte të Kryengritjes së Shtatorit*, në "Jehona", Nr. 6, Shkup: 1993.
- Shpuza, Gazmend. *Kryengritja e shtatorit 1913 dhe lufta politike në Shqipëri*, Shkup: 1993.

### **III. Periodikë**

- Gazeta "Bashkimi", nr. 3, Stamboll, 1908.
- Gazeta "*Bashkimi i Kombit*" nr. 1, shtator 1909
- Gazeta "*Bashkimi i Kombit*" nr. 15, 17 dimëror 1909.
- Gazeta "Drita", Sofje, 1907.
- Gazeta "Dielli", 25 mars 1910
- Gazeta "Dielli", 3 shtator 1909.
- Gazeta "Dielli", 8 gusht 1912.
- Gazeta "Dielli", 1 tetor 1909.
- Gazeta "Kalendari Kombiar", Sofje, 1909.
- Gazeta "Korça", Korçë 1909.
- Gazeta "Kombi", nr. 43, Boston, qershor, 1907
- Gazeta "Shqypeja e Shqypënis", nr 17, Sofje, 1910
- Gazeta "Lidhja Ortodokse", Korçë 1910.
- Gazeta "Lirija", Selanik 1908-1910.
- Gazeta "Lirija", Selanik, 12 vjeshtë e parë 1909.
- Gazeta "Mësuesi", 1 shtator 1984.
- Gazeta "Tomorri", Elbasan, 1910.
- Gazeta "Përlindja e Shqypniës" 1913, Organ zyrtar i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës
- Gazeta "*Zgjim i Shqipërisë*", Janinë, 1909.

- “*Dokumenta Historike për t’I shërbye Historiës tonë Kombëtare*”, Elbasan, 1924.
- Revista shkencore “Jehona”, Shkup, Nova Makedonija, 1993.
- Gazeta “Shqipëria”, Magaga(Egjypt0, Nr. 5, 15 qershor 1907.
- Gazeta “Shpnesa e Shqypënisë”, Raguzë, nr. 9, 22 maj 1907.
- *L’Italia all’estero*, Roma, 1920 vjeshtë e parë, nr.18.
- “*La nazione Albanese*”, Catanzaro, 1909
- Revista “*Normalisti*”, Botimi i shkollës Pedagogjike Elbasan, viti 1959.

#### **IV. Tekste, monografi**

- Bevapi, K. *Hulumtime Etnologjike*, Elbasan: Sejko, 2007.
- Boletini, Tafil. *Pranë Isa Boletinit, kujtime (1892-1916)*, Tetovë: 1996.
- Clayer, N. *Në fillimet e Nacionalizmit shqiptar, Lindja e një kombi me shumicë mmuslimane në Europë*, Tiranë: “Përpyjekja”, 2009.
- Duka, Valentina. *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: “Kristalina-KH”, 2007.
- Duka, Valentna. *Çështje të Historisë Bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë: 2008.
- Dedej, S. *Abedin Çausi në gjurmët e traditës elbasanase*. Elbasan: 1999.
- Durham, E. *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë: Argeta – LMG, 2001.
- Durham, E. *Brenga e Ballkanit*, Tiranë: Argeta, 1998.
- *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan: Sejko, 2004.
- *Elbasani-Enciklopedi, Normalja në fokus të bashkëkohësisë*. Elbasan: Silver, 1999.
- *Elbasan-Enciklopedi, Në Panteon drejt Panteonit*. Elbasan: Silver, 2000.
- Erickson, Telford. vëll. II, Tiranë: Edualba, 2002.
- Frashëri, K. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881*. Tiranë: 8 nëntori, 1989.
- Frashëri, K. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881*. Tiranë: Press, 2012.
- Frashëri, K. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912*, Tiranë: “Kristalina – KH”, 2008.
- Frashëri, S. “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*”, Tiranë: Naim Frashëri, 1962.
- *Historia e Shqipërisë*. Vëllimi II, Tiranë: 1965.
- *Historia e Popullit Shqiptar*. Vëllimi II, III, Tiranë: 2007.
- Hoxha, I. *Nëpër udhën e penës shqiptare*. Tiranë, 1986.

- Osmani, T. *Udha e Shkronjave shqipe*, Shkodër: 1999.
- Poincare, Raymond. *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike, si dhe Konferenca e Londrës 1912-1913*, përkthyer nga Shaqir Shehu, Shkup, Prishtinë, Tiranë: 2006,
- *Kujtime veteranësh, Elbasani në luftë për çlirim*. Tiranë: 1962.
- Jacob Gould Schurman, *Luftërat Ballkanike 1912-1913*, përkthyer nga Taulant Hatia, botimi i tretë, Tiranë: 2006.
- Jacques, E. *Shqiptarët*, vëll. II, Tiranë: Kartë dhe Pendë, 1995.
- Lloshi, Xhevat, *Rreth alfabetit të shqipes*, Shkup/Prishtinë/Tiranë: Logos, 2008,
- Myzyri, H. *Shkollat e para kombëtare shqipe*, I.S.P, Tiranë: 8 nëntori, 1973.
- Myzyri, H. *Shkolla Normale e Elbasanit*. Tiranë: AlbPAPER, 2004.
- Milo, Paskal. *Politika e jashtme e shtetit shqiptar*, vëll. I, Tiranë: 2013.
- Musai, K. *Aqif pashë Elbasani, figurë e ndritur e kombit shqiptar*. Tiranë: 2002.
- Prifti, K. *Dr. Ibrahim Temo*. Prishtinë, 1996.
- Salliu, I. *Peqini*. Durrës, 2005.
- Skëndi, S. *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, Tiranë: Phoenix 2000.
- Swire, Joseph. *Shqipëria, Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria 2005.
- Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Neraida, 2000.
- Vlora, Ismail Qemal. *Kujtime*, Tiranë: Toena, 1996.

numeri  
8010 6  
1078/11

III / 47

25 nëndor 1912

Populli i Elbasanit pranon independencën

(telegram nga Elbasani)

Shk. së Tijë Ismail Qemal Beut

Vlonë

Gjithë populli ynë, myslimanë e të krishtenë, me një zë kanë pranuar independencën e Shqipërisë.

U'emën të të gjithë popullit të prefekturës  
s'Elbasanit:

Haxhi Hafëz Sulejman Kungulli, zav. mitrop. Papa Dhimitër Dhimitruka, Aqif Bashë Biçakçiu, Shevqet Bej Vërlaci, Hasan Bej Biçakçiu, Abdulla Bej Tirana, Fuad Bej Kahreman Beu, Servet Bej Zylfi, Ismail Bej Xhelalyddin Beu, Ali Agjah Bej Adil Beu, Malic Bej Riza Beu, Demir Bej Sulçe Beu, Refik Myftiu, Sheh Mahmud Guma, Sheh Xhaferr Pasmagja, Sheh Hysen Sulova, Kryetari i Bashkisë Rushdi Alush Saraçi, Papa Benjamin Deliana, Benjamin Nosi, Taq Buda, Kol Papajani, Lazër Papajani, Serafin Jorgaqi, Haxhi Nikolla Jorgaqi, Mihal Prifti, Dhimitër Peparisto, Emin Haxhiaden Shjeku, Rrapush Demeti, Mehmet Hakani, Hysejn Dakli, Jusuf Bej Taushani, Hasan Çifte, Ymer Peni, Hysejn Hastopalli, Demir Zenelhxha.

O. T. Fjalini në Zyrën Telegrafike  
ndërmjet Vlonës e Elbasanit  
15 Vjeshta e Tretë 1328-1912  
.....ora e .....

Vlona – Tyke qenë se Durrsi me gjithë ndënprefekturat u a  
komunikoi konsujvet zyrtarisht shpalljen e Independencës, na  
nën keq qi ju pritni të shtyme prej këndëi për ngritjen e flamurit.  
Ngrini-e sa mâ shpejt. Mbë një anë i dërgoni ushtëriës serbe  
komision të posaçëm e më tjetrët anë flamurin nuk e ngrini. Si  
të bëhet kjo punë?

Kongresi edhe nuk ka fillue. Ndashti do të hapet. Vendimet do  
të njoftohen veçanërisht.

Lef Nosi, Shefqet Daiu

Elbasani – Ndashti po e ngremë. Qeverria e Përkohshme  
angref, edhe milica uformue e nisi nga puna.

Mahmud Nedim, Hasan Osmanai

Vlona – Fort mirë. Kryetar i Qeverriës kush usgjoth?

Shefqet Daiu, Lef Nosi

Elbasani – Shkëlqesia e Tija Aqif Pasha.

Mahmud Nedim, Hasan Osmanai

\*\*\*



A. Q. H. i R.P.SH. F.71, D.1, Dok. Nr.723/9, kopje turqisht, telegrafuar nga Ohri, përkthim.

Nr. 15

*Bisedim telefonik midis Vlorës dhe Elbasanit mbi ngritjen e flamurit dhe Shpalljen e Pavarësisë në Elbasan.*

15 nëndor 1328

28 nëndor 1912

Vlora — Duke qenë se Durrësi me gjithë nënprefekturat u komunikoi konsujvet zyrtarisht Shpalljen e Pavarësisë, na vien keq që ju pritni nxitje prej këndeje për ngritjen e flamurit. Ngrijeni sa më shpejt. Me një anë i dërgoni ushtërisë serbe komision të posaçëm e më anë tjetër flamurin nuk po e ngrini. Si bëhet kjo punë?

Kuvëndi akoma nuk ka filluar. Tashti do të hapet.

Vendimet do t'ju njoftohen veçanërisht.

Elbasani — Tashti po e ngrëmë. Qeveria e përkohëshme u ngre dhe milicia u formua e filloi nga puna.

Vlora — Shumë mirë. Kryetar i Qeverisë kush u zgjodh?

Elbasani — Shkëlqesia e Tij Aqif Pasha.

Nr. 16

*Proces-verbal i mbledhjes së parë të Kuvendit Kombëtar në Vlorë, ku u vendos Shpallja e Pavarësisë Kombëtare të Shqipërisë.*

15 nëndor 1328

28 nëndor 1912

Mbledhja e parë e Kuvendit Kombëtar të Përgjithshëm 15/28 të Vjeshtës së tretë 1912.

31

Nr. 19

*Telegram i Kryetarit të Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, Ismail Qemalit, drejtuar kryesisë së bashkisë së Elbasanit dhe parësisë së vëndit, me anën e të cilit i lajmëron se Kuvëndi i Vlorës Shpalli Pavarësinë e Shqipërisë, u ngrit Flamuri Kombëtar dhe u krijua Qeveria e Përkohëshme nën kryesinë e tij.*

15 nëndor 1328

28 nëndor 1912

Sot u çel Kuvëndi edhe vendosi të Shpallë Pavarësinë e Shqipërisë, që është rruga e shpëtimit tonë. U ngrit Flamuri dhe Kuvëndi më ngarkoi mua kryesinë e Qeverisë së Përkohëshme që do të formohet. Pra, lutemi, të shpallet edhe atje e nëpër rrethe pavarësia dhe përpiquni për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë së vëndit.

Ismail Qemali

A. Q. H. i R.P.SH., F. 71, D. 1, Dok. Nr. 723/19, kopje turqisht, telegrafuar nga Vlora, përkthim.

ora 1e 25 e natës

Nr. 6

Telegram i parësisë Elbasanit, drejtuar Ismail Qemalit në Vlorë me anën e të cilit e njoftojnë se populli i Elbasanit e pranoi Shpalljen e Pavarësisë.

12 nëndor 1328

25 nëndor 1912

Gjithë populli ynë, musliman e i krishterë, unanimitisht pranoi pavarësinë e Shqipërisë \*).

A.Q.H. i R.P.SH., F. 71, D. 1, Dok. Nr. 428, origjinal.  
përkthim nga turqishtja.

Nr. 7091 Fjalë 62 O. T.

Tiranë, 13 Vjeshta e Tretë 1328-1912

3.40 ora e natës

Shefqet Beut e Haxhi Ali Efendiut

Elbasan

Dodhemi në një gjendje të mjerushme. Ju aty ç'farë masash keni marrë? Po ndëgjojmë se keni shpallë independencën. Vallë mund të përfitohet prej këti vepërimi, po qe i vërtetë; dhe a munt t' a sigurojë vendin, qi ka ngelun pa mprojtje, nga shkelja e anmikut, i cili munt edhe të vijë?

Ju drejtohem i emën të të gjithë popullit të dishpruem, qi të na e rrëfeni punën gjân' e gjatë e të përfitojmë edhe ne.

Presim përgjigjën tuej në Zyrët Telegrafike.

N' emën të Popullit  
**Refik Bej Toptani**  
**Myslim Agë Beshiri**

\*\*\*

Nr..... Fjalë 34 O. T.

Tiranë, 13 Vjeshta e Tretë 1328-1912

..... ora e .....

Refik Beut e Myslim Agës

Tiranë

Populli i Elbasanit, myslimanë e të krishtenë me një zâ i upërgjegj Ismail Qemal Beut se e pranon ftimin e tija edhe u-dërguan përfaqësuesit. Ashtu edhe përfaqësuesit e Shqipniës së Sipërme shkuan për Vlonë.

Shefqet Bej Vërlaci

\*\*\*

Nr..... Fjalë ..... O. T.

Ohër, 15 Vjeshta e Tretë 1328-1912

4.40 ora e natës

Kryesiës së Bashkiës

Elbasan

N'i udorëzofshi edhe ju ushtëriës serbe si i udorëzua Dibra edhe n'i dhânçi armët të gjitha, ju ap fjalën se do t'ju sigurohet çdo gjã; domethanë: feja, pasunia, jeta e qetësia e juej. N'është se ju çoheni me përdorë armë kundër nesh, nuk ka me ju dalë mirë edhe dini-e të sigurtë, se po shtyreni në të keqet të pasuniës e të jetës tuej.

Përgjigjën tuej e pres në zyrët telegrafike.

Komandanti Serb  
Gjeneral Metoviç

\* \* \*

O. T. Fjalim në Zyrat Telegrafike

ndërmjet t'Ohrit e Elbasanit

njoftue Vlonës

15 Vjeshta e Tretë 1328-1912

.....ora e .....

Ohri – Elbasani do t'i dorëzohet ushtëriës serbe apo jo?

Elbasani – Kush po e kërkon këtë?

Ohri – Pashai Serb gjeneral Metoviç-i.

Elbasani – Elbasani shpalli Independencën n'emën të Shqipniës, ngriti flamurin edhe Turqit i përzuni krejt. Këtu ndashti është formue një Qeverrië Shqiptare e Përkohshme e cila ka fillue nga detyra. T'a lajmojmë kryetarin e Qeverriës edhe Komisionin apo jo? Sepse këtu në zyrët telegrafike nuk ka njiri.

Elbasani Vlonës – Pas kësaj përgjigje, Selim Efendiu telegrafisti i Ohrit qi po korespondonte me ne, tha këto fjalë: "Këtë

Qamil Musa Haxhi Fijaz, nga lagja Alacolin e Elbasanit, 27 vjeç, shtetas otoman, simbol kenneres dhe detillearates qe ka paraqitur, në baze të ligjer shtypit, është lejuar të botojë në Elbasan, si pronar dhe drejtor përgjigjes, një gazetë të përjavëshme me titullin "Elbasani" në turqisht edhe shqip, e cila, simbol përmbajtjes të deklaratis për mendim, do të shërbejë kushtetutes dhe interesave të përgjithëshme, me botime politike, ekonomike dhe kulturore.

I lëshohet ky vartetim.

1326 (=1910) Vula Zyrtare  
Lirivaja e Elbasanit

شروطه و فن و مخبره متاثيره خادم و سياسى لا تقدره و عليه يمتد اذنه و ليحياهم خلافته و بقره اوردوه بقره  
اوله و هم ايدى انه بقره شريفه بيان مراتب ايدى و هم ايدى و در و حله ايدى و هم ايدى  
ثانيه و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى  
ثالثه و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى و هم ايدى

٤٤٣



Dëshmi mbi lejimin e Qamil Musa Haxhifezës  
për të botuar një gazetë shqip turqisht  
të titulluar "Elbasani"  
(1910)


nr. 250.  
af shtypshkroje urand  
arrish Hina  
umien e punen Sht  
nje med ete t'a  
shku gjithë afa  
In lutem pra  
je utra mend  
ni për gjithë p  
edhe regani  
e udgushken  
a të dy kllku  
mu i cili do të  
tigrisht në për  
evaja.  
Zoruk 1000

Marrë nga botimi i A.Q.SH. Ekspozitë Elbasani në 100 vjetorin e shtetit shqiptar.

N. 388

131/83

z. nis Pretorit t' Elbasanit.



Bojif Pashajt.

105.509

Elbasan.

Ministoria e Drejtësisë mer nderim t' ugo-  
 je Kënaqësiat esaj për shërbimet q' i keni bënë  
 degës drejtësisë pa vjesht e pa u. lotë, dhe ca ma fort  
 për shërbimet e fundit në pikëpamjen e fillimit të  
 zburisë për të parën herë në gjykatariën t' Elbasanit  
 për të cilën repër emri juaj do kujtohet bres pas bre-  
 zë në historiën e Drejtësisë së Shqipërisë.

Me nder.

Ministri i Drejtësisë -

Popar

M/ve 15/12/1913

## *I nderçmi sot,*

*Me gëzim ju lajmërojmë se të dytën ditë të Majit u-ngref këtu në qytet l' one një shoqni me emnin „Afërdita“.*

*Shoqnia pas Rregullores, sajë ka ndër mend m' e përbëmun sot për sot një Bandë Muzikore „Afërdita“ ene pas ca kohe si l' i shtohet pasja n' atë shkallë që duhet një Stervëllore të trupit bashkë me një Shëjëlore. Aht' e dilme që puntat e mëdha lypin ene ndifma të shumta.*

*Andaj pra ju lutemi nxëhtë që të shtrini dorën' e l' i jepni shpirt një pune me rëndësi që ka për qëllim qytetënimin e një populli i cili ka jetumun kaqi shekuj në barbarim e padie.*

*Me shpresë se ndifma e zotënisë juajë do të na vijë me kohë.*


*Mbetemi me nder:*

**Kryetari: Lef Nosi.**

**Shkronjësi: Dhimitër Deliana.**

Styyp, "Bashkim" i Kombit, Manastir

**Njoftim mbi krijimin e Shoqërisë Muzikore  
Fiskulturore "Afërdita" në Elbasan**



Leje dhënë Lef Nosit për të botuar gazetën "Tomori" (1910)

Marrë nga botimi i A.Q.SH. Ekspozitë Elbasani në 100 vjetorin e shtetit shqiptar.



Çeta e Byshekut, ndër ta Ahmet Dakil (1911)



Çeta e Sadik Zharrit në Shpat (1911)



Qamil Biçaku, Dervish Biçaku, Ibrahim Dakli, Myftar Himçi,  
Reshit Skilja, Sul Haxhihyseni, Hasan Beu (1908)



Luftëtarë nga krahina e Elbasanit (1911)





**Takimi i gjeneralit Tomson me parinë e Elbasanit (1913)  
(mes tyre Lef Nosi, Ali Agjah Beu, Aqif Pasha, Emin Martaxhiu, Andon Beça, etj.)**

1807 12  
Vjeshtë e 3të 912 Shpallje për vetëqeverimin  
e Shqipërisë.

25-11-1711

Etja gjindja e Elbasanit për ndonjë shkri-  
mim të paktësi ose të brendëshmi, po nga de-  
shiri i ynë i lirë bashkë me të gjithë qytetet e Shqi-  
përisë po i bëjmë të diturë gjithë botës se qytet  
termarë se sot shpallim vëlter të një fare të shkri-  
turë nga mbretëria Ottomane tue u numëruar  
si një kompi i lirë, i cili me ndihmën e të Madh  
Lot Mbretërit të gjithë kombeve edhe me prijat  
i Liveriçit të Europës shpallim se do të qeveris-  
me ndëri, drejtësi, edhe me një pa anësi të plotë  
pa vënë në ndryshim feje ose dogme. Q' do  
Shqiptarë ose i huaj, ndëri këtë qeverie  
Shqiptare, do të mund të rrot liri shp  
dytë i gëruar të gjithë të drejtat njerëz-  
Edhe na kemi ndër mend të rrafmë vi-  
Zorishë edhe me qeverit fqinjëse, pa dashur  
t' u bëjmë as të të pa kin dashë, po duke iu lutur  
të na ndihmojnë në vetqeverimin tonë, sikur  
na ndihmë edhe në regjimin e qeverisë Ottomane.

Proftë Shqipëria e lirë.

Kështu e bëftë lotë!

Nga përfaqësorët e Elbasanit vërditë,  
të afërmen dytë vumë ndëri shkri-  
t' onë.